




Empowered lives.  
Resilient nations.



# PARANDALIMI I DHUNËS NDAJ GRAVE NË ZGJEDHJE:

*Udhëzues programimi*






# PARANDALIMI I DHUNËS NDAJ GRAVE NË ZGJEDHJE:

*Udhëzues programimi*



*Empowered lives.  
Resilient nations.*





# FALENDERIME

**AUTORE KRYESORE:**

Julie Ballington

**AUTORE KONTRIBUESE:**

Gabrielle Bardall Gabriella Borovsky

**GRAFIKA:**

Dammsavage Inc.

**REDAKTORE:**

Manuela Popovici

**SHTYPSHKRONJA:**

Lowe-Martin Company Inc.

**KOPERTINA:**

UN Photo/Logan Abassi

Ky raport përmban ide origjinale, sugjerime, përvoja dhe njohuri që shumë individë i kanë përvetësuar gjatë punës së tyre në fushën e pjesëmarrjes së grave në politikë, duke eliminuar dhunën ndaj grave dhe duke ofruar ndihmë zgjedhore.

Në fillim, ky botim u konceptua në kuadër të Programit Global të UNDP-së për Mbështetjen e Ciklit Zgjedhor (GPECS) dhe u realizua me mbështetjen e UN Women. Nuk do të ishte bërë i mundur pa kontributin e shumë personave që parashtruan ide për konceptin fillestar dhe tekstin e hartuar: Julie Ballington, Gabrielle Bardall, Hannah Cody, Aleida Ferreyra, Suki Beavers, Sonia Palmieri, Jennifer Piscopo dhe Jeff Fischer.

Ky tekst ka përfituar më tej nga rishikimet dhe komentet e disa personave, veçanërisht Marta Val dhe Juncal Plazaola Castaño. Personat e tjerë që kanë dhënë feedback-un e tyre përfshijnë: Irune Aguirrezabal Quijera, Donia Ben Romdane, Valentina Bianchini, Tonni Ann Brodber, Umutai Dauletova, Xenia Diaz, Lourdes Gonzalez, Tania Farha, Simon Finley, Jebbeh Foster, Tatyana Jiteneva, Emily Kenney, Begoña Lasagabaster, James Littleton, Alice Mauske, Niall McCann, Manuela Matzinger, Rose Mutayiza, Nielsen Perez, Sara Peitropaoli, Thomas Rossignol, Nika Saeedi, Elizabeth Salguero, Maureen Shonge, Ria Westergaard Pederson, Lea Zoric dhe kolegët në UNDP dhe Zyrat e Vendit të UN Women.


UNDP dhe UN Women janë veçanërisht mirënjohëse për pikëpamjet dhe inputet e vlefshme, që ofruan kolegët nga agjencitë e tjera të OKB-së dhe nga zyrat që janë pjesë e Mekanizmit Koordinues ndërmjet Agjencive të OKB-së për Asistencë Zgjedhore (ICMEA), veçanërisht Departamenti i Asistencës Zgjedhore për Çështjet Politike (EAD) dhe OHCHR.

Ky studim u mundësua falë kontributit të madh që Sida Suedi i ka bërë Kuadrit për një Partneritet Strategjik të Grave të UN Women.

ISBN: 978-1-63214-097-5  
© 2017 UN Women dhe UNDP. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

*Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorit (autorëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, UNDP, OKB-së ose organizatave të tjera.*

*Ky botim mund të përdoret lirisht për qëllime jokomerciale, për qëllime të drejta, duke shprehur falënderimet për UN Women dhe UNDP. Për çdo përdorim tjetër duhet të merret miratimi me shkrim nga UN Women pas kërkesës me shkrim për leje. Përdorimi i përbajtjes, në tërësi apo të një pjese të saj, në formë të shtypur apo në internet, duhet të përfshijë kontributin e UN Women dhe UNDP si botuesit origjinalë.*





# PARATHËNIE

Në mbarë botën, pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në politikë dhe mundësitë e grave për të udhëhequr në të gjitha nivelet vendimmarrëse njihen si kontribute kyçe për të pasur shoqëri me mirëqenie dhe qëndrueshmëri më të lartë, sipas Axhendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030. Në fakt ka pasur ecuri, pasi sot më shumë gra se kurrë mbajnë poste publike dhe angazhohen në procese zgjedhore, si pjesëtare të stafit, zgjedhëse, kandidatë ose pjesëmarrëse në fushatë. Me përfaqësim më të mirë dhe shprehjen e mendimeve të tyre, gratë arrijnë që të ngrenë profilin ose shqetësimet fizike mbi të drejtën për riprodhim dhe sigurinë fizike, krahas çështjeve sociale, si: kujdesi ndaj fëmijës, rroga e barabartë, leja prindërore dhe pensionet, si dhe çështje zhvillimi më të gjera, si: zbutja e varfërisë dhe ofrimi i shërbimeve.


Megjithatë, dhuna ndaj grave mbetet një nga sfidat më të mëdha për realizimin e të drejtave të grave në ditët e sotme. Ajo mund t'i zhveshë nga e drejta e votës në zgjedhje, duke pasur efekt mbi shoqëri që shumohen nga deficitet demokratik. Kjo është një problematikë që duhet të trajtohet nga politikëbërësit dhe praktikantët e spektrit politik. Së fundmi, mungesa e të dhënave dhe stigmatizimi i lidhur me dhunën me bazë gjinore kanë shkaktuar që dhuna ndaj grave në zgjedhje (DHNGZ) nuk merr vëmendjen e duhur në studime. Megjithatë, ajo është pengesë për gratë në çdo vend, që zmadhohet me diskriminimin me bazë racën, moshën, shtresën, aftësinë e kufizuar, arsimin, etninë dhe gjininë. Kjo përbën një shkelje që kërkon veprime për të matur, për t'iu përgjigjur dhe për ta parandaluar DHNGZ-në.

UN Women dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara e kanë hetuar në mënyrë aktive këtë dukuri botërore, kanë bashkëpunuar së bashku dhe me partnerë të tjerë për të thyer heshtjen mbi këtë problematikë reale, si dhe për të përparuar në këtë fushë të re të programimit kërkimor. Në këtë Udhëzues Programimi, do të ofrojmë një shqyrtim të gjithanshëm të informacioneve aktuale mbi DHNGZ-në, si dhe paraqesim përkufizimin e saj për të bashkërenduar dhe për të orientuar përpjekjet për parandalimin dhe zbutjen e saj në të ardhmen. Krahas kësaj, ne do të paraqesim edhe një vështrim të përgjithshëm mbi forma të caktuara të DHNGZ-së, duke përfshirë fushëveprimin, llojet, viktimat, dhunuesit dhe pasojat, si dhe do të parashtrojmë një sërë veprimesh që mund të ndërmerren në secilën fazë të ciklit zgjedhor.

Ky Udhëzues thekson shembujt tronditës të DHNGZ-së në mbarë botën, si dhe sugjeron masa risiprurëse për parandalimin dhe reagimin, që aktualisht janë në fazën e testimi. Udhëzuesi synon personat që ndodhen në pozicionet e duhura për të parandaluar dhe për të zbutur DHNGZ-në, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare dhe ata që ofrojnë mbështetje në programimin për asistencën zgjedhore, pjesëmarrjen e grave në politikë, monitorimin e të drejtave të njeriut dhe dhënien fund të dhunës ndaj grave. Do të shërbejë si burim për anëtarët e partive politike, sidomos për krerët e tyre, organizmat e menaxhimit të zgjedhjeve, organizatat e shoqërisë civile, grupet e grave dhe aktivistët për barazinë gjinore. Dhënia fund e dhunës ndaj grave në zgjedhje është përgjegjësi e të gjithë aktorëve në të gjitha nivelet e spektrit zgjedhor dhe politik, dhe krahas kësaj do të jetë shpërblyese për të gjithë.

Shpresojmë që të jetë një burim i dobishëm për praktikantët e fushës, dhe se duke nxitur ndërmarrjen e veprimeve për të zbutur DHNGZ-në në ciklin zgjedhor, do të krijojë një të ardhme me pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse të grave në zgjedhje dhe politikë, dhe shoqëri që janë më të afta për të arritur paqen dhe mirëqenien.

**PHUMZILE MLAMBO-NGCUKA**



**ACHIM STEINER**



# PASQYRA E LËNDËS

<b>SHKURTESA</b>	<b>8</b>
<b>HYRJE</b>	<b>10</b>
i.Vështrim i Përgjithshëm i Udhëzuesit	10
ii.Përse Duhet të Adresojmë DHNGZ-në?	11
iii.Kuadri Normativ	12
iv.Kuadri i Politikave të OKB-Së	15
<b>PJESA A: VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I DHNGZ-SË</b>	<b>19</b>
<b>1.SFIDAT E ADRESIMIT TË DHNGZ-SË</b>	<b>20</b>
<b>2.PËRKUFIZIMI</b>	<b>22</b>
2.1 Dhuna ndaj Grave	22
2.2 Dhuna në Zgjedhje	23
2.3 Dhuna ndaj Grave në Politikë dhe Zgjedhje	24
<b>3.LLOJET E DHNGZ-SË</b>	<b>26</b>
3.1 Dhuna Psikologjike	26
3.2 Dhuna Fizike	27
3.3 Dhuna Seksuale	29
<b>4.FUSHËVEPRIMI I DHNGZ-SË</b>	<b>31</b>
4.1 Të dhënat e disponueshme	31
4.2 Kush janë Viktimat e DHNGZ-së?	33
4.3 Kush janë Autorët e DHNGZ-së?	36
<b>5.SHKAQET DHE PASOJAT</b>	<b>43</b>
5.1 Përse ndodh DHNGZ-ja?	43
5.2 Cili është ndikimi i DHNGZ-së?	45
<b>PJESA B: NDËRMARRJA E VEPRIMEVE PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E DHNGZ-SË</b>	<b>46</b>
<b>PROPOZIMI 1</b>	
<b>HARTËZIMI DHE MATJA E DHNGZ-SË</b>	<b>51</b>
1.1 Hartëzimi i DHNGZ-së	
1.2 Përcaktimi i matësve të DHNGZ-së	55
1.3 Mundësitë për mbledhjen e të dhënave të DHNGZ-së nëpërmjet nismave ekzistuese	56
<b>PROPOZIMI 2</b>	
<b>INTEGRIMI I DHNGZ-SË NË VËZHGIMIN ZGJEDHOR DHE MONITORIMIN E DHUNËS</b>	<b>63</b>

2.1 Misionet e vëzhgimit zgjedhor	64
2.2 Vëzhgimi vendas dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm	64
2.3 Instrumentet e monitorimit të dhunës zgjedhore	66
2.4 Bordi i situatës së grave dhe parandalimi i konfliktit në zgjedhje	68
<b>PROPOZIMI 3</b>	
<b>REFORMA LIGJORE DHE POLITIKASH PËR PARANDALIMIN DHE REAGIMIN NDAJ DHNGZ-SË</b>	<b>70</b>
3.1 Përdorimi i Kuadrit Normativ ekzistues	70
3.2 Reforma ligjore në nivel kombëtar	74
3.3 Zbatimi i ligjeve	80
3.4 Protokollet e EMB-së për parandalim dhe zbatim	82
3.5 Kodet e Sjelljes të rregulluara me ligj	83
<b>PROPOZIMI 4</b>	
<b>PARANDALIMI DHE ZBUTJA E DHNGZ-SË NËPËRMJET RREGULLIMEVE ZGJEDHORE</b>	<b>85</b>
4.1 Matja e rrezikut dhe Hartëzimi i DHNGZ-së	86
4.2 Procedurat e regjistrimit të votuesve dhe kandidatëve	86
4.3 Periudha e fushatës politike	87
4.4 Trajnimi dhe mbulimi	87
4.5 Dita e votimit dhe Organizimi i Votimit	88
4.6 Puna me forcat e policisë dhe sigurisë	91
4.7 Periudha paszgjedhore	92
<b>PROPOZIMI 5</b>	
<b>PUNA ME PARTITË POLITIKE PËR PARANDALIMIN E DHNGZ-SË</b>	<b>94</b>
5.1 Zbatimi i kodeve të sjelljes	94
5.2 Adresimi i DHNGZ-së në rregulloret e brendshme të partisë dhe monitorimi i zbatimit të tyre	96
5.3 Parandalimi i DHNGZ-së gjatë proceseve të kandidimit	96
5.4 Financimi politik	97
5.5 Trajnimi dhe sensibilizimi ndaj DHNGZ -së	97
5.6 Përfshirja e DHNGZ -së në veprimtaritë e monitorimit të partisë	98
5.7 Përkrahja e grave të zgjedhura	99
<b>PROPOZIMI 6</b>	
<b>RITJIA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE NDRYSHIMI I NORMAVE</b>	<b>100</b>
6.1 Rritja e ndërgjegjësimit nëpërmjet fushatave	100
6.2 Puna me mediat	102
6.3 Angazhimi i ligjvënësve dhe rrjeteve parlamentare	103
6.4 Përfshirja e burrave dhe djemve në përpjekjet për parandalimin dhe reagimin ndaj DHNGZ-së	104
<b>REFERENCAT</b>	<b>106</b>

# SHKURTESA

ACOBOL	Shoqata e Këshilltareve në Bashki (Bolivi)
BRIDGE	Ndërtimi i Burimeve në Demokraci, Qeverisja dhe Zgjedhjet
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
CONAPRED	Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Eliminimin e Diskriminimit (Meksikë)
CPRW	Konventa për të Drejtat Politike të Grave
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
CSW	Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Statusin e Gruas
DMT	Departamenti i Mbështetjes në Terren
DÇP	Departamenti i Çështjeve Politike
DOPR	Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse
ECLAC	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Amerikën Latine dhe Karaibet
ECOSOC	Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara
OMZ	Organet për Menaxhimin e Zgjedhjeve
MVZ	Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
MRRZ	Menaxhimi i Rrezikut Zgjedhor
BE	Bashkimi Evropian
EVAW	Eliminimi i Dhunës ndaj Grave
EVER	Edukimi dhe Zgjdhja e Dhunës në Zgjedhje
SPH	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
GPECS	Programi Global i UNDP-së për Mbështetjen e Ciklit Zgjedhor
HRW	Monitori i të Drejtave të Njeriut
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IDASA	Instituti për Demokraci në Afrikë
IDEA	Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore
INE	Instituti Kombëtar Zgjedhor (Meksikë)
IPU	Unioni Ndërparlamentar



IRI	Instituti Ndërkombëtar Republikan
VA	Vëzhgues afatgjatë
D	Deputet
NCA	Asambleja Kombëtare Kushtetuese (Zimbabve)
NDI	Instituti Demokratik Kombëtar për Çështje Ndërkombëtare
OAS	Organizata e Shteteve Amerikane
OAU	Organizata e Unitetit Afrikan
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
POECI	Platforma e Organizatave të Shoqërisë Civile që Vëzhgojnë Zgjedhje (Bregu i Fildishtë)
RSS	Sistemi Rajonal i Mbikëqyrjes
SAARC	Shoqata e Azisë Jugore për Bashkëpunim Rajonal
SAP	Partneriteti i Azisë Jugore
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
MVP	Masa të veçanta të përkohshme
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UN DESA	Departamenti për Çështjet Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë
UNGA	Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
UNIFEM	Shihni UN Women
UNSC	Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
DHNG	Dhuna ndaj Grave
DHNGZ	Dhuna ndaj Grave në Zgjedhje
DHNGP	Dhuna ndaj Grave në Politikë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
WSR	Bordi i Situatës së Grave

# HYRJE

Sot, më shumë gra se kurrë më parë në histori mbajnë poste publike. Në vitin 2017, më shumë se 10,500 gra shërbenin si parlamentare kombëtare, një shifër kjo që përbënte mbi 23% të numrit të parlamentarëve në mbarë botën.<sup>1</sup> Miliona politike shërbejnë në nivelet nënkombëtare, dhe shumë kandidatë të tjera garojnë në çdo zgjedhje për poste politike. Krahas kësaj, në shumë vende numri i grave zgjedhëse është aq i lartë, saqë shpeshherë në Ditën e Zgjedhjeve është i barabartë me numrin e burrave zgjedhës. Një numër në rritje grash janë aktive në fushën e menaxhimit të zgjedhjeve, si staf në zgjedhje ose për sondazhe.

Pavarësisht kësaj ecurie motivuese, qëllimi ndërkombëtar për “ekuilibrin gjinor” në pozicionet publike, parashikuar në Platformën për Veprim të Pekinit 1995, kërkon ende kohë për t’u realizuar. Gratë vazhdojnë të përballen me sfida të shumta për të fituar pozicione në jetën politike dhe publike.<sup>2</sup> Një numër i vogël grash zgjidhen si guvernatore, kryebashkiake ose vendimmarrëse në nivelin vendor. Në vitin 2017, vetëm 16 vende kishin gra në krye të shtetit ose të qeverisë.<sup>3</sup>

Ndonëse pjesëmarrja e grave në politikë kufizohet nga një mori faktorësh, më alarmuese është rritja e dhunës ndaj grave (DHNG) në jetën politike. Disa persona mendojnë se prania më e madhe e grave në politikë bie në kundërshti me rolin gjinor tradicional të tyre, çka kërcënon marrëdhëniet tradicionale të pushtetit dhe statukuosë. Përfaqësimi më i madh i grave në politikë është shoqëruar me rritjen e dhunës ndaj grave në politikë (DHNGP), thuajse në mbarë botën. Kjo gjë shfaqet në forma të ndryshme, si:

përkallëzimi i ngacmimit dhe agresionit në mënyra të shumëllojshme, frikësimi dhe dhuna fizike dhe seksuale ndaj grave në jetën publike, detyrimi i politikanëve që të japin dorëheqjen, si dhe komentimi publik i pamjes së jashtme të kandidatëve, në vend të përvojës që kanë dhe politikave që propozojnë. Në formën më të skajshme të DHNGP-së, politikanet janë vrarë si pasojë e ushtrimit të të drejtave të tyre politike. Në ditët e sotme, DHNGP-ja mbetet një nga sfidat më të mëdha për realizimin e të drejtave politike të grave.<sup>4</sup>

Dhuna politike mund të shfaqet në shumë kontekste, por ka ndikime unike dhe negative mbi gratë gjatë periudhës zgjedhore. Tensioni politik dhe konkurrenca e egër gjatë zgjedhjeve mund ta bëjë të cenueshme pjesëmarrjen e grave në politikë, që në shumë raste është vetë e disavantazuar në krahasim me meshkujt, çka mund të shpjerë në përjashtimin e grave nga procesi.<sup>5</sup> Taktika, si: sulmi fizik, frikësimi dhe abuzimi psikologjik, i prekin edhe meshkujt edhe femrat, por ndikimi gjinor është i ndryshëm, si dhe disa forma të dhunës me bazë gjinore janë specifike për gratë.<sup>6</sup> Reagimi për parandalimin dhe zbutjen e dhunës politike gjatë zgjedhjeve duhet t’i pasqyrojë medoemos këto dimensione gjinore të rëndësishme.

## 1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I UDHËZUESIT

Ky Udhëzues kërkon të ndihmojë personat që punojnë për rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore dhe zbutjen e prevalencës së DHNGZ-së. Kërkon të identifikojë komponentët e saj specifike, duke përfshirë llojet, taktikat, viktimat dhe dhunuesit, si dhe ofron një

1. IPU, 2016. Baza e të dhënave PARLINE.; IPU dhe UN Women. 2017. Hartë e Grave në Politikë.

2. Shihni <http://www.undocs.org/en/E/CN.6/2015/3> dhe A/HRC/23/50

3. Përlogaritje e UN Women mbështetur mbi informacionet e dhëna nga Misioni i Përhershëm në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

4. Përshtatur nga UNW/Purna Sen, 2016. “Global Perspectives on Violence against Women in Politics.” (Pikëpamje Botërore mbi Dhunën ndaj Grave në Politikë.) Prezantim në Konferencën “#Not-TheCost: Stopping Violence against Women in Politics” (Jo Kostoja: Dhënia Fund e Dhunës ndaj Grave në Politikë), organizuar nga NDI, mars, Nju-Jork.

sërë mundësish për ta parandaluar dhe për ta zbutur DHNGZ-në mbështetur në praktikata e mira aktuale. Në këtë Udhëzues paraqiten disa praktika dhe mundësi aktuale, si dhe përgjigje programuese që mund të mbështetin ofruesit e asistencës teknike, si UNDP, UN Women dhe agjenci të tjera të OKB-së në punën e tyre. Krahas kësaj, ofrohen edhe shembuj të përkufizimeve dhe metodave nga të gjitha rajonet. Udhëzuesi nuk kërkon të përcaktojë një qasje specifike, por pranon faktin se problematikat dhe zgjidhjet do të ndryshojnë sipas kontekstit kombëtar të secilit vend. Ajo që mund të ketë funksionuar në një vend dhe në një periudhë të caktuar, mund të mos jetë e përshtatshme në të gjitha vendet, por mund të sjellë ide për veprime të tjera në një kontekst specifik.

Udhëzuesi përbëhet nga dy pjesë kryesore. Në pjesën A prezantohen konceptet bazë të DHNGZ-së dhe synohet përcaktimi i formave të saj dhe ilustrimi i viktimave dhe dhunuesve. Kjo pjesë kërkon të ofrojë një përkufizim gjinor të dhunës zgjedhore dhe identifikon veprimet që shënjestrojnë gratë në proceset zgjedhore. Pjesa B i kushtohet shqyrtimit të politikave dhe përgjigjeve programuese aktuale për zbutjen e DHNGZ-së. Duke u mbështetur në praktikata e mira aktuale, në Pjesën B ofrohen udhëzime për programimin dhe politikata, me propozime të hollësishme në mënyrë që politikëbërësit dhe praktikantët të arrijnë të identifikojnë, të parandalojnë dhe të reagojnë ndaj DHNGZ-së gjatë ciklit zgjedhor.

## 2. PËRSE DUHET TË ADRESOJMË DHNGZ-NË?

Zgjedhjet janë një instrument për të zgjedhur institucionet përfaqësuese dhe për të realizuar të drejtën e votës. Ato janë tërësisht politike dhe kyçe për zhvillimin demokratik, ndaj mbështetja e zgjedhjeve gjithëpërfshirëse është një element shumë i rëndësishëm në punën e qeverisjes.

Çdo vit, zgjedhjet kombëtare parlamentare zhvillohen mesatarisht në 40-55 vende. Gjatë proceseve zgjedhore, shpeshherë ekspozohen dallime sociale dhe politike, si

dhe rritet rreziku i dhunës. Ndonëse mund të shihen si instrument për të ndërmjetësuar konfliktin ideologjik midis palëve, zgjedhjet mund të nxisin lloje të ndryshme të dhunës, që ndonjëherë janë shkatërrimtare, duke shpjerë drejt çrregullimit të proceseve demokratike dhe të zhvillimit ekonomik dhe politik të vendit në tërësi. Në të vërtetë, konflikti zgjedhor mbetet pengesë e konsolidimit të institucioneve demokratike në shumë vende.<sup>7</sup> Nëse nuk zbatohen strategjitë dhe programimi për parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit, rreziku i proceseve zgjedhore shndërrohet në premisë për dhunën dhe frikësimin, ku konflikti përdoret si taktikë politike për të ndikuar te rezultati i zgjedhjeve, çka nga ana tjetër prek ligjshmërinë e qeverisë që vjen në pushtet.<sup>8</sup> Kjo lidhet në veçanti me vendet në konflikt ose në tranzicion, ndonëse dhuna në zgjedhje nuk kufizohet në këto kontekste.

Ndaj, DHNGZ-ja kërkon hetim dhe veprim. Natyra e rrezikshme e zgjedhjeve dhe mundësia për konflikt të dhunshëm mund të ketë pasoja të rënda mbi qytetarët e një vendi. Pavarësisht faktit që gratë përbëjnë thujse gjysmën e zgjedhësve të pranueshëm të një vendi, studimet dhe kërkimet mbi dhunën në zgjedhje as nuk janë përqendruar te gjinia dhe as nuk kanë marrë parasysh format, natyrën dhe pasojat e ndryshme të dhunës me të cilën përballen gratë në proceset politike dhe zgjedhore, në krahasim me burrat. DHNGZ-ja është veçanërisht rrënuese për gratë, pasi ndodh si pasojë e diskriminimit, normave dhe anësive të qenësishme sociale dhe kulturore. Efektet përbërëse të racës, moshës, shtresës, aftësisë së kufizuar,<sup>9</sup> arsimit, etnisë dhe gjinisë mund të krijojnë premisa për mbivendosjen e shtresave të diskriminimit dhe shënjestrimin e grave që të dhunohen në zgjedhje.

7. USAID, 2010. "Electoral Security Framework, Technical Guidance Handbook for Democracy and Governance Officers" (Kuadri i Sigurisë në Zgjedhje, Manual Udhëzues Teknik për Nënpunësit e Qeverisjes dhe Demokracisë). Korrik f. 2.

8. Po aty.

9. Sipas disa studimeve, është konstatuar se në krahasim me gratë pa aftësi të kufizuara, ato që kanë aftësi të kufizuara rrezikojnë më tepër dhe bien viktimë e një numri më të madh të shtresave të dhunës. Shihni Ingrid van der Heijden, Naeemah Abrahams & Jane Harries, 2016. "Additional Layers of Violence: The Intersections of Gender and Disability in the Violence Experiences of Women with Physical Disabilities in South Africa." (Shtresa Shtesë të Dhunës: Ndërthurja e Gjinisë dhe Aftësisë së Kufizuar në Dhunën e Përjetuar nga Gratë me Aftësi të Kufizuara në Afrikën e Jugut.) Buletini për Dhunën Ndërpersonale.

5. Përshtatur nga UNDP, 2012 Raport informues për Dhunën Politike ndaj Grave, përgatitur nga Jeff Fischer, i pabotuar.

6. Gabrielle Bardall/IFES, 2011. "Breaking the Mold: Understanding Gender and Electoral Violence Washington" (Le të Thejme Heshjen: Të Kuptojmë Dhunën Zgjedhore dhe Gjinore), Uashington, D.C., IFES. 7.

## SHQETËSIM PËR ZHVILLIMIN DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Tashmë njihet fakti që dhuna ndaj grave përbën shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të gruas, si dhe një problematikë për zhvillimin e qëndrueshëm, sikundër pasqyrohet në Axhendën për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, sidomos në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) 6 dhe 16.<sup>10</sup> Duke e ditur që adresimi i pandemisë së DHNG-së është kyç për zhvillimin e qëndrueshëm, për vite me radhë, UNDP-ja, UN Women dhe partnerët e tyre kanë punuar mbi këtë problematikë në nivelin botëror, rajonal dhe vendor, duke arritur rezultate konkrete në terren, si dhe duke nxjerrë mësim dhe praktika të mira. Megjithatë, ka ende punë për të bërë nga pikëpamja e matjes, raportimit, parandalimit dhe reagimit.

Ka shumë arsye për të njohur, për të përcaktuar, për të monitoruar, për të ndërjegjësuar, për të hartuar politika dhe për të programuar përgjigjen ndaj DHNGZ-së. Dhuna që prek të drejtën e çdo qytetari për të votuar, për të kandiduar ose për të shprehur apo për të mbrojtur mendimet dhe besimet e tij politike përbën shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në mbarë botën, dhuna ndaj grave dhe vajzave është një nga shkeljet më të përhapura të të drejtave të njeriut, ku 1 në 3 gra në botë bien viktimë e dhunës seksuale dhe/ose fizike nga partneri, ose e dhunës seksuale nga jopartneri, në jetën e tyre.<sup>11</sup> Në vendet në krizë ose pas krizës, shumë forma të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ), veçanërisht dhuna seksuale, vazhdojnë të jenë ndër shqetësimet më të mëdha dhe sfiduese për të drejtat e njeriut, sigurinë, shëndetin publik, rikuperimin dhe zhvillimin.<sup>12</sup> Dhuna ka një ndikim të dëmshëm mbi përparimin e vendit në tërësi dhe pengon arritjen e objektivave të barazisë, zhvillimit dhe paqes.<sup>13</sup>

Krahas kësaj, në mbarë botën, gratë janë të nënpërfaqësuar në postet publike dhe dhuna politike përbën një pengesë madhore. Përjashtimi i grave në praktikë do të thotë që frenohet zhvillimi demokratik. Sipas kërkimeve, përfshirja e grave në politikë ngre çështje të reja në axhendën politike, veçanërisht kur gratë “theksojnë problematika sociale, si: kujdesi ndaj fëmijës, paga e barabartë, leja prindërore dhe pensionet; shqetësime fizike, duke përfshirë të drejtën për riprodhim, sigurinë fizike dhe dhunën me bazë gjinore; dhe zhvillimin, që përfshin zhvillimin njerëzor, zbutjen e varfërisë dhe ofrimin e shërbimeve.”<sup>14</sup> Përfshirja e grave në proceset vendimmarrëse i përmirëson ato, si dhe garanton që pjesëmarrja e tyre kontribuon në barazinë gjinore, demokracinë gjithëpërfshirëse dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Nënpërfaqësi i grave në jetën politike përbën një deficit demokratik, çka duket sheshazi në “mungesën e kapaciteteve të Shteteve për të adresuar pasigurinë e vazhdueshme në të gjitha dimensionet e saj, duke përfshirë militarizmin dhe kulturën e dhunës, veçanërisht, por jo vetëm, situatat e konfliktit dhe tranzicionit, ku gratë janë viktimat kryesore.”<sup>15</sup>

### 3. KUADRI NORMATIV PJESËMARRJA NË POLITIKË DHE ZGJEDHJE

Kuadri normativ në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje dhe politikë është konsoliduar në deklaratat, mbledhjet dhe konventat për të drejtat e njeriut dhe të drejtat politike, raportet, rezolutat, planet e veprimit, si dhe politikat ekzistuese për asistencën zgjedhore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).<sup>16</sup> Pjesëmarrja e plotë dhe e efektshme e grave në proceset politike dhe zgjedhore i ka fillimet në parimet e mosdiskriminimit dhe gëzimit të të drejtave politike të barabarta, të parashikuara në *Deklaratën Universale të të drejtave të njeriut* (DUDNJ), miratuar në vitin 1948.

10. OZHQ 5, “Achieve gender equality and empower all women and girls,” (Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave,) ofron një bazë të fortë që shtetet të eliminojnë dhunën në jetën politike dhe publike. Shihni UN UN DESA. Platforma Informuese për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

11. Departamenti i Shëndetit Riprodhues dhe i Kërkimit në OBSH, Shkolla Londineze e Higjienës dhe Mjekësisë Tropikale, dhe Këshilli për Kërkimin Mjekësor në Afrikën e Jugut, 2013. Përlogaritjet rajonale dhe botërore mbi dhunën ndaj grave: prevalenca dhe efektet shëndetësore të dhunës nga partneri intim dhe dhunës seksuale nga jopartneri.

12. UNDP, 2009b. “Guidance Note: Gender-Based Violence in Crisis and Post-Crisis Settings” (Udhëzime: Dhuna me Bazë Gjinore në Mjediset e

Krizës dhe Pas Krizës), nëntor.

13. OKB, 1995. “Beijing Declaration and Platform of Action, adopted at the Fourth World Conference on Women” (Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim, miratuar në Konferencën e Katërt Botërore mbi Gratë).

14. Julie Ballington/IPU, 2008. “Equality in Politics: A Survey of Women and Men in Parliaments” (Barazia në Politikë: Anketë për Gratë dhe Burrat në Parlamente), Gjenevë.

15. §52 A/HRC/23/50.

16. UN/DPA, 2013. “Promoting Women’s Electoral and Political Participation through UN Electoral Assistance” (Promovimi i Pjesëmarrjes së Grave në Politikë dhe Zgjedhje nëpërmjet Asistencës Zgjedhore të OKB-së). Direktiva e politikave. 24 dhjetor. f. 3.



**FORUMI PËR  
TRANSFORMIMIN  
E AFRIKËS I  
UDHËHEQËSEVE GRA  
TË NIVELIT TË LARTË,  
2017.**

Neni 3 parashikon se “të gjithë kanë të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë së personit.” Dhuna në zgjedhje i kërcënon këto të drejta. Dhuna mund ta kufizojë aksesin e qytetarëve në liritë e tjera themelore, që identifikohen në DUDNJ, si: kufizimi i mundësisë për të marrë pjesë në zgjedhje si kandidat ose zgjedhës (Neni 21), ose kufizimi i liritë të shprehjes (Neni 19), lëvizjes (Neni 13) ose mbledhjes dhe bashkimit paqësor (Neni 20).<sup>17</sup> Duke i kufizuar këto të drejta, dhuna mund të sabotojë besimin në proces, dhe në disa raste, edhe në rezultatin dhe besueshmërinë dhe pranimin e zgjedhjeve.<sup>18</sup>

*Konventa për të Drejtat Politike të Grave* (CPRW, 1952) dhe konventa të tjera rajonale pohojnë shprehimisht se të drejtat politike gëzohen pa asnjë lloj dallimi, duke përfshirë edhe seksin.<sup>19</sup> Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), miratuar në vitin 1979, thekson të drejtën e grave për të

pasur poste publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë.” Më konkretisht,

**NENI 7 PARASHIKON:**

*Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe në mënyrë të veçantë do t’u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën:*

- Për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike si dhe për të garantuar mundësinë që të zgjidhen në të gjitha organet e zgjedhura publike;
- Për të marrë pjesë në formulimin e politikave qeveritare dhe në zbatimin e tyre, për të mbajtur poste publike dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.<sup>20</sup>
- CEDAW-ja parashikon një detyrim tjetër pozitiv që Shtetet Palë të marrin masat e duhura për të eliminuar çdo lloj diskriminimi, duke përfshirë përdorimin e masave të veçanta të përkohshme (MVP). Ndonëse mendohet se rritin numrin e grave në postet publike, MVP-të mund të përdoren edhe për t’i dhënë efekt të plotë Nenet 7 në drejtim të ndërmarrjes së programeve ose veprimeve të veçanta, për të adresuar pengesat që hasin gratë në procesin zgjedhor, duke përfshirë edhe ato që rrjedhin nga diskriminimi, dhuna ose frikësimi.

E drejta e grave për të marrë pjesë plotësisht në të gjitha sferat e jetës publike vazhdon të jetë një pikë kthese në rezolutat dhe deklaratat e OKB-së. Duke filluar nga *Rezoluta e Këshillit Social dhe Ekonomik të*

17. Përshtatur nga UN/DPA, 2016. “Policy Directive on Preventing and Mitigating Election-related Violence” (Direktiva e Politikave për Parandalimin dhe Zbutjen e Dhunës në Zgjedhje.

18. Po aty.

19. Kjo pjesë është marrë nga UNDP/UNW, 2015. “Inclusive Electoral Processes: A Guide for Electoral Management Bodies on Promoting Gender Equality and Women’s Participation” (Procese Zgjedhore Gjithëpërfshirëse: Udhëzues për Organet e Menaxhimit të Zgjedhjeve mbi Promovimin e Barazisë Gjinore dhe Pjesëmarrjen e Grave), Nju-Jork.

20. UNGA, 1979. A/RES/34/180. “Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women” (Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave) (CEDAW).



**ZGJEDHJET  
PRESIDENCIALE  
TIMOR-LESTE**

OKB-së 1990/15 (E/ RES/1990/15), deri te Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (1995), Komisioni mbi Përfundimet e Dakordësuara për Statusin e Grave 2006 (E/2006/27-E/ CN.6/2006/15), Rezoluta e Këshillit të Sigurimit (2000) 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme (2011) për Gratë dhe Pjesëmarrjen Politike (66/130), qeveritë janë nxitur vazhdimisht për të zbatuar masat që rritin ndjeshëm numrin e grave të cilat caktohen ose zgjidhen në funksione dhe poste publike në të gjitha nivelet, duke u përqendruar tek arritja e përfundimit të barabartë të grave dhe burrave, përmes veprimeve pozitive, nëse është e nevojshme.<sup>21</sup>

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1325 bën thirrje që të gjitha partitë të marrin masa të veçanta për t'i mbrojtur gratë dhe vajzat nga DHBGJ-ja gjatë konflikteve të armatosura.<sup>22</sup>

Më konkretisht, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e OKB-së 66/130 (2012) për gratë dhe pjesëmarrjen politike i shtyn të gjitha Shtetet që të veprojnë dhe të nxisin sistemin e OKB-së dhe organizata të tjera që të përmirësojnë asistencën që iu ofrojnë Shteteve në përpjekjet e tyre kombëtare:

*Hetimi i pretendimeve për dhunë, sulm ose ngacmim të grave që janë përzgjedhur si zyrtare ose candidate për*

*poste politike, krijimi i një mjedisi me zero tolerancë për këto shkelje, dhe, garantimi i llogaridhënies, ndërmarrja e hapave të duhur për të ndjekur autorët penalisht.*

Raporti i Grupit të Punës së OKB-së në vitin 2013 mbi diskriminimin e grave në ligj dhe në praktikë, paraqitur në Këshillin e të Drejtave të Njeriut (A/HRC/23/50) “thekson nevojën për të përsheptuar përpjekjet për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave në jetën publike dhe politike, duke përfshirë punën drejt një kuadri ligjor kombëtar gjithëpërfshirës për të luftuar pandëshkueshmërinë, dhe duke garantuar aksesin në zgjidhjet dhe korrigjimet civile të përshtatshme, si dhe duke marrë parasysh disa forma të përqësuar dhe të ndërthurura të diskriminimit.” Në Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 30 në vitin 2013 mbi gratë në situata konflikti, gjatë parandalimit të konfliktit dhe pas konfliktit, Komisioni i CEDAW-së u shpreh se “progresi i ndjeshëm drejt pjesëmarrjes së barabartë të grave si candidate dhe zgjedhëse, si dhe zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, nuk do të bëhen të mundur pa ndërmarrjen e një sërë masash të përshtatshme,” duke përfshirë sigurimin që zgjedhëset dhe kandidatet politike nuk bien viktimitë e dhunës as nga Shteti as nga aktorët privatë (Pika 72). Krahas kësaj, Komisioni rekomandon që Shtetet Palë “të miratojnë politikën e tolerancës zero ndaj asnjë forme të dhunës që cenon pjesëmarrjen e grave, duke përfshirë edhe dhunën e ushtruar nga grupet shtetërore dhe joshtetërore ndaj grave që kandidojnë për poste publike ose grave që ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar (Pika 73-f).<sup>23</sup>

21. UNDP/UNW, 2015.

22. UNSC, 2000, S/RES/1325. “Resolution 1325 on women, peace and security” (Rezoluta 1325 për gratë, paqen dhe sigurinë.)



Miratimi i Axfordës për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030 në vitin 2015 ofron shtysa të mëtejshme që shtetet të adresojnë dhe të luftojnë diskriminimin gjinor dhe dhunën ndaj grave, në mbarë botën.<sup>24</sup> Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) 5, "Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave," përfshin synimin 5.5, "sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të grave dhe mundësi të barabarta në drejtim për to në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike."

### DHUNA NDAJ GRAVE

Një kuadër i gjerë për të drejtat e njeriut tregon përkushtimin e komunitetit ndërkombëtar për të parandaluar, për t'iu përgjigjur dhe për të eliminuar DHBGJ-në. Kuadri mbështetet nga disa instrumente. Në CEDAW nuk përmendet shprehimisht dhuna ndaj grave dhe vajzave, por Rekomandimet e Përgjithshme 12 dhe 19 qartësojnë se Konventa përfshin dhunën ndaj grave dhe iu jep Shteteve Palë rekomandime të hollësishme. Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut në vitin 1993 e njohu dhunën ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut dhe bëri thirrje për caktimin e një Raportuesi të Posaçëm për Dhunën ndaj Grave në Deklaratën e Vjenës dhe Platformën për Veprim.<sup>25</sup> Krahas kësaj, kjo ka kontribuar në Deklaratën për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave 1993, që u bë instrumenti i parë ndërkombëtar i cili adreson shprehimisht dhunën ndaj grave, dhe ofron një kuadër për veprimet kombëtare dhe ndërkombëtare.<sup>26</sup> Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim përfshin eliminimin e dhunës si një nga 12 çështjet shqetësuese kyçe. *Komisioni për Statusin e Grave* dha përfundimet e dakordësuara për eliminimin dhe parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave në vitin 2013, mbi dhunën ndaj grave në vitin 1998, dhe mbi eliminimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj vajzave të vogla në vitin 2007. Në kuadër të Axfordës për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, synimi 5.2 adreson në veçanti eliminimin e "të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferat private dhe publike, duke përfshirë trafikimin, shfrytëzimin seksual

dhe të llojeve të tjera." Dhuna ndaj grave dhe vajzave adresohet edhe nga OZHQ 11, për t'i "bërë qytetet dhe vendbanimet e njerëzve më gjithëpërfshirëse, të sigurta, reziliente dhe të qëndrueshme," dhe OZHQ 16, për të "promovuar shoqëritë gjithëpërfshirëse dhe paqësore për zhvillimin e qëndrueshëm, për të ofruar akses në drejtësi për të gjithë dhe për të themeluar institucione gjithëpërfshirëse, llogaridhënëse dhe të efektshme në të gjitha nivelet."

Një sërë rezolutash të Këshillit për të Drejtat e Njeriut, Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit të Sigurimit që përqendrohen te çështja e dhunës ndaj grave përvijojnë qartësisht detyrimet e Shteteve për ta adresuar, dhe bëjnë thirrje për një mjedis me zero tolerancë për dhunën ndaj grave që janë zgjedhur si zyrtare dhe kandidatë për poste publike. Krahas rezolutave që realizohen dy herë në vit mbi intensifikimin e përpjekjeve për të eliminuar të gjitha format e dhunës ndaj grave (A/C.3/69/L.19), janë miratuar edhe rezoluta për një sërë çështjesh tematike, si trafikimi i grave dhe vajzave, dhuna ndaj punonjëseve migrante, intensifikimi i përpjekjeve botërore për eliminimin e gjymtimit të organeve gjinitale femërore, përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale, krimeve të kryera për nderin dhe praktikat tradicionale dhe zakonore, që prekin shëndetin e grave dhe vajzave, si dhe dhunës në familje.

Në nivelin rajonal, janë bërë shumë përpjekje për qasje koherente, konsistente dhe gjithëpërfshirëse për t'iu përgjigjur DHNG-së, duke përfshirë edhe instrumente ligjore shumë të rëndësishme. Këtu përfshihen: *Konventa Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Çrrënjosjen e Dhunës ndaj Grave* (Belem do Para), *Protokolli i Kartës Afrikane për të Drejtat e Popullit dhe të Njeriut dhe të Drejtat e Grave në Afrikë* (Protokolli Maputo) dhe *Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje* (Konventa e Stambollit), që hyri në fuqi në gusht 2014 (shihni Propozimin 2 për informacione shtesë).

## 4. KUADRI I POLITIKAVE TË OKB-SË

Mbështetja e përpjekjeve kombëtare të Shteteve Anëtare për garantimin e proceseve politike gjithëpërfshirëse dhe promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë përfshihet ndjeshëm në axhendën e sistemit të OKB-së. Subjektet e OKB-së dhe personeli janë të detyruar të respektojnë dhe synojnë të zhvillojnë më tej të drejtat dhe standardet e parashikuara të kuadrit normativ të OKB-së për barazinë gjinore. Disa pjesë të sistemit

23. Rekomandimi i Përgjithshëm i CEDAW-së 30. 2013. <http://www.ohchr.org/documents/hrbodies/cedaw/gcomments/cedaw.c.cg.30.pdf>

24. Shihni UNGA, 2015, A/RES/70/1. Shndërrimi i botës sonë: Axhenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, 25 shtator.  
25. [http://www.un.org/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/CONF.157/2.3](http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/CONF.157/2.3)  
26. UNGA, 1993. A/RES/48/104. "Declaration on the Elimination of Violence against Women" (Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave). 20 dhjetor. <http://www.un.org/documents/ga/res/48/a48r104.htm>

të OKB-së luajnë rol në parandalimin e dhunës ndaj grave, promovimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në politikë, ofrimin e asistencës zgjedhore dhe zbutjen e dhunës në zgjedhje.

Në vitin 1997, Këshilli Social dhe Ekonomik i OKB-së (ECOSOC) miratoi strategjinë e “integritimit të perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet në sistemin e OKB-së” (integrimi gjinor) duke “vlerësuar implikimet e grave dhe burrave në veprimet e planifikuara, duke përfshirë legjislatonin, politikat ose programet, në të gjitha fushat dhe nivelet.”<sup>27</sup> Një *Politikë në Mbarë Sistemin e OKB-së për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave* u miratua nga Bordi i Drejtuesve për Koordinim i OKB-së në vitin 2012, si një mjet për të çuar më tej qëllimin e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në politikat dhe programet e sistemit të OKB-së, si dhe zbatimin e përfundimeve të dakordësuara të ECOSOC-ut 1997/2. Në praktikë, të gjitha politikat dhe programet e OKB-së duhet të përfshijnë një vlerësim të ndikimit mbi gratë dhe burrat, krahas asistencës zgjedhore dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në politikë.

Të gjitha vendet që kanë nënshkruar ose kanë rënë dakord t'i miratojnë këto marrëveshje dhe angazhime kanë detyrimin t'i zbatojnë, dhe ato kanë përfituar shumë ndihmë në këtë drejtim, në nivelin vendor dhe rajonal. Këtu përfshihet mbështetja e vendeve me raporte për zbatimin e CEDAW-së. *Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm për Dhënien Fund të Dhunës ndaj Grave - nga Fjalë në Veprim* në vitin 2006 iu ofron qeverive gjetje dhe rekomandime të hollësishme që të ndihmojnë në zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave. Së fundmi, përfundimet e dakordësuara të Komisionit për Statusin e Grave (2013) mbi eliminimin edhe parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vazhdeve ofrojnë një udhëzues të qartë për zbatimin.

Asistenca zgjedhore e OKB-së drejtohet nga një kuadër politikash, të përgatitur, të publikuar dhe të shpërndarë nga Pika Fokale e OKB-së për Asistencën Zgjedhore, Nënsekretari i Përgjithshëm për Çështjet Politike (në Departamentin e Çështjeve Politike). Para se OKB-ja të ofrojë çfarëdo asistence zgjedhore, duhet të plotësohen dy parakushte: së pari, asistenca e OKB-së duhet të mbështetet mbi mandatin e Këshillit të Sigurimit ose të Asamblesë së Përgjithshme ose një kërkesë zyrtare nga një shtet anëtar ose territor, dhe së dyti, duhet kryer një vlerësim nevojash nga Pika

Fokale në konsultim me subjektet përkatëse të OKB-së. Kuadri i politikave bazohet te kuadri normativ i OKB-së dhe iu jep udhëzime subjekteve të OKB-së që ofrojnë asistencë zgjedhore. Sistemi i OKB-së drejtohet nga miratimi i udhëzuesve dhe politikave të mëposhtme të direktivave:

*Direktiva e Politikave për Parandalimin dhe Zbutjen e Dhunës në Zgjedhje (2016)*, që synon të përmirësojë mënyrën se si kuptohen shkaqet e dhunës në zgjedhje dhe ofron një kuadër që subjektet e OKB-së të angazhohen në aktivitete për dhunën në zgjedhje.

*Direktiva e Politikave për Promovimin e Pjesëmarrjes së Grave në Politikë dhe Zgjedhje nëpërmjet Asistencës Zgjedhore të OKB-së (2013)*, që ofron strategji dhe pikënisje të qarta për integrimin gjinor në asistencën zgjedhore (shihni seksionin 2.1.5 mbi gamën e ndërhyrjeve).<sup>28</sup>

*Direktiva e Politikave për Parimet dhe Llojet e Asistencës Zgjedhore nga OKB-ja (2012)*, që jo vetëm thekson rëndësinë e “pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve që janë marginalizuara gjithmonë, veçanërisht gratë dhe pakicat,” por edhe sugjeron që pas vlerësimit të dobive të mundshme të masave me ndjeshmëri gjinore në kontekstin e një vendi të caktuar, asistenca e OKB-së do të përfshijë, *ndër të tjera*, masa të veçanta të përkohshme, specifike për zgjedhjet, dhe programe më afatgjata.”

*Udhëzues për Vlerësimin e Nevojave Zgjedhore nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (2012)*, që shërben si kuadër për të vendosur nëse dhe se si OKB-ja do të ofrojë asistencë zgjedhore. Këto vlerësime duhet të përfshijnë analizën dhe rekomandimet “për të garantuar integrimin gjinor në të gjitha veprimtaritë e OKB-së për asistencën zgjedhore dhe për t'u siguruar që i jepet përparësi promovimit të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave” (p.sh. një listë kontrolli për gjininë që përdoret për të mbledhur të dhëna që do të përmirësojnë rekomandimet).

Në përputhje me praktikën e OKB-së në mbarë sistemin, këto politika do të ofrojnë një kuadër për

---

27. <http://www.un.org/womenwatch/daw/followup/main.htm>

angazhimin e OKB-së për t'u siguruar që programet e saj, sipas kërkesës dhe miratimit, njohin dhe adresojnë mjaftueshëm dhunën ndaj grave në zgjedhje, me synim parandalimin e pjesëmarrjes së tyre në kushte të barabarta me burrat, në angazhimin me palët kombëtare të interesit. Asistenca zgjedhore ofrohet duke mbajtur parasysh faktin që gjithsecili kërkon një model ose zgjidhje të ndryshme. Llojin e këshillave që ofrohen duhet ta drejtojë një analizë gjithëpërfshirëse e kontekstit kombëtar politik, ekonomik dhe social të kombinuar me një analizë të hollësishme të nevojave. Mundësitë dhe alternativat e secilës duhet të paraqiten për t'u marrë në shqyrtim, sa më shumë të jetë e mundur. Ndonëse në përgjithësi nuk duhet të jetë urdhëruese, OKB-ja mund t'i këshillojë shtetet kërkuese mbi zbatimin e normave, parimeve dhe angazhimeve rajonale dhe ndërkombëtare në lidhje me zgjedhjet, si dhe mbi nevojën për transparencë dhe gjithëpërfshirje, që me shumë gjasa do të rritin besueshmërinë e procesit zgjedhor.

Si UNDP-ja ashtu edhe UN Women orientohen nga Planet Strategjike, që përfshijnë arritjen e rezultateve në promovimin e grave në zgjedhje dhe luftimin e dhunës ndaj grave. Mesatarisht, çdo dy javë, UNDP-ja mbështet zgjedhjet në vende të ndryshme të botës; adresimi i DHNG-së në proceset zgjedhore dhe asistenca nuk nënkupton vetëm sigurinë që kandidatet dhe zgjedhëset çlirohen nga cenimi dhe frika e dhunës, por edhe faktin që partitë politike nxiten për ta bërë çështjen e DHNG-së pjesë të një platforme për promovimin e të drejtave të njeriut dhe të grave.

Shihni edhe DPKO/DFS-DPA, 2007. *“Joint guidelines on enhancing the role of women in post-conflict electoral processes” (Udhëzime të përbashkëta për përmirësimin e rolit të grave në proceset zgjedhore pas konfliktit)*. Tetor, që përvijon specifikisht nevojën për të integruar perspektivën gjinore në asistencën zgjedhore në mjedise pas konfliktit.



STATE LA/1

01

03

03

No. 1

01

03

03



# PJESA A:

## VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI DHNGZ-NË

1. SFIDAT E ADRESIMIT TË DHNGZ-SË	20
2. PËRKUFIZIME	22
2.1. DHUNA NDAJ GRAVE	22
2.2. DHUNA NË ZGJEDHJE	23
2.3. DHUNA NDAJ GRAVE NË POLITIKË DHE ZGJEDHJE	24
3. LLOJET E DHNGZ-SË	26
3.1. DHUNA PSIKOLOGJIKE	26
3.2. DHUNA FIZIKE	27
3.3. DHUNA SEKSUALE	29
4. FUSHËVEPRIMI I DHNGZ-SË	31
4.1. TË DHËNAT E DISPONUESHME	31
4.2. KUSH JANË VIKTIMAT E DHNGZ-SË?	33
4.3. KUSH JANË AUTORËT E DHNGZ-SË?	36
5. SHKAQET DHE PASOJAT	43
5.1. PËRSE NDODH DHNGZ-JA?	43
5.2. CILI ËSHTË NDIKIMI I DHNGZ-SË?	45



# SFIDAT E ADRESIMIT TË DHNGZ-SË

Pavarësisht rëndësisë së saj, DHNGZ-ja nuk e ka marrë vëmendjen e duhur as në studime as në politika për shkak të mungesës së raportimit dhe të dhënave, si dhe të moskuptimit të problematikës dhe stigmës që lidhet me dhunën me bazë gjinore në shumë shoqëri. Përpjekjet për të hartuar një kuadër për analizimin dhe parandalimin e DHNGZ-së hasin disa pengesa:

**MUNGESA E PËRKUFIZIMEVE TË QARTA TË NDËRTHURURA ME MUNGESËN E TREGUESVE STANDARDË.** Aktualisht, nuk ekzistojnë përkufizime dhe tregues të dakordësuar për të matur nivelin e DHNGZ-së, ndonëse po bëhet çdo ditë e më e dukshme me përfshirjen e grave në zgjedhje dhe arenën politike. Pikëpamja tradicionale tregon se dhuna në zgjedhje nuk ka njohur gjini, duke çuar drejt fshehjes së realitetit të përvojave unike të grave, si: frikësimi dhe abuzimi psikologjik.<sup>29</sup> Duke qenë se janë më të ndjeshme dhe shpeshherë më private, këto forma dhune nuk janë pjesë e të kuptuarit të zakonshëm të dhunës në zgjedhje. Megjithatë, pa kuptuar fushëveprimin e plotë të dhunës në zgjedhje,

përkufizimi i problemit të DHNGZ-së mbetet i paplotë dhe nuk mund të përcaktohen as treguesit për të matur prevalencën, incidencën dhe ndikimin e strategjive për zbutjen. Pa pasur këto, është e vështirë që të zhvillohen zgjidhjet.

**MUNGESA E TË DHËNAVE TË MBLEDHURA PËR TË MATUR PREVALENCËN DHE INCIDENCËN.** Për shkak të mungesës së treguesve standardë, nuk ka pasur mbledhje sistematike të dhënash mbi incidentet e DHNGZ-së dhe përqindjen e grave që bien viktimë e saj, në nivelin botëror. Në përgjithësi, përpjekjet që dokumentojnë dhunën në zgjedhje në nivel kombëtar<sup>30</sup> nuk përqendrohen te gjinia. Këto sete të dhënash ende nuk përfshijnë ose njohin format e dhunës gjinore, çka do të thotë se të dhënat për incidentet e DHNGZ-së nuk mblidhen në mënyrë sistematike, dhe njohuritë për temën mbeten të paplota.

**PËRKUFIZIMET STANDARDE TË DHNG-SË DHE PËRGJIGJET PROGRAMUESE NEGLIZHOHEN NË NIVELIN POLITIK.** Njësoj si niveli gjinor që nuk është njohur plotësisht në fushën e dhunës në zgjedhje, edhe niveli politik nuk njihet shumë në studimet për dhunën ndaj grave. Qasjet sasiore ndaj mbledhjes së të dhënave për DHNG-në kanë kërkesa specifike etike dhe metodologjike, që shpeshherë janë të vështira për t'u përmbushur. Shtimi i nivelit politik në këtë situatë shpie drejt sfidave konceptuale dhe praktike.

29. Bardall/IFES, 2011.

30. Shihni, vëzhgimin dhe monitorimin e zgjedhjeve, si dhe Projektin për Edukimin dhe Zgjidhjen e Dhunës në Zgjedhje (EVER) të Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore. Të dhëna për incidentet në 13 zgjedhje në mbarë botën, 2002-2012. [www.ifes.org](http://www.ifes.org)





NË ZGJEDHËS  
DUKE MBAJTUR  
FLETËN E VOTIMIT  
NË REPUBLIKËN  
E AFRIKËS  
QENDRORE, 2015.

**NËNRAPORTIMI I DHNG-SË DHE DHUNËS** në zgjedhje. Mungesa e informacionit mbi incidencën shkaktohet nga nënraportimi nga ana e viktimave kur ndodhin incidente. Nënraportimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave është një problem tashmë i njohur dhe arrin deri te DHNGZ-ja. Kultura e heshtjes është edhe rezultat i kulturës së pandëshkueshmërisë së DHNG-së në shumë raste. Krahas të gjitha arsyeve që i frenojnë gratë nga raportimi i formave të tjera të DHNG-së, kandidatet mund të fshehin kërcënimet dhe sulmet fizike kundër tyre, në mënyrë që mos të duken “të dobëta” ose të papërshtatshme për botën e politikës.

**ANËSITËNË MEDIA DHE MBULIM.** Ndërgjegjësimi i publikut dhe veprimet për të zbutur DHNGZ-në kufizohen nga stereotipat me bazë gjinore, që përfaqësohen në media. Mungesa e ndërgjegjësimit dhe raportimit të DHNGZ-së nënkupton se as nuk raportohet dhe as nuk hetohet siç duhet nga media, ose eklipsohet nga raportimi i dhunës fizike në zgjedhje, që mund të verifikohet lehtë. Krahas kësaj, gratë përgjithësisht nënperfaqësohen si redaktore, producente dhe menaxhere në mediat e lajmeve, ndaj janë kryesisht meshkujt ata që e përcaktojnë axhendën dhe raportimin e lajmeve në produksionet e përditshme.

**MUNGESA E VULLNETIT POLITIK PËR TË ADRESUAR DHE PËR TË LUFTUAR DHUNËN.** Mungesa e vullnetit politik për ta adresuar këtë çështje është problem thelbësor për identifikimin, përcaktimin dhe reagimin ndaj DHNGZ-së. “Mungesa e vullnetit politik pasqyrohet në burimet e papërshtatshme që i kushtohen trajtimit të dhunës ndaj grave, dhe paaftësinë për të krijuar dhe për të ruajtur mjedisin social dhe politik, ku dhuna ndaj grave nuk tolerohet.”<sup>31</sup> Mungesa e vullnetit për ta adresuar këtë çështje krijon një problem vetëpërforsues, ku mungesa e informacionit mbi DHNGZ-në sjell pamundësinë për të vepruar, si dhe shpie drejt kulturës së heshtjes dhe mosinformimit.

31. UNGA, 2006. A/61/122/Add.1. Studim i Thelluar mbi të Gjitha Format e Dhunës ndaj Grave: Raport i Sekretarit të Përgjithshëm. 6 korrik.

# PËRKUFIZIME

Për të përkufizuar DHNGZ-në, duhet të fillojmë nga njohja e faktit që (a) DHBGJ-ja dhe DHNGZ-ja ndikojnë mbi gratë në sferën politike, çka deri tani është neglizhuar;<sup>32</sup> dhe (b) fusha e studimit dhe programeve të dhunës në zgjedhje dhe politikë nuk është përqendruar te gjinia për të kuptuar, për të analizuar dhe për të mbledhur të dhëna, si dhe ka pasur shumë forma specifike të dhunës me bazë gjinore në zgjedhje. Shtimi i perspektivës gjinore në përkufizimet standarde të dhunës në zgjedhje, dhe marrja parasysh e formave, natyrës dhe pasojave specifike të DHNG-së në krahasim me dhunën ndaj burrave, do të ofrojë një bazë të konsoliduar për identifikimin dhe përkufizimin e DHNGZ-së.

## 2.1. DHUNA NDAJ GRAVE

**DHUNA NDAJ GRAVE** është shfaqja e lidhjeve të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave në jetën publike dhe private. Karakterizohet nga përdorimi dhe abuzimi me pushtetin dhe kontrollin mbi gratë, dhe është një formë diskriminimi që shkel dhe dëmton rëndë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të grave dhe vajzave.<sup>33</sup> Në Deklaratën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, Rezolutën 48/104 më 20 dhjetor 1993, DHNG-në përkufizohet si “çfarëdolloj akti i dhunës me bazë gjinore që shpie ose ka gjasa të shpjerë drejt vuajtjes ose dëmit psikologjik, seksual ose fizik të grave, duke përfshirë kërcënimet për këto akte, kanosjen ose mohimin e paarsyeshëm të lirisë, ose në jetën publike ose atë private.”<sup>34</sup>

**DHUNA ME BAZË GJINORE** i referohet dhunës ndaj një personi për shkak të gjinisë së tij ose të saj dhe pritshmërive ndaj rolit të tij ose të saj në shoqëri ose kulturë.<sup>35</sup> Ndonëse disa e konsiderojnë DHBGJ-në si termi i plotë për morinë e shkeljeve që mund të ndodhin për shkak të pabarazive dhe diskriminimit me bazë gjinore, në kontekstin e dhunës në zgjedhje dhe politikë, përdorim DHNG-në në vend të termit të gjerë DHBGJ, pasi ai përfshin edhe shkelje të tjera (si martesë në moshë të hershme ose abuzimi seksual në fëmijëri).<sup>36</sup> Ndonëse mund të ndodhë në hapësira publike ose private, shumica e të dhënave për DHNG-në tregojnë se ndodh në sferën private. Në mbarë botën, tri në dhjetë gra që kanë pasur një marrëdhënie, kanë rënë viktimë e dhunës fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim në jetën e tyre; në disa vende, kjo shkallë mund

32. Hollësi të tjera për nëntë treguesit bazë të DHNG-së ofrohen në Pjesën B, seksioni 1.2.

33. UN CSW, 2013. “Report on the fifty-seventh session” (Raport për Seancën e 57. Suplementi Nr. 7, 4) – 15 mars.

34. Theksuar. UNGA, 1993. Neni 1.

35. UNW. “Global Database on Violence against Women” (Baza Botërore e të Dhënave mbi Dhunën ndaj Grave). <http://evaw-global-database.unwomen.org/en/about>

36. Krahas kësaj, DHNGZ-ja përqendrohet te kandidatet, zgjedhëset, vëzhgueset, ato që mbajnë poste publike, etj., që kryesisht janë të rritura. DHBGJ-ja e ka filluesën të shkeljet që përfshijnë djemtë dhe vajzat që nuk janë shënjestra të drejtpërdrejta të DHNGZ-së, ndërsa DHNG-ja përqendrohet te gratë.

## DHUNA NDAJ GRAVE NDODH NË TRI KONTEKSTE: FAMILJE, KOMUNITET DHE SHTET

Ndonëse mund të ndodhë në hapësira publike ose private, shumica e të dhënave për DHNG-në tregojnë se ndodh në sferën private. Në mbarë botën, tri në dhjetë gra që kanë pasur një marrëdhënie, kanë rënë viktimë e dhunës fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim në jetën e tyre; në disa vende, kjo shkallë mund të arrijë deri shtatë në dhjetë gra.<sup>42</sup> Partneri intim dhe dhuna në familje, si dhe disa aspekte të dhunës në komunitet, e kanë bërë DHNG-në të padukshme në shoqëri.

Familja është konteksti më i zakonit ku ndodh DHNG-ja. Aty ndodh abuzimi seksual, psikologjik dhe fizik (duke përfshirë dhunën fizike, abuzimin seksual, përdhunimin martesor, dhe kontrollin ekonomik, që përjetohet nga gratë në mbarë botën është dhuna nga partneri intim.<sup>37</sup> Familja i “përgatit pjesëtarët e saj për jetë sociale, formon stereotipa gjinorë dhe perceptime të ndarjes së punës midis sekseve” dhe ose<sup>38</sup> përjetëson ose shndërron marrëdhëniet gjinore që formojnë shkaqet themelore të dhunës.

Edhe komuniteti është arenë e rëndësishme e DHNG-së. Njësoj si familja, kur ndajnë aspekte të normave dhe praktikave kulturore dhe sociale të dëmshme, komunitetet mund të përjetësojnë pabarazinë në pushtet në shoqëri dhe e pranojnë, tolerojnë dhe/ose përjetësojnë DHNG-në. Normat dhe praktikat kulturore dhe sociale nuk duhen përdorur kurrë për të justifikuar dhunën ndaj grave dhe vajzave. Shembuj të dhunës dhe praktikave diskriminuese ndaj grave që përfshijnë komunitetin janë: dhuna seksuale nga jopartneri; ngacmimi seksual, psikologjik ose fizik dhe ngacmimi në vendin e punës, institucione fetare dhe arsimore; ngacmimi seksual në hapësira të tjera publike, si: rrugët, tregjet dhe transporti publik; përjashtimi social, si dëbimi ose mohimi i lidhjeve familjare; si dhe praktika të dëmshme, si: gjymtimi i organeve gjenitale femërore dhe martesë e hershme e<sup>39</sup> detyruar e fëmijëve.

Krahas kësaj, shteti është aktor kyç në ushtrimin e DHNG-së. Shteti mund të ushtrojë dhunë psikologjike, seksuale dhe fizike ndaj grave nëpërmjet agjentëve të tij, dhe/ose nëpërmjet ligjeve dhe politikave publike diskriminuese ose zbatimit të paefektshëm të ligjeve.<sup>40</sup> Krahas kësaj, mund të angazhohet me DHNG-në në mënyrë të drejtpërdrejtë, si: forcat e armatosura kombëtare ose forcat policore, që angazhohen ose ushtrojnë DHNG. Krahas kësaj, mund të ushtrojë DHNG në mënyrë të tërthortë, duke toleruar DHNG-në në nivel jozyrtar (në familje dhe në komunitet). Duke qenë se ka rolin të sanksionojë norma të caktuara që mbrojnë jetën dhe dinjitetin e individit, shteti duhet edhe të hartojë dhe të zbatojë masat që korrigjojnë DHNG-në.<sup>41</sup> Në këtë kategori mund të përfshihen kriminelët, rebelët dhe milicia; në disa kontekste të caktuara, DHNG-ja është një formë lufte dhe dominimi etnik.

të arrijë deri shtatë në dhjetë gra.<sup>42</sup> Partneri intim dhe dhuna në familje, si dhe disa aspekte të dhunës në komunitet, e kanë bërë DHNG-në të padukshme në shoqëri.

### 2.2. DHUNA NË ZGJEDHJE

Direktiva e Politikave të OKB-së për *Parandalimin dhe Zbutjen e Dhunës në Zgjedhje* (2016) e përkufizon dhunën në zgjedhje si një formë të dhunës në politikë, “që shpeshherë synon të ndikojë te rezultati zgjedhor, e si rrjedhojë të shpërndarja e pushtetit politik.” Vëzhgon se dhuna në zgjedhje mund të shfaqet si dhunë fizike

37. Winrock International, 2001. “Prevention of Domestic Violence and Trafficking in Humans, Training Manual “(Parandalimi i Dhunës në Familje dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Manual Trajnimi). Kiev, Ukrainë.

38. Po aty.

39. Për më shumë informacion, shihni OKB. 2006. “Ending violence against women: From words to action “(Dhënia Fund e Dhunës ndaj Grave: Nga Fjalë në Veprim.) Studim i Sekretarit të Përgjithshëm. f. 47.

40. Po aty. f. 52.

41. Winrock, 2001.

42. OBSH e të tjerë, 2013.

43. UN/DPA, 2016. f. 4.

44. UNDP, 2009a. “Elections and Conflict Prevention: A Guide to Analysis, Planning, and Programming “(Zgjedhjet dhe Parandalimi i Konfliktit: Udhëzues për Analizimin, Planifikimin dhe Programimin). f. 4; dhe UNDP, 2012.



ose në forma të tjera të agresionit, duke përfshirë kanosjen ose frikësimin, dhe mund të ndodhë në faza të ndryshme të ciklit zgjedhor, duke përfshirë periudhën para ose gjatë votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve. Ndonëse përqendrohet te procesi zgjedhor, ekzistenca e kësaj dhune shpeshherë nënkupton që rendi politik as nuk e adreson as nuk e balancon siç duhet interesin politik konkurrues.<sup>43</sup>

Po ashtu, UNDP-ja e përkufizon dhunën në zgjedhje si akte ose kërcënime të lëndimit fizik ose kanosjes, me qëllim ndikimin te procesi zgjedhor, ose në kontekstin e garës zgjedhore. Nëse ushtrohet për të prekur procesin zgjedhor, dhuna mund të përdoret për të ndikuar te procesi i zgjedhjeve, si: përpjekjet për të vonuar, për të çrregulluar, ose për të sabotuar votimin, dhe për të ndikuar te rezultatet, pra për të përcaktuar fituesit në garat politike ose për të siguruar miratimin ose mospranimin e pyetjeve të referendumit.<sup>44</sup>

## 2.3. DHUNA NDAJ GRAVE NË POLITIKË DHE NË ZGJEDHJE

E drejta e grave për të marrë pjesë në jetën publike dhe politike vendoset nga një kuadër normativ gjithëpërfshirës, dhe mund të përmbledhet nga Neni 7b i CEDAW-së, që iu kërkon Shteteve Palë të marrin masa për të garantuar se gratë kanë të drejtën të marrin pjesë në formulimin (dhe zbatimin) e politikave qeveritare, të mbajnë poste publike dhe të kryejnë të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë. “Gratë në jetën politike” është një term që përfshin gratë që marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në forma të ndryshme të aktiviteteve politike, duke përfshirë rolin si politikane të caktuara ose të zgjedhura në nivelin vendor dhe kombëtar, anëtare të partive politike, kandidatë në zgjedhje, zgjedhëse, staf i zgjedhjeve, dhe pjesëmarrëse në fushata politike, si dhe aktiviste dhe organizuese.<sup>47</sup> Gratë në jetën publike mund të jenë edhe zyrtare të caktuara, si:

### DUHEN THEKSUAR PESË KARAKTERISTIKA KYÇE TË DHUNËS NË ZGJEDHJE:

- ▶ Dhuna në zgjedhje shfaqet në mënyra të ndryshme, duke nisur nga çrregullimet ose vonesat në procesin e votimit deri te frikësimi kanosës dhe kërcënimi për dëm seksual, psikologjik ose fizik të zgjedhësve, përkrahësve politikë dhe zyrtarëve të votimit.
- ▶ Dhuna në zgjedhje ushtrohet për të arritur një objektiv politik që mund të ndryshojë në varësi të llojit të dhunuesit, që mund të jetë agjent i shtetit, i partive politike, ose i grupeve të tjera me interesa në lidhje me procesin politik.<sup>45</sup>
- ▶ Dhuna në zgjedhje mund të ndodhë gjatë çdo faze të ciklit zgjedhor, duke filluar nga regjistrimi i zgjedhësve, fushata politike dhe dita e votimit, deri te shpallja e rezultateve dhe formimi i qeverisë.<sup>46</sup>
- ▶ Përkufizimet standarde të dhunës në zgjedhje nuk përqendrohen te gjinia. Ndonëse dhuna në zgjedhje nuk i përjashton qëllimisht gratë ose konsideratat e shtysave gjinore, raportimi i zakonit nga palët e interesit politik dhe llojet e dhunës në përgjithësi kanë shpjerë drejt njohjes dhe analizës së orientuar drejt gjinisë mashkullore ose anashkalimit të gjinisë.
- ▶ Shumica e analizave mbi dhunën në zgjedhje përqendrohen te sfera publike, dhe anashkalojnë ndjeshëm format e mundshme të dhunës në familje ose në jetën private. Natyra gjinore e dhunës publike është anashkaluar dhe natyra politike e DHNG-së që ushtrohet në familje dhe komunitet është e padukshme.


45. UNDP, 2012.

46. Po aty.

47. Shihni UN Women/Derrick Marco. 2011. “A Toolkit for Managing and Preventing Political Violence against Women (PVAW) in Africa “ (Paketë

Instrumentesh për Menaxhimin dhe Parandalimin e Dhunës Politike ndaj Grave (DHPNG) në Afrikë). I pabotuar

48. Shihni fushatën e NDI-së, “Jo kostoja”: <https://www.ndi.org/not-the-cost>



**DHNGZ-JA** mund t'i ndalojë gratë që të kandidojnë, të fitojnë gara për poste politike, mund t'i shkurarojë nga votimi ose mund t'i ndëshkojë për faktin që janë aktive në procesin zgjedhor. Këto akte mund të kenë natyrë psikologjike, fizike dhe seksuale, dhe përfshijnë humbjen e mjeteve të jetesës, frikësimin, sulmin fizik ose seksual, shpërnguljen, dhe vrasjen.<sup>51</sup> Aktet e DHNGZ-së mund të ndodhin në kontekstin e familjes, komunitetit ose shtetit, në sferat publike ose private. Në secilin prej këtyre konteksteve, aktet e DHNGZ-së shndërrohen në akte të dhunës në zgjedhje, kur ndikojnë negativisht te pjesëmarrja e grave në procesin zgjedhor dhe realizimin e të drejtave politike të grave.

ministre, burokrate (në nivelin bashkiak, provincial/rajonar/kombëtar), si dhe anëtare të bordeve publike, institucione, komisione, anëtare unionesh, udhëheqëse të bazave të komunitetit, dhe advokuese.

Nuk ekziston një përkufizim i dakordësuar në nivelin ndërkombëtar mbi “dhunën ndaj grave në politikë”, por organizata dhe akademikë të ndryshëm kanë filluar të punojnë mbi këtë çështje.<sup>48</sup> Ndonëse dhuna ndaj grave në politikë (DHNGP) ndalon realizimin e të drejtave politike, përkufizimi i UN Women është rrënjësor në qasjen me bazë të drejtat e njeriut:

Dhuna ndaj grave në jetën politike është çfarëdolloj akti, ose kërcënimi, i dhunës me bazë gjinore, që shpie drejt vuajtjes ose dëmit psikologjik, seksual dhe fizik të grave, që i ndalon të ushtrojnë dhe të realizojnë të drejtat e tyre politike, qoftë në hapësirat publike ose private, duke përfshirë të drejtën për të votuar dhe për të mbajtur poste publike, për të votuar në fshehtësi dhe për të bërë fushatë lirisht, për t'u bashkuar dhe për t'u mbledhur, dhe për të gëzuar lirinë e mendimit dhe shprehjes. Kjo dhunë mund të ushtrohet nga një familjar, anëtar i komunitetit ose nga shteti.<sup>49</sup>

Mbetet detyrë e Shtetit që të parandalojë dhe të reagojë me efektshmëri dhe në mënyrën e duhur ndaj të gjitha formave të dhunës ndaj grave në jetën politike, pavarësisht faktit nëse kjo dhunë ushtrohet nga familjarët, anëtarët e komunitetit, anëtarët e një partie politike të njëjtë ose të ndryshme, të panjohurit, ose përfaqësues të shtetit.<sup>50</sup>

Duke e marrë parasysh këtë përkufizim të dhunës ndaj grave në politikë, **ATËHERË DHUNA NDAJ GRAVE NË ZGJEDHJE (DHNGZ) ËSHTË NJË FORMË E DHUNËS NDAJ GRAVE QË SYNON TË NDIKOJË TE REALIZIMI I TË DREJTAVE POLITIKE TË GRAVE NË KONTEKSTIN ZGJEDHOR**. Këtu përfshihet pjesëmarrja e grave si kandidatë, zgjedhëse, aktiviste, përkrahëse të partive, vëzhguese, punonjëse në zgjedhje, ose zyrtare publike.

DHNGZ-ja duhet të shqyrtohet më vete, si rrjedhojë e karakteristikave të saj: viktima të veçanta që shënjestrohen për shkak të pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje, në bazë të seksit dhe/ose gjinisë së tyre; dhunues të veçantë me arsye specifike për sulmet që bëjnë; forma dhe metoda të veçanta dhune; vendndodhje specifike publike dhe private, si dhe pasoja specifike.

DHNGZ-ja ndodh në çastin kur mbi një grua ushtrohen dhunë fizike, sulme seksuale, ose dëm psikologjik, me qëllim që ta ndalojnë dhe/ose ta ndëshkojnë për ushtrimin e të drejtave zgjedhore. Gratë mund të bien viktimitë e DHNGZ-së në shumë role, si: kandidatë, përkrahëse të partive, zgjedhëse dhe familjare të kandidatëve. Dhunuesit mund të vijnë nga sfera politike, shoqërore ose individuale. Secila nga këto sfera do të adresohen në këtë seksion.

49. Julie Ballington, 2016. “Turning the Tide on Violence against Women in Politics: How Are We Measuring Up?” (Le ta Kthejmë Shikimin nga Dhuna ndaj Grave në Politikë: Si po e Matim?), paraqitur në Kongresin e 24-t Botëror të Shoqatës Ndërkombëtare Shkencore dhe Politike. Poznan, Poloni, 23-28 korrik.

50. Suki Beavers, 2016. Korrespondencë me autorin (Ballington), qershor.

51. UN, 2006.

# LLOJET E DHNGZ-SË

DHNGZ-ja ndodh në çastin kur mbi një grua ushtrohen dhunë fizike, sulme seksuale, ose dëm psikologjik, me qëllim që ta ndalojnë dhe/ose ta ndëshkojnë për ushtrimin e të drejtave zgjedhore. Gratë mund të bien viktimë e DHNGZ-së në shumë role, si: kandidatë, përkrahëse të partive, zgjedhëse dhe familjare të kandidatëve. Dhunuesit mund të vijnë nga sfera politike, shoqërore ose individuale. Secila nga këto sfera do të adresohen në këtë seksion.

## 3.1. DHUNA PSIKOLOGJIKE

Abuzimi dhe frikësimi psikologjik janë format më të shpeshta të dhunës ndaj grave në zgjedhje, sipas të dhënave të disponueshme (shihni Tabelën 1). Dhuna psikologjike mund të përcaktohet si sjellje që synon frikësimin dhe përndjekjen, dhe merr formën e kërcënimeve për braktisje ose abuzim, ngujim në shtëpi, përgjim, kërcënime për heqjen e kujdestarisë së fëmijëve, shkatërrimin e objekteve, izolimin, agresionin verbal dhe poshtërimin e vazhdueshëm.”<sup>52</sup>

### ÇFARË FORMASH MERR DHNGZ-JA PSIKOLOGJIKE?

Nga të gjitha format e DHNGZ-së, dhuna psikologjike përfshin çështje të shumëllojshme dhe të ndjeshme. Përfshin kërcënime të hapura për ngacmimin dhe lëndimin fizik të të gjitha grupeve, duke përfshirë kandidatët, përkrahësit e partive, zgjedhësit dhe zyrtarët e zgjedhjeve. Kërcënimet e hapura ose të nënkuptuara për përjashtimin social, divorc dhe mohim mund t'i frenojnë gratë nga kandidatura për poste politike, votimi në përgjithësi ose votimi kundër kandidatit të parapëlqyer të familjes/fisit. Dëmi psikologjik degradon, demoralizon ose turpëron viktimën. Shpeshherë dhuna fizike paraprihet nga kërcënimet.

Njësoj si format e tjera të dhunës ndaj grave, dhuna psikologjike mund të ndodhë në shtëpi, komunitet dhe publik, ose në internet. Ndonëse nuk ekzistojnë shifra për prevalencën dhe incidencën, provat anekdotike dhe kërkimet ekzistuese tregojnë se dhuna psikologjike

ndodh kryesisht në mjedise të brendshme. Çdo ditë e më shumë, abuzimi psikologjik po ndodh në internet dhe forume publike, duke përfshirë mediat sociale, si: Facebook dhe Twitter, si dhe telefonat celularë. Thuajse të gjithë autorët e DHNGZ-së ushtrojnë dhunë psikologjike. Një grua mund ta njohë nga afër autorin e dëmit psikologjik, si për shembull kur familja ose anëtarët e komunitetit dhe grupit fetar e përdorin për të frenuar ose për të kanosur pjesëmarrjen e gruas. Krahas kësaj, dëm psikologjik mund të kryejnë edhe aktorët që gruaja nuk i njeh, si: shteti, partitë politike dhe grupet e armatosura.

Për shembull, në Pakistan, gjatë zgjedhjeve plotësuese parlamentare në Distriktin e Dir-it të Ulët në maj 2015, asnjë nga 53,000 zgjedhëset e pranueshme nuk votoi.<sup>53</sup> U raportua se “xhamitë i paralajmëruan gratë, dhe qendrat e votimit ruheshin nga “burra me shkopinje prej gome”, që nuk i lejonin të hynin ato pak gra që donin të votonin.”<sup>54</sup> Gratë raportuan se familjarët meshkuj iu

52. UN Women. “Glossary of Terms from Programming Essentials and Monitoring and Evaluation Sections” (Fjalorth i Termave nga Programimi i Elementeve Kyçe dhe Seksionet e Monitorimit dhe Vlerësimit.) Qendra e Njohurive Virtuale për t'i Dhënë Fund Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave.  
53. UN Women Pakistan, 2016. “Creating an Enabling Environment for Women’s Political Participation: Ending violence against women in political and electoral processes “ (Krijimi i një Mjedisi Aftësues për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë: Dhënia Fund e Dhunës ndaj Grave në Proceset Zgjedhore dhe Politike). I pabotuar.



Shënjestër	Llojet e DHNGZ-së psikologjike	Dhunues të mundshëm
<b>Kandidate dhe aspirante</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sulm dhe ngacmim verbal</li> <li>Kërcënim për lëndim, kanosje dhe frikësim me qëllim heqjen dorë nga kandidatura</li> <li>Cenim reputacioni</li> <li>Kërcënim për divorc ose kanosje ekonomike</li> <li>Kanosje ekonomike ose kërcënim për anulimin e mbështetjes financiare</li> <li>Izolimi dhe marginalizimi social</li> <li>Fushatat për përhapjen e frikës dhe thashethemeve</li> <li>Kërcënime ndaj familjes, ekipit të fushatës dhe biznesit</li> <li>Portretizim negativ në media</li> <li>Ngacmim në internet dhe bullizëm kibernetik</li> <li>Shantazh, kërcënim ose sanksionim moral nga punëdhënësi ose udhëheqësi fetar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Familjarë</li> <li>Partner intim/bashkëshort</li> <li>Komunitete dhe zgjedhës</li> <li>Udhëheqës tradicionalë dhe/ose fetarë</li> <li>Grupe rinore</li> <li>Anëtarë dhe përkrahës të partive politike</li> <li>Aktorë të sigurisë shtetërore</li> <li>Grupe të armatosura joshtetërore</li> <li>Milici</li> <li>Kandidate</li> <li>Zgjedhëse</li> <li>Zyrtarë në zgjedhje</li> <li>Vëzhgues të zgjedhjeve</li> <li>Media dhe gazetarë</li> </ul>
<b>Zgjedhëse</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sulm dhe ngacmim verbal</li> <li>Kërcënim për lëndimin, kanosjen dhe frikësimin mbi ushtrimin e të drejtave politike</li> <li>Trysni nga prindërit ose bashkëshortët në lidhje me parapëlqimet politike</li> <li>Detyrim mbi parapëlqimet politike/votim familjar</li> <li>Moslejimi për të dalë nga shtëpia për të votuar</li> <li>Mospranimi nga ana e të afërmeve që të kujdesen për fëmijët ndërkohë që gratë votojnë</li> <li>Kanosje ose ndëshkim ekonomik</li> </ul>	
<b>Aktiviste dhe përkrahëse ekonomike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ngacmim verbal për parapëlqimet politike</li> <li>Kërcënime për dëm dhe frikësim</li> <li>Përhapja e thashethemeve dhe cenimi i reputacionit</li> <li>Sanksion moral nga ana e punëdhënësit ose udhëheqësit fetar</li> </ul>	
<b>Punonjëse në zgjedhje, vëzhguese dhe zyrtare publike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kërcënime për dëm dhe frikësim</li> <li>Kërcënim për sanksion nga ana e punëdhënësit/kanosje ekonomike</li> <li>Tallje dhe turpërim</li> <li>Sanksion moral nga të moshuarit ose udhëheqësit fetarë</li> </ul>	

ndalonin pjesëmarrjen në tubime politike, nuk pranon të diskutonin për zgjedhjet ose politikën në shtëpi, si dhe nuk i lejonin të votonin.<sup>55</sup>

### 3.2. DHUNA FIZIKE

Një formë tjetër e zakonit të DHNGZ-së është dhuna fizike. Përfshin përdorimin e qëllimshëm të forcës fizike me mundësinë e vdekjes, plagosjes dhe dëmit. Përfshin, por pa u kufizuar, shtyrjen, goditjen, hedhjen, kapjen, mbytjen, shkundjen, goditjen me shuplakë, grushtimin,

gjuajtjen, djegien, përdorimin e kufizimeve, trupin ose forcën kundër një tjetër personi, si dhe përdorimin ose kërcënimin se do të përdoren armët ose objektet.<sup>56</sup> Krahas kësaj, mund të përfshijë edhe rrëmbimin dhe ndalimin arbitrar, rrahjen dhe goditjen me gurë, si dhe braktisjen ose shpërnguljen fizike.

#### ÇFARË FORMASH MERR DHNGZ-JA FIZIKE?

Dhuna fizike shënjestron gratë si kandidate, zgjedhëse, aktiviste dhe punonjëse në zgjedhje. Si aktorët shtetërorë ashtu edhe ata politikë mund të përdorin dhunën fizike për t'i ndaluar zgjedhëset, partitë rivale dhe kandidatet.

54. Jon Boone, 2015. "Women Barred from Voting in Parts of Pakistan" (Gratë Ndalohen të Votojnë në Pjesë të Pakistanit.) The Guardian, 29 maj.

55. Sirajuddin, 2015. "PK-95: A Short-Lived Victory for Hopeful Female Voters in Lower Dir" (PK-95: Një Fitore e Shkurtër për Zgjedhëset Shpresëplota në Dirin e Ulët.) Dawn, 18 qershor.

56. UN Women. "Glossary of Terms from Programming Essentials and Monitoring and Evaluation Sections" (Fjalorth i Termave nga Programimi i Elementeve Kyçe dhe Seksionet e Monitorimit dhe Vlerësimit).

Krahas kësaj, edhe zgjedhësit e përdorin dhunën fizike, njësoj si qytetarët e zakonshëm, duke përfshirë bashkëshortët dhe familjarët, që kërkojnë të ndalojnë angazhimin e grave në zgjedhje.

Dhuna fizike ndodh në të gjitha nivelet, duke përfshirë shtëpinë, komunitetin dhe publikun, por është më e dukshme në mjedise publike: tubime për fushatë, mitingje, trajnime, si dhe fushatat derë më derë nga ana e kandidatëve. Krahas kësaj, mund të ndodhë në mjedise institucionale, si zyrat e partive politike, Organet e Menaxhimit të Zgjedhjeve, (EMB), në qendrat e votimit dhe hapësira të tjera qytetare.

Dhuna fizike është e zakonshme për të gjithë autorët, ndonëse shpeshherë vërehet midis partive politike rivale. Aktualisht, zgjedhjet e lidhura me dhunën në familje, në të gjitha format e saj, duke përfshirë dhunën fizike, nuk është dokumentuar, por besohet se është domethënëse. Forma më e skajshme e DHNGZ-së është vdekja dhe vrasja politike.

Në Libi, në vitin 2014, Salwa Bugaighis, udhëheqëse e lëvizjes së grave u vra kur shkoi të votonte në zgjedhjet e përgjithshme në vend.<sup>57</sup> Në Irak, në vitin 2015, OKB-ja paralajmëroi se “gratë e arsimuara dhe profesioniste, që kanë kandiduar në zgjedhje për poste publike” janë veçanërisht në rrezik ekzekutimi nga militantët.<sup>58</sup>

Shënjestër	Llojet e DHNGZ-së fizike	Dhunues i mundshëm
Kandidate dhe aspirante	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vrasje ose vrasje në tentativë</li> <li>• Rrahje, sulme, kanosje dhe lëndim trupor</li> <li>• Frikësim dhe dëm fizik për të hequr dorë nga kandidatura dhe politika</li> <li>• Rrëmbim ose ndalim arbitrar</li> <li>• Abuzim ose torturë</li> <li>• Vjedhje e pronës</li> <li>• Dëm ose abuzim i familjes dhe ekipit të fushatës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Familjarë;</li> <li>• Partner intim/bashkëshort</li> <li>• Komunitete dhe zgjedhës</li> <li>• Grupe rinore dhe milici</li> <li>• Anëtarë dhe përkrahës të partive politike</li> </ul>
Zgjedhëse	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sulme fizike ndaj grupeve të synuara</li> <li>• Ndalim dhe arrestim arbitrar</li> <li>• Abuzim fizik për parapëlqimin e zgjedhëses</li> <li>• Rrahje, sulme, kanosje dhe lëndim trupor</li> <li>• Ndalim fizik për të mos aksesuar qendrat e votimit dhe të regjistrimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Grupe të armatosura joshitetërore</li> <li>• Aktorë të sigurisë shtetërore</li> </ul>
Aktiviste dhe përkrahëse ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përplasje të grupeve</li> <li>• Shuarje e dhunshme e protestave</li> <li>• Dhunë ndër- dhe brendapartiake</li> <li>• Rrahje, sulme, kanosje dhe lëndim trupor</li> <li>• Ndalim arbitrar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kandidatë</li> <li>• Zgjedhës</li> <li>• Zyrtarë në zgjedhje</li> <li>• Vëzhgues të zgjedhjeve</li> </ul>
Punonjëse në zgjedhje, vëzhguese dhe zyrtare publike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sulm fizik</li> <li>• Kërcënime për dëm dhe frikësim</li> <li>• Vjedhje e pronës</li> </ul>	

57. Chris Stephen, 2014. “Libia e Shokuar pas Vrasjes së Aktivistes për të Drejtat e Njeriut Salwa Bugaighis.” The Guardian, qershor 26.

58. Samuel Smith, 2015. “OKB: ISIS po Vret Gratë e Arsimuara, Veçanërisht Politikanet.” Christian Post.

### 3.3. DHUNA SEKSUALE

Ndonëse shpesh nuk njihet dhe është e vështirë për t'u dokumentuar, dhuna seksuale përdoret haptazi në DHNGZ.<sup>59</sup> Dhuna seksuale përfshin aktet seksuale jokonsensuale, tentativën për të kryer një akt seksual, komente ose përpjekje të padëshiruara seksuale, ose akte për të trafikuar ose për të sulmuar seksualitetin e një personi nga kushdo, pavarësisht marrëdhënies së tij me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë, por pa u kufizuar, shtëpinë dhe vendin e punës.<sup>60</sup>

#### ÇFARË FORMASH MERR DHNGZ-JA?

Dhuna seksuale përfshin ngacmimin, abuzimin dhe sulmin seksual dhe përdhunimin. Kërcënimet dhe sulmi seksual mund të ndodhin si në mjediset private ashtu edhe ato publike. Në hapësirat private, abuzimi seksual mund të ndodhë kur një grua ka mendime politike të ndryshme nga bashkëshorti ose fisi i saj ose kur përpiqet që të ndryshojë rolet tradicionale, duke kandiduar për poste publike. Në të vërtetë, në disa kontekste të pabarazisë gjinore të skajshme dhe DHBGJ-së së ndryshme, tensioni dhe pasioni i periudhës zgjedhore në përgjithësi mund të nxisë më shumë dhunë seksuale, pavarësisht pjesëmarrjes ose mendimeve të grave mbi politikën. Përdhunimi është përdorur si armë e DHNGZ-së. Dhuna seksuale mund të jetë oportuniste, “mund të lidhet me çrregullimin e përgjithshëm të ligjit dhe rendit dhe me rritjen e kriminalitetit të çdo lloji,”<sup>61</sup> gjatë trazirave zgjedhore, ose mund të jetë instrumentale, me qëllim degradimin ose dobësimin e kundërshtarit.

Përdhunimi dhe llojet e tjera të dhunës seksuale nga partneri intim thuhet gjithmonë ndodhin në shtëpi, si mënyrë për të kontrolluar parapëlqimet ose pjesëmarrjen e grave në politikë. Nga ana tjetër, dhuna seksuale nga të panjohurit (milicia, policia,

etj.) shpeshherë ndodh në publik. Mund të ndodhë në ara, vendtakime, qendra votimi, rrugë ose transport publik, dhe përfshin sulmin dhe ngacmimin seksual, deri te përdhunimi gjatë ngjarjeve politike publike. Në këtë rast, dhuna seksuale vepron si mekanizëm për t'i ndaluar gratë që të marrin pjesë në tubime dhe të shprehin mendimin e tyre.<sup>62</sup>

Dhuna seksuale në publik shpeshherë i atribuohet ushtrisë, policisë dhe pjesëmarrësve në ngjarje politike, njësoj siç ndodh me ngacmimin seksual ndër- dhe jashtëpartiak. Për shembull, në Kenia në vitin 2009, rreth 35,000 kenianë u zhvendosën për shkak të dhunës pas zgjedhjeve dhe sipas raporteve, vajza dhe gra të zhvendosura kishin bërë seks transaksional me punëtorët vullnetarë dhe punonjësit formalë të sigurisë në këmbim të ushqimeve dhe sigurisë, si dhe kishte pasur dhunë seksuale midis personave të zhvendosur në kampe.<sup>63</sup> Spitali i grave në Nairobi raportoi një numër tri herë më të lartë të rasteve të dhunës seksuale, sidomos të përdhunimit, gjatë dhunës pas zgjedhjeve.<sup>64</sup> Në Zimbabve në periudhën 2008-2009, “...gra të të gjitha moshave u shënjestruan për shkak të përkatësive të tyre politike dhe u rrëmbyen nga vendet e punës dhe shtëpitë e tyre, u përdhuan, u torturuan dhe u rrahën në qendra torture sekrete. Është përlogaritur se nga maji deri në korrik 2008, grupet e sanksionuara nga shteti kanë përdhunuar mbi 2,000 gra dhe vajza.”<sup>65</sup>

59. UNDP, 2012.

60. UN Women. “Fjalorth i Termave nga Programimi i Elementeve Kyçe dhe Seksionet e Monitorimit dhe Vlerësimit.”

61. Muthoni Wanyeki, 2008. “Mësime nga Kenia: Gratë dhe Dhuna pas Zgjedhjeve.” *Feminist Africa*.

62. Buletini SG.

63. Wanyeki, 2008.

64. Po aty.

65. RAU, 2009. “Na Dëgjoni: Flasin Gratë nga Zimbabve, të Prekura nga Dhuna Politike.” *The Hub*, 4 maj, cituar në UNDP, 2012.

Shënjestër	Llojet e DHNGZ-së	Dhunues të mundshëm
<b>Kandidate dhe aspirante</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përpjekje seksuale e padëshiruar ose kërkesë për një nder seksual në një mjedis politik</li> <li>• Sjellje verbale ose fizike ose një gjest me natyrë seksuale</li> <li>• Sulm seksual dhe përdhunim (në familje ose nga një aktor publik)</li> <li>• Ngacmim seksual</li> <li>• Sjellje verbale ose fizike me natyrë seksuale që ndikon tek aftësia e personit për të marrë pjesë në politikë (kandidatura, pjesëmarrja në fushatë)</li> <li>• Sjellje me natyrë seksuale që mund të pritet ose të perceptohet që shkakton fyerje ose poshtërim ndaj grave të cilat ushtrojnë të drejta politike</li> <li>• Shfrytëzim seksual, si abuzimi faktik ose në tentativë i cënueshmërisë, pushtet ose besim i diferencuar për qëllime seksuale, duke përfshirë fitimet monetare ose politike nga shfrytëzimi seksual i dikujt<sup>62</sup></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Familjarë</li> <li>• Partner intim, bashkëshort</li> <li>• Komunitete dhe zgjedhës</li> <li>• Udhëheqës tradicionalë dhe/ose fetarë</li> <li>• Grupe rinore</li> <li>• Anëtarë dhe përkrahës të partive politike</li> </ul>
<b>Zgjedhëse</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përpjekje seksuale të padëshiruara ose kërkesë për ndere seksuale që ndikojnë tek aftësia e zgjedhëses për të marrë pjesë lirisht në një veprimtari politike</li> <li>• Sulm ose ngacmim seksual, në qendrat e votimit dhe zyrat e regjistrimit</li> <li>• Përdhunim për arsye politike, që përdoret si instrument për të kontrolluar, për të frikësuar, për të poshtëruar dhe për t'i hequr zgjedhëses të drejtën e votës</li> <li>• Sjellje verbale ose fizike me natyrë seksuale, që ndikon tek aftësia e zgjedhëses për të marrë pjesë në politikë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Grupe të armatosura joshitetërore</li> <li>• Aktorë sigurie</li> <li>• Zyrtarë në zgjedhje</li> </ul>
<b>Aktiviste dhe përkrahëse ekonomike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sulm ose ngacmim seksual në tubimet ose sheshet e fushatave</li> <li>• Çfarëdolloj përpjekjeje seksuale e padëshirueshme ose kërkesë për nder seksual në një mjedis politik</li> </ul>	
<b>Punonjëse në zgjedhje, vëzhguese dhe zyrtare publike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarëdolloj përpjekjeje seksuale ose kërkesë për nder seksual në një mjedis politik</li> <li>• Sulm ose ngacmim seksual ndaj punonjësve në zgjedhje</li> <li>• Shfrytëzim ose kontakt seksual i çfarëdo lloji midis një profesionisti ndihmës, si punonjës në zgjedhje ose agjent regjistrimi, dhe një klienteje, si zgjedhëse ose kandidate</li> </ul>	

# FUSHËVEPRIMI I DHNGZ-SË

Në këtë seksion paraqiten llojet e ndryshme të DHNGZ-së, diskutohen prevalenca dhe incidenca e saj, si dhe identifikohen viktimat dhe autorët më të shpeshtë të kësaj forme të veçantë dhune.

## 4.1. TË DHËNAT E DISPONUESHME

Setet standarde të të dhënave mbi dhunën në zgjedhje nuk përqendrohen te gjinia, ndaj nuk japin shumë të dhëna mbi DHNGZ-në. Kjo do të thotë që një pjesë e madhe e dhunës në zgjedhje që përjetojnë gratë nuk është dokumentuar. Krahas kësaj, mungesa e një përkufizimi të dakordësuar të DHNGZ-së dhe treguesit për ta matur, nënkupton se nuk janë mbledhur të dhëna sistematike në nivelin botëror, rajonal ose kombëtar.

Pavarësisht kufizimeve në të dhëna, sipas kërkimeve, DHNGZ-ja është përhapur në vendet dhe rajonet e botës. Gjetjet e kategorizuara sipas seksit në të vetmin studim ndërvendor të disponueshëm deri tani, që krahasonin mbi 2,000 akte të dhunës në zgjedhje në gjashtë vende gjatë periudhës 2006-2010, vlerësonin se gratë ishin viktimat në thuhetse 40% të akteve të dhunës në zgjedhje.<sup>66</sup> Megjithatë, prevalenca mendohet të jetë më e lartë se 40%, pasi në këtë studim nuk janë mbledhur të dhëna për gamën e plotë të formave të dhunës, që përjetojnë gratë, duke përfshirë dhunën në sferën private (si ndalimi nga partneri ose një familjar që të dalin nga shtëpia për të votuar), sulmi seksual për arsye politike ose abuzimi psikologjik gjinor.

Sipas një studimi të kohëve të fundit mbi temën e dhunës ndaj grave parlamentare, dhuna psikologjike arrinte nivele të larta, si forma më e përhapur që prekte 81.8% të të anketuarave nga të gjitha vendet dhe rajonet. Nga dhuna psikologjike e raportuar, 44.4 për

qind e të anketuarave thanë se kanë marrë kërcënime për vdekje, përdhunim, rrahje ose rrëmbim gjatë mandatit të tyre parlamentar.<sup>67</sup>

Llojet e dhunës në zgjedhje të ushtruar mbi gratë dhe shpeshtësia me të cilën përjetojnë disa lloje të tjera të caktuara të dhunës janë thelbësisht të ndryshme nga ato me të cilat përballen burrat. Ndonëse padyshim që ekziston dhuna fizike ndaj grave në zgjedhje, shumë shpesh dhuna politike ndaj grave ka një karakter psikologjik ose seksual.<sup>68</sup> Në studime është konstatuar se gratë përjetojnë një të tretën e numrit të sulmeve të drejtpërdrejta fizike në krahasim me burrat, por kanë tri herë më shumë gjasa që të përjetojnë dhunë psikologjike.<sup>69</sup> Kjo tregon se gratë përballen me një përvojë tejet të ndryshme nga burrat lidhur me dhunën në zgjedhje. Gratë kanë më shumë gjasa që të përballen

66. Bardall/IFES, 2011. Incidentet e dhunës u identifikuan sipas një përkufizimi neutral gjinor të dhunës në zgjedhje: si rrjedhojë, nuk u identifikuan as forma seksuale të dhunës as forma të tjera të dhunës specifike gjinore.

67. IU, 2016b. Seksizmi, Ngacmimi dhe Dhuna ndaj Grave Parlamentare. <http://www.ipu.org/pdf/publications/ issuesbrief-e.pdf>

68. Bardall/IFES, 2011.

69. Po ai. Sipas të dhënave të studimit, 32 për qind e të gjitha akteve të dhunës zgjedhore të kryera ndaj grave janë akte të dhunës psikologjike, në krahasim me vetëm 9 për qind të dhunës psikologjike ndaj burrave. Përkundrazi, 34 për qind e akteve të dhunshme ndaj burrave përfshinin lëndimin fizik, në krahasim me 9 për qind të grave.

me dhunë të fshehtë bazuar në frikë: frikë për sigurinë e tyre personale dhe sigurinë e të afërmeve të tyre, frikë nga veçimi social dhe sulme ndaj karakterit moral dhe vetëbesimit të tyre. Për më tepër, ato kanë më shumë gjasa që të përballen me ngacmimin seksual brenda partive të tyre politike, ose të poshtërohen në një mënyrë të seksualizuar, si për shembull, kur u kërkohet të kryejnë favore seksuale. Kjo është një veçanti e DHNGZ-së.

Në mënyrë që të kuptohet sa më mirë shtrirja e DHNGZ-së, ne duhet të shohim përtej raporteve publike dhe të marrim parasysh edhe incidentet që ndodhin brenda në shtëpi dhe në komunitet, të cilat nuk raportohen në mënyrë zyrtare. Duke


u bazuar në të dhënat e disponueshme, pjesa më e madhe e DHNGZ-së në përgjithësi (p.sh. Jo specifike për zgjedhjet) llogaritet se ndodh në shtëpi.

Prallëherë të dokumentuara në mënyrë zyrtare, aktet e DHNGZ-së që ndodhin në shtëpi më së shumti janë verbale, dhe mbahen shënim nga vëzhguesit zgjedhorë, agjentët zgjedhorë dhe burime të komunitetit, por jo nga policia dhe raporte të medias apo të spitaleve.<sup>71</sup> Krahas kësaj, DHNGZ-ja ndodh në vendndodhje të veçanta, si zona zgjedhore shumë të kontestuara që përfshijnë kandidatë meshkuj dhe femra, gra që bëjnë fushatë në zona tradicionale apo konservatore, ose aty ku janë të pranishme grupe të armatosura.<sup>72</sup>

**TABELA 1: SHPËRNDARJA PROPORCIONALE E FORMAVE TË NDRYSHME TË DHUNËS NË ZGJEDHJE PËR BURRAT DHE GRATË (2006-2010)<sup>70</sup>**

**LLOJET E DHUNËS ZGJEDHORE**

Shpërndarja e Incidenteve të Dhunës për Burrat dhe Gratë



**Shënim:** Në tabelë paraqitet shpërndarja proporcionale e incidenteve të formave të ndryshme të dhunës në zgjedhje siç përjetohet nga burrat dhe gratë. Informacioni mbi sulmin seksual nuk bënte dallimi nga format e tjera të lëndimeve fizike. Vendet përfshijnë Guyana 2006; Bangladesh 2006-07; Timor-Leste 2007; Nepal 2007-08; 2008; Burundi 2010; dhe Guinea 2010.

70. Po aty. Në tabelë paraqitet shpërndarja proporcionale e incidenteve të formave të ndryshme të dhunës në zgjedhje për burrat dhe gratë. Informacioni mbi sulmin seksual nuk bënte dallimi nga format e tjera të lëndimeve fizike.

71. Po aty.  
72. UNDP, 2012.



## 4.2. KUSH JANË VIKTIMAT E DHNGZ-SË?

Viktimat e mundshme të DHNGZ-së janë të gjitha gratë që janë palë të interesuara në zgjedhje, si zgjedhëse, kandidatë, përkrahëse të partive politike, staf i fushatës zgjedhore, staf i zgjedhjeve, zyrtare të zgjedhura dhe zyrtare të medias. Duke qenë se nuk ka të dhëna të besueshme rreth numrit të viktimave dhe autorëve të DHNGZ-së, ky seksion përdor më shumë prova jozyrtare për të ofruar ilustrime të çështjeve në diskutim.

Gratë mund të jenë viktimat të dhunës zgjedhore në mënyrë rastësore ose të qëllimshme. Trazira, rrëmujë, sulme me mjete eksplozive në vende publike, shpërngulje në shkallë të gjerë dhe rritje të përgjithshme të krimeve të dhunshme dhe zgjedhje të paqëndrueshme ndonjëherë i prekin pa dallim si burrat dhe gratë. Këto janë *forma të tërthorta* të DHNGZ-së, pasi ato nuk shënjestrojnë haptazi gratë për shkak të gjinisë së tyre apo arsyeve të nxitura nga gjinia në lidhje me politikën. Por, është e rëndësishme që të vihen në dukje, pasi ndikojnë te gratë në mënyra dhe shkallë të ndryshme nga burrat, dhe kanë efektin përfundimtar në pengimin e të drejtave politike të grave. Ndonjëherë kjo përshkruhet si “dhunë zgjedhore me dallim gjinor”.<sup>73</sup>

*Format e drejtpërdrejta të DHNGZ-së* përfshijnë sulme që veçojnë gratë për të penguar ose manipuluar qëllimisht pjesëmarrjen e tyre dhe/ose të përsërisin vartësinë e tyre. Ndonjëherë kjo përkufizohet si dhunë politike e nxitur nga gjinia ose me bazë gjinore.<sup>74</sup> Në këtë Udhëzues, përqendrohemi te këto forma të fundit të drejtpërdrejta.

### ZGJEDHËSET GRA

Zgjedhëset gra, të cilat përbëjnë më shumë se gjysmën e elektoratit në shumë vende, janë shënjestra të zakonshme të dhunës lidhur me zgjedhjet. Dhuna që shënjestron zgjedhëset gra, qoftë gjatë periudhës së regjistrimeve, në qendrat e votimit, në shtëpi ose lidhur me aktivitete të tjera të angazhimit qytetar, është projektuar që t’u ndërrojë mendjen nga regjistrimi për votim, nga votimi, pjesëmarrja në tubime apo aktivitete politike, paraqitja në qendrën e votimit apo për të ndikuar në zgjedhjen e tyre, apo duke i dënuar pas kësaj (gjë që është projektuar që të ndalojë pjesëmarrjen e tyre në të ardhmen). Për shembull, një studim i kryer në vitin 2016 në Pakistan konstatoi se DHNGZ-ja ishte një nga faktorët kyç për shkallën e ulët të regjistrimeve të grave në krahasim me burrat.<sup>75</sup> Kërcënimi i dhunës fizike ndaj grave dhe situata e rrezikshme e sigurisë në shumë zona të vendit e kanë kufizuar aksesin e

grave në qendrat e votimit. Statistikat e Komisionit Zgjedhor të Pakistanit tregojnë se në zgjedhjet e 2013-s, kishte pothuajse 800 qendra votimi ku pjesëmarrja e zgjedhësve gra ishte më pak se 10 për qind, dhe në disa zona të provincës Balochistan, pjesëmarrja e grave zgjedhëse zbriste deri në 2.9 për qind.<sup>76</sup> Në Afganistan, gjatë zgjedhjeve të 2009-s, gratë u kthyen në shënjestra të dhunës ekstremiste, ku mbi 650 qendra votimesh për gratë nuk u hapën, veçanërisht në rajonet e jugut dhe juglindjes. Talebanët shpërndanë të ashtuquajturat “letrat e natës” duke kërcënuar se do të prisnin gishtat e kujtdo që do shihej me shenjën e votimit (provë që personi kishte votuar). Shënjestrat e kësaj dhune ishin gratë.<sup>77</sup>

Gratë edhe mund të kanosen që të votojnë kundër bindjeve të tyre personale nëpërmjet votimit familjar. Më gjerësisht, votimi familjar i referohet situatës në të cilën kryefamiljarët (në të shumtën e rasteve meshkuj) influencojnë familjarët në dhënien e votës. Kjo është një praktikë e zakonshme në zonat që kanë struktura tradicionale të zakoneve familjare.<sup>78</sup> Votimi familjar mund të pengojë një grua nga dhënia e votës sipas bindjes së saj, ose ajo mund të jetë nën një pritshmëri të fortë kulturore për t’u bindur bashkëshortit apo babait dhe të votojë për kandidatin e partisë që i është diktuar. Votimi familjar mund të kryhet nëpërmjet kanosjes dhe frikësimit, duke përfshirë edhe kërcënimet me divorc. Në Tanzani, një raport i vitit 2015 konstatoi se shumë burra kërcënuan zgjedhëset gra kur i panë pranë qendrave të votimit, duke shkakuar që disa gra të kishin frikë nga ushtrimi i të drejtës së tyre për të votuar.<sup>79</sup> Një raport i nxjerrë nga Platforma Ndërpartiake e Grave në Tanzani (TWCP), e cila monitoronte DHNGZ-në në të njëjtin vit, konfirmoi incidentet e dhunës të kryera ndaj grave për shkak se kishin bindje politike të ndryshme nga bashkëshortët, familjet dhe/ose komunitetet; disa

73. Gabrielle Bardall, 2016. “Gender-Based Distinctions and Motivations in Political Violence.” (Dallime dhe nxitje me bazë gjinore në dhunën politike.) Në *Voices, Votes and Violence: Essays on Selected Dynamics of Electoral Authoritarianism*. (Zëra, vota dhe dhunë: ese në dinamika të përzgjedhura të autoritarizmit zgjedhor.) Universiteti i Montrealit. Shihni edhe Gabrielle Bardall, Elin Bjarnegård dhe Jennifer Piscopo, 2017. 74. Po ai.

75. UN Women Pakistan, 2016.

76. Po ai.

77. Ms. Magazine, 2009. “Women’s Fingers Cut Off in Afghan Election Violence.” (Grave u priten gishtat gjatë dhunës zgjedhore në Afganistan.) *Feminist Wire*, 24 gusht, cituar në UNDP, 2012.

78. Marrë nga UNDP/UN Women, 2015.



reagojnë. Kandidatet gra shpesh mund të ndihen të izoluar kur trajtojnë dhunën në zgjedhje. Sipas një studimi në vitin 2008 në Nepal, kandidatet gra nuk janë në dijeni të dhunës që përjetojnë gratë e tjera në politikë. Studimi konstatoi se 82 për qind e 117 kandidateve gra të intervistuar u shprehën se nuk kishin dijeni rreth faktit se kandidate të tjera gra po përballëshin me çfarëdolloj forme tjetër dhune.<sup>91</sup> Kjo vlente veçanërisht për kandidatet gra me më pak se një vit përvojë politike. Kjo i atribuohet faktit se “në shumicën e rasteve, gratë binden të shtypin ndjenjat e tyre për t’i shërbyer ‘të mirës së të gjithëve dhe ‘të ruajnë nderin’ e familjes”.<sup>92</sup> Për më tepër, në Nepal DHNGZ-ja nuk mbulohet nga media dhe mungon ndërgjegjësimi publik rreth problemit. Së bashku, këto tendenca përforcojnë izolimin dhe kulturën e heshtjes që mbulon përvojat e DHNGZ-së të kandidateve gra, që si rrjedhojë shton potencialin e kërcënimeve dhe ndjenjën e frikës.

### **PÛRKRAHËSET POLITIKE DHE STAFI I FUSHATËS**

PÛrkrahëset politike dhe stafi i fushatës janë gjithashtu shÛnjestrat e DHNGZ-s.<sup>93</sup> PÛrkrahëset gra të partisë mund të shÛnjestrohen në ambiente publike, si tubime, marshime dhe mitingje të fushatës, por edhe mund të shÛnjestrohen në ambiente private për shkak se mbÛshtesin fushatën e kandidateve gra dhe mbrojnë bindje politike të ndryshme nga ato të partnerëve të tyre intimë, familjes apo fisit. PÛr shembull, gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010 në Afganistan, u rrÛmbyen 10 gra që punonin në fushatën e një kandidateje grua dhe deputete, në një pÛrpkjekje aspak të suksesshme duke kanosur për tÛrheqje nga gara. Pesë gra u lanë të lira, por pesë të tjerat u qÛlluan dhe u vranë.<sup>94</sup>

### **ZYRTARËT ZGJEDHORË DHE STAFI I QENDRAVE TÛ VOTIMIT**

Në pÛrgjithÛsi, pÛrsÛritja e kulturës së seksizmit dhe dhunës nÛpÛrmjet akteve të ngacmimit seksual dhe/ose sulme të tjera me bazë gjinore ndaj grave në jetën publike mund t’i shkurajojë gratë nga pÛrfaqÛsimi i vetvetes në poste apo pozicione të shÛrbimit publik (si një EMB (Organ i Menaxhimit Zgjedhor) apo një ministri) gjatë zgjedhjeve. Kjo pÛrfshin punonjÛset gra të punÛsuara nga EMB-tÛ,

punonjÛset e qendrës së votimit, anÛtaret e komisioneve të EMB-sÛ, burokrate apo nÛpunÛse të qeverisÛ (nÛ nivel vendor, rajonal ose kombÛtar) edhe vÛzhguesit zgjedhorÛ. Kultura e vendit të punÛs nuk duhet të lejojÛ asnjÛ lloj diskriminimi të asnjÛ anÛtari të stafit, në veçanti diskriminim gjinor, apo kÛrcÛnime dhe ngacmime. Në vitin 2008, ish-kryetarja e Komisionit Qendror Zgjedhor të Kirgizistanit, dha dorÛheqjen nga posti, pasi ishte kÛrcÛnuar dhe gjendej në një dinamikÛ pushteti me të birin e Presidentit në atÛ kohÛ. Në deklaratat e saj, ajo pÛrmendi qÛ ai e kishte ofenduar dhe kishte kÛrcÛnuar sigurinë e saj.<sup>95</sup>

EMB-ja mund të duhet të ndÛrmarrÛ veprime që të mbrojnë punonjÛset e qendrave të votimit gjatÛ kohÛs që ato pÛrmbushin detyrat e tyre, veçanërisht ato të angazhuara në mÛnyrÛ aktive në regjistrimin e zgjedhÛsve ose që punojnÛ ditÛn e zgjedhjeve, sidomos në zona tradicionale apo konservatore ku gratë kanë një lÛvizje të kufizuar. PÛr shembull, në vitin 2004 në Afganistan, TalebanÛt hodhÛn në erÛ një autobus që po transportonte gra afgane të cilat po kryenin regjistrimet për të votuar në 2004-n, duke vrarÛ dy gra që punonin për organin zgjedhor Afgan-OKB, dhe duke lÛnduar nÛntÛ anÛtara gra të qendrës së votimit dhe dy fÛmijÛ.<sup>96</sup>

### **GRA NÛ POSTE POLITIKE**

DHNG-ja ndodh në të gjitha fazat e ciklit zgjedhor dhe në spektra të ndryshÛm, duke pÛrfshirÛ dhe periudhÛn paszgjedhore, kur pas zgjedhjeve gratë marrin postet e tyre në legjislaturÛ. KÛtjÛ dimensionin i referohemi edhe si dhuna ndaj grave në politikÛ (DHNGP). Kjo dhunÛ kÛrkon të heshtÛ zÛrat e grave në organet vendimmarrÛse duke u ndaluar atyre pjesÛmarrjen për ushtrimin e mandateve të tyre, duke i ndaluar ato nga të kÛrkuarit poste drejtuese në legjislaturÛ, duke i detyruar ato të japin dorÛheqjen pÛrpara pÛrfundimit të mandatit të plotÛ, duke i shkurajuar nga pjesÛmarrja në seancat parlamentare, duke detyruar pÛrjashtimin dhe marginalizimin brenda parlamentit dhe komisioneve dhe duke i shtyrÛ ato që të mos rizgjidhen. Mund të ndikojÛ edhe te gratë lidhur me rolet politike, si stafi i parlamentit dhe praktikantÛt.

86. Sipas deputetes keniane, PhoebeAsiyo. Cituar në SwaneeHunt, 2007. “LetWomen Rule,” (LÛrini gratë të drejtojnÛ.) PoliticsandSociety (Politika dhe shoqÛria), maj/qershor

87. Sipas MaryOkumu, cituar në Hunt, 2007.

88. PÛr më tepÛr informacion, shihni INE et al., 2016. “Protocolo para Atender la ViolenciaPolíticaContraLasMujeres.” (ProtokollinÛ pÛr trajtimin e dhunÛs politike ndaj grave.) Qyteti i MeksikÛs; dhe SEGOB/CONAPRED,

2016. Guía para la Acci3n PÙblica: Eleccioness indiscriminaci3n. (UdhÛzues pÛr veprim publik: zgjedhje pa diskriminim.) Qyteti i MeksikÛs.

89. UN Women Pakistan, 2016.

90. ZESN, 2015. Policy Brief: Challenges in AttainingGender Balance in Elections in Zimbabwe. (Dokument politikash: Sfidat në arritjen e balancÛs gjinore në zgjedhjet në Zimbabwe.) <http://www.zesn.org.zw/wp-con-tent/uploads/2016/10/policybrief.pdf>

## SHEMBUJ TË DHUNËS QË SHËNJESTROJNË KANDIDATET GRA

- ▶ Në **KENIA**, kandidatet gra shpesh janë viktime të DHNGZ-së. Një deputete grua konstatoi se “kostoja më e madhe për gratë që kandidojnë për deputete në Kenia është siguria 24-orëshe, e cila është e nevojshme për shkak të rrezikut të përdhunimit, një taktikë e zakonshme frikësimi”.<sup>86</sup> Një kandidate tjetër u shpreh se ajo ishte rrahur kur kandidoi për zgjedhje, dhe se ajo “mbante vazhdimisht dy thika të fshehura dhe vishte dy palë geta nën fustane në mënyrë që të fitonte më shumë kohë për të bërë turr gjatë një tentative përdhunimi,” dhe se “për gratë që kanë aspirata në politikë, dhuna përfshin edhe abuzim verbal të pisët, rrahje, rrëmbim dhe kërcënime me vdekje”.<sup>87</sup>
- ▶ Në **MEKSIKË**, zgjedhjet e vitit 2015 nxorën në pah problemin e DHNGZ-së. Organizatat civile dokumentuan raste të përdhunimit, shantazheve, ngacmimit dhe sulmit seksual, vrasjeve, rrahjeve dhe torturave të kandidateve gra. Numri në rritje i ankesave të dhunës dhe diskriminimit ndaj kandidateve gra çoi në thirrjen e Senatit për veprim, gjë që solli ndërhyrjen e Institutit Kombëtar Zgjedhor (INE) dhe Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Eliminimin e Diskriminimit (CONAPRED). U bë një apel urgjent për veprim dhe INE dhe CONAPRED hartuan një “Udhëzues për veprim publik: Zgjedhje pa diskriminim”.<sup>88</sup>
- ▶ Në **PAKISTAN**, disa zyrtare të zgjedhura dhe kandidate gra, të cilat u intervistuan pas zgjedhjeve të vitit 2013, raportuan se kishin përjetuar frikë, shpifje, cenim reputacioni, dhe lajmërimi të rreme, saqë një kandidate grua ishte tërhequr nga zgjedhjet në favor të një kandidati mashkull. Gjithashtu, ato përmendën se familjarët meshkuj të kandidateve grua ishin kërcënuar apo u ishin ofruar shuma parash në mënyrë që gruaja të tërhiqej. Intervistat sugjeruan se një nga format më të përhapura të dhunës ndaj kandidateve dhe politikanëve gra ishte pritshmëria e shërbimit seksual dhe kërcënimet me dhunë fizike dhe vdekje.<sup>89</sup>
- ▶ Në **ZIMBABVE**, një Dokument Politikash i vitit 2015 hartuar nga Rrjeti Mbështetës i Zgjedhjeve në Zimbabve, konstatoi se kandidatet gra përmenden frikën nga dhuna dhe viktimizimin si një pengesë e madhe e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje. Për më tepër, gratë e angazhuara me politikë damkoseshin si “të shturura, të vrazhda dhe që u mungonte eleganca e grave të respektueshme”. Disa gra konstatuan se ato ishin subjekt i ngacmimit seksual të vazhdueshëm gjatë përpjekjeve të tyre politike dhe zgjedhore.<sup>90</sup>

Dhuna ndaj figurave politike gra shpesh ndodh sepse gratë shihen si kërcënime të mundshme ndaj pushtetit tradicional mashkullor dhe statukuosë.<sup>91</sup>

### 4.3. KUSH JANË AUTORËT E DHNGZ-SË?

Identifikimi dhe të kuptuarit e atyre që kryejnë aktet e DHNGZ-së është kyç për të parandaluar dhe për të zbutur dhunën. Autorët e DHNGZ-së mund të klasifikohen

si aktorë politikë, shoqërorë apo shtetëror. Organet shtetërore dhe të partive politike janë përgjithësisht autorët në nivelin politik, ndërsa autorët e nivelit shoqëror janë pjesëtarët e familjes dhe komunitetit, udhëheqës tradicionalë dhe fetarë, banda, apo rrjete të tjera shoqërore, si dhe media. Autorët mund të jenë të të dyja gjinive, edhe pse shumica dërrmuese e autorëve të DHNGZ-së janë burra.<sup>104</sup> Vërtet, sipas një studimi

91. SAPI/International IDEA, 2008. Women, Representation and Violence: Exploring Constituent Assembly Election in Nepal. (Gratë, përfaqësimi dhe dhuna: eksplorimi i zgjedhjeve parlamentare në Nepal.) gusht.

92. Po ai.

93. UNDP, 2012.

94. BBC News, 2010. “Kidnapped Workers for Afghan Female MP Found Dead.” (Gjenden të vdekura punonjëset e rrëmbyera që punonin për deputeten afgane.) 29 gusht.

95. GenderStan, 2008. Female head of Kyrgyz Central Election Commission resigns over threats. (Kryetarja femër e Komisionit Qendror Zgjedhor të Kirgizistanit jep dorëheqjen për shkak të kërcënimeve.) Shtator.

96. Dawood Wafa, 2004. “Blast Kills 2 Female Poll Workers in Afghanistan.” (Shpërthimi vret dy punonjëse të qendrës së votimit në Afganistan.) Reuters, 27 qershor.

97. Për më shumë informacion mbi DHNGP, shihni Ballington, 2016; Elin Bjarnegard, 2016; Mona Lena Krook, 2017; Jennifer Piscopo, 2016.

## SHEMBUJ TË DHUNËS QË SHËNJESTROJNË POLITIKANET GRA:

- ▶ Në **AUSTRALI**, përvojat e ish-kryeministres së Australisë, Julia Gillard, janë kthyer në simbolin e abuzimit seksual që gratë në jetën publike vuajnë në mënyrë të vazhdueshme. Në fjalimin e saj mbi “seksizmin dhe mizogjininë” përpara parlamentit në vitin 2012, Gillard theksoi seksizmin me të cilin përballen gratë në jetën publike, duke paralajmëruar se ato “mund të presin” kërcënime të dhunës apo përdhunimit “pothuajse çdo ditë”. Në vitin 2016, Gillard vuri në dukje se, “Besoj se çështja e seksizmit, dhe në veçanti seksizmit me të cilin përballen gratë drejtuese, është një nga çështjet e bisedës botërore të kohërave tona. Nuk po rris rolin e fjalimit tim, por besoj se ka pasur sadopak ndikim”.<sup>98</sup>
- ▶ Në **BOLIVI**, në muajin prill 2010, Juana Quispe u zgjodh Këshilltare e bashkisë së Ancoraimes (Rajoni i La Paz) dhe mori pozicionin e saj më 31 maj. Por, që prej fillimit të mandatit të saj, ajo u shpreh se u keqtrajtua nga anëtarët e këshillit. Ajo dorëzoi disa ankesa ku denonconte abuzimin fizik dhe verbal, duke u shprehur se nuk e lejonin që të ushtronte të drejtat e saj politike dhe u hoq nga posti. Më 13 mars 2012, 32 ditë pasi kishte fituar të drejtën e saj si Këshilltare, Juana Quispe u gjend e vdekur. Rasti i Këshilltares Quispe, së bashku me shumë ankesa të tjera të grave në poste publike, çoi në miratimin e Ligjit kundër Ngacmimit dhe Dhunës Politike ndaj Grave (Nr. 243), datë 28 maj 2012.
- ▶ Gjithashtu në **BOLIVI**, një anketim i ndërmarrë nga Shoqata e Këshilltareve në Bashki (ACOBOL) tregoi se “36 për qind e të gjitha rasteve të ngacmimit dhe abuzimit [të regjistruara nga shoqata] synonin të detyronin këshilltaret gra që të jepnin dorëheqjen dhe t’i lironin vendin një kandidati mashkull apo alternative tjetër. Njëzet për qind e ankesave kishin të bënin me dhunën fizike dhe 19 për qind me ngacmimin dhe presione për t’i mbajtur gratë larg funksioneve të kontrollit dhe mbikëqyrjes në qeverisjen bashkiake. [Si rrjedhojë,] zakonisht, këshilltaret gra nuk kërkojnë një mandat të dytë”.<sup>99</sup>
- ▶ Në **ITALI**, Kryetarja e Dhomës së Deputetëve, Laura Boldrini, ka folur rreth ofendimeve mizogjiniste, kërcënimeve dhe imazheve zhvlerësuese që ka marrë kur kandidoi gjatë zgjedhjeve, si dhe ka denoncuar autorët e dhunës me bazë gjinore.<sup>100</sup>
- ▶ Në **PERU**, sipas një studimi të vitit 2015 nga Qendra Flora Tristán, dy në pesë gra të zgjedhura ishin të ngacmuara politikisht në qeveritë vendore dhe rajonale nga kryetarë bashkie, këshilltarë dhe kryetarë rajonalë meshkuj. Shumë raste përfshinin incidente të sulmeve fizike, kërcënime me vdekje, humbje të jetës ekonomike dhe abuzim verbal dhe psikologjik.<sup>101</sup>
- ▶ Në **TUNIZI**, një studim i grave të zgjedhura në Asamblenë Kushtetuese konstatoi se disa deputete gra kanë përjetuar ngacmim: “Ndërkohë që deputetët i përshkruajnë marrëdhëniet e tyre si të respektueshme, si deputetët meshkuj dhe femra raportojnë stereotipizim dhe komente negative, ngacmim verbal dhe sjellje agresive ndaj deputeteve gra. Për më tepër, deputetët gra të të gjitha sferave politike raportojnë se zgjedhjet apo stilet e veshjeve të tyre përbuzen haptazi. Anëtare të tjera kanë komentuar se media ka postuar fotografi të falsifikuara të tyre dhe kanë publikuar kritika të tjera”.<sup>102</sup>
- ▶ Në **ZIMBABVE**, gratë e zgjedhura nëpërmjet vendeve të rezervuara të miratuara me reformën kushtetuese të vitit 2013 kanë qenë subjekt i ngacmimeve verbale dhe turpërimit publik.<sup>103</sup>

98. John Morgan, 2016. “Julia Gillard dont ackling sexism against female leaders.” (Julia Gillard mbi ndalimin e seksizmit ndaj drejtuesve gra.) Times Higher Education.

99. Franz Chavez, 2009. “BOLIVIA: Politics, a Risky Business for Women,” (BOLIVI: Politika, një biznes i rrezikshëm për gratë.) InterPressService, 27 tetor.


100. Lizzy Davies, 2014. “Laura Boldrini: The Italian politician rising above the rape threats.” (Laura Boldrini: politikanja italiane që ngrihet mbi

kërcënimet e përdhunimit.) The Guardian, 9 shkurt.

101. Flora Tristan: Qendra e Gruas Peruviane, 2015. “Las Mujeres Rurales Dijeron NO a la Violencia de Genero,” (Gratë rurale i thonë JO dhunës me bazë gjinore.) 27 nëntor.

102. NDI, 2012. Tunisia’s National Constituent Assembly Gender Assessment. (Vlerësimi Kombëtar Gjinor i Asamblesë Kushtetuese në Tunizi.) F. 9

103. Informacion i ofruar nga Maureen Shonge, Zyra e UN Women në Zimbabve.





ndërshtetëror, gratë më vete kryen vetëm katër për qind të dhunës në zgjedhje; gratë dhe burrat së bashku kryen 20 për qind.<sup>105</sup> Autorët mund t'i përkasin më shumë se një kategorie, si për shembull kur një anëtar partie është edhe aktor shtetëror apo familjar.

Pavarësisht autorit, Shteti mban përgjegjësinë për mbrojtjen ndaj të gjitha llojeve të dhunës ndaj grave, duke dënuar nxitësit e dhunës dhe duke u ofruar kompensim dhe shërbime për viktimat. Kjo është një përgjegjësi ndërsektoriale që përfshin të gjithë sektorët e qeverisë, duke përfshirë ligjvënësin, gjyqësorin dhe shërbimin civil.

DHNGZ-ja është një shkelje e të drejtave të njeriut, dhe si e tillë, Shtetet mbajnë përgjegjësinë për të respektuar të drejtat e njeriut, duke përfshirë vlerësimin e ndikimeve aktuale dhe të mundshme të të drejtave të njeriut, integrimin dhe veprimin sipas gjetjeve, ndjekjen e reagimeve, si dhe për të komunikuar se si trajtohen ndikimet.

## AKTORËT POLITIKË

Brenda partive politike, autorët më të zakonshëm të DHNGZ-së janë kryetarët, kandidatët, anëtarët, përkrahësit dhe stafi i fushatës. Në shumë vende, partitë politike janë rruga kryesore drejt një posti të zgjedhur dhe shumë zgjedhin në mënyrë aktive që të promovojnë

dhe të mbështetin kandidatet gra. Por, në shumë raste, partitë politike (dhe kryetarët apo anëtarët e tyre) janë në fakt pengesa më e madhe ndaj ecurisë politike të grave. Incidentet e DHNGZ-së në partitë politike rriten gjatë zgjedhjeve, me qëllimin për të frenuar gratë dhe t'i ndalojnë nga realizimi i aspiratave të tyre politike. Kjo dhunë mund të kryhet brenda partive politike (d.m.th. dhuna brenda partisë) ose nga partitë politike rivale (d.m.th. dhuna ndërpartiake).

DHNGZ-ja brenda partisë ndodh kur partitë politike mund të kryejnë dhunë ndaj kandidateve gra dhe anëtareve të partive të tyre. Kjo mund të vijë si rezultat i rezistencës së tyre të thellë ndaj barazisë së grave në përgjithësi, ose ndaj prezantimit të një kandidateje në mënyrë specifike. Mund të jetë më e theksuar aty ku vendosen kuota gjinore ose kur ka garë brenda partisë për vende të kufizuara, si gjatë zgjedhjeve primare, apo kur përcaktohet pozicioni i kandidateve gra në listën e partisë. Edhe militantët e partive politike mund të venë në shënjestër kandidatet dhe zgjedhëset gra. DHNGZ-ja ndërpartiake, zakonisht, kryhet nga kryetarët apo anëtarët e partive politike kundrejt rivalëve të tyre. Shpesh, u drejtohet kandidateve femra të partisë opozitare. Përveç akteve fizike të dhunës, DHNGZ zakonisht përfshin edhe kërcënime ndaj fëmijëve të kandidates apo kërcënime për humbje të tjera apo lëndim personal.

Aktorë politikë	Aktorë shoqërorë	Aktorë shtetërorë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryetarët e partive politike</li> <li>• Kandidatët zgjedhorë</li> <li>• Anëtarët e partisë politike</li> <li>• Mbështetësit politikë</li> <li>• Stafi i fushatës</li> <li>• Militantët e partisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjedhësit</li> <li>• Pjesëtarët e familjes</li> <li>• Partnerë intimë, bashkëshortë</li> <li>• Anëtarë të komunitetit apo të grupeve</li> <li>• Udhëheqës fetarë apo tradicionale</li> <li>• Media</li> <li>• Punëdhënës dhe kolegë</li> <li>• Elementë krimi, duke përfshirë dhe grupe të armatosura joshitetërore</li> <li>• Grupe apo kadro të rinjsh</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktorë të sigurisë së shtetit (policia, forcat e armatosura)</li> <li>• Institucione qeveritare (pushteti ekzekutiv, gjyqësor dhe legjislativ)</li> <li>• Komisionerët zgjedhorë, punonjësit dhe siguria</li> <li>• Grupe joshitetërore (milicia, bandat, rebelët, siguria private)</li> </ul>

104. Bardall/IFES, 2011.

105. Po aty.



## SHEMBUJ TË AUTORËVE POLITIKË TË DHNGZ-SË

- ▶ Në **NEPAL** “kandidatet gra u viktimizuan nga kuadro të partive opozitare. Kishte incidente të dhunës fizike, si dhe kërcënime ndaj këtyre kandidatëve gra gjatë procesit zgjedhor. ... Kishte disa incidente ku kandidatet gra së bashku me personelin e tyre të sigurisë u sulmuan nga kuadro të partive të tjera”.<sup>106</sup>
- ▶ Në **PAKISTAN** kryetarët kryesorë të pesë partive më të mëdha politike nënshkruan marrëveshje formale ku deklaroi se ata nuk do të lejonin gratë që të paraqitnin aplikimin e tyre të kandidimit apo të votonin në zgjedhje, duke u bazuar në traditat vendase. Për më tepër, ata kërcënuan se do të nisnin një fushatë për të detyruara kandidatet gra që kishin paraqitur letrat e kandidimit që të tërhiqeshin dhe paralajmëruan organizatat e shoqërisë civile që të ndalonin mobilizimin dhe mbështetjen e grave për të marrë pjesë në zgjedhje. Gjithashtu, ata nxorën disa dekrete dhe edikte fetare nga xhamitë, duke pretenduar se pjesëmarrja e grave është jo-islamike dhe duke deklaruar se ata do të ndalonin gratë me forcë nga të shkuarit në qendrat e votimit. Si rrjedhojë, kandidatet gra dhe familjarët e tyre u ngacmuan dhe u vunë nën presion për t’u tërhequr nga kontestimi i zgjedhjeve.<sup>107</sup>
- ▶ Në **PARAGUAI**, një anëtare grua e partisë opozitare pohoi se asaj iu desh të largohej nga partia për shkak të ofendimeve të marra nga anëtarët e partisë së saj kur ajo nuk pranoi të caktohej si kandidatë alternative në listën zgjedhore. Kur ajo iu bashkua një fraksioni të ndryshëm të partisë së saj për të gjendur një vend në listën e kandidatëve, ajo u quajt tradhtarë nda ish-kolegët e saj dhe iu ndalua që të kandidonte.<sup>108</sup>
- ▶ Në **ZAMBIA**, partitë politike angazhojnë “kuadro” (banda të organizuara të të rinjve meshkuj) për të sulmuar dhe frikësuar kundërshtarët. Vitet e fundit, kuadrot kanë kërcënuar në mënyrë të vazhdueshme se do të “përdhunojnë në grup” kryetaren e opozitës Edith Nawakwi. Në qendrat rurale, kuadrot shënjestruan gratë e tezgave në vendet vendase duke i kërcënuar ato me humbjen e jetës së tyre nëse nuk do të votonin për një parti të caktuar.<sup>109</sup>

## AKTORË SHOQËRORË

Autorët shoqërorë të DHNGZ-së mund të jenë ose njerëz të lidhur ngushtë me kandidaten grua, si burri, babai apo pjesëtar tjetër i familjes, ose zgjedhës apo përkrahës së partisë, udhëheqës fetarë meshkuj, ose fshati apo fisi. Këta aktorë kryejnë akte të shënjestruara të dhunës të cilat janë shpesh personale në karakter, si përdhunimi, përjashtimi shoqëror apo ndalimi i daljes nga shtëpia. Udhëheqësit fetarë apo tradicionale, apo anëtarë të tjerë të komunitetit vendas të gruas, mund të kryejnë akte të dhunës për të ndaluar pjesëmarrjen ose për t’i detyruar zgjedhjet e tyre politike.

Forma të tjera të DHNGZ-së nga aktorët shoqërorë janë më pak intime por jo më pak të dëmshme. Media dhe gazetarët mund të sulmojnë pjesëmarrjen e grave nëpërmjet përfoljes dhe shpifjes.<sup>115</sup> Nënraportimi nga ana e medias kontribuon në kulturën e


pandëshkueshmërisë dhe heshtjes që shpesh shoqëron DHNGZ-në. Përfaqësimet e gabuara dhe/ose përpjekjet për të prekur reputacionin e kandidatëve gra (cenimi i reputacionit) mund të nxisë dhunën ndaj tyre.<sup>116</sup> Gjithashtu, media mund të vendosë platformën dhe tonin e DHNGZ-së duke degraduar apo turpëruar një kandidatë femër apo zyrtaret e zgjedhura duke u bazuar në veshjen, paraqitjen, apo zgjedhjet e tyre të jetesës, etj. Duke i futur kandidatet gra në këto korniza, media

106. SAP/IDEA, 2008.

107. Po ai.

108. QueremosParidad (Duam barazi), 2015. “ThreeHistorias de Mujeresque Han Luchado por Espaciosen sus PropiosPartidos.” 11 gusht.

109. Chatula Kampo, 2012. “Zambia: I Live in FearofBeingRaped.” (Zambia: jetoj me frikën se do të më përdhunojnë.) Timesof Zambia, 14 nëntor, cituar në UNDP, 2012



## SHEMBUJ TË AUTORËVE SHOQËRORË TË DHNGZ-SË:

- ▶ Në **REPUBLIKËN DEMOKRATIKE TË KONGOS**, një kandidate për presidente dëshmoi se kishte përjetuar kanosje dhe sulm fizik nga i shoqi, udhëheqësi fetar dhe familja si kundërpërgjigje e kandidimit të saj. Familja dhe udhëheqësi fetar e akuzuan atë se ajo ishte një 'prostitutë' pasi kishte ekspozuar veten në një fushatë publike dhe e detyruan të "zgjidhte ndërmjet martesës [së saj] dhe fëmijëve ose ambicies [së saj] politike". Kërcënimet e familjes e detyruan atë të largonte fëmijët nga vendi dhe ajo nuk mban më kontakte me familjen e saj apo ish-burrin.<sup>110</sup>
- ▶ Në **EL SALVADOR**, kandidatet gra kanë folur për DHNGZ-në e kryer nga pjesëtarë të familjes dhe/ose partnerë intimë kur ato vendosën të kandidonin dhe u përzgjedhën si kandidate në zgjedhje. Disa sryesh, konstatuan se ishin kërcënuar dhe shkura juar apo ndaluar haptazi nga pjesëmarrja.<sup>111</sup>
- ▶ Në **MOLDAVI**, në vitin 2016, besueshmëria e kandidates për presidente Maia Sandu u vendos në pikëpyetje nga një udhëheqës i Kishës Ortodokse të Moldavisë, i cili hodhi dyshime mbi moralitetin e Sandu-së pasi në moshën 44 vjeçare ajo nuk ishte as e martuar e as nënë.<sup>112</sup>
- ▶ Në **PAKISTAN**, gratë që votojnë mund të përjetojnë dhunën e ushtruar nga komuniteti i tyre. Gjatë zgjedhjeve vendore në muajin nëntor 2015, vetëm një grua shkoi të votonte në një qendër votimi në veri përëndim, me sa duket gruaja e para që votonte në 70 vitet e fundit për shkak të pakteve që i ndalonin gratë nga votimi. Ajo e përshkroi se "brenda natës u dëbua nga komuniteti". Në një intervistë me Radion Publike Kombëtare, votuesja u shpreh se kur u kishte thënë për herë të parë bashkëfshatarëve që po mendonte të votonte, ata e këshilluan që të "mbyllte gojën dhe të mos fliste më për këtë."<sup>113</sup>
- ▶ Në **SHBA**, studime të shumta gjatë 40 viteve të fundit kanë treguar në mënyrë konsistente se "kandidatet gra shpesh marrin më shumë mbulim [në media] rreth paraqitjes, personalitetit dhe familjeve të tyre dhe më pak mbulim rreth qëndrimeve të tyre mbi çështjet se sa kandidatët meshkuj. Këto dallime, të cilat shkojnë përtej thjesht gjuhës seksiste, mund të gërryejnë besueshmërinë e kandidates grua."<sup>114</sup>

shtron rrugën për DHNGZ, duke nxitur negativitetin, anshmërinë dhe agresionin ndaj grave që mbajnë poste të zgjedhura dhe publike.

Për më tepër, teknologjitë e reja të medias sociale dhe komunikimit, duke përfshirë rrjete si Facebook dhe Twitter, paraqesin platforma dhe mundësi shtesë për

të sulmuar gratë, dhe po ngrihen si një problem botëror me implikime serioze.<sup>117</sup> Një raport zbuloi se gratë kanë 27 herë më shumë gjasa që të abuzohen online në krahasim me burrat.<sup>118</sup> Së fundmi, disa politikane gra kanë folur rreth abuzimit dhe ngacmimit që ato marrin online, duke përfshirë dhe në Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA.<sup>119</sup>

110. QueremosParidad (Duam barazi), 2015. "Three Historias de Mujeres que Han Luchado por Espacios en sus Propios Partidos." 11 gusht.

111. Morena Herrera, Mitzzy Arias dhe Sara Garcia, 2012. Hostilidad y violencia política: Develando Develando Desvelando realidades de mujeres autoridades municipales. Sistematización de experiencias de violencia política que viven mujeres electas en gobiernos municipales en El Salvador O- NUMujeres, Santo Domingo.

112. Charles Recknagel, 2016. "In Moldova, Smears, Orthodox-Church Target Pro-EU Candidate Ahead Of Runoff." (Në Moldavi, Shpifje, Kisha Ortodokse vë në shënjestër kandidaten pro-Evropiane përpara

garës.) RadioFreeEu- rope. <https://www.rferl.org/a/moldova-sandu-smears-orthodox-church-pro-eu-candidate-russia/28108474.html>

113. Ekstrakt nga UN Women Pakistan, 2016.

114. Rachel Joy Larris dhe Rosalie Maggio, 2012. "The Women's Media Center Media Guide to Gender Neutral Coverage of Women Candidates and Politicians." (Udhëzuesi mediatik për mbulimin neutral gjinor të kandidateve dhe politikeve gra nga Qendra e Medias së Grave.)

115. UNDP, 2012.

116. Po ai.



**BANORËT E IL  
DE LA GONAVE,  
HAITI, KËRKOJNË  
EMRAT E TYRE NË  
LISTËN E VLEFSHME  
TË ZGJEDHËSVE NË  
ZYRËN VENDORE  
ZGJEDHORE.**

## AKTORË SHKETËRORE

Autorët me bazë shtetërore mund të jenë autorë të spikatur të DHNGZ-së. Ata përfshijnë forcat e sigurisë, siç janë forcat e armatosura kombëtare, policia dhe agjencitë e shërbimit informativ. Gjatë zgjedhjeve, komisionerët zgjedhorë, punonjës të qendrës së votimit dhe forcat e sigurisë zgjedhore mund të përfshihen në DHNGZ. Pas zgjedhjeve, autorët mund të përfshijnë dhe zyrtarë në poste politike dhe deputetët. Të gjitha pjesët e qeverisë, duke përfshirë pushtetin ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, mund të përfshihen në mënyrë aktive apo pasive në kryerjen e DHNGZ-së. Autorët shtetërorë të DHNGZ-së mund të kenë një axhendë të qartë diskriminuese, ose aktet e tyre mund të vënë në shënjestër minimin e një procesi nëpërmjet përdorimit të dhunës me specifike gjinore.

Taktikat e forcave të sigurisë mund të lëndojnë si gratë dhe burrat; për shembull, protestueset gra mund të jenë viktimat të brutalitetit të policisë gjatë shtypjes së një marshimi politik. Por, gjithashtu, gratë shpesh vihen drejtpërdrejt në shënjestër si pjesëmarrëse në tubime apo demonstrata politike, dhe mund të jenë viktimat të formave të urrejta seksuale dhe dhune politike me

bazë gjinore. Për shembull, në Guinea, gjatë dhunës që u ushtrua në Konakri më 28 shtator 2009, 167 persona u vranë ose u zhdukën, nga të cilët 109 gra ishin viktimat të mëparshme të përdhunimit, akteve të tjera të dhunës seksuale dhe gjymtimit seksual dhe skllavërisë seksuale.<sup>120</sup>

Ndërkohë që është një shqetësim i gjerë i të drejtave të njeriut dhe shpesh e lidhur me modele më të mëdha të dhunës ndaj grave, DHNGZ-ja është edhe një çështje bazike e sigurisë zgjedhore. Dhuna ndaj zgjedhësve gra shpesh ndodh për shkak të dështimit të administratës zgjedhore dhe ofruesve të sigurisë për të mbrojtur gratë nga kërcënime specifike me të cilat mund të përballen gjatë votimit. Ajo mund të jetë dhe rezultat i sulmeve dhe frikësimit të drejtpërdrejtë të ushtruar nga këta aktorë zgjedhorë. Vende të dendura votimi, radhë të gjata me votues meshkuj dhe femra, tensione të larta në gara të ngushta dhe kushte të tjera të Ditës së Votimit mund të kontribuojnë që votueset gra të bëhen viktimat të goditjeve dhe sulmeve në qendrat e votimeve. Punonjësit e qendrave të votimit jo të trajnuar mirë të cilët kanë përgjegjësi delikate, si verifikimi i identitetit të zgjedhësve gra të mbuluara apo vendosja e shenjës së gishtërinjve (që mund të kërkojë kontakt fizik) mund t'i bëjë zgjedhëset gra të ndihen të kërcënuara apo të frikësuara. Abuzime të këtij autoriteti mund të rezultojnë në shfrytëzim të drejtpërdrejtë.

117. UN Women, UNDP dhe ITU, 2015. *Cyber Violence against Women and Girls: A World-Wide Wake-Up Call*. (Dhuna kibernetike ndaj grave dhe vajzave: një thirrje mbarëbotërore për ndërgjegjësim.) Raport nga Komisioni i Transmetimit të OKB-së për Grupin e Punës të Zhvillimit Digjital.

118. Po aty f. 15.

119. Shihni për shembull, iKNOWPolitics, 2016. "Women in politics and cyberabuse in the United Kingdom" dhe Jessie Opoien, 2016. (Gratë në politikë dhe abuzimi kibernetik në Mbretërinë e Bashkuar). "Handling hate: Women in politics face a remarkable amount of sexist vitriol." (Trajtimi i urrejtjes: gratë në politikë përballen me një sasi të konsiderueshme të sarkazmës seksiste.) *The Capital Times*, 11 maj.

120. UN, 2009. "Report of the International Commission of Inquiry Mandated to Establish the Facts and Circumstances of the Events of 28 September 2009 in Guinea." (Raport i Komisionit Ndërkombëtar të Hetimit për të Zbuluar Faktet dhe Rrethanat në Ngjarjet e 28 shtatorit 2009 në Guinea.) UN doc. S/2009/693, Annex.

## SHEMBUJ TË AUTORËVE SHTETËROR TË DHUNËS NË INSTITUCIONE PUBLIKE:

- ▶ Në **KANADA**, në vitin 2016, një parlamentare grua, Michelle Rempel, foli për çdo rast seksizmi që ajo kishte përjetuar. Rempelvuri në pah se trajtimi i anshëm përfshinte të folurën përbuzëse nga kolegët meshkuj, përshkrimin si emocionale dhe marrjen e propozimeve dhe komenteve seksuale të padëshiruara.<sup>121</sup>
- ▶ Në **FRANCË**, në vitin 2016, 17 ish-ministre të qeverisë franceze nxorën një deklaratë të përbashkët ku shpreheshin se ato nuk do të heshtnin më mbi ngacmimin seksual në politikën franceze dhe u betuan se do të publikonin “të gjitha vërejtjet dhe sjelljet seksiste”, si dhe “veprimet dhe sjelljet e papërshtatshme” të kolegëve në korridoret e pushtetit politik francez.<sup>122</sup> Politikane të tjera gra kanë folur kundër “prekjes së përditshme, ngacmimit, komenteve seksiste dhe sulmeve seksuale të cilat gratë i nënshtrohen ende në parlament nga politikanët meshkuj.”<sup>123</sup>
- ▶ Në **IZRAEL**, në vitin 2016, të paktën dy deputete gra raportuan se ishin ngacmuar ose sulmuar seksualisht në Knesset (parlamenti i Izraelit). Një deputete, Merav Ben Ari, u shpreh se “fakti që jam një grua beqare në Knesset më bën të gjendem në situata të pakëndshme ... ndonjëherë njerëzit bëjnë komente ... dhe së fundmi pati një rast në Knesset.”<sup>124</sup>
- ▶ Në **SKOCI**, një raport i vitit 2016, konstatoi se gjashtë anëtare të këshillit të Glasgow-t shprehën qëllimin e tyre për të dhënë dorëheqjen, duke u ankuar nga kultura maskiliste dhe mjedisi i pakëndshëm i punës. Një këshilltare grua e përshkroi këshillin “si të ktheheshe në kohë në vitet 1970”.<sup>125</sup>
- ▶ Në **PERU**, Susana Villarán, një ish-kryetare bashkie e kryeqytetit Lima ka folur haptazi rreth sulmeve dhe kërcënimeve të ashpra dhe të dëmshme që ka marrë gjatë mbajtjes së postit, të cilat kishin për qëllim uljen e imazhit dhe të bënin të qartë se një grua si ajo nuk mund të përpiqej e të përçante botën mashkullore të politikës dhe pushtetit.<sup>126</sup>

Pas zgjedhjeve, institucionet shtetërore dhe ata që shërbejnë në to mund të kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në dhunë nëpërmjet mosveprimeve ose duke lejuar sjellje mundësuese.

Gratë mund të shënjestrohen nga kolegët në institucionet ku ato shërbejnë, nga parlamentet në këshillat vendorë dhe poste të tjera publike. Një kulturë seksizmi, ngacmimi seksual dhe/ose sulme ndaj karakterit me bazë gjinore në parlament ndaj deputeteve gra shkurajon pjesëmarrjen dhe praninë, mund të çojë në dorëheqje të parakohshme dhe mund të shkurajojë gratë nga të kërkuarit e një mandati të dytë. Në shumë vende, parlamentarët meshkuj

janë përfshirë në turpërimin publik të udhëheqëseve politike gra, duke detyruar dorëheqjen e parlamentareve gra, dhe ndërmorën kërcënime fizike dhe politike ndaj grave në poste publike.

Tradicionalisht, incidentet e DHNGZ-së lidheshin më së shumti me gratë që shënjestroheshin për shkak të lidhjes së tyre me politikanët meshkuj (si gra, nëna dhe fëmijë) dhe si viktime të afërta që përdorshin për të kërcënuar dhe shkurajuar bashkëshortët/baballarët/bijtë/vëllezërit e tyre nga ambicet e tyre politike.<sup>127</sup> Por, kjo perspektivë është tashmë e vjetër, siç do të shihet më poshtë.

121. Michelle Rempel, 2016. “Confront your Sexism.” (Përballu me seksizmin tënd.) National Post, 18 prill.

122. Lou Lorscheider, 2016. “French Ex-ministers take on Sexual Misconduct in Politics.” (Ish-ministret franceze trajtojnë sjelljet e pahijshme seksuale në politikë.) Zëri i Amerikës, 15 maj.

123. Angelique Chrisafis, 2016. “We can no longer stay silent”: Fury erupts over sexism in French politics.” (Nuk mund të heshtim më: Shpërthen tërbimi ndaj seksizmit në politikën franceze.) The Guardian, 13 maj.

124. Max Bearak, 2016. “Almost all of Israel’s 32 women in parliament have been sexually harassed or assaulted.” (Pothuajse të gjitha 32 gratë në parlament janë ngacmuar ose sulmuar seksualisht.) Washington Post, 31 maj.

125. 2016. “Half of Labour’s female councillors in Glasgow to quit ‘macho’ council.” (Gjysma e këshilltareve laburiste gra në Glasgow japin dorëheqjen nga këshilli ‘maskilist’.) iKNOW Politics, 16 qershor.

126. Liz Ford, 2016. “From Peru to Kosovo, female MPs aim to end abuse of women in politics.” (Nga Perua në Kosovë, deputetet gra kanë për qëllim t’i japin fund abuzimit të grave në politikë.) The Guardian, 24 mars.

# SHKAQET DHE PASOJAT E DHNGZ-së

## 5.1. PËRSE NDODH DHNGZ-JA?

DHNGZ është një fenomen botëror në rritje që përqipet të frenojë gratë dhe të ndalojë pjesëmarrjen e tyre politike autonome/të pavarur. Ajo i ndalon gratë nga ushtrimi dhe realizimi i të drejtave të tyre politike, si në hapësirat publike dhe ato private. Ajo nxitet nga motivime dhe diskriminime specifike gjinore, veçanërisht kur gratë sfidojnë rolet tradicionale dhe angazhohen në politikë. Një ligjvënese kanadeze e përmbloodhi si më poshtë: “Realiteti është se gratë e përfshira në jetën publike në mbarë botën, në mënyrë të vazhdueshme frikësohen, kërcënohen, ndalohen, u mbyllet goja, tallen, dhe në disa raste, torturohen, përdhunohen dhe vriten. Këto veprime kërcënuese dhe vdekjeprurëse janë të rrënjësura ndër breza në legjislacion, rregullime dhe marginalizimin e hapësirës dhe veprimit të grave.

Drejtimi i shërbimit publik, diskursit dhe qeverisjes nuk është fusha ekskluzive e burrave”.<sup>128</sup> DHNGZ është një formë tjetër e Dhunës me Bazë Gjinore që ka për qëllim të mbajë gratë në varësi. Gratë përjetojnë dhunë politike të nxitur nga gjinia sepse pjesëmarrja e tyre në procesin zgjedhor kërcënon mbizotërimin e strukturës së pushtetit mashkullor dhe si një formë ndëshkimi pasi nuk bien konform roleve gjinore që u vishen grave. Si rrjedhojë, disa lloje të DHNGZ-së mund të shihen si një “reagim i ashpër” ndaj ngritjes së grave në jetën publike.<sup>129</sup> Disa nga këto motivime specifike gjinore përfshijnë ndalimin e grave nga votimi i pavarur, frenimi i kandidateve femra ose nxitja e dhënies së dorëheqjes së grave të zgjedhura. DHNGZ i ndalon gratë nga mbajtja e posteve publike, nga zhvillimi i lirshëm i fushatës ose nga shprehja e bindjeve politike pa frikën

e hakmarrjes apo sfidës në shtëpitë, komunitetet dhe hapësirat e tyre publike.<sup>130</sup> Sa më shumë që gratë bëhen të dukshme në politikë dhe rriten numrat e tyre, po ashtu rritet dhe korrelacioni me DHNGZ-në. Për shembull, gjatë një studimi të DHNGZ-së në Nepal, studiuesit zbuluan se gratë me më shumë arsim dhe përvojë përballëshin me incidente më të dhunshme në krahasim me grupet e tjera, duke sugjeruar se “natyra e dhunës është e ndërlidhur me profilin e kandidateve gra”.<sup>131</sup>

Disa vende kanë pësuar rritje të DHNGZ-së që u atribuohen miratimit dhe zbatimit të kuotave ligjore, të cilat kanë për qëllim rritjen e përfaqësimit të grave si kandidate në listat zgjedhore ose në legjislaturë nëpërmjet vendeve të rezervuara. Një raport konstaton se në Kenia, kryetarët dhe kandidatët meshkuj të partive “kanë shtrembëruar parimin e veprimit afirmativ të përcaktuar në kushtetutën e vitit 2010 duke i ndaluar ato nga pjesëmarrja në zgjedhje nëpërmjet mosrespektimit të heshtur të zbatimit të kuotave, duke i tallur kandidatet gra dhe nëpërmjet dhunës dhe kanosjes. Gratë e emëruara për Asamblenë e Kontesë nëpërmjet kuotave quhen ‘Pikët Bonga’ (d.m.th. pikët shtesë) dhe nuk u rezervohet i njëjti

127. Bardal/IFES, 2011.

128. Është shtuar theksi në fjali. NahanniFontaine, deputete e Asamblesë Ligjvënese të Manitobas duke nderuar Jo Cox në një fjalim para Kuvendit. Cituar në Laura Glowacki, 2016. “Manitoba MLA speaks out about violence against women in politics.” (Deputetja e Asamblesë Ligjvënese të Manitobës flet për dhunën ndaj grave në politikë.) CBS News, 20 qershor.

129. Shihni edhe Krook, 2017.

130. Përshtatur nga UNW/PurnaSen, 2016.

131. SAPI/International IDEA, 2008.

## REAGIM I DHUNSHËM NDAJ BARAZISË KUSHTETUESE NË ZGJEDHJET VENDORE NË MEKSIKË

*Për disa autorë, motivi është frenimi i grave nga kandidimi ose nxitja e tërheqjes së tyre nga gara në mënyrë që të mbajnë kontrollin patriarkal të fushës politike. Përpara zgjedhjeve vendore të vitit 2015 në Meksikë, gratë nga një sërë fushash të ndryshme (politikane, organizata feministe, rrjete, OSHC, eksperte dhe akademike) denoncuan valën e dhunës ndaj kandidatëve gra, të cilën ato e perceptonin si një reagim ndaj dispozitave kushtetuese që kërkonin barazi midis kandidatëve (50 për qind gra). Kostoja e grave që vendosën të kandidonin në arenën politike të dominuar nga meshkujt ishte rritja ekstreme e dhunës.<sup>132</sup>*

*Zgjedhjet u mbajtën në 17 shtete të Meksikës, dhe kandidatet gra raportuan përjetimin e formave të ndryshme të dhunës, duke përfshirë abuzimin verbal dhe dhunën fizike, komente seksiste të bëra gjatë zhvillimit të fushatës dhe në media, dhe marrjen e kërcënimeve të dhunës fizike, dhunës seksuale, rrëmbimit dhe vrasjes, duke përfshirë dhe ato në median sociale. Disa gra u shprehën se për to u shpif në media me akuza të rreme mashtrimi dhe korrupsioni për t'i detyruar ato që të tërhiqnin kandidaturën. Midis autorëve të përmendur ishin zyrtarët në detyrë dhe kandidatët meshkuj, grupe të armatosura meshkujsh të lidhur me konkurruesit meshkuj, udhëheqësit e komunitetit dhe bashkanëtarët e partive politike.<sup>133</sup>*

respekt në mbledhje si anëtarëve të tjerë”.<sup>134</sup> Për më tepër, gratë që janë zgjedhur nëpërmjet kuotave apo vendeve të rezervuara shpesh përballen me më shumë kontrolle të mënyrës së zgjedhjes së tyre se sa ato të zgjedhura nëpërmjet vendeve “të hapura”. Ato kanë më shumë gjasa që të përballen me seksizëm dhe tallje,<sup>135</sup> dhe të abuzohen verbalisht dhe të gjykojnë më ashpër nga publiku dhe media, duke zvogëluar legjitimitetin e tyre si udhëheqëse të zgjedhura. Ndërkohë që akte të dhunës së drejtpërdrejtë të nxitura nga gjinia janë të rrënjësura në mizogjini, DHNGZ-ja e tërthortë shpesh shkaktohet dhe nga pabarazi me bazë gjinore në shoqëri. DHNGZ-ja e tërthortë (d.m.th. lloje të ndryshme të dhunës zgjedhore që prekin burrat dhe gratë në mënyrë të ndryshme) shpesh ndodh sepse gratë dhe burrat priren të kenë hapësira të ndryshme në jetën ekonomike dhe politike të vendeve të tyre. Këto hapësira dhe role shpiten në dallime gjinore në llojin e dhunës zgjedhore dhe në kategorinë e viktimave.<sup>136</sup> Për shembull, aty ku nuk ka ose ka shumë pak candidate gra, mund të ketë shumë pak candidate gra viktime të dhunës zgjedhore. Sidoqoftë, kur dhuna politike shënjestron hapësirat publike, të tilla si tregjet apo shkollat që frekuentohen më shumë nga gratë, ato kthehen në viktimat kryesore në mënyrë joproporcionale. Gjithashtu, gratë kanë më shumë gjasa të jenë viktime të sulmeve të seksualizuara dhe të akteve

të kërcënimit për shkak të pozitës së pushtetit që ato kanë në shoqëritë e tyre. Për shembull, një studim në Maldive<sup>137</sup> tregon se sulmet seksualisht poshtëruese ndaj grave gjatë zgjedhjeve kishin për qëllim të provokonin dhe të frikësonin kundërshtarët dhe jo të largonin gratë nga sfera politike. Por, fakti që autorët zgjedhën që të përdornin sulmin seksual, në vend të një lloji tjetër dhune, pasqyron dallimin e dhunës bazë gjinore .

### 5.2. CILAT JANË NDIKIMET E DHNGZ-SË?

Duhet të merren parasysh ndikimet specifike të DHNGZ-së në procesin politik dhe zgjedhor, krahas pasojave psikologjike dhe fizike afatshkurtër dhe afatgjatë për viktimat e DHNGZ-së dhe ndikimet më të gjera në familjet dhe komunitetet e tyre. Në përgjithësi, ndikimet më të zakonshme dhe të menjëhershme të dhunës zgjedhore njihen si:

132. AnayeliGarcíaMartínez, 2015. “Reportaje - Reacciónviolenta del patriarcadocontra la paridad.” Cimacnoticias, Meksikë, 3 gusht.

133. Po aty.

134. TamO’Neil dhe Pilar Domingo, 2016. Womenandpower: Overcomingpengess to leadershipand influence. (Gratë dhe pushteti: Kapërcimi i pengesave të udhëheqjes dhe influencës.) Raport, ODI.

135. Po aty.

136. Bjarnegard, 2016; Krook, 2017; Piscopo, 2016.

137. Bjarnegard, 2016.







कह दो सब डंके की चोट  
महिलाओं को देंगे वोट

बेलवाले कामवाले  
मजदूरों का कामवाले

अपना



## PJESA B:

### NDËRMARRJA E VEPRIMEVE PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E DHNGZ-SË

1. HARTËZIMI DHE MATJA E DHNGZ-SË	51
2. INTEGRIMI I DHNGZ-SË NË VËZHGIMIN ZGJEDHOR DHE MONITORIMIN E DHUNËS	63
3. REFORMA LIGJORE DHE POLITIKASH PËR PARANDALIMIN DHE REAGIMIN NDAJ DHNGZ-SË	70
4. PARANDALIMI DHE ZBUTJA E DHNGZ-SË NËPËRMJET RREGULLIMEVE ZGJEDHORE	85
5. PUNA ME PARTITË POLITIKE PËR TË PARANDALUAR DHE REDUKTUAR DHNGZ-NË	94
6. NDËRGJEGJËSIMI DHE NDRYSHIMI I NORMAVE	100



# MATRICA 1:

## PROPOZIMET PËR ZBUTJEN DHE PARANDALIMIN E DHNGZ-SË

PROPOZIME	FAZA PARAZGJEDHOR
<b>1. HARTËZIMI DHE MATJA E DHNGZ-SË</b> <i>(p.sh. organizata ndërkombëtare dhe rajonale, OSHC-të, programe kombëtare, programe të monitorimit të dhunës)</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>Realizoni hartëzimin e DHNGZ-së në nivel vendor dhe rajonal</li><li>Përfshini DHNGZ-në në EMB dhe vlerësimet e sigurisë në zgjedhje</li><li>Hartoni dhe përcaktoni treguesit</li><li>Përshtatni ose ndërtoni mbi treguesit dhe mjetet matëse aktuale të DHNG-së</li><li>Konsideroni përfshirjen e DHNGZ-së në monitorimin e OZHQ-ve përkatëse</li><li>Konsideroni të përdorni kontributin online nga njerëzit dhe mjetet e vizualizimit të të dhënave</li></ul>
<b>2. INTEGRIMI I DHNGZ-SË NË VËZHIMIN ZGJEDHOR DHE MONITORIMI I DHUNËS</b> <i>(p.sh. organizata ndërkombëtare dhe rajonale, OSHC-të, vëzhguesit zgjedhorë, partnerë të Bordit të Situatës së Grave)</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>Përshtatni dhe integroni DHNGZ-në në vëzhgimet zgjedhore ndërkombëtare dhe vendore</li><li>Integroni DHNGZ-në në sistemin e hershëm paralajmërues të dhunës zgjedhore</li><li>Integroni një perspektivë gjinore në mjetet ekzistuese të monitorimit të dhunës në zgjedhje</li><li>Identifikoni treguesit që duhen matur</li><li>Përfshini ndjeshmërinë gjinore në trajnimet e vëzhguesve</li><li>Siguroni që DHNGZ-ja monitorohet dhe raportohet në Bordet e Situatës së Grave dhe në programe të tjera të monitorimit të shoqërisë civile (p.sh. të drejtat zgjedhore dhe të njeriut)</li><li>Zhvilloni mjetet të harmonizuara të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave</li></ul>
<b>3. REFORMA LIGJORE DHE POLITIKASH PËR PARANDALIMIN DHE REAGIMIN NDAJ DHNGZ-SË</b> <i>(p.sh. Legjislatura dhe ligjvënësit, organet e menaxhimit zgjedhor, organizata ndërkombëtare dhe rajonale, gjykata, parti politike)</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>Miratimi i ligjeve dhe politikave që përcaktojnë dhe mbrojnë ndaj DHNGZ-së</li><li>Përshtatni legjislacionin ekzistues të Eliminimit të DHNG-së (EDHNG) për të ofruar masa të qarta në mbrojtjen ndaj DHNGZ-së</li><li>Protokolle dhe rregullime të miratuara nga EMB-të për parandalimin e DHNGZ-së në procesin zgjedhor</li><li>Kodet e sjelljeve zgjedhore dhe të partive politike duhet të trajtojnë DHNGZ-në</li><li>Ofroni trajnime me ndjeshmëri gjinore për forcat e policisë, gjykesit, gjyqtarët, OSHC-të, etj., të cilët mund të trajtojnë rastet e raportuara të DHNGZ-së</li></ul>
<b>4. PARANDALIMI DHE ZBUTJA E DHNGZ-SË NËPËRMJET RREGULLIMEVE ZGJEDHORE</b> <i>(p.sh. EMB-të, ministritë përkatëse të linjës, sektori i sigurisë/policia)</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>EMB-të sigurojnë që çdo monitorim i dhunës apo vlerësime të rrezikut të përfshijnë marrjen parasysh të DHNGZ-së</li><li>Trajnioni stafin e EMB-ve mbi DHNGZ-në dhe reagimet</li><li>Merrni masa për të pakësuar votimin familjar sipas nevojës</li><li>Integroni DHNGZ-në në edukimin e zgjedhësve, duke përfshirë ndërgjegjësimin mbi fshehtësinë e votës dhe votimin familjar</li><li>Njësia përkatëse brenda EMB-së caktohet me adresimin e shqetësimeve gjinore dhe DHNGZ-së</li><li>Ofroni mbrojtje të kandidatëve gra</li><li>Trajnioni forcat e policisë dhe sigurisë rreth DHNGZ-së</li><li>Rrisni numrin e grave në forcat e policisë dhe në poste drejtuese</li></ul>
<b>5. PUNA ME PARTITË POLITIKE PËR TË PARANDALUAR DHE REDUKTUAR DHNGZ-NË</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>Mbuloni të gjitha partitë politike për të vazhduar me punën advokuese</li><li>Respektoni kodet legjislative të sjelljes dhe sensibilizoni anëtarët e partisë</li><li>Miratoni kodin tuaj të sjelljes sipas nevojës</li><li>Përditësoni rregulloret dhe statutet e partisë për adresimin e DHNGZ-së</li><li>Monitoroni dhe zbatoni politikat dhe praktikën e partisë për DHNGZ-në</li><li>Siguroni rregulla transparente për përzgjedhjen e kandidatëve dhe akses në financimin politik</li><li>Prezantoni çështjet e DHNGZ-së në trajnimet dhe në materialet e përpjekjet për mbulimin e votuesve</li><li>Nxitni miratimin e një deklaratë të përbashkët publike nga partitë politike ku angazhohen të respektojnë kodet e sjelljeve dhe të drejtat e njeriut</li><li>Trajnioni agjentë/vëzhgues të partisë për monitorimin e DHNGZ-së</li></ul>
<b>6. NDËRGJEGJËSIMI DHE NDRYSHIMI I NORMAVE</b> <i>(p.sh. ligjvënësit dhe rrejtet parlamentare, OSHC-të, media, burrat, organizatat ndërkombëtare dhe rajonale)</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>Zhvilloni fushata ndërgjegjësimi për parandalimin e DHNGZ-së</li><li>Përshtatni programet e trajnimit për të prezantuar DHNGZ-në</li><li>Përshtatni materialet të mbulimit civil me çështjet e DHNGZ-së</li><li>Angazhim për të raportuar rastet e DHNGZ-së në media</li><li>Ngritja e kapaciteteve të mediave për DHNGZ-në</li></ul>

## FAZA ZGJEDHOR

- Mblidhni dhe verifikoni të dhënat
  - Përshtatni dhe integroni DHNGZ-në në mjetet e monitorimit
- Përshtatni dhe integroni DHNGZ-në në mjetet e vëzhgimit
  - Synoni balancën gjinore në ekipet e vëzhgimit të zgjedhjeve
  - Integroni raportimin në grupet e Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ)
- Mundësoni aksesin në drejtësinë zgjedhore për gratë, dhe kërkoni drejtësi për viktimat
  - Krijoni metoda për raportimin e sigurtë dhe konfidencial të rasteve të DHNGZ-së
- Konsideroni rregullime për fshehtësinë e votës për votuesit
  - Planifikoni logjistikën për ditën e votimit duke përfshirë ndjeshmërinë ndaj DHNGZ-së (qendra votimi me ndarje gjinore, roje sigurie femra/ forca policore të sensibilizuara në zonat me rrezikshmëri të lartë, punonjës të qendrave të votimit të sensibilizuar ndaj DHNGZ-së)
  - Qendra votimi të ndara sipas gjinisë nëse është e nevojshme për të ulur dhunën ose presionet për votim familjar
  - Caktoni oficerë të policisë femra në qendrat e votimit vetëm për gratë
  - Siguroni mbrojtjen e komisionerëve të zgjedhjeve
- Rekrutoni dhe shpërndani në terren më shumë gra në rolin e agjenteve të partisë
- Ngrini kapacitetet e mediave për DHNGZ-në
  - Monitoroni mediat për anshmëri gjinore
  - Angazhoni burrat si aleatë dhe avokues me ndikim të lartë

## FAZA PASZGJEDHOR

- Analizoni rezultatet e përpjekjeve të mbledhjes së të dhënave
  - Siguroni ndarjen dhe raportimin e të dhënave
  - Identifikoni hendeqet dhe përmirësoni treguesit sipas nevojës
  - Përfshini DHNGZ-në në raportet dhe gjetjet paszgjedhore
- Siguroni ndarjen dhe raportimin e të dhënave
  - Identifikoni hendeqet dhe ofroni rekomandime
  - Përfshini dimensionin gjinor dhe qasjen me bazë në të drejtat e njeriut në raportin dhe gjetjet e vëzhgimit
- Siguroni zbatimin e ligjeve dhe politikave të DHNGZ-së
  - Rishikoni ligjet dhe politikat dhe kryeni përshtatjet sipas nevojës
  - Gjykoni mosmarrëveshjet zgjedhore që lidhen me DHNGZ-në
  - Siguroni hetimin dhe ndjekjen penale të shkeljeve dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut ndaj grave në politikë
  - Përshtatni dhe integroni burime të reja për viktimitë në shërbimet aktuale për DHNGZ-në
- Përfshini dimensionin gjinor në rishikimin paszgjedhor
  - Zbatoni ndëshkimet ndaj shkeljeve lidhur me gjininë
- Siguroni që përfaqësueset e përzgjedhura gra përkrahen në funksionet e tyre
  - Siguroni që asnjë grua nuk detyrohet të heqë dorë nga posti i saj në përfitim të burrave
- Identifikoni mësimet e nxjerra
  - Shfrytëzoni edukimin qytetar për të informuar publikun dhe formuesit e opinionit mbi DHNGZ-në
  - Ndëshkime dhe sanksione për shkeljet e medias
  - Angazhoni ligjvënësit dhe rrjetet parlamentare



Empowered lives.  
Resilient nations.







# PROPOZIMI 1:

## HARTËZIMI DHE MATJA E DHNGZ-SË

Ndërkohë që përcaktimi dhe matja e DHNGZ-së mbetet e vështirë, profesionistët, studiuesit dhe palët e interesit bien dakord se DHNGZ-ja duhet të emërtohet, monitorohet dhe të eliminohet.<sup>138</sup> Hartëzimi dhe mbledhja e të dhënave rreth DHNGZ-së është hapi i parë kritik në zbutjen dhe parandalimin e DHNGZ-së, pasi mundëson identifikimin dhe matjen e problemit, modelit të tij dhe lidhjet për t'u kuptuar, si dhe reagimet përkatëse për t'u përvetësuar. Deri më sot, DHNGZ-ja ka mbetur kryesisht e padukshme sepse rrallëherë është dokumentuar në mënyrë sistematike. Informacioni mbi prevalencën dhe incidencën shërben si një udhëzues i vlefshëm mbi informimin e reagimeve të programuara të parashtruara në matricën e mësipërme. Në çdo kontekst, treguesit për matjen e DHNGZ-së duhet të përzgjidhen ose të përdoren në një studim longitudinal si për incidencën (d.m.th. numrin e ngjarjeve gjatë periudhave specifike kohore) dhe prevalencën (d.m.th. përqindjen e popullatës që përjeton aktet e DHNGZ-së).<sup>139</sup>

Ky seksion ofron opsione për matjen dhe monitorimin e DHNGZ-së, duke përfshirë:

1. Përdorimin e hartëzimit të synuar për të identifikuar pika të nxehta dhe modele të mundshme të DHNGZ-së, duke përfshirë profilet rajonale dhe kombëtare, hartëzimin nga organet e menaxhimit të zgjedhjeve (EMB-të) dhe vlerësimet e përgjithshme të sigurisë;
2. Përcaktimi i matjeve dhe treguesve të DHNGZ-së;
3. Shfrytëzimi i mundësive për mbledhjen e të dhënave të DHNGZ-së nëpërmjet nismave ekzistuese, duke përfshirë monitorimin dhe matjen e DHNGZ-së, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe kontributin online nga njerëzit.

### 1.1. HARTËZIMI I DHNGZ-SË

Hartëzimi i DHNGZ-së ofron një themel për synimin dhe zhvillimin e ndërhyrjeve të informuara në fakte. Një hartëzim i DHNGZ-së ka për qëllim të ekzaminojë situatën për pjesëmarrjen zgjedhore të grave, të ndihmojë me identifikimin e pikave të nxehta, të identifikojë modele të dhunës dhe të mundësojë vendosjen e masave parandaluese dhe reaguese përkatëse.

Përpjekjet e hartëzimit duhet të identifikojnë si po përdoret ose është përdorur DHNGZ-ja për të shkrajuar, shtypur ose ndaluar gratë nga ushtrimi i të drejtave të tyre zgjedhore si votuese, candidate, përkrahëse partie, komisionere, vëzhguese, gazetare, ose zyrtare publike. Çdo hartëzim i tillë duhet të përpiqet të ekzaminojë situatën aktuale për pjesëmarrjen zgjedhore të grave dhe potencialin për DHNGZ, dhe mund të shoqërohet dhe me sugjerime se si të zbutet më mirë. Një hartëzim i DHNGZ-së duhet të mbulojë të gjitha fazat e ciklit zgjedhor: para, gjatë dhe pas zgjedhjeve, pasi format e DHNGZ-së mund të jenë të ndryshme në varësi të kohës që ndodh dhuna. Pyetjet kyçe për t'u marrë parasysh në hartëzimin e DHNGZ-së janë:

#### INCIDENTE TË SHKUARA DHE/OSE AKTUALE TË DHNGZ-SË:

- Çfarë? A ishin aktet e DHNGZ-së të një natyre psikologjike, fizike apo seksuale? Çfarë formash merr: sulm, kanosje, ngacmim apo vrasje?
- Ku? Ku ndodhi DHNGZ-ja, në kontekstin e familjes, komunitetit ose shtetit, në sferën publike apo private? Cili është konteksti aktual politik duke pasur parasysh zgjedhjet e ardhshme?
- Kush? Kush ishin autorët kryesorë të DHNGZ-së? Cilat ishin motivimet e tyre?
- Ndaj kujt? Kush ishin viktimat e DHNGZ-së?

- Veprimi i marrë? A kishte ndonjë ankesë, sanksion, ndjekje penale?

#### KUADRI LIGJOR, INSTITUCIONAL DHE I POLITIKAVE:

- Cilat janë detyrat e Shtetit? A janë ratifikuar traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (p.sh. CEDAW dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, ICCPR)? Çfarë ligjesh dhe politikash ekzistojnë për mbrojtjen e grave dhe për parandalimin e dhunës ndaj tyre dhe DHNGZ-së? Cilat institucione ekzistojnë? EMB-të, komisionet zgjedhore, ministritë e linjës?
- A ka kode të sjelljes për partitë politike, për forcat e mbrojtjes dhe sigurisë dhe/ose për stafin zgjedhor?
- Cilat të drejta u shkelën/janë shkelur/po shkelen nëpërmjet akteve të DHNGZ-së?

#### MONITORIMI:

- A monitorohet DHNGZ-ja? Nga kush?
- A ka grupe të caktuara grash që e përjetojnë dhunën në përqindje më të madhe? Cilat janë karakteristikat e tyre? A ka një model specifik të dhunës që përjetojnë këto grupe?

- A ka tregues të dakordësuar më herët për matjen e DHNGZ-së në kontekstin kombëtar?
- A ka organizata të përfshira në mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e DHNGZ-së? Cilat? A kanë kryer ndonjë trajnim për ndjeshmërinë gjinore?
- Cilat janë mësimet e nxjerra nga monitorimi i zgjedhjeve të mëparshme?
- A janë përdorur masa për parandalimin e DHNGZ-së?
- A janë marrë masa për t'u ofruar mbështetje grave që kanë përjetuar DHNGZ-në?
- A ekziston mbulimi i medias për të vlerësuar mbulimin e zgjedhjeve nga perspektiva gjinore?

#### A. HARTËZIMI KOMBËTAR DHE RAJONAL I DHNGZ-SË

Një burim premtues për hartëzimin e fushëveprimit të DHNGZ-së përfshin raste studimore të vendeve dhe studime rajonale, të cilat përpiqen të kapin informacion cilësor dhe sasior. Metodologjitë e këtyre studimeve të hartëzimit variojnë (duke përfshirë kërkimin për zhvillimin dhe organizimin dhe analizat akademike) dhe ka një llojshmëri të dhënash që përdoren, por studimet ofrojnë informacion të pasur në identifikimin e natyrës, shkaqeve dhe pasojave të DHNGZ-së.<sup>140</sup>

## SHEMBUJ TË HARTËZIMIT KOMBËTAR DHE RAJONAL TË DHNGZ-SË

- Zyra për Vendin e **UN WOMEN**, në Pakistan publikoi një studim në vitin 2016 mbi sfidat e pjesëmarrjes politike të grave në Pakistan, duke ekzaminuar në mënyrë specifike çështjen e dhunës ndaj grave gjatë proceseve zgjedhore. Studimi synonte të identifikonte llojet e DHNGZ-së në Pakistan për të nxitur masat e duhura të politikave nëpërmjet reformave legjislative nga Komisioni Zgjedhor i Pakistanit dhe palë të tjera kyçe të interesit.
- **UNDP** zhvilloi raste studimore të vendeve në vitin 2011 për të ekzaminuar dhunën në zgjedhje në Azi, veçanërisht në Indi, Nepal dhe Pakistan.<sup>141</sup> Rastet studimore tregojnë se si dhuna përsëritet dhe materializohet në kontekste të ndryshme politike dhe shoqërore brenda rajonit të Azisë.
- Qendra e Trajnimeve të **UN WOMEN** në Santo Domingo, Republika Domenikane hartoi një projekt kërkimor që përqendrohej në dhunën ndaj grave në politikë, për të mbështetur zbatimin e Konsensusit të Kuitos (2007) për fuqizimin e grave, ku qeveritë u zotuan se do të ndërmerrnin veprime për *“miratimin e masave legjislative dhe reformave institucionale për të parandaluar, ndëshkuar dhe çrënjosur ngacmimin politik dhe administrativ të grave*

140. Po aty.

141. Studimi përfshinte punë kërkimore nga Bangladeshi, India, Indonezia, Nepali, Pakistani, Filipinet dhe Tajlanda. Shihni UNDP, 2011. “Understanding Electoral Violence in Asia.” (Të kuptuarit e dhunës zgjedhore në Azi.)

që marrin poste vendimmarrëse nëpërmjet zgjedhjeve ose nëpërmjet emërimit në shkallë kombëtare dhe vendore, si dhe në partitë dhe lëvizjet politike". Projekti përfshinte katër studime empirike dhe hartëzimin e dhunës dhe ngacmimit në politikë në Kosta Rika (2011),<sup>142</sup> El Salvador (2012),<sup>143</sup> Ekuador (2012),<sup>144</sup> dhe Bolivi (2012) duke vënë theksin në pasurimin e kornizave teorike dhe metodologjike për trajtimin e çështjes.<sup>145</sup>

- **UN WOMEN DHE QENDRA PËR KËRKIM SHOQËROR (INDI)** ndërmori një studim rajonal për dhunën ndaj grave në politikë në vitin 2014 (kryer në Indi, Nepal dhe Pakistan) për të kuptuar natyrën, shtrirjen dhe arsyet për dhunën ndaj grave në jetën politike dhe, në veçanti, DHNGZ-në dhe motivimet për këtë dhunë. Gjithashtu, studimi synonte rritjen e ndërgjegjësimit nëpërmjet identifikimit dhe përhapjes së praktikave të mira për zbutjen ndikimit të DHNGZ-së nëpërmjet workshop-eve konsultative.<sup>146</sup>
- **PARLAMERICAS** ka nisur një projekt video të quajtur "Hartëzimi i ngacmimit politik me bazë gjinore: shprehen deputetet". Faqja e internetit ofron një hapësirë ndërvepruese ku prezantohen dëshmi të grave deputete nga Amerika e Veriut, e Jugut dhe Karaibet mbi temën e DHNGZ-së, pasi "dhuna dhe ngacmimi politik me bazë gjinore janë sfida të përhapura me të cilat përballen deputetet gra në të gjithë hemisferën".<sup>147</sup>



## B. HARTËZIMI I DHNGZ-SË NGA EMB-TË

Një EMB mund të ndërmarrë një hartëzim të DHNGZ-së për identifikimin e zonave të pikave të nxehta dhe projektimin e mekanizmave të përshtatshëm për zbutjen dhe monitorimin. Për shembull, **KOMISIONI ZGJEDHOR I INDISË** ka kryer një Hartëzim të Cenueshmërisë në mënyrë që të identifikojë individët dhe zonat më në rrezik ndaj dhunës. Hartëzimi ka për qëllim që të zbulojë "prekshmerinë e çdo votuesi apo pjesë votuesish, edhe nëse ata jetojnë apo jo në një zonë gjeografikisht të identifikueshme, të cilët ndalohen padrejtësisht nga apo ndikohen lidhur me ushtrimin e të drejtës [së tij/ saj] për të votuar në mënyrë të lirë dhe të drejtë, nëpërmjet kanosjes ose përdorimit të influencës së gabuar apo forcës së çdo lloji të ushtruar mbi të".<sup>148</sup> Hartëzimi mbulon zona të tilla si shtëpi dhe familje të cenueshme, përmbledhje të cenueshmërisë dhe veprimet për t'u marrë. Më pas

studimi i hartëzimit certifikohet nga Përgjegjësi i Sektorit apo Magjistrati i Sektorit dhe nënshkruhet nga Oficeri i Zonës Zgjedhore.<sup>149</sup> Duke identifikuar sektorët e cenueshëm, studimi mund të përftojë informacion mbi gratë në rrezik në zgjedhje dhe t'i ofrojë EMB-së informacionin e duhur rreth mënyrave të efektshme për mbrojtjen e popullatave më shumë të cenueshme.<sup>150</sup>

## C. VLERËSIME TË PËRGJITHSHME TË SIGURISË

Ata që ndërmarrin vlerësime të përgjithshme të sigurisë zgjedhore mund të integrojnë një hartëzim të DHNGZ-së në qasjen e tyre, pasi është e rëndësishme që të merret parasysh dhe të hartëzohet DHNGZ-ja brenda një analize të gjerë të rreziqeve të dhunës zgjedhore.<sup>151</sup> Organizatat ndërkombëtare dhe vendore dhe OSHC-të mund të përfshihen në vlerësimet e sigurisë.<sup>152</sup> Për shembull, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për

142. Ana Cecilia Escalante dhe Nineth Méndez, 2011. Sistematización de experiencias de acoso político que viven o han vivido las mujeres que ocupan puestos de elección popular en el nivel local. ONU Mujeres-INAMU -SOLIDAR.

143. Herrera, Arias dhe García, 2012.

144. María Arboleda, 2012. Levantado el velo: Estudio sobre acoso y violencia política en contra de las mujeres autoridades públicas electas a nivel local en Ecuador. ONU Mujeres-AMUNE.

145. María Eugenia Rojas, 2012. Acoso y violencia política en contra de mujeres autoridades públicas electas en los gobiernos locales - municipales en Bolivia. ONU Mujeres-ACOBOL-AECID.

146. UN Women dhe Qendra për Hulumtime Shoqërore, 2014. Violence against Women in Politics: A study conducted in India, Nepal and Pakistan. Indi. (Dhuna

ndaj grave në politikë: një studim i kryer në Indi, Nepal dhe Pakistan.)

147. ParlAmericas, 2017. Mapping gender-based political harassment: Parliamentarians speak out. (Hartëzimi i ngacmimit politik me bazë gjinore: shprehen deputetet.)<http://www.parlAmericas.org/en/group-of-women/political-harassment-map.aspx>

148. Përshtatur nga UNDP/UN Women, 2015.

149. Komisioni Zgjedhor i Indisë, 2011. Nr. 464/Udhëzime/ EPS/ 2011. New Delhi, 5 mars.

150. UNDP/UN Women, 2015.

151. Për shembull, shihni Direktivën e Politikave të OKB-së mbi Parandalimin dhe Zbutjen e Dhunës lidhur me Zgjedhjet dhe mjetet e bashkëngjitura për analizën e rrezikut zgjedhor.

152. Përshtatur nga UNDP, 2012.

Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) hartoi një udhëzues mbi “Praktikat më të mira në sigurinë zgjedhore”, i cili shërben si një dokument shoqëruar i “Kornizës së Sigurisë Zgjedhore”, që përcakton metodologjinë për një analizë fillestare të kontekstit, faktorët historikë të konfliktit dhe palët e interesit të katër vendeve.<sup>153</sup> Më pas, këto vlerësime të sigurisë së vendeve u përdorën për identifikimin e praktikave më të mira për organizatat politike, të sigurisë, shoqërisë civile, medias dhe jofitimprurëse për t’u angazhuar në programimin e sigurisë zgjedhore gjatë gjithë ciklit zgjedhor. Udhëzuesi i USAID-it identifikoi parandalimin e dhunës politike ndaj grave në zgjedhje (DHPNGZ) si një shqetësim parësor sigurie:

*“Objektiva e identifikimit të praktikave më të mira për parandalimin e DHPNGZ-së është njohja se gratë në zgjedhje mund të jenë më të cenueshme ndaj dhunës dhe programimi duhet t’i pasqyrojë këto cënueshmëri. Ndërkohë që analiza e mëparshme e dhunës ndaj grave diskuton se një dhunë e tillë ndodh në kontekstin e shtëpisë, komunitetit dhe shtetit, ky Udhëzim mbështet pikëpamjen*

*që zgjedhjet mund të konsiderohen si një kontekst i katërt për shkak të natyrës konfliktuale të zgjedhjeve dhe cënueshmërive të grave në to”.*<sup>154</sup>

Udhëzuesi i USAID-it identifikoi se gratë mund të shënjestrohen jo vetëm si kandidatë për post, por edhe si “zyrtare publike, komisionere ... ose zgjedhëse”.<sup>155</sup> Një vlerësim tjetër nga USAID mbi sigurinë në zgjedhje identifikoi se gratë kishin më shumë rrezik se burrat që të përjetonin dhunë në Kolumbi dhe Bangladesh.<sup>156</sup> Këto gjetje të USAID-it sollën rekomandimin e pranisë më të madhe të oficerëve femra të policisë në qendrat e votimit në këto vende “për t’iu përgjigjur çështjeve të konfliktit me bazë gjinore”.<sup>157</sup>

Ndaj, si rezultat i vlerësimeve të sigurisë zgjedhore të informuar mbi DHNGZ-në, vendet mund të identifikojnë më mirë kapacitetet e ndryshme në të cilat gratë mund të jenë shënjestër e dhunës. Në këtë mënyrë, vendet dhe komunitetet mund të zhvillojnë më mirë programimin e parandalimit dhe zbutjen e incidenteve të DHNGZ-së gjatë gjithë ciklit zgjedhor.

Matësit sasiorë	Matësit cilësorë
<p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Anketime</li> <li>Analizë statistikore e të dhënave të mbledhura nëpërmjet mjeteve të hartëzimit</li> </ul>	<p><b>Metodat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Intervista/fokus grupe</li> <li>Anketime që përmbajnë pyetje me shtjellim</li> <li>Histori gojore</li> <li>Etnografi</li> <li>Kërkim me pjesëmarrje dhe veprim</li> <li>Anketim i perceptimit</li> </ul>
<p><b>Treguesit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shpeshtësia e incidenteve individuale</li> <li>Shpeshtësia e llojeve të ndryshme të sulmeve (p.sh. lëndim fizik, kërcënim me lëndim ose sulm seksual)</li> <li>Lloji i viktimës (p.sh. votuese, kandidatë, punonjëse në qendrën e votimit, etj.)</li> </ul>	<p><b>Treguesit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Opinione mbi pengesat ndaj votimit brenda një konteksti të caktuar</li> <li>Qëndrimet dhe ndjenjat e burrave dhe grave rreth legjislacionit të ri për DHNGZ-në</li> <li>Përvojat e grave me DHNGZ-në, para, gjatë dhe pas fushatës</li> </ul>

153. Afganistan, Guatemalë, Meksikë dhe Filipinet. Sihin USAID, janar 2013. “Best Practices in Electoral Security: A Guide for Democracy, Human Rights and Governance Programming.” (Praktikat më të mira në sigurinë e zgjedhjeve: një udhëzim për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe programimin e qeverisjes.) f. 9.  
154. USAID, 2013. f. 6.

155. Po aty, f. 34.  
156. USAID, mars 2010. “Electoral Security Assessment: Bangladesh, Zimbabwe, and Colombia.”  
157. (Vlerësimi i sigurisë në zgjedhje: Bangladesh, Zimbabve dhe Kolombi.) 157 Po aty, f. 31.



## ZGJEDHJET NË TUNIZI, DITA E VOTIMIT

### 1.2. PËRCAKTIMI I MATËSVE TË DHNGZ-SË

Në mënyrë që të monitorohet efektivisht DHNGZ-ja, duhet të përcaktohen matësit ose treguesit e saktë dhe të pranuar gjerësisht. Treguesit janë kritere ose matës: shenja, fakte, shifra, opinionet, ose perceptime, kundrejt së cilëve mund të vlerësohen ndryshimet në mënyrë konsistente përgjatë kohës.<sup>158</sup> Përcaktimi i treguesve të DHNGZ-së është një hap i parë kritik pasi statistikave që burojnë nga tregues të tillë “rrisin ndërgjegjësimin dhe ofrojnë një shtysë për ndryshim, për të ofruar një bazë për politikën, programet dhe projektet dhe për të monitoruar dhe vlerësuar politikën dhe masat e tilla”.<sup>159</sup> Gjithashtu, treguesit ndihmojnë në identifikimin e fushave parësore për ndërhyrje, mundësojnë planifikim më të mirë, ndihmojnë në llogaridhënien e institucioneve ndaj angazhimeve të tyre, dhe nxisin ndryshimin nëpërmjet mbledhjes së të dhënave.<sup>160</sup>

Natyrë e DHNGZ-së varion ndërmjet vendeve dhe rajoneve dhe me kalimin e kohës. Ndaj, matësit duhet të marrin parasysh kontekstin kombëtar dhe natyrën e përjetimit të pabarazive gjinore. Mundësisht, matësit duhet të konsiderojnë:

- Prevalenca e DHNGZ-së, d.m.th. përqindja e viktimave nga popullata e matur;
- Incidenca e DHNGZ-së, d.m.th. numri i incidenteve/ngjarjeve që ndodhin brenda një periudhe të caktuar kohore;
- Periudhat e synuara, si p.sh. një periudhë e caktuar e ciklit zgjedhor, ose gjatë një periudhe të gjatë kohore.<sup>161</sup>

Treguesit mund të jenë si sasiore ose cilësore dhe të maten në nivele të ndryshme (vendore, kombëtare, rajonale, globale) dhe përgjatë periudhave të ndryshme kohore (p.sh. një fazë e caktuar gjatë ciklit zgjedhor). Treguesit sasiore, ndër të tjera, mund të përfshijnë shpeshësinë e incidenteve individuale, ose shpeshësinë e llojeve të ndryshme të sulmeve (p.sh. lëndimi fizik, kërcënim me lëndim, ose sulm seksual) për viktima të ndryshme (zgjedhëse ose kandidatet), nga grupe të ndryshme (bazuar në moshë, etni, orientim seksual ose identitet gjinor). Treguesit cilësorë dhe metodat kërkimore mund të plotësojnë studimet sasiore dhe ofrojnë një përshkrim më të plotë të situatës. Pasi të përcaktohen treguesit e përshtatshëm të DHNGZ-së, mund të merret parasysh se si ata mund

158. Imp-Act, 2005. “Choosing and Using Indicators for Effective Social Performance Management.” (Zgjedhja dhe përdorimi i treguesve për menaxhimin e performancës së efektshme shoqërore.) Në Shënimet e Praktikës së Imp-Act, Nr. 5. Brighton: IDS.

159. Birgitta Hedman, Francesca Perucci dhe Pehr Sundström, 1996. “Engen-

dering statistics: A Tool for Change.” (Statistika me bazë gjinore: një mjet për ndryshim.) Örebro, Statistika Suedi. f. 9.

160. Justina Demetriades, 2007. “Gender Indicators: What, Why, How?” (Treguesit gjinorë: çfarë, pse, si?” Ballington, 2016.

të integrohen në matjet ekzistuese për monitorimin e dhunës në politikë ose zgjedhje, ose te treguesit ekzistues të DHNG-së.

Në tabela 2 më poshtë përmbledhen llojet kyçe të dhunës dhe treguesit që u diskutuan në Pjesën A të këtij Udhëzuesi. Meqenëse ka disa tregues të mundshëm që mund të maten në faza të ndryshme të ciklit zgjedhor, masave duhet t’iu jepet përparësi bazuar në kontekstin kombëtar. Duhet të merret parasysh edhe identifikimi i autorëve të përfshirë në çdo rast si dhe grupet specifike të grave të cilat kanë më shumë rrezik të përjetojnë dhunë.

### 1.3. MUNDËSITË PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE TË DHNGZ-SË NËPËRMJET NISMAVE EKZISTUESE

Monitorimi dhe të dhënat nga DHNGZ-ja ofrojnë prova që mund të përdoren për dokumentimin, parandalimin dhe raportimin e problemit.<sup>162</sup> Si rrjedhojë, metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe sistemi i monitorimit janë të nevojshme për të hartuar dhe vlerësuar plotësisht DHNGZ-në. Ndonëse monitorimi i dhunës zgjedhore është zhvilluar përgjithësisht gjatë një dekade dhe ka përjetuar një rritje të madhe interesi

me futjen e zgjidhjeve të teknologjisë së komunikimit të informacionit (TIK), monitorimi i DHNGZ-së është sfidues sepse, “ajo i takon dy fushave paralele të kërkimit dhe monitorimit: nga njëra anë, mungesa e mirëkuptimit, raportimit dhe monitorimit të dhunës ndaj grave në sferat politike dhe publike, dhe, nga ana tjetër, mungesa e mirëkuptimit dhe njohurive për dimensionin gjinor të dhunës politike dhe zgjedhore më gjerësisht”.<sup>163</sup> Shumë modele ekzistuese të monitorimit mbështeten në të dhëna të verifikueshme publikisht (siç janë raportet e policisë dhe spitalit etj.) dhe dëshmitarët okularë, gjë që e bën DHNGZ-në sfiduese veçanërisht lidhur me procesin e monitorimit duke pasur parasysh natyrën e saj të ndjeshme dhe shpesh konfidenciale.

- a. Ekzistojnë disa modele monitorimi që u japin mundësi profesionistëve të krijojnë një bazë të dhënash për ndjekjen e DHNGZ-së në një shtet të caktuar. Në grupin e praktikave aktuale të mbledhjes së të dhënave që kanë potencialin të monitorojnë DHNGZ-në përmendim:
- b. Matjet dhe mbledhjen e të dhënave nga EVAW (d.m.th përmes pyetësorëve ose të dhënave administrative nga shërbimet) që ndërmerren

**TABELA 2: SHEMAJ TREGUESISH OSE TË DHËNASH PËR TË MATUR DHNGZ-NË**

Periudha parazgjedhore*	Periudha zgjedhore*	Periudha pas/ndër-zgjedhore*
# incidente të dhunës/abuzimit fizik # gratë nuk lejohen të regjistrohen # tentativë vrasjesh të kandidateve, zgjedhëseve gra, etj. # kandidate, zgjedhëse gra, etj. të vrara # incidente të kanosjes verbale, ngacmimit apo bullizmit # gra të përdhunara, të sulmuara ose të ngacmuara seksualisht # gra të shënjestruara nga thashetheme dashakeqe/ cenim reputacioni # kandidatet gra detyrohen të tërhiqen nga zgjedhjet # gra të mbajtura në mënyrë arbitrare, dhe sa gjatë # gra të rrëmbyera # postime të ngacmimeve që venë në shënjestër gratë # artikuj dhe raporte të medias që paraqesin gratë negativisht # incidente të familjarëve të kandidateve gra, të vrarë ose të sulmuar fizikisht # incidente të stafit të fushatës/përkrahës të sulmuar fizikisht	# incidente të votimeve familjare/ votim të detyruar # gratë nuk lejohen të votojnë # dekrete të nxjerra nga udhëheqës tradicionalë ose fetarë që ndalojnë gratë nga votimi # gra të ngacmuara ose të sulmuara ditën e zgjedhjeve # gra të frikësuara ose të kërcënuara	# gratë detyrohen të japin dorëheqjen nga postet e tyre # gratë përballen me ngacmim seksual # gratë përballen me sulme dhe abuzim me bazë gjinor # artikuj dhe raporte të medias paraqesin negativisht udhëheqëset gra # postime të ngacmimit dhe bullizmit online ndaj zyrtareve të zgjedhura # gratë e zgjedhura vihen nën presion ose detyrohen nga partia e tyre të kenë një rol të varur politik

\* Përfshini informacion mbi viktimën (p.sh. zgjedhëset, kandidatet, komisioneret, media, etj.) dhe autorin

162. UNDP, 2012.

163. Ballington, 2016.



nga qeveritë dhe zyrat statistikore kombëtare që bashkëpunojnë me shoqërinë civile, akademinë dhe palë të tjera përkatëse të interesit;

- c. Mundësitë në OZHQ-të;
- d. Kontributi online nga njerëzit dhe instrumentet e vizualizimit të të dhënave; dhe

Studimet pilot për dhunën ndaj grave në politikë. (Monitorimi i zgjedhjeve, përfshirë këtu Misionet e Monitorimit të Zgjedhjeve dhe Bordet e Situatës së Grave, trajtohen në seksionin e mëposhtëm, Propozimi 2).

**A. MATJET DHE MONITORIMI NGA EVAW** Eliminimi i dhunës ndaj grave përbën një prioritet ndërkombëtar. Gjatë 20 viteve të fundit, deklaratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare kanë rritur qartësinë e çështjes,<sup>164</sup> si dhe kanë sjellë zhvillimin e matjeve të standardizuara dhe instrumenteve të mbledhjes së të dhënave për DHNG-në. Megjithatë, sikurse është përcaktuar në pjesën A, monitorimi i EVAW-s i ka përjashtuar sferat politike dhe zgjedhore. Integrimi i matjeve të drejtuara nga DHNGZ-ja në instrumentet e mëparshme të grumbullimit të të dhënave nga DHNG-ja, mund të ofrojë një mënyrë për të monitoruar DHNGZ-në. Kjo gjë mund të jetë më efikase dhe të arrihet me më pak rezistencë sesa futja e instrumenteve të reja, një taktikë e cila mund të rrisë monitorimin ndërsa maksimizon burimet e mbledhjes së të dhënave tashmë të disponueshme.

Në vitin 2011, Komisioni Statistikor identifikoi dhe miratoi 9 (nëntë) tregues kyç të DHNGZ-së, të ndjekur nga zhvillimi i udhëzimeve për prodhimin e këtyre statistikave në vitin 2014 nga Divizioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara.<sup>165</sup> Zhvillimi i këtyre treguesve dhe udhëzuesve bazë është thelbësor për të siguruar qëndrueshmërinë e masës në të gjitha vendet, si dhe për adresimin e konsideratave metodologjike dhe etike të një matjeje të tillë. Në vitin 2015, rishikimi 20-vjeçar i zbatimit të Deklaratës dhe Platformës së Pekinit për Veprim u bëri thirrje shteteve që të rrisin përpjekjet e tyre për të mbledhur dhe raportuar të dhëna në përputhje me *treguesit kyç të DHNGZ-së*.<sup>166</sup>

Për fat të keq, asnjë nga treguesit kyç të miratuar të DHNGZ-së nuk parashikon marrjen e masave lidhur me dhunën ndaj grave në kontekst të përgjithshëm politik ose në veçanti në kontekst zgjedhor, duke theksuar mungesën e qartësisë dhe mobilizimit për këtë çështje të veçantë.<sup>167</sup> Kjo mund të jetë për shkak se fushëveprimi i dhunës ndaj grave në politikë dhe zgjedhje ishte më i kufizuar kur treguesit u miratuan sesa është sot, ose mund të kishte më pak njohje publike.<sup>168</sup> Mund të merret në konsideratë shtimi i pyetjeve ose opsioneve përkatëse për DHNGZ-në në përgjigjen e pyetjeve rreth “autorit” ose “vendit të shfaqjes” në anketat ekzistuese të përhapjes së DHNG-së për të zgjeruar matjen. Megjithatë, kjo mund të jetë tepër sfiduese duke marrë parasysh specifikën e treguesve të DHNGZ-së.<sup>169</sup>

Ekzistojnë njohuri të dobishme që mund të mblidhen përmes zhvillimit të matjeve dhe treguesve të DHNG-së, të cilat mund të ndihmojnë në zhvillimin e matjeve të DHNGZ-së. Së pari, pati një thirrje të madhe për mbledhjen dhe kërkimin e të dhënave, e cila u krijua përmes rezolutave ndërkombëtare të miratuara nga shtetet anëtare. Së dyti, u krijua një grup minimal treguesish të miratuar me metoda të qarta dhe kërkesa etike për matje, gjë e cila është e rëndësishme për përmirësimin e besueshmërisë dhe krahasueshmërisë së të dhënave në të gjitha shtetet.<sup>170</sup>

## **B. INSTRUMENTET E MONITORIMIT PËR DHUNËN ME BAZË**

**GJINORE** Instrumentet ekzistuese për të monitoruar dhunën me bazë gjinore mund të shërbejnë si bazë për monitorimin e DHNGZ-së. Për shembull, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Dhunën me Bazë Gjinore është një nismë shumëdimensionale e përbërë nga shumë partnerë, që u jep mundësinë aktorëve humanitarë t’u përgjigjen incidenteve të DHBGJ-së për të mbledhur, ruajtur, analizuar dhe ndarë në mënyrë efikase dhe të sigurt të dhënat e raportuara nga të mbijetuarit e DHBGJ-së.<sup>171</sup> Sistemi përfshin një mjet për të klasifikuar dhunën sipas gjashtë llojeve të DHBGJ-së për të standardizuar përkufizimet e DHBGJ-së, dy forma të përdorura për mbledhjen e të dhënave të saj, si dhe një

164. Shiko UNGA, 1993; UN, 1995; UN CSW, 2013; si dhe Axfordën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, 2015.

165. Referuar në Ballington, 2016. fq. 8. Shiko edhe Departamentin e Kombeve të Bashkuara për Marrëdhëniet Ekonomike dhe Sociale, 2014. ST/ESA/STAT/SER.F/110. Guidelines for Producing Statistics on Violence against Women: Pyetësorë statistikorë.

166. I njëjti. Shiko edhe UN Women, 2015. Raporti i përmbledhur: 20-vjetori i Deklaratës dhe Platformës për Veprim e Pekinit.

167. Ballington, 2016.

168. I njëjti.

169. Po aty, fq. 9.

170. I njëjti.

bazë të dhënash për regjistrimin e incidenteve, e krijuar për të lehtësuar dhe përmirësuar mbledhjen, përpilimin dhe analizën e të dhënave. Instrumente të tilla të mirëkrijuara janë shembuj të mirë për mënyrën e mbledhjes së të dhënave mbi DHNGZ-në.

**C. MUNDËSITË NË QËLLIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM**  
OZHQ-të e njohin kërcënimin që DHNGZ-ja paraqet për arritjen e barazisë gjinore dhe zhvillim të qëndrueshëm, veçanërisht përmes objektivit 5.2. “Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj të gjitha grave dhe vajzave në sferat private dhe publike, duke përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual, si dhe lloje të tjera shfrytëzimesh”, si dhe objektivave të tjerë të lidhur me qëllimet e tjera.<sup>172</sup> Përpjekjet e monitorimit do të kërkojnë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme të prevalencës, të cilat duhet të mblidhen në përputhje me standardet ekzistuese të miratuara në nivel global, siç parashikohet në kuadrin global të treguesve të OZHQ-ve.<sup>173</sup> Është e rëndësishme të theksohet se janë bërë përpjekje për të siguruar harmonizimin midis treguesve të lidhur me DHNGZ-në sipas kuadrit të OZHQ-ve dhe treguesit thelbësorë të DHNGZ-së të miratuar më parë në vitin 2011.

Kuadri global i treguesve të OZHQ-ve përfshin dy tregues mbi prevalencën e dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike nga partneri intim, si dhe të dhunës seksuale nga persona të ndryshëm nga partneri intim në 12 muajt e mëparshëm. Këta tregues synojnë të monitorojnë ecurinë e objektivit specifik për të eliminuar të gjitha format e dhunës ndaj të gjitha grave dhe vajzave (objektivi 5.2). Tregues të tjerë që lidhen me dhunën ndaj grave dhe vajzave, të cilët i referohen përshkallëzimit të

ngacmimit fizik dhe seksual sipas gjinisë dhe vendit ku ka ndodhur (objektivi 11.7), numrit të viktimave të vrasjeve të qëllimshme sipas gjinisë (objektivi 16.1) dhe proporcionit të grave dhe burrave të rinj viktime të dhunës seksuale deri në moshën 18 vjeç (objektivi 16.2), janë gjithashtu pjesë e kuadrit dhe do të lejojnë vlerësimin e formave të tjera të dhunës, përfshirë këtu dhunën në ambiente publike.<sup>174</sup>

Sikurse *treguesit kryesorë të DHNG-së*, asnjë nga treguesit e propozuar të OZHQ-së nuk parashikon në mënyrë të qartë monitorimin e DHNGZ-së ndonëse ka hapësirë për ta realizuar këtë gjë. Për shembull, objektivat 5.2 dhe 11.7 lejojnë marrjen e të dhënave mbi dhunën në hapësirat publike. Treguesit 5.2.2 mbi dhunën seksuale nga një partner dhe 11.7.2 mbi ngacmimin fizik dhe seksual, kërkojnë që të dhënat të ndahen sipas vendngjarjes, gjë e cila mund të përfshijë sferën politike. Gjithashtu, treguesi 5.11 mbi dhunën intime nga partneri intim kërkon raportimin e formës së dhunës (pra fizike, seksuale dhe psikologjike), e cila mund të zgjerohet për të përfshirë sjelljet kontrolluese ndaj grave në jetën politike dhe publike. Këtu mund të përfshihen, për shembull, incidentet ku gratë e kanë të ndaluar të votojnë nga partneri i tyre ose binden që të votojnë në një mënyrë të caktuar.

#### **D. KONTRIBUTI NGA TURMA DHE VIZUALIZIMI I TË DHËNAVE**

Për qëllimet e matjes së DHNGZ-së, të dhënat nga turma dhe instrumentet e vizualizimit nga një burim i hapur mund të ofrojnë një platformë për ndjekjen vizuale të incidenteve të DHNGZ-së, i cili përbën hapin e parë për mbledhjen e të dhënave në mënyrë që të kuptohet rëndësia e problemit dhe të adresohet.

Mjeti më i njohur për vizualizimin e dhunës në zgjedhje është platforma e hartëzimit me burim të hapur Ushahidi, që do të thotë “dëshmitar” ose “dëshmi” në suahilisht, i cili u krijua për herë të parë në Kenia në vitin 2008. Ai mbështetet në të dhënat “me kontribut online nga njerëzit” të mbledhura nga publiku i gjerë dhe të dërguara me mesazhe tekst, Twitter, Facebook, YouTube, thirrje telefonike, email etj. Këto të dhëna transmetohen në një platformë në internet dhe skematizohen në harta të aksesueshme për publikun, siç janë Google Maps. Platforma siguron prova thelbësore të bazuara në të dhëna dhe lejon pjesëmarrjen e qytetarëve të thjeshtë, të

171. Fondi për Popullsisë i KB (UNFPA), UNHCR, UNICEF et al. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Dhunën me Bazë Gjinore <http://www.gbvims.com/what-is-gbvims/>

172. UN DESA. Platforma e Njohurive për Qëllimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Shiko OZHQ-të 11 (objektivi 11.7) dhe 16 (objektivat 16.1 dhe 16.2) të axhendës në adresën: <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>

173. Ballington, 2016. Në seancën e 47-të të Komisionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara të mbajtur në mars të vitit 2016, Grupi Ekspert dhe Ndërgjencor për Treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (IAEG - OZHQ-të) zhvilloi dhe miratoi një kornizë për treguesit globalë si një pikë fillimi praktike. Raporti i Komisionit, i cili përfshinte kuadrin për treguesit globalë, u mor në shënim nga ECOSOC në seancën e 70-të të tij në qershor të vitit 2016. Shiko UN ECOSOC, 2016. E/CN.3/2016/2/Rev.1. Raport i Grupit Ekspert dhe Ndërgjencor për Treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Komisioni Statistikor, seksioni i 47-të, 8-11 mars.

174. Ballington, 2016.



NJË GRUA  
DUKE FUTUR  
FLETËVOTIMIN  
E SAJ GJATË  
ZGJEDHJEVE TË  
PËRGJITHSHME  
NË SPANJË.

cilët mund të mos kenë mënyra të tjera për të denoncuar dhunën dhe padrejtësinë. Për shembull, është përdorur në Shtetet e Bashkuara në vitin 2016 për të monitoruar pretendimet e frikësimit të votuesve në zgjedhjet e 58-ta presidenciale, duke përfshirë dhe raste të shtypjes së votuesve në ditën e zgjedhjeve.<sup>176</sup> Këto të dhëna me kontribut online nga njerëzit kanë potencialin për të monitoruar rastet e DHNGZ-së, veçanërisht nëse të dhënat raportohen sipas gjinisë ose nëse llojet specifike të saj ndiqen gjatë periudhës zgjedhore. Në Egjipt, të

dhënat mbi DHNG-në janë mbledhur përgjithësisht përmes kontributit online nga njerëzit. Kontributi online nga njerëzit mbi ngacmimin seksual monitorohet përmes Harassmap, e cila përdor të njëjtën platformë hartëzimi vizuale si Ushahidi dhe jep informacione mbi përhapjen e një problemi. Incidentet e ngacmimit seksual mund të raportohen përmes një denoncimi, mesazh me tekst, email, Twitter ose Facebook. Pas verifikimit të denoncimit, ai pasqyrohet në formën e një pike të kuqe e vendosur në një hartë të Egjiptit, duke i dhënë problemit një pamje

### Shembull i raportimit dhe vizualizimit të të dhënave rreth incidentit në Harassmap

#### The map



Të gjitha kategoritë

Ngulitje sysh

Shprehje fytyre

Ngacmim verbal

Komente

Ndjekje

Ftesa seksuale

Vëmendje e padëshiruar

Foto seksuale

Online

Telefonata

Burimi: <http://harassmap.org/en/what-we-do/the-map/>

175. Juncal Plazaola Castano, Korrik 2016, intervistë personale.

176. Nat Manning, 2016. "USA Election Monitor: Of the People, By the People" (Monitori i zgjedhjeve të SHBA-ve: E njerëzve, nga njerëzit) Ushahidi, 1 nëntor; UNDP, 2012. fq. 38.

të qartë vizuale.<sup>177</sup> Publiku mund të klikojë ndonjë nga pikat në faqen lehtësisht të aksesueshme të internetit dhe të shohë transkriptet e secilit denoncim. Për më tepër, projektet përfshijnë veprimtaritë e partnerëve në komunitet, ndërgjegjësimin në mediat sociale dhe fushatat e blogjeve kundër ngacmimit seksual.

Në mënyrë të ngjashme, që prej muajit gusht të vitit 2016, një grup në Liban ka testuar një version beta të një harte të quajtur HarassTracker, e cila mbledh denoncime vullnetare të ngacmimit seksual dhe sulmit në të gjithë vendin.<sup>178</sup> Platforma është gjithashtu një mjet denoncimi në internet, ku njerëzit që kanë dëshmuar ose përjetuar

## HARTËZIMI DHE MATJA E DHNGZ-SË NË ZGJEDHJET E VITIT 2015 NË TANZANI

Zgjedhjet e Përgjithshme në vitin 2015 në Tanzani paraqitën një mundësi për të zhvilluar ushtrimin vendor për mbledhjen e të dhënave për DHNGZ-në, të realizuar kryesisht nga OSHC-ja, Platforma Ndërpartiake e Grave në Tanzani (TWCP) dhe mbështetur nga UN Women si pjesë e një grupi më të gjerë veprimtarish për një proces zgjedhor me ndjeshmëri gjinore dhe gjithëpërfshirëse. Këtu përfshihet ndërgjegjësimi për DHNGZ-në midis grave kandidate dhe aspirante, trajnime për policinë dhe forcat e sigurisë, vëzhguesit e zgjedhjeve vendase dhe Komisionin Kombëtar Zgjedhor (NEC) për DHNGZ-në dhe mbështetje për rishikimin e politikave përkatëse dhe kuadrit ligjor.

Duke përdorur një larmi metodash, TWCP-ja mbikëqyri monitorimin e DHNGZ-së përpara, gjatë dhe pas zgjedhjeve të tetorit 2015, midis korrikut dhe nëntorit të vitit 2015. Mbi 50 vëzhgues të trajnuar të DHNGZ-së, të ndihmuar nga Koordinatorët Rajonalë të Zgjedhjeve nga NEC-ja dhe të pajisur me lista kontrolli dhe pyetësorë të posaçëm, u vendosën në 14 rajone në të gjithë vendin për të marrë pjesë çdo ditë në dy aktivitete të lidhura me zgjedhjet (p.sh. mitingje fushate, takime të brendshme të partive dhe forume diskutimesh publike), duke vëzhguar sjelljen e njerëzve, shfaqjen e DHNGZs-së dhe pjesëmarrjen politike të grave në përgjithësi në një total prej 530 aktiviteteve. Po ashtu, vëzhguesit zhvilluan intervista të strukturuar për një total prej 1532 të anketuarish që u zgjodhën duke përdorur shembuj të qëllimshëm dhe të rastit, kryesisht në varësi të disponueshmërisë dhe gatishmërisë së tyre për tu përgjigjur. Këtu përfshiheshin: votues gra (647) dhe burra (540); udhëheqës të mendimit lokal, të tillë si udhëheqës fetarë, udhëheqës të pushtetit lokal dhe anëtarë me ndikim të komunitetit (204), si dhe gra kandidate për zgjedhjet parlamentare dhe vendore (141).


Gjetjet përfshinin:

- **69 PËR QIND** e grave të anketuara raportuan gjuhë abuzive, siç janë ngacmimet verbale dhe fyerjet.
- **17 PËR QIND** e grave të anketuara raportuan sulme fizike, të cilat përfshinin rrahje, hedhje gurësh ose rroba të grisura.
- **13 PËR QIND** e grave të anketuara raportuan kërkesa për favore seksuale.
- **53 PËR QIND** e grave të intervistuaras pas zgjedhjeve thanë se nuk votuan për shkak të disa faktorëve që përfshinin frikën e dhunës, mungesën e kartave të regjistrimit të votuesve, dhe presionin nga bashkëshorti i tyre.
- **VOTIMI FAMILJAR DHE DHUNA ME BAZË FAMILJARE** u përmendën në shumë dëshmi: disa gra raportuan se iu ishin konfiskuar kartat e zgjedhësit nga pjesëtarët e familjes; të tjera nuk ishin lejuar të votonin pasi ishin dhunuar nga bashkëshortët e tyre, duke marrë lëndime në trup pasi kishin mbështetur kandidatë që nuk preferoheshin nga bashkëshortët; është raportuar se bashkëshortët, vëllezërit dhe djemtë e tyre kanë kontrolluar zgjedhjet e votimit në disa raste; dhe disa gra raportuan se burrat e tyre votuan për to, me pretendimin se ato ishin analfabete.
- Koha dhe vendndodhjet për mbledhjet e ekipit të fushatës, të cilat zakonisht organizohen në orët e vona të natës, rezultuan të papërshtatshme për pjesëmarrjen efikase të grave.

177. Hina Ansari, 2013. "Could Mobile Technology Combat Sexual Harassment?" (A mundet teknologjia celulare të luftojë ngacmimin seksual?) Huffington Post: Blogu, 11 shkurt.

## DHUNA NDAJ GRAVE NË POLITIKË NË AFRIKË

Në vitin 2011, UN Women dhe Instituti për Demokraci në Afrikën e Jugut (IDASA) pilotoi një projekt për monitorimin e dhunës ndaj grave në politikë. Modeli me shumë partnerë synon të stimulojë mekanizmat, sistematikë, të institucionalizuar dhe të bazuar në dëshmi për reagimin ndaj DHNGZ-së. Modeli u pilotua fillimisht gjatë zgjedhjeve të shkurtit të vitit 2011 në Ugandë dhe më pas në Nigeri dhe Zimbabve. Në të trija rastet, studimi u zbatua nga një koalicion i OSHC-ve, aktivistëve dhe vullnetarëve me mbështetjen e UN Women në bashkëpunim me UNDP-në dhe IDASA-n. Metodologjia e programit nxori të dhëna nga një kampion faqesh interneti në çdo shtet duke përdorur dy pyetësorë, të cilët trajtuan aspekte të ndryshme të DHNGP-së gjatë periudhës së fushatës në Ditën e zgjedhjeve. Të dhënat u regjistruan nga analistë të të dhënave në 'qendra' të ndryshme programesh dhe u analizuan përmes analiza sasore statistikore. Analiza u përdor në vijim për advokim publik dhe deklarata nga organizatat partnere. Mbledhja e të dhënave siguroi disa informacione të rëndësishme në fushat për të cilat pyetësi ishte hartuar, por rezultatet nuk ishin mjaftueshëm përfaqësuese për të mbledhur raportet e duhura mbi incidentet.<sup>181</sup>



ngacmim seksual mund të shënojë vendndodhjen në hartë dhe të sigurojnë informacione mbi llojin e ngacmimit seksual me të cilin u përballën.<sup>179</sup>

Sidoqoftë, deri më sot, as Ushahidi, Harassmap dhe HarassTracker nuk ndjekin në mënyrë të qartë incidentet e DHNGZ-së. Ndonëse këto modele premtojnë monitorimin e DHNGZ-së, ato nuk janë pa sfida. Për shembull, kontributi online nga njerëzit nuk është i verifikueshëm pa një sistem rezervë, dhe gjithashtu mund të bjerë pre e mashtrimit, manipulimit ose gabimeve njerëzore, gjë që ndikon në cilësinë e metodologjisë së monitorimit. Modelet e raportimit mund të mos jenë të njëjta, pasi ato varen nga ndërgjegjësimi i përdoruesve për programin, si dhe nga mbulimi i telefonit celular dhe/ose qasja në internet. Ndaj, çështjet e panjohura mirë, si DHNGZ-ja, mund të kenë nevojë për edukim dhe ndërgjegjësim civil, në mënyrë që qytetarët t'i raportojnë këto raste në mënyrë sistematike. Kufizimet teknike shtojnë akoma më tepër vështirësitë. Platforma Ushahidi, për shembull, nuk i klasifikon të dhënat sipas seksit apo të përdorë variabla që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me DHNGZ-në.

Ndoshta ky mund të jetë shkak se përse organizata të tilla si Merr në Dorë Teknologjinë! (Take Back the

Tech!) janë me shumë rëndësi për gjetjen e mënyrave për përmirësimin e platformave TIK ekzistuese për monitorimin specifik të DHNGZ-së.<sup>180</sup> Krijuar në vitin 2006 nga Programi i të Drejtave të Grave i Shoqatës për Komunikime Përparimtare, Merr në Dorë Teknologjinë! Synon të nxisë gratë dhe vajzat që të zhvillojnë zgjidhje novatore për DHNG-në nëpërmjet TIK-ut. Krahas të përvitshmes "16 Ditë aktivizëm kundër dhunës gjinore", ato gjithashtu menaxhojnë mjetin e tyre të hartëzimit për vizualizimin e të dhënave, i cili paraqet një hartë të incidenteve të DHNG-së të bazuar në teknologji të raportuar në të gjithë botën.

### E. STUDIMET PILOT PËR DHUNËN NDAJ GRAVE NË POLITIKË

Gjatë dekadës së fundit, shumë projekte pilot të dokumentuara kanë kërkuar mbledhjen e të dhënave mbi DHNGP-në dhe DHNGZ-në përmes nismave me disa bashkëpunëtorë duke u mbështetur në angazhimin e OSHC-ve për monitorimin. Ndonëse metodologjitë dhe pikat e mbledhjes së të dhënave ndryshojnë dhe nuk përqendrohen te zgjedhjet, ato japin shembuj interesantë të përpjekjeve për të marrë informacione mbi natyrën, shkaqet dhe pasojat e DHNGP-së.

Gjetjet e ushtrimit të parë të hartëzimit dhe matjes së DHNGZ-së në Tanzani konfirmuan rastet e dhunës psikologjike, fizike dhe seksuale, ku mbizotëron ajo psikologjike, dhe në kontekstin e zgjedhjeve të vitit 2015, autorët e DHNGZ-së ishin kryesisht familjarë, kandidatë meshkuj, përkrahës të partive politike, si dhe zyrtarë të partisë. Ushtrimi tregoi gjithashtu disa gjetje pozitive: për shembull, kishte gra që raportuan se kishin

178. Shihni <http://harasstracker.org/>

179. Jack Moore, 2016. "Female Entrepreneurs Launch Online Sexual HarassmentTracker in Beirut" (Sipërmarrëset femra vënë në punë Gjurmuesin e ngacmuesit seksual online në Beirut) Newsweek, 25 shkurt.

180. Shiko <https://www.takebackthetech.net/>

181. Mjeti i monitorimit, pyetësorët dhe studime pilot nuk u publikuan.



bashkëshortë përkrahës në jetën e tyre, të cilët i nxisin të bëheshin pjesë e politikës; megjithatë, natyra private e DHNGZ-së, veçanërisht në kontekstin familjar dhe druajtja që lidhet shpesh me të, krijonte sfida për monitorimin dhe përgjigjen ndaj DHNGZ-së duke përdorur metodat tradicionale të mbledhjes së të dhënave dhe vëzhgimit zgjedhor. Duke u bazuar në mësimet nga viti 2015, përmirësimet e ardhshme në monitorimin e DHNGZ-së do

të përfshijnë: rritjen e mbulimit të monitorimit dhe lidhjet me mekanizmat tradicionale të vëzhgimit zgjedhor, lidhje dhe mekanizma më të mirë reagues përmes policisë, gjyqësorit, EMB-të etj; më shumë trajnime dhe sensibilizim të grave aspirante dhe kandidate; si dhe shpërndarje të gjerë të raporteve të DHNGZ-së për vitin 2015 dhe atyre të ardhshme, EMB-të, regjistrimi kombëtar i partive politike, OSHC-të dhe palë të tjera përkatëse të interesit.<sup>182</sup>

## SISTEMI I MBIKËQYRJES SË GRAVE NË POLITIKË NË AZINË JUGORE

Në vitin 2016, Partneriteti i Azisë Jugore (SAP), një rrjet rajonal i grave të angazhuara në politikë dhe grupeve të vëzhgimit të komunitetit në pesë vende të Azisë Jugore, prezantoi një nga projektet e para monitoruese përmes sistemit rajonal të mbikëqyrjes (RSS) së dhunës ndaj grave. RSS-ja duhej të mblidhte dhe të shpërndante informacione në lidhje me dhunën ndaj grave në politikë nga niveli qendror në atë rajonal. Komuniteti dhe Grupet Kombëtare të Vëzhgimit duhet të mblidhnin informacione fillestare në lidhje me incidentet e dhunës në rastet kur ajo ishte e pranishme, për t'u shpërndarë më pas në Qendrat e Shërbimit të Komunikimit dhe palëve të tjera të interesit, përfshirë policinë, autoritetet përkatëse qeveritare dhe zyrën kombëtare të SAP-it.<sup>183</sup> Sistemi gjithashtu siguronte krijimin e një kuadri referimi për të mbështetur viktimat. Sistemi synonte të mblidhte katër lloje të dhënash: 1) informacione mbi incidentet e DHNGZ-së, 2) informacione mbi strategjitë e zbutjes dhe/ose praktikatat më të mira të miratuara nga gratë politikane, 3) informacione mbi çështjet e referuara, si dhe 4) informacione mbi çështjet gjyqësore.

Ndonëse RSS-ja synonte të mbulonte gjerësisht dhunën ndaj grave në politikë, një nga risitë unike të programit ishte një pyetësor që përfshin një grup të gjerë treguesish të hartuar posaçërisht për të adresuar DHNGZ-në. Për shembull, të dhënat e mbledhura përfshijnë shfaqjen e dhunës 'gjatë kundërshtimit të zgjedhjeve', 'gjatë kandidimit', 'gjatë zgjedhjeve', dhe 'pas zgjedhjeve'.<sup>184</sup>

### PËRMBLEDHJE E NISMAVE TË HARTËZIMIT DHE MONITORIMIT TË DHNGZ-SË:

Faza parazgjedhore	Faza zgjedhore	Faza paszgjedhore
<ul style="list-style-type: none"> <li>Realizoni hartëzimin e DHNGZ-së në nivel vendor dhe rajonal</li> <li>Përfshini DHNGZ-në në EMB dhe vlerësimet e sigurisë në zgjedhje</li> <li>Hartoni dhe përcaktoni treguesit</li> <li>Rregulloni ose përmirësoni treguesit aktualë të DHNGZ-së dhe instrumenteve matëse</li> <li>Konsideroni përfshirjen e DHNGZ-së në monitorimin e OZHQ-ve përkatëse</li> <li>Merrni në konsideratë përdorimin e kontributit nga masat online dhe instrumenteve të vizualizimit të të dhënave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mblidhni dhe verifikoni të dhënat</li> <li>Përshtatni dhe integroni DHNGZ-në në instrumentet e monitorimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Analizoni rezultatet e përpjekjeve të mbledhjes së të dhënave</li> <li>Siguroni ndarjen dhe raportimin e të dhënave</li> <li>Identifikoni hendeqet dhe përmirësoni treguesit sipas nevojës</li> <li>Përfshini DHNGZ-në në raportet dhe gjetjet paszgjedhore</li> </ul>

182. Negrao, 2017.

183. Partneriteti Ndërkombëtar i Azisë së Jugut (SAP), dhjetor 2006. Violence Against Women in Politics Surveillance System Guidebook

(Udhëzuesi për sistemin e mbikëqyrjes së dhunës ndaj grave në politikë)  
184. Për informacione të mëtejshme, shikoni: [http://peacewomen.org/sites/default/files/PartPol-VAW\\_Surveillance\\_SAPI-VAWP\\_2007\\_0.pdf](http://peacewomen.org/sites/default/files/PartPol-VAW_Surveillance_SAPI-VAWP_2007_0.pdf)



# PROPOZIMI 2:

## INTEGRIMI I DHNGZ-SË NË VËZHGIMIN ZGJEDHOR DHE MONITORIMIN E DHUNËS

Programet e vëzhgimit të zgjedhjeve dhe monitorimit të dhunës kanë potencial të madh për të siguruar informacione mbi pjesëmarrjen e grave në zgjedhje, duke përfshirë atë mbi DHNGZ-në, si dhe mund të kontribuojnë në pakësimin e dhunës. Misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve dhe nismat e monitorimit mund të përfshijnë dimensionin gjinor në raportimin e tyre, si dhe mund të mbledhin informacione të rëndësishme për të kuptuar modelet e përgjithshme, për të krijuar më pas një profil për DHNGZ-në. Shpeshherë, këto programe kanë përfitime të shumta, duke përfshirë:

- Mbulimin e gjerë në të gjithë vendin dhe lidhjet me komunitete të ndryshme;<sup>185</sup>
- Përdorimin e metodave të standardizuara për mbledhjen e të dhënave, dokumentimin dhe raportet;
- Monitorues të trajnuar, duke përfshirë dhe metodat për mbledhjen e të dhënave me ndjeshmëri gjinore;
- Mundësinë e krahasimit të tendencave të DHNGZ-së në rajone dhe midis shteteve.

185. Caroline Hubbard dhe Claire DeSoi/NDI, 2016. Votes without Violence: A Citizen Observer's Guide to Addressing Violence against Women in Elections (Vota pa dhunë: Udhëzuesi i vëzhguesit të qytetarëve për adresimin e dhunës ndaj grave në zgjedhje) Uashington, D.C. Instituti Demokratik Kombëtar.

186. Negrao, Sara, 2017.

Deri së fundmi, mungesa e metodave tradicionale të mbledhjes së të dhënave mbi DHNGZ-në krijoi sfida në vendet ku është provuar. Kjo gjë do të ndihmohej shumë nga miratimi i treguesve tradicionalë, duke mundësuar me kalimin e kohës krahasime ndërkombëtare dhe monitorim.

### 2.1. MISIONET E VËZHGIMIT ZGJEDHOR

Misionet vendore dhe ndërkombëtare për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ), të cilët caktojnë vëzhgues afatshkurtër dhe afatgjatë, mund të shërbejnë si burim informacioni për DHNGZ-në. MVZ-të mund të angazhohen me komunitetet për të identifikuar një sërë llojesh konflikti dhe dhune që në rastin e kundërt nuk marrin vëmendjen kombëtare (ose ndërkombëtare). Ndërsa disa organizata që mbështesin vëzhgimin zgjedhor kohët e fundit kanë bërë përpjekje për të siguruar që format e mbledhjes së të dhënave nuk janë të pavërteta, dhe për të trajnuar vëzhguesit në modele kërkimore me ndjeshmëri gjinore, ka hapësirë për të përmirësuar monitorimin e DHNGZ-së. Duhet marrë në konsideratë të veçantë edhe monitorimi i periudhave të kandidimit dhe fushatës pasi një pjesë e madhe e incidenteve të DHNGZ-së ndodhin pikërisht gjatë kësaj kohe. Për shembull, Koalicioni për Monitorimin dhe Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Tanzani (CEMOT) mundësoi trajnimin e Vëzhguesve Afatgjatë (VA) rreth mënyrave të marrjes dhe dokumentimit të informacionit në lidhje me pjesëmarrjen e grave, të rinjve, personave me aftësi

të kufizuara dhe grupeve të tjera të marginalizuara në procesin zgjedhor. Një nga këshilluesit gjinorë brenda CEMOT-së siguroi vëzhgimin me ndjeshmëri gjinore të kuadrit ligjor, sistemit zgjedhor (përfshirë ekzistencën dhe zbatimin e masave të veçanta të përkohshme (MVP) për grupe të veçanta), administrimit të zgjedhjeve, partive politike, mediave dhe DHNGZ-së.<sup>186</sup>

Në vitet e fundit, organizata të tilla si Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Bashkimi Evropian (BE), Organizata e Shteteve Amerikane (OAS), dhe Qendra Karter, kanë pasur si synim integrimin e konsideratave gjinore në vëzhgimet e zgjedhjeve të kryera nga ta, nëpërmjet klasifikimit të të dhënave, zgjatjes së kohës së funksionit të vëzhguesve afatgjatë, punësimit të këshilluesve të posaçëm gjinorë si pjesë e ekipeve kryesore të vëzhgimit, dhe zhvillimit të udhëzimeve specifike për monitorimin e pjesëmarrjes politike të grave në zgjedhje. Në të vërtetë, vëzhgimi me ndërjegjësim gjinor mundëson përfshirjen e “parimeve të barazisë gjinore në të gjithë strukturën dhe parimet organizative, duke ruajtur balancën gjinore në grupin e vëzhguesve dhe pozicionet drejtuese”.<sup>187</sup>

Në vitin 2004, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut hartoi një udhëzues bazë për të gjithë MVZ-të e saj lidhur me monitorimin e pjesëmarrjes së grave në proceset zgjedhore.<sup>188</sup> Megjithëse udhëzuesi ofron një sërë idesh për integrimin e analizës gjinore në misionet e vëzhgimit, ai nuk përfshin raportimin e incidenteve të dhunës ndaj grave në politikë apo në zgjedhje. Në vitin 2013, OAS-ja botoi Manualin për Përfshirjen e Pikëpamjes Gjinore në Misionet e OAS për Vëzhgimin e Zgjedhjeve.<sup>189</sup> Manuali synon që t’iu mundësojë ekipeve OAS të vëzhgimit të zgjedhjeve instrumentet teknike për shqyrtimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave përgjatë procesit zgjedhor. Ai identifikon me efikasitet një matricë ‘treguesish gjinorë’ dhe variablash për monitorim, si mënyrë për vlerësimin e përfshirjes së grave në proceset zgjedhore, si dhe të dhëna dhe burime informacioni për matjen e variablave. Një tjetër

udhëzues është hartuar për të siguruar ekspertizën gjinore brenda misioneve, trajnimit të vëzhguesve, dhe mbledhjen e raportimit të të dhënave.

Ky manual lehtësisht i përdorshëm ofron udhëzime për mënyrën e vlerësimit të zbatimit të angazhimeve të ndërmarra nga Shtetet anëtare të OAS, si në legjislacionin kombëtar dhe në atë ndërkombëtar, duke përfshirë dhe Konventën Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Zhdukjen e Dhunës ndaj Grave e vitit 1994. Manuali përfshin disa tregues të posaçëm për monitorimin e DHNGZ-së, të tillë si “integriteti në dokumentimin e parapëlqimeve të votuesve”, i cili përfshin vëzhgimin e “kufizimeve të mundshme të ushtrimit të së drejtës për votë të lirë dhe të fshehtë, si dhe presionet e jashtme të ushtruara nëpërmjet formave të ndryshme të dhunës”. Gjithashtu ofrohen dhe instrumente udhëzuese për të drejtuar vëzhguesit e zgjedhjeve në përfshirjen e analizimit të barazisë gjinore, duke përfshirë dhe pyetje specifike rreth DHNGZ-së në pyetësorin e vëzhgimit të Ditës së Votimit, të tilla si “sa raste dhune dhe manipulimi vëzhguat, të cilat synonin ndalimin e grave të regjistruara që të votojnë” dhe “a vëzhguat ndonjë rast të votimit ‘familjar’, me ‘delegat’ apo me përfaqësim në lidhje me votueset gra?”<sup>190</sup>

Të gjitha këto janë risi pozitive që mund të lehtësojnë përfshirjen e vëzhgimit të DHNGZ-së në vëzhgimet zgjedhore. Për të arritur këtë, MVZ-të duhet të investojnë në përfshirjen e gjinisë në të gjithë misionet e tyre krahas sigurimit të përfshirjes së analistit të posaçëm gjinor, duke edukuar vëzhguesit rreth kësaj çështjeje, duke kërkuar standarde raportimi të qëndrueshme për të gjitha fazat e shpërndarjes në terren dhe zgjedhjeve, si dhe duke i dhënë përparësi shqetësimeve gjinore bashkë me çështje të tjera të zhvillimit të zgjedhjeve.

## 2.2. VËZHGIMI VENDAS DHE SISTEMET E PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM

Grupet e vëzhgimit vendas, të cilët shpërndajnë në terren vëzhgues afatshkurtër dhe afatgjatë për të monitoruar zgjedhjet, janë një tjetër burim informacioni rreth DHNGZ-së. Këto grupe kanë mundësinë të angazhohen me komunitetet përgjatë një periudhe të caktuar kohore për të identifikuar një

187. Hubbard dhe DeSoi, 2016.

188. OSBE/ODIHR, 2014. Handbook for Monitoring Women's Participation in Elections (Manual për monitorimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje)

189. OAS, 2013. Manual for Incorporating a Gender Perspective into OAS Electoral Observation Missions (Manual për Përfshirjen e Pikëpamjes Gjinore në Misionet e OAS të Vëzhgimit të Zgjedhjeve)

190. Po aty, fq. 60.

191. Bardall/IFES, 2011.

sërë formash konflikti dhe dhune që nuk raportohen dhe nuk dalin në media.<sup>191</sup> Sikurse ndodhi me MVZ-të, edhe në këtë aspekt janë bërë përpjekje së fundmi për të siguruar përfshirjen e pikëpamjes gjinore gjatë monitorimit, duke përfshirë trajnimin e vëzhguesve rreth metodave të kërkimit me ndjeshmëri gjinore dhe duke trajtuar dhunën që ndodh në hapësirat private dhe publike. Ka gjithashtu dhe një fushëveprimi për të përshkallëzuar përfshirjen monitorimit të DHNGZ-së. Monitorimi i periudhave të kandidimit dhe fushatës duhet gjithashtu të marrë konsideratë të veçantë, pasi një pjesë e madhe e incidenteve të DHNGZ-së ndodhin pikërisht gjatë kësaj kohe.

Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) botoi një udhëzues gjithëpërfshirës për adresimin e DHNGZ-së në vitin 2016, Vota pa dhunë: Udhëzuesi i vëzhguesit të qytetarëve për adresimin e dhunës ndaj grave në zgjedhje. Kjo

paketë instrumentesh ofron udhëzime për grupet e vëzhguesve të qytetarëve (në veçanti për vëzhguesit afatgjatë) së bashku me instrumente vlerësimi me ndjeshmëri gjinore dhe trajnim rreth mënyrave se si duhet të identifikohen dhe dokumentohen incidentet e DHNGZ-së, të cilat mund të ndihmojnë në zbutjen dhe parandalimin afatgjatë të DHNGZ-së.<sup>192</sup>

Paketa e instrumenteve është parashikuar si shoqëruese e udhëzimit ekzistues për vëzhgimin e qytetarëve gjatë zgjedhjeve dhe vëzhgimit me ndërjegjësim gjinor të zgjedhjeve, duke mundësuar kështu informacionin e nevojshëm për vëzhguesit, në mënyrë që ata të mund të kryejnë vëzhgim me ndërjegjësim gjinor, ku synohet monitorimi dhe zbutja e DHNGZ-së. Është e rëndësishme të theksohet se udhëzuesi ka gjithashtu për qëllim që të përfshijë të gjitha fazat e ciklit zgjedhor në praktikën e veta të monitorimit.

## PARTNERITETI ME MVZ-TË PËR PROMOVIMIN E “VOTA PA DHUNË”

Projekti dhe paketa e instrumenteve Vota pa Dhunë nga NDI u krijuan në bazë të përpjekjeve shumëvëndëshe të MVZ-ve në bashkëpunim me OSHC-të nga Mianmari, Nigeria, Guatemala, Tanzania, Burma, dhe Bregu i Fildishtë, ku NDI ka punuar që prej vitit 2015 për të përfshirë ndjeshmërinë gjinore në trajnimet e vëzhguesve dhe strukturat e përgjithshme. Në këtë mënyrë, NDI shpreson të rrisë njohjen dhe raportimin e incidenteve të DHNGZ-së para, gjatë dhe pas periudhës së zgjedhjeve. Të gjitha të dhënat e klasifikuara do të grumbullohen në një mjet vizualizimi në internet, me qëllim që të rrisin njohjen nga ana e publikut për mënyrat se si DHNGZ-ja “pengon gratë nga pjesëmarrja aktive në jetën publike.”

Për shembull, në **GUATEMALA** në vitin 2015, NDI në partneritet me Aksionin Qytetar (Acción Ciudadana), monitoruan financimin e fushatës dhe dhunën zgjedhore, duke u përqendruar te DHNGZ-ja. Programi përfshinte trajnimin rreth pjesëmarrjes së grave në zgjedhje për drejtuesit e misionit dhe seanca diskutimi me palët e interesit për të kuptuar kontekstin zgjedhor. Një nga pikat shqetësuese ishte përdorimi i dhunës për të influencuar votimin, veçanërisht për gratë. Këto diskutime ndihmuan për identifikimin e çështjeve kyçe që duheshin vëzhguar.<sup>193</sup>

Në **BREGUN E FILDISHTË**, programi, në partneritet me Platformën e Organizatave të Shoqërive Civile për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (POECI), u angazhuan për rritjen e numrit të vëzhgueseve gra në zgjedhjet e vitit 2015. Programi u mbështet në mësimet e nxjerra nga kërkimet e mëparshme rreth DHNGZ-së gjatë zgjedhjeve të vitit 2010, ku u përfshi dhe refuzimi i grave për të folur për dhunën që përjetonin pasi i druheshin mohimit nga pjesëtarët meshkuj të familjes ose komunitetit.<sup>194</sup> Në formularët e vëzhgimit të POECI-t u përfshinë pyetje specifike për të identifikuar dhe mundësuar raportimin e DHNGZ-së.



192. Hubbard dhe DeSoi, 2016.

193. Po aty, fq. 34.

194. Po aty, fq. 46.

Paketa e instrumenteve e NDI-së vë në dukje rëndësinë e sistemit të paralajmërimit të hershëm (SPH) të dhunës zgjedhore si një nga mënyrat për zbutjen e DHNGZ-së. Vëzhguesit e qytetarëve kanë mundësinë për t'iu bërë të ditur palëve të interesit të zgjedhjeve incidentet e dhunës, duke krijuar kështu hapësirën e nevojshme që mekanizmat e reagimit të shpejtë të adresojnë dhe zbusin dhunën sa më parë.<sup>195</sup> Një sërë organizatash kanë mundësuar instrumente të sistemit të paralajmërimit të hershëm për monitorimin e përgjithshëm të dhunës në zgjedhje; megjithatë, nevojiten më tepër përpjekje për të siguruar që pikëpamja gjinore është integruar në strategjitë e parandalimit të konfliktit.<sup>196</sup> Paketa e instrumenteve e NDI-së synon ta adresojë këtë deficit duke identifikuar se si SPH-të mund të adresojnë në mënyrë sistematike çështjet gjinore, duke përfshirë dhe sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në ekipet e vëzhgimit, krijimin e treguesve të dhunës zgjedhore me ndjeshmëri gjinore dhe dokumentimin e shenjave të hershme paralajmëruese. Disa nga hapat që parashtron kjo paketë instrumentesh përfshijnë:

- Identifikimin e treguesve me ndjeshmëri gjinore, duke pasur parasysh kontekstin dhe shkaqet kryesore të dhunës, dhe larminë e përvojave të grave. Këta tregues duhet të krijohen duke u këshilluar me organizatat e grave dhe vëzhguesit, të cilët kanë njohuritë e duhura të kontekstit vendor. Kjo paketë përfshin një listë me pika kyçe për të kuptuar shkaqet kryesore të DHNGZ-së, si dhe një listë me treguesit e mundshëm për dokumentimin e incidenteve të DHNGZ-së. Ofrohen dhe udhëzime për përfshirjen e SPH-së dhe DHNGZ-së në formularët e raportimit, formularët kyç të raportimit të incidenteve dhe listave të kontrollit të përdorura nga vëzhguesit.
- Kjo paketë thekson nevojën për kuptimin e gjerë të DHNGZ-së nëpërmjet trajnimit të vëzhguesve të zgjedhjeve dhe palëve të interesit: “Shpesh, ndalimi i dhunës me bazë gjinore, si përdhunimi apo ngacmimi seksual, nuk konsiderohet me rëndësi për promovimin e integritetit zgjedhor. Mbulimi parësor do të kërkojë edukimin dhe rritjen e synuar të ndërgjegjësimit rreth përkufizimit të DHNGZ-së dhe pse ajo duhet trajtuar në zgjedhjet demokratike. Ky mbulim duhet të përfshijë diskutime rreth reagimit të përshtatshëm nga individët dhe institucionet për parandalimin, zbutjen dhe trajtimin e viktimave”.<sup>197</sup>
- Paketa e instrumenteve thekson rëndësinë e ngritjes së një platforme të reagimit të shpejtë, e cila do

t'iu mundësojë vëzhguesve të bëjnë me dije palët përkatëse të interesit për incidentet, të cilët më pas do të kenë mundësi të përpiqen për zgjidhjen e incidenteve ose pakësimin e rrezikut, si dhe t'i referojnë viktimat te shërbimet që mund t'iu nevojiten. Lista e palëve të interesit përfshin aktorët e sigurisë (duke përfshirë dhe policinë), aktorët politikë (si partitë politike), OSHC-të, mediat dhe ofruesit e shërbimeve të viktimave (duke përfshirë shërbimet ligjore dhe mjekësore), të cilët mund të bashkëpunojnë për ngritjen e një sistemi referimi.<sup>198</sup>

- Gjithashtu, jepen udhëzime për mënyrat e dokumentimit dhe ruajtjes së të dhënave, metodave të transmetimit të të dhënave (ku përfshihen mesazhet, telefonatat, aplikacionet e specializuara, dhe dorëzimi i kopjeve fizike) dhe mbrojtja e të dhënave dhe viktimave.<sup>199</sup>

Kjo paketë instrumentesh ofron udhëzime shumë të vlefshme për çdo përpjekje monitorimi, duke përfshirë dhe sigurimin që çdo monitorim i DHNGZ-së shqyrton se si gratë dhe burrat ndikohen apo shënjestrohen në mënyra të ndryshme, duke i kushtuar vëmendje të veçantë llojeve të dhunës që gratë mund të përfshijnë dhe sigurimin e shpërndarjes sa më të gjerë të informacionit si masë zbutëse.<sup>200</sup> Paketa gjithashtu thekson se mund të nevojiten metodologji të ndryshme vëzhgimi në varësi të periudhës nën vëzhgim.

### 2.3. INSTRUMENTET E MONITORIMIT TË DHUNËS ZGJEDHORE

Instrumentet e specializuara për monitorimin dhe zbutjen e dhunës mund të shërbejnë si një burim shtesë për monitorimin e dhunës politike dhe zgjedhore ndaj grave, por duhet marrë në konsideratë dhe mënyra se si është integruar pikëpamja gjinore.<sup>201</sup> Për shembull, në rastin e vëzhgimit të drejtuar nga CEMOT-ja në Tanzani, pavarësisht mundësisë së trajnimit të thëlluar të vëzhguesve për vëzhgimin e DHNGZ-së, VA-të dolën në përfundimin se instrumentet e zakonshme të vëzhgimit zgjedhor që kishin në dispozicion nuk ishin të mjaftueshme për mbledhjen e hollësishme të të

195. Po aty, fq. 47.

196. Po aty.

197. Hubbard dhe DeSoi, 2016. fq. 56.

198. Po aty, fq. 59.

199. Po aty, fq. 74.

200. I njëjti

201. I njëjti

dhënave të DHNGZ-së.<sup>202</sup> Ndërsa çështjet e integritetit dhe rrezikut zgjedhor fitojnë vëmendje nga praktikuesit, është e nevojshme që të ripërcaktohet rreziku zgjedhor për të përfshirë “çdo situatë që rrezikon integritetin e procesit zgjedhor, ku përfshihen dhe situatat që kërcënojnë, kufizojnë apo cenojnë pjesëmarrjen e grave si votuese, kandidatë dhe në role të tjera zgjedhore”.<sup>203</sup> Në këtë mënyrë, do të bëhet e mundur mbledhja e të dhënave më të qarta rreth DHNGZ-së.

Programi për Edukimin dhe Zgjidhjen e Dhunës në Zgjedhje (EVER) nga Fondacioni Kombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), është një shembull kryesor i një instrumenti specifik për mbledhjen e mikro të dhënave rreth dhunës. EVER mbështetet në të dhëna të vërtetueshme publikisht dhe në një rrjet monitoruesish të bazuar në komunitet për gjurmimin dhe dokumentin e incidenteve të dhunës zgjedhore në varësi të disa variablave (vendi, autori, viktimë, lloji, metoda, ndikimi, burimi). Programi ka monitoruar 15 zgjedhje në 13 vende që prej vitit 2003, por të dhënat e klasifikuara në bazë gjinie janë të disponueshme vetëm për gjashtë raste të raportuara. Klasifikimi bazë pa përcaktim gjinor i të dhënave, i cili u krye gjatë një studimi në vitin 2011, vuri në dukje ndryshime të theksuara në përjetimin e dhunës zgjedhore midis burrave dhe grave. Përshtatjet e kohëve të fundit të metodologjisë kanë përmirësuar specifikën gjinore të instrumentit dhe kanë shtuar mundësitë që ky instrument të kthehet në një burim të besueshëm mbarëkombëtar i të dhënave sasiore rreth DHNGZ-së.

Në vitin 2016, IFES-i publikoi një tipologji dhe seri metodologjish për vlerësimin dhe monitorimin e DHNGZ-së. Këto instrumente mbështeten në metodologjinë e projektit EVER, si dhe në gjetjet nga të dhënat që ky i fundit ka mbledhur, duke përfshirë dhe gjetjet e paraqitura në botimin e vitit 2011.<sup>205</sup>

Si rrjedhojë, instrumenti i monitorimit plotëson metodologjinë e vlerësimit duke ofruar një mënyrë për gjurmimin e DHNGZ-së përgjatë të gjitha fazave

202. Negrao, Sara, 2017.

203. Gabrielle Bardall, cituar në International IDEA, 2016. “Electoral risk management through a gender lens” (Menaxhimi i rrezikut zgjedhor nëpërmjet këndvështrimit gjinor) 29 mars.

204. International IDEA, 2016.

205. IFES, gusht 2016. “Violence Against Women in Elections: An Excerpt from IFES’ Framework” (Dhuna ndaj grave në zgjedhje: Pjesë e marrë nga Kuadri i IFES-it) Arlington, VA. USAID, fq.2.

## TIPOLOGJIA I PËRKUFIZON ‘PENGESE TË NDAL PJESËMARRJES’ SI:

“Një akt, rrethanë, normë shoqërore, rregullore, ligj, ose anësi sistemike që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë (nëpërmjet provave anekdotike, analizave të botuara, apo vetëraportimit) me pengimin e grave nga pjesëmarrja e plotë në disa pjesë të procesit zgjedhor. Pengesat ndaj pjesëmarrjes përfshijnë pengesat për aksesin e informacionit, burimeve, apo mundësive, dhe mund të vijnë nga praktikat dhe besimet kulturore/shoqërore/fetare, dhe mund të shfaqen në sistemet shoqërore, politike, ekonomike ose ligjore”.<sup>206</sup>

Këto pengesa shërbejnë si bazë për metodologjitë e IFES, duke përfshirë dhe një metodologji vlerësimi e cila mbështetet tek gjinia dhe instrumentet e vlerësimit të rrezikut të sigurisë të krijuara nga USAID-i dhe CARE.<sup>207</sup> Mekanizmi i vlerësimit përqendrohet në shqyrtimin e këtyre ‘pengesave ndaj pjesëmarrjes’, duke përfshirë: marrëdhënien midis autorit dhe viktimës; vendngjarjen e incidentit; statusin e grave në kontekstin vendor dhe kombëtar; dhe format e dhunës të përjetuara përgjatë procesit zgjedhor. Duke i kuptuar këto pengesa, IFES shpreson të ofrojë një mënyrë për të kuptuar rreziqet dhe faktorët e ndërlikuar që mund të përkeqësojnë DHNGZ-në, me qëllim që të mbështesë përpjekjet e reagimit për parandalimin dhe zbutjen e DHNGZ-së.

të ciklit zgjedhor. Siç përcaktohet në pjesën e marrë nga “Dhuna ndaj grave në zgjedhje (VAWiE)” e IFES-it, i botuar në gusht të vitit 2016, instrumenti i monitorimit përfshin tetë lloje “veprimtarish monitorimi”, si vizita në terren, mbulimi publik, kutitë e grumbullimit, dhe vëzhgimet.<sup>208</sup> Nëpërmjet veprimtarive të vlerësimit dhe monitorimit, si dhe nga gjetjet e të dhënave të EVER-it, ky botim përmbillet me rekomandime gjithëpërfshirëse programimi, të cilat mund të jenë të dobishme për adresimin e DHNGZ-së në kontekste të ndryshme vendesh dhe rajonale. Këto sugjerime përfshijnë një sërë palësh

206. Po aty, fq. 5.

207. Shihni Kuadrin e Rrezikut të Sigurisë Zgjedhore të USAID-it këtu: <https://www.usaid.gov/documents/2496/best-practices-electoral-security-guide-democracy-human-rights-and-governance>. Shihni Kuadrin e Analizimit Gjinor të CARE këtu: <http://gendertoolkit.care.org/Pages/Gender%20Areas%20of%20Inquiry.aspx>

208. IFES, 2016. Fq. 9-10.

zgjedhore të interesit dhe përqendrohen në promovimin edhe programimin e mbështetur në të dhëna dhe përpjekje të mëtejshme kërkimi/monitorimi për DHNGZ-në. Megjithatë, këto instrumente dhe tipologji kërkojnë ende kohë përpara se të testohen në këtë fushë; prandaj, është e nevojshme kryerja e analizimeve të ardhshme të potencialit të tyre për mbledhjen e të dhënave në mënyrë që të analizohet plotësisht efikasiteti dhe ndikimi i metodologjive të paraqitura nga IFES-i brenda kontekstit zgjedhor në kohë reale.

#### **2.4. BORDI I SITUATËS SË GRAVE DHE PARANDALIMI I KONFLIKTIT NË ZGJEDHJE**

Bordet e situatës së grave (WSR) janë një lloj i nismave të shoqërisë civile të drejtuara nga gratë të cilat monitorojnë zgjedhjet me gjasa për t'u kthyer në konflikt në Afrikë. WSR-ja synon 'të promovojë zgjedhje paqësore, transparente, të parandalojë dhunën zgjedhore dhe të rrisë pjesëmarrjen demokratike. Si rezultat, ajo vë në praktikë strategji që përdorin eksperiencat e grave si ndërtuese të paqes nga themelet teksa trajnojnë, angazhojnë dhe autorizojnë agjentët politikë aktivë në publik.'<sup>209</sup> WSR-ja luajti rol fillimisht në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në Liberi dhe është shpalosur në disa shtete në Afrikë.

WSR-të përqendrohen në ofrimin e përkrahjes, përgjigjes së menjëhershme, trajnimeve, monitorimeve dhe ndërhyrjeve gjatë periudhave zgjedhore dhe mbështeten mbi një ekip 'monitoruesish' të shpërndarë në terren në Ditën e Zgjedhjeve. Duke vepruar kështu, WSR-të krijojnë partneritet me komunitetin dhe organizatat rajonale dhe palët e interesit, veçanërisht gratë dhe të rinjtë, në mënyrë që të monitorojnë zgjedhjet dhe të raportojnë dhe ndërhyjnë në incidente të dhunës zgjedhore. Një dhomë fizike e bordit të situatës ngrihet përpara ditës së zgjedhjeve dhe

funksionon si stacion qendror komandash për të marrë raporte nga monitoruesit në terren. Informacioni iu përcillet autoriteteve të caktuara, përfshirë EMB-në dhe forcat e sigurisë, që mund t'iu përgjigjen në mënyrë të menjëhershme raportimeve të incidenteve.

WSR-të ofrojnë një mundësi të rëndësishme për të mbledhur të dhëna mbi incidentet e dhunës të bazuara në gjini përgjatë zgjedhjeve. Duke qenë pranë në terren, WSR-të mund të kontribuojnë në ndjekjen e rasteve të dhunës që në të kundërt nuk do të raportoheshin nga media e as nga vetë viktimat. Ndërkohë që një bord situatë mbledh informacion mbi incidentet dhe ankesat nga publiku nëpërmjet një linje të posaçme të drejtpërdrejtë, formularët e mbledhjes së të dhënave priren të lenë jashtë mbledhjen e qartë të incidenteve të DHNGZ-ve ose dhunës me bazë gjinore, ndonëse disa të dhëna ndahen sipas gjinisë.<sup>210</sup> Standardizimi i një metode për monitorimin e DHNGZ, gjithashtu edhe i një kuadri metodologjik për ngritjen e WRS-ve, do të ndihmonte në krijimin e një baze të dhënash për DHNGZ-në duke bërë gjithashtu një hap të madh për të tërhequr vëmendjen drejt çështjeve të DHNGZ-së nëpërmjet provave të mbledhura nga WSR-të.

Në të vërtetë, të gjitha mjetet e parashtruara në këtë seksion nxjerrin në pah risi pozitive që mund të lehtësojnë integrimin e DHNGZ-së në vëzhgimin e zgjedhjeve dhe në programet e monitorimit të dhunës. Në mënyrë që të kontribuojnë në plotësimin e hendekut të të dhënave të DHNGZ-së, do të ishte e dobishme të konsideroheshin treguesit e përbashkët ose qasjet në metodologjitë e mbledhjes së të dhënave dhe pyetjet e përdorura në formularët e raportimeve. Standardet e vazhdueshëm të raportimit në zona të shpërndarjes dhe në fazat e zgjedhjeve do të ndihmojnë në mënyrë domethënëse në sigurimin e raportimit të incidenteve dhe prova mbi llojet dhe format e DHNGZ-së.

---

209. Paula Drumond, 2015. "Promoting Democracy in Preventing Electoral Violence: The Women's Situation Room" (Promovimi i Demokracisë në Parandalimin e dhunës zgjedhore: Bordi i situatës së grave). Rrjeti i zhvillimit të zgjidhjeve të qëndrueshme, 1 qershor. Fq. 7-8.

210. Ballington, 2016.



## SHEMBUJ TË WSR-SË NGA PROGRAMET E MONITORIMIT TË SHOQËRISË CIVILE.

Për të promovuar paqe në zgjedhjet e vitit 2015 në Nigeri, UN Women u bë partner me Qendrën Ndërkombëtare të Komunitetit Ekonomik të shteteve të Afrikës Perëndimore, me mbështetjen e UNDP-së, për të krijuar një mekanizëm monitorimi të dhunës zgjedhore të drejtuar nga shoqëria civile. Përfaqësues të Komisionit Kombëtar Zgjedhor dhe të Forcës Policore Nigeriane bashkëpunuan ngushtë me anëtarët e “Platformës së Grave Nigeriane për Zgjedhje paqësore” për të zbutur rastet e raportuara të dhunës zgjedhore dhe për të mundësuar reagimin në kohën e duhur. UN Women mori një çmim për kontributin e saj në zgjedhjet paqësore.

Në vitin 2013 në Mali, u ngritën platforma për paqen në bashkëpunim me autoritetet vendore duke siguruar një hapësirë ku votueset femra në Mali mund të shkëmbenin pikëpamje dhe informacione mbi zgjedhjet. Çdo ditë, folëset vinin dhe debatonin përkrah njëra-tjetrës mbi një sërë çështjesh kritike, si rëndësia e votës së grave, impakti i dhunës zgjedhore në votën e tyre, rolin e të rinjve në zgjedhje, rolin e medias në ruajtjen e paqes etj. Gjithashtu, u diskutuan aspektet praktike të votimit, si shpërndarja e kartave me Numrin Kombëtar të Identifikimit për votuesit dhe fazat e ndryshme të numërimit të votimit. Si pjesë e projektit për asistencën psikologjike dhe ekonomike për vajzat dhe gratë e shpërngulura si rrjedhojë e konfliktit të armatosur në rajonet veriore të Malit, 18 hapësira për dialog dhe ndërveprim u krijuan dhe morën jetë në Bamako, Mopti dhe Timbuktu.



## PËRMBLEDHJE E VËZHGIMEVE NË ZGJEDHJE DHE INICIATIVAVE PËR MONITORIMIN E DHUNËS.

Periudha parazgjedhore	Periudha e zgjedhjeve	Periudha paszgjedhore
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshtatni dhe integroni DHNGZ-në në vëzhgimet zgjedhore ndërkombëtare dhe vendore</li> <li>• Integroni DHNGZ-në në sistemin e paralajmërimit të hershëm të dhunës zgjedhore</li> <li>• Integroni një pikëpamje gjinore në instrumentet ekzistuese të monitorimit të dhunës në zgjedhje</li> <li>• Identifikoni treguesit që duhen matur</li> <li>• Siguroni që DHNGZ-ja monitorohet dhe raportohet në Bordet e Situatës së Grave dhe në programe të tjera të monitorimi të shoqërisë civile</li> <li>• Zhvilloni mjete të harmonizuara të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshtatni dhe integroni DHNGZ-në në mjetet e vëzhgimit</li> <li>• Përfshini ndjeshmërinë gjinore në trajnimet e vëzhguesve</li> <li>• Synoni balancën gjinore në ekipet e vëzhgimit të zgjedhjeve</li> <li>• Riorganizoni raportimet nëpërmjet grupeve EOM.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguroni grumbullimin dhe raportimin</li> <li>• Identifikoni hendeqet dhe bëni rekomandime</li> <li>• Përfshini dimensionin gjinor në raportin dhe zbulimet e vëzhgimit</li> </ul>

# PROPOZIMI 3:

## REFORMA LIGJORE DHE POLITIKASH PËR PARANDALIMIN DHE REAGIMIN NDAJ DHNGZ-SË

Dhuna ndaj grave përbën shkelje të të drejtave të njeriut. Si e tillë, parandalimi i DHNGZ-së kërkon një kuadër gjithëpërfshirës dhe të shumëfishtë ligjor dhe politikash, bazuar në konventat për të drejtat e njeriut dhe kuadrot normativë ndërkombëtarë.<sup>211</sup> Reformat ligjore dhe të politikave për DHNGZ-në synojnë të rrisin sigurinë për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje në të gjitha fushat (p.sh. kandidatet, votueset, punonjëset e zgjedhjeve ose gazetaret) duke kodifikuar legjislacionin që forcon mbrojtjet dhe vendosjen e gjobave rreth DHNGZ-së në nismat zgjedhore kombëtare dhe programimin e sundimit të ligjit. Në këtë seksion analizohen kuadrot ligjore dhe të politikave që mund të ndihmojnë në parandalimin e DHNGZ-së, duke përfshirë:

- Përdorimin e kuadrit ekzistues normativ ndërkombëtar;
- Miratimin e legjislacionit të ri ose reformimin e ligjeve ekzistuese;
- Zbatimin e ligjeve që parandalojnë DHNGZ-në;
- Lëshimi i protokolleve ose rregulloreve të reja nga EMB-të; dhe
- Miratimin e kodeve të sjelljes që lidhen me partitë politike dhe proceset zgjedhore.

### 3.1. PËRDORIMI I KUADRIT NORMATIV EKZISTUES

Ekziston një kuadër i gjerë normativ që përcakton të drejtat politike të grave në deklarata, marrëveshje dhe konventa. Përveç traktateve të shumta ndërkombëtare dhe rajonale dhe instrumenteve të politikave të

përshkruara më parë (shihni hyrjen), brenda kuadrit normativ gjejmë disa pika hyrëse për parandalimin dhe reagimin ndaj DHNGZ-së (shiko Tabelën 3).

Për shembull, deklaratat dhe komunikatat rajonale kanë shtyrë me sukses çështjet e DHNGZ-së dhe DHNGP-së në axhendën e politikave duke shprehur angazhime nga shtetet pjesëmarrëse dhe palët e përkatëse të interesit për të vepruar për të eliminuar dhunën në politikë. Në një shembull të hershëm, “Deklarata e Kathmandusë” e vitit 2007, e miratuar nga një konferencë e sponsorizuar nga Partneriteti Ndërkombëtar i Azisë Jugore, International IDEA dhe UN Women, paraqiti parimet e mëposhtme udhëzuese:

- Të gjitha organet përkatëse ndërkombëtare të traktateve të të drejtave të njeriut, të tilla si Komiteti CEDAW dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, duhet të njohin dhe të veprojnë kundër Dhunës ndaj Grave në Politikë, si një formë diskriminimi ndaj grave dhe shkeljes së të drejtave të tyre;
- Ligjet dhe politikat kombëtare duhet të harmonizohen me instrumentet, mekanizmat dhe standardet ekzistuese ndërkombëtare për të adresuar posaçërisht DHNGP-në;
- Organet përkatëse rajonale dhe kombëtare duhet të përfshijnë statistikën, informacionin dhe të dhënat për nivelet e pjesëmarrjes politike të grave dhe DHNGZ-së në bazat ekzistuese të të dhënave;
- Ligjet e veçanta zgjedhore duhet të hartohen për të adresuar çështjen e DHNGP-së;
- Komisionet zgjedhore duhet të jenë të autorizuar të administrojnë dhe zbatojnë këto ligje gjatë periudhave zgjedhore;
- Krrerët e shteteve duhet të marrin angazhime zyrtare

211. UNDP, 2012.

212. Përshtatur nga SAP International, et al., 2007.

**TABELA 3: KORNIZA NORMATIVE PËR PARANDALIMIN DHE REAGIMIN NDAJ DHNGZ-NË**

Korniza normative	
Traktatet dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948 <sup>213</sup>
	Konventa e të drejtave Politike të Grave, 1952 <sup>214</sup>
	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 1966 <sup>215</sup>
	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1979 <sup>216</sup>
	Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, neni 4, 1993 <sup>217</sup>
Instrumentet Ndërkombëtare të Politikës	Platforma për Veprim e Pekinit, 1995 <sup>218</sup>
	Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, 2000 <sup>219</sup>
	Rezoluta 66/130 e Asamblesë së Përgjithshme për Gratë dhe Pjesëmarrjen Politike, 2012 <sup>220</sup>
	Rezoluta A/HRC/RES/23/7 e Këshillit të të Drejtave të Njeriut për promovimin dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave të njeriut, të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore, përfshirë dhe të drejtën për zhvillim <sup>221</sup>
	Transformimi i botës sonë: Axhenda e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm, 2015 (A/RES/70/1)
Instrumente, Deklarata dhe Komunikime të Politikave Rajonale	Konventa Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Zhdukjen e Dhunës ndaj Grave (Belém do Pará), 1994 <sup>222</sup>
	Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Grave dhe Fëmijëve për Prostitucion (rajoni SAARC), 1997 <sup>223</sup>
	Protokoll i Kartës Afrikane mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit të Grave në Afrikë, 2003 <sup>224</sup>
	Deklarata e Kathmandu mbi Fytyrat e Padukshme të Dhunës ndaj Grave në Politikë, 2007 <sup>225</sup>
	Konsensusi i Kuitos, 2007 (Konferenca e 10-të Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe) <sup>226</sup>
	Këshilli i Evropës, Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 2011 <sup>227</sup>
	Konsensusi i Santo Domingos, ECLAC, 2013 <sup>228</sup>
	Deklarata e MESECVI mbi Ngacmimin Politik dhe Dhunën ndaj Grave, 2015 <sup>229</sup>
Deklarata e Përkushtimit e ParlAmericas për Diversifikimin e Fuqive Politike për të Ndërtuar Shoqëri Gjithëpërfshirëse, 2016 <sup>230</sup>	

213. UNGA, 1948. 217 A (III). Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor.

214. UNGA, 1952. A/RES/640(VII). Konventa e të Drejtave Politike të Grave, 20 dhjetor.

215. UNGA, 1966. Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Seria e Traktateve, Vëllimi 999, 16 dhjetor. Fq.171

216. UNGA, 1979.

217. UNGA, 1993.

218. UN, 1995.

219. UNSC, tetor 2000.

220. UNGA, 2011. A/66/130. Rezoluta mbi Gratë dhe Pjesëmarrjen Politike, 19 dhjetor.

221. <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G13/149/58/PDF/G1314958.pdf?OpenElement>

222. Inter-American Convention on the Prevention, Punishment and Eradication of Violence against Women (Konventa Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Zhdukjen e Dhunës ndaj Grave) (Belém do Pará), 1994.

223. SAARC, maj 1997. Convention on Preventing and Combating Trafficking in Women and Children for Prostitution (Konventa për Parandalimin dhe luftimin e trafikut të grave dhe fëmijëve për prostitucion).

224. OAU, qershor 1995. Protocol to the African Charter on Human and Peoples' Rights on the Rights of Women in Africa (Protokoll i Kartës

Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve për të Drejtat e Grave në Afrikë). Paraqitur në Takimin e tridhjetë e një të zakonshëm të organizatës së bashkimit Afrikan.

225. SAP International, International IDEA dhe UN Women, 2007. Declaration of the South Asian Regional Conference on the Invisible Faces of Violence on Women in Politics: Breaking the Silence (Deklarata e Konferencës Rajonale të Azisë Jugore për Fytyrat e padukshme të dhunës ndaj grave në politikë)(Deklarata e Kathmandusë). Kathmandu, Nepal, 18 – 20 shtator.

226. ECLAC, 2007. Quito Consensus at the Tenth session of the Regional Conference on Women in Latin America and the Caribbean. (Konsensusi i Kuitos në Seancën e Dhjetë të Konferencës Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe).Kuito, Ekuador.

227. Këshilli i Evropës, 2011. Convention on Preventing and Combating Violence against Women and Domestic Violence (Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje).

228. ECLAC, 2013b. Konsensusi i Santo Domingos në Seancën e Dymbëdhjetë të Konferencës Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe. Santo Domingo, Republika Domenikane, 15 – 18 tetor.

229. MESECVI, 2015. Declaration on Political Harassment and Violence Against Women (Deklarata për ngacmimin dhe dhunën politike ndaj grave). Lima, Peru, 15-16 tetor.

230. ParlAmericas, 2016. Deklaratë Angazhimi në Mbledhjen e Tetë vjetore për Diversifikimin e Pushtetit Politik për Ngritjen e Shoqërive Përfshirëse. Kuito, Ekuador, 2-3 qershor.

për të adresuar DHNGP-në vend dhe në forumet ndërkombëtare/rajonale.<sup>212</sup>


**“KONSENSUSI I KUITOS”** i vitit 2007, në të cilin janë palë 33 qeveri të Amerikës Latine dhe Karaibeve, refuzon në mënyrë të qartë “dhunën strukturore, e cila është një formë diskriminimi ndaj grave dhe vepron si një pengesë për arritjen e barazisë në ekonomi, punë, marrëdhëniet politike, shoqërore, familjare dhe kulturore, si dhe që pengon autonominë e grave dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në vendimmarrje”.<sup>231</sup> Qeveritë janë angazhuar posaçërisht për:

*(x) “të miratuar masa legjislative dhe reforma institucionale për të parandaluar, sanksionuar dhe zhdukur ngacmimin politik dhe administrativ të grave që arrijnë në pozicione vendimmarrëse përmes instrumenteve zgjedhore ose me emërim në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe në parti dhe lëvizje politike”.*

Që nga viti 1994, “MESECVI”, Mekanizmi Ndjekës i Konventës Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Zhdukjen e Dhunës ndaj Grave (referuar edhe si Konventa Belém do Pará), është përqendruar në zhdukjen e dhunës ndaj grave në rajonin e Amerikës Latine. MESECVI punon për të ndjekur zbatimin e angazhimit të bërë nga shtetet palë në Konventën Belem do Pará, përfshirë njohjen se:

- “Dhuna ndaj grave ‘...përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij, si dhe dëmton ose anulon respektimin, gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tilla...”<sup>232</sup>
- Gratë përjetojnë dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike në sferat private dhe publike, si dhe nga aktorët shtetërorë.<sup>233</sup>

Deklarata e vitit 1994 përcaktoi një listë të të drejtave të njohura dhe detyrimeve të shtetit, të cilat përfshijnë një larmi angazhimesh që përqendrohen në reformat



Deklarata e OAS për Ngacmimin Politik dhe Dhunën ndaj Grave (2016) riafirmon angazhimin e MESECVI-t për të eliminuar DHNGP-në, duke deklaruar se do të:

- “Promovojë dhe shpërndajë kërkime që marrin parasysh natyrën dhe specifikat e dhunës politike dhe/ose ngacmimit ndaj grave, si dhe gjenerimin e të dhënave statistikore lidhur me këtë çështje...”
- “Promovojë se politikat publike janë hartuar mbi ngacmimin politik dhe/ose dhunën ndaj grave, si dhe të lehtësojë barazinë thelbësore dhe forcimin e udhëheqjes së grave dhe praninë e tyre në pozicionet vendimmarrëse dhe zbatimin e tyre në nivele kombëtare dhe nënkombëtare...”
- “Promovojë se institucionet zgjedhore dhe subjektet e tjera publike, sipas rastit, përfshijnë çështjen e ngacmimit politik dhe/ose dhunës ndaj grave në kuadrin e funksioneve të tyre në lidhje me organizimin e zgjedhjeve, mbrojtjen e të drejtave politiko-zgjedhore të shtetësisë dhe zhvillimin e politikave të edukimit qytetar, si dhe në punën e tyre me partitë politike...”
- “Promovojë se partitë politike, organizatat politike dhe shoqërore dhe sindikatat, krijojnë instrumentet dhe mekanizmat e tyre të brendshëm për të parandaluar, ndëshkuar dhe zhdukur dhunën politike dhe/ose ngacmimin ndaj grave, si dhe për të kryer aktivitete të ndërjegjësimit dhe trajnimit të brendshëm për këtë çështje...”<sup>235</sup>

231. ECLAC, 2007. fq. 3.

232. I njëjti.

233. OAS, 1994. Inter-American Convention on the Prevention, Punishment and Eradication of Violence against Women (Konventa Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Zhdukjen e Dhunës

ndaj Grave) (“Konventa e Belem do Para”), 9 qershor. <http://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-61.html>.

234. Nëse shtetet dëshirojnë të miratojnë legjislacionin kundër DHNGZ-së, ligji model u siguron një ‘model teksti’.

235. MESECVI, 2015. Fq. 8-11.

ligjore dhe të drejtësisë në lidhje me mbështetjen e të mbijetuarave dhe parandalimin e të gjitha formave të DHNG-së. Në takimin e dytë të ekspertëve në vitin 2016, MESECVI ka punuar në bashkëpunim me aktorët rajonalë për të krijuar një projektligj model për dhunën ndaj grave në politikë.<sup>234</sup> Legjislacioni i ardhshëm i modelit do të sigurojë një pikë referimi për vendet e Amerikës Latine sipas Konventës së Belém do Pará të vitit 1994 duke nxitur shtetet e angazhuara të miratojnë ligje që adresojnë në mënyrë specifike çështjen e DHNGP-së. ECLAC, 2007.

Në vitin 2013, Komisioni Ekonomik për Amerikën Latine dhe Karaibet (ECLAC) organizoi Konferencën e 12-të Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe në Santo Domingo, Republika Domenikane. Çështjet e dhunës ndaj grave në sferat politike dhe publike, si dhe përmes teknologjisë dhe mediave, u trajtuan posaçërisht në “Konsensusin e Santo Domingos”.<sup>236</sup> Dokumenti u bën thirrje të gjitha shteteve anëtare të ECLAC-së dhe anëtarëve të asociuar<sup>237</sup> të rekomandojnë aktivitetet që çojnë barazinë gjinore në rajon përpara, veçanërisht pasi lidhet me fokusin aktual të Konferencës në TIK.<sup>238</sup> Këtu përfshihet:

- “Përforcimi i mekanizmave të vëzhgimit dhe monitorimit të zgjedhjeve me pikëpamje gjinore si instrumente që sigurojnë respektimin e të drejtave të grave për përfaqësim politik...” (Neni 104, fq. 12)
- “Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit për parandalimin, ndëshkimin dhe zhdukjen e dhunës politike dhe administrative ndaj ose ngacmimit të grave që arrijnë në pozicione vendimmarrëse të të gjitha niveleve...” (Neni 105, fq. 12)
- “Nxitja e mediave për t’u angazhuar ndaj objektivave të barazisë midis burrave dhe grave, përmes marrëveshjeve për të kryer veprime mediatike të lidhura me barazinë dhe të drejtat e grave në të gjitha sferat, përfshirë këtu barazinë gjinore në pjesëmarrjen

në proceset politike dhe në kandidim, të cilat përfshijnë format e ndryshme të pjesëmarrjes politike të grave dhe çështjet që prekin ato...” (Neni 107, fq. 13)

Në vitin 2016, ECLAC-ja publikoi një dokument qëndrimi, “Barazia dhe Autonomia e Grave në Axfordën e Zhvillimit të Qëndrueshëm”,<sup>239</sup> dhe “Strategjia Montevideo”<sup>240</sup> (ndjekurën vijim të Konferencës së 13-të Rajonale të grave të ECLAC-së në LAC). Ndërsa dokumenti i pozicionit i ECLAC-së diskuton përparimin e bërë që nga Konferenca e parë Rajonale në vitin 1977 dhe rekomandon “politika të mundshme pro-barazisë”<sup>241</sup> për rajonin në të ardhmen, Strategjia e Montevideos përcakton një plan rajonal zbatimi për përbushjen e angazhimeve të Axfordës së vitit 2030 të bëra nga shtetet anëtare të LAC-së.<sup>242</sup> Së bashku, këto dokumente reflektojnë dhe rivendosin marrëveshjet e bëra në Konsensusin e Santo Domingos, Konsensusin e Kuitos dhe Deklaratën e MESECVI-it për vitin 2015.

Dokumenti “Barazia dhe Autonomia e Grave në Axfordën e Zhvillimit të Qëndrueshëm” pranon në mënyrë të veçantë “ngacmimin politik” si një pengesë për pjesëmarrjen politike të grave që duhet të adresohet:

*“Përvoja në nivel rajonal tregon se natyra dhe ashpërsia e ngacmimit politik të grave ndryshon, duke filluar nga caktimi i grave në rrethe ku nuk mund të fitojnë dhe deri në mos sigurimin e mbështetjes materiale ose njerëzore, si dhe sulme ose kërcënime gjatë periudhave të fushatës. Në rastin e grave të zgjedhura, mund të nënkuptohet caktimi në komisione ose zona me më pak rëndësi, me pak ose aspak buxhet; trajtim diskriminues nga media; kërkesë më e madhe për përgjegjësi krahasuar me kolegët e tyre; dhe frikësim, kërcënime ose dhunë fizike ndaj tyre ose familjeve të tyre, të cilat në raste ekstreme mund të përfshijnë përdhunim ose vrasje (ECLAC, 2015j).” (fq. 125)*

236. ECLAC, 2013b.

237. Për një listë të plotë të shteteve anëtare të ECLAC dhe anëtarët e asociuar, shiko: <http://www.cepal.org/en/estados-miembros>

238. Shikoni ECLAC, 2013a. “Objektivat e seancës së XII të Konferencës Rajonale për gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe.”

239. ECLAC, 2016a. “Barazia dhe Autonomia e Grave në Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm” në Konferencën e Trembëdhjetë Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe. Montevideo, Uruguaj, 25 – 28 tetor.

240. ECLAC, 2016b. Strategjia e Montevideo për Zbatimin e Agjendës

Rajonale për Gjininë në kuadrin e Zhvillimit të Qëndrueshëm brenda 2030 (Strategjia Montevideo) në Konferencën e Trembëdhjetë Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe. Montevideo, Uruguaj, 25 – 28 tetor.

241. ECLAC, 2016a. “Barazia dhe Autonomia e Grave në Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm.” Fq. 9.

242. Plani përfshin edhe raportimet e detyrueshme dhe ndjekjen e raportimeve vullnetare në bazë vjetore nëpërmjet Forumit të Vendeve të Amerikës Latine dhe Karaibeve mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe Zyrarëve Kryesues të Konferencës Rajonale mbi Gratë në përkatësisht në Amerikën Latine dhe Karaibe. (ECLAC, 2016b.)

Duke u bazuar në dokumentin e qëndrimit, Strategjia e Montevideos parashikon një numër masash që Shtetet e ECLAC-së të adresojnë dhunën “publike, simbolik, institucionale, kibernetike...(dhe) politike” me të cilën mund të përballen gratë në rajon.<sup>243</sup> Në hyrjen e saj, Strategjia citon «demokracinë e bazuar në parime, përfaqësuese dhe pjesëmarrëse», si dhe lirinë nga dhuna si dy nga pesë qasjet e saj udhëzuese.<sup>244</sup> Në të përfshihen gjithashtu strategji që synojnë median dhe teknologjinë, reformat legjislative dhe përpjekjet programatike për të rritur monitorimin e çështjeve gjinore:

- “Miratoni ligje dhe rregulla gjithëpërfshirëse dhe specifike mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, përfshirë këtu legjisllacionin mbi të drejtën e një jete pa forma të dhunës me bazë gjinore, si dhe siguron zbatimin e tyre të plotë dhe efikas.” (Neni 1.d, fq. 13)
- “Miratoni ligje dhe norma për të siguruar qasje të barabartë të grave në pushtetin politik, duke nxitur barazinë gjinore në pjesëmarrje në të gjithë sferën publike.” (Neni 1.k, fq. 14)
- “Hartoni dhe kryeni vlerësime periodike përpara dhe pas përfektet e teknologjive në lidhje me ngacmimin dhe dhunën përmes mjeteve teknologjike...” (Neni 7.a, fq. 19)


Zhvilloni dhe përforconi instrumente për të matur pabarazitë gjinore, të tilla si anketat mbi përdorimin e kohës, dhunën ndaj grave, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe përdorimin e hapësirave publike, si dhe sigurimin e financimit dhe periodicitetit të tyre.” (Neni 9.c, fq. 21)

- “Krijoni ose përforconi sisteme monitorimi, sipas kriterëve të miratuara, që vlerësojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe periodike nivelin e zbatimit të ligjeve, normave, politikave, planeve dhe programeve për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave në nivelin rajonal, kombëtar dhe nënkombëtar.” (neni 10.a, fq 22).<sup>245</sup>

### 3.2. REFORMA LIGJORE NË NIVEL KOMBËTAR

Ndërgjegjësimi për peshën dhe shtrirjen e DHNGZ-së është rritur me shpejtësi, një zhvendosje e cila ka sjellë me vete një kërkesë në rritje për një përgjigje ligjore për të parandaluar, mbrojtur dhe ndëshkuar veprimet e DHNGZ-së. Ekzistojnë tri mënyra kryesore përmes së cilave mund të ndiqen reformat juridike:

- a. Përmes futjes së legjisllacionit të ri në formën e ligjeve të veçanta dhe të pavarura për të adresuar DHNGP-në (dhe DHNGZ-në);



#### REAGIMI NDAJ DHUNËS NË AMERIKËN LATINE

Kërkesat për një përgjigje ligjore për të parandaluar, mbrojtur dhe ndëshkuar akte të dhunës në politikë janë paraqitur kryesisht në Amerikën Latine. Diskutimi në Amerikën Latine përqendrohet pothuajse ekskluzivisht në dhunën ndaj grave në politikë sesa në dhunën ndaj grave në procesin e zgjedhjeve. Përqendrimi në politikë u lejon aktivisteve të theksojnë veprimet diskriminuese dhe të dëmshme që përjetohen nga gratë si candidate dhe si zyrtare të zgjedhura.<sup>246</sup> Ky përqendrim krijohet gjithashtu në përvojën ndër dekada të Amerikës Latine në miratimin dhe zbatimin e ligjeve për kuotën gjinore dhe ligjet për barazinë. Gratë përballen me diskriminim dhe ngacmim të vazhdueshëm gjatë kandidaturave të tyre dhe ndërsa janë në detyrë, duke vënë kështu në dukje që kuotat dhe barazia nuk janë të mjaftueshme për garantimin e ushtrimit të barabartë të të drejtave politiko-zgjedhore të grave. Në Amerikën Latine, DHNGP-ja është emëruar dhe sfiduar nga të njëjtat rrjete të formuar fillimisht për të siguruar zbatimin e kuotave, të tilla si Mujeres en Plural në Meksikë dhe ACOBOL në Bolivi.

243 ECLAC, 2016b, fq. 6.

244. Po aty, fq. 5.

245. I njëjti.

246. Piscopo, 2016.



- b. Duke futur DHNGP-në (dhe DHNG-në) në ligjet ekzistues për eliminimin e dhunës ndaj grave; dhe
- c. Duke prezantuar reformat ose zgjerimin e kodeve zgjedhore ose penale.

#### a. Ligje të posaçme

Një nga rrugët që vendet e Amerikës Latine kanë ndjekur është miratimi i një ligji të posaçëm dhe special që merret ekskluzivisht me DHNGP-në. Deri më tani, Bolivia është i vetmi vend i Amerikës Latine që ka miratuar legjislacionin për adresimin e DHNGP-së, me Ligjin Nr. 243 në vitin 2012. Senati meksikan miratoi legjislacionin në vitin 2013, por ligjvënësit në të dy dhomat vazhdojnë të diskutojnë propozime të shumta. Kongresi në Ekuador hodhi poshtë legjislacionin e DHNGP-së në vitin 2011, por kodi zgjedhor i vitit 2012 prezantoi një dispozitë neutrale gjinore, sipas së cilës ngacmimi sistematik i kandidatëve ose zyrtarëve të zgjedhur është subjekt i sanksioneve të kodit penal. Anëtarët e asamblesë së femrave në Ekuador rivendosën legjislacionin e DHNGP-së në vitin 2016.

Kosta Rika, Peru dhe Honduras, ndër të tjera, kanë marrë në konsideratë edhe ligjet e DHNGP-së.<sup>247</sup>

Ligji bolivian përcakton 17 akte të dallueshme të DHNGP-së, si dhe (në të vërtetë, shumica e projektligjeve) bën dallimin midis acoso político (ngacmimit politik) dhe violencia política (dhunës politike). Zakonisht, ngacmimi është më pak serioz dhe meriton ndëshkime më të lehta, ndërsa dhuna konsiderohet më serioze dhe meriton ndëshkim më të rreptë. Statuti bolivian e karakterizon acoso si “presion, persekutim, ngacmim ose kërcënim” dhe violencia si “veprime, sjellje dhe sulme fizike, psikologjike dhe emocionale”.<sup>252</sup> Ligji bolivian dhe propozimet në Kosta Rika dhe Honduras përcaktojnë qartësisht dënime minimale dhe maksimale për akte me ashpërsi të ndryshme. Diku tjetër, projektligjet specifikojnë kohëzgjatjen e dënimeve (p.sh., burgim nga tre muaj deri në gjashtë vite në një propozim meksikan), por pa i lidhur dënimet minimale ose maksimale me akte specifike. Bolivia ndalon në mënyrë të veçantë pajtimin midis viktimave dhe agresorëve në të gjitha rastet e DHNGP-së.<sup>253</sup>

Ligjet dhe ligjet e posaçme të propozuara
Bolivi, Ligji kundër ngacmimit dhe dhunës politike ndaj grave, 2012 <sup>248</sup>
Kosta Rika, Projektligji kundër ngacmimit politik/dhunës ndaj grave, 2013 <sup>249</sup> (draft)
Ekuador, Projekt për një ligj organik kundër diskriminimit politik, ngacmimit dhe dhunës me bazë gjinore, 2011 (draft); Projekt për një Ligj Organik që do të reformojë Ligjin Organik Zgjedhor, Kodin e Demokracisë për Parandalimin dhe Sanksionimin e Ngacmimit Politik me Bazë Gjinore, 2016 (draft)
El Salvador, Ligji i veçantë gjithëpërfshirës për jetën e lirë të grave nga dhuna, 2011 <sup>250</sup> (draft)
Peru, Projektligji kundër ngacmimit politik ndaj grave, 2012 <sup>251</sup> (draft)

247. I njëjti.

248. ALP, 2012. Ley Contra el Acoso y Violencia Política Hacia Las Mujeres, No. 0026.


249. ALRCR, 2013. Proyecto de Ley Contra Acoso y/o Violencia Política Contra Las Mujeres, Nr. 18.719.

250. Në krijimin e ligjit, qeveria e El Salvador pranoi se dhuna ndaj grave i pengon ata të ushtrojnë të drejtat e tyre në sferat sociale, politike, ekonomike, kulturore dhe familjare”. (ALES, 2011. Ley Especial Integral Para Una Vida Libre DeViolencia Para Las Mujeres, nr.520.)

251. CRP, 2012. Proyecto de Ley Contra el Acoso Politico Hacia Las Mujeres, No. 1903.

252. ALP, ligji nr. 243/2012. Neni 7.

253. Piscopo, 2016.



## EVOLUCIONI I LIGJIT KUNDËR NGACIMIT DHE DHUNËS POLITIKE NDAJ GRAVE NË BOLIVI<sup>254</sup>

Procesi i reformës juridike daton në vitin 2000 dhe nisi në një seancë të Kongresit të Komisionit të Republikës për Pjesëmarrjen e Popullit, ku "...së bashku me Zëvendësministrin për Çështjet e Gjinisë, Brezit dhe të Familjes, gratë e këshillit denoncuan publikisht ngacmimet dhe dhunën politike që po kryhej ndaj tyre në komuna të ndryshme të vendit".<sup>255</sup> Në vitin 2001, u përpunua Projektligji i parë kundër ngacmimit me bazë gjinore dhe dhunës politike.

Gjatë viteve 2002-2004, Projektligji i parë u verifikua nga institucione të ndryshme në fushën e barazisë gjinore, me qëllim sistematizimin dhe shpërndarjen e tij përmes seminareve në shkallë vendi. Për t'u ndjekur më pas nga lobimi i kryer në Shtëpinë e Senatorëve të Kongresit Kombëtar në vitin 2004. Komiteti i Veprimit për të Drejtat Politike për Gratë, i përbërë nga përfaqësues nga institucione të ndryshme që punojnë mbi çështjet gjinore (përfshirë ACOBOL, Zëvendësministrja e Grave, Zëvendësministri i Drejtësisë, Zëvendësministri i Pjesëmarrjes së Njerëzve, Avokati i Popullit, Unioni i Grave Deputete, dhe Forumi Kombëtar Politik i Grave) ishte një mbështetje dhe katalizator i rëndësishëm për ndryshimet në vitet në vijim. Puna e Komitetit bëri që gratë në organe të ndryshme publike të ndërjegjësoheshin më shumë mbi rëndësinë e luftimit të ngacmimit dhe dhunës politike.

Me rritjen e vëmendjes mediatike dhe ndërjegjësimin mbi dhunën politike ndaj grave, e rritur më tej pas vrasjes së Këshilltares Juana Quispe, ishte momenti i duhur për të miratuar Ligjin Nr. 243 më 28 maj të vitit 2012. Ligji nuk e kufizon zbatimin e tij tek gratë në zyrën publike, por ai shtrin fushëveprimin e tij për çdo grua të caktuar në rol politik/publik ose që ushtron rol të tillë. Ligji klasifikon aktet e ngacmimit dhe dhunës politike, duke i kategorizuar ato si 'të lehta', 'të rënda' dhe shumë 'të rënda', si dhe duke përcaktuar sanksionet për çdo kategori, duke bërë kështu të mundur identifikimin e qartë të këtyre akteve dhe sanksionet e tyre përkatëse.

Në rastet e ngacmimeve ose dhunës politike, denoncimi duhet të bëhet nga vetë e mbijetuara, anëtarët e familjes së saj ose 'çdo personi fizik ose ligjor' në mënyrë verbale ose me shkrim përpara autoriteteve kompetente. Ekzistojnë tri mënyra denoncimi: administrative, penale dhe kushtetuese. Në rastin e rrugës penale, një përparim i rëndësishëm në këtë legjislacion ka qenë futja e kategorive të reja të krimit në Kodin Penal në Bolivi. Kjo mënyrë ndalon pajtimin, me qëllim për të parandaluar presionin e mëtejshëm ndaj viktimat e ngacmimit dhe dhunës politike.

Përgjithësisht, projektligjet në Kosta Rika, Ekuador dhe Meksikë ndjekin të njëjtin dallim që bën Bolivia midis ngacmimit dhe dhunës me ndryshime të vogla. Projektligji i Kosta Rikës bazohet në përkufizimin e dhunës në Bolivi ("veprime ose sjellje që shkaktojnë vdekje fizike, seksuale, ose psikologjike, dëmtim dhe vuajtje") dhe e ndan ngacmimin në tri kategori të veçanta.<sup>256</sup> Në Kosta Rika, "ngacmimi" përfshin ngacmimet politike (duke përdorur përkufizimin e Bolivisë për termin); ngacmimin psikologjik (duke

shtuar një kategori krimesh që lidhet me poshtërimin sistematik ose ngacmimin e politikaneve femra); dhe dhunën politike verbale (duke përfshirë sulmet verbale si një kategori e veçantë).<sup>257</sup> Pavarësisht nga termat e përdorur, i gjithë legjislacioni i propozuar përqendrohet në sulmet fizike, psikologjike dhe seksuale, si dhe ngacmimet dhe diskriminimet sistematike.

Pothuajse të gjithë kuadrot ligjorë të miratuar ose në shqyrtim në Amerikën Latine kufizojnë klasën e

254. Përshtatur nga UNDP-ja, et al. "Gender-Based Political Violence: Bolivia." (Dhuna politike me bazë gjinore: Bolivia) në Advancing Gender Equality: Promising Practices (Avancimi i Barazisë Gjinore: Praktika premtuese)

255. 2009. "Incidencia política para la Aprobación de ACOBOL." La Paz, Bolivia, fq. 11.

256. Piscopo, 2016.

257. ALRCR, 2013. Neni 5.



**TAKIM NË BOLIVI  
PËR DISKUTIMIN  
E ZBATIMIT TË  
OBSERVATORIT  
TË TRIBUNALIT  
ZGJEDHOR PËR  
MONITORIMIN E  
DHNGZ-SË.**

viktimize duke përfshirë vetëm gratë pjesëmarrëse në politikën zyrtare zgjedhore ose që shërbejnë në zyra formale.<sup>258</sup> Ligji i Bolivisë përfshin “të gjitha kandidatet femra, zyrtare të zgjedhura ose të caktuara, ose ato që ushtrojnë një funksion politik-publik”, si dhe anëtarët e familjes së tyre.<sup>259</sup> Mbrojtjet e përshkruara në Ligjin Nr. 243 nuk përmendin gratë që marrin pjesë në politikën jozyrtare, ku përfshihen gratë që marrin pjesë në grupe aktiviste, sindikata dhe organizata joqeveritare. Projektligji në Kosta Rika do të shtrijë mbrojtjen për gratë që marrin pjesë në lëvizje politike, organizata shoqërore dhe organizata punëtore.<sup>260</sup> As statuti i Bolivisë dhe as ligjet e propozuara nuk i përmendin gratë si votuese apo si nëpunëse civile.<sup>261</sup>

Nga ana tjetër, autorët kategorizohen gjerësisht. Statuti i Bolivisë i referohet akteve të ngacmimit politik ose dhunës politike të kryer nga “një person ose grup anëtarësh, drejtpërdrejt ose përmes palëve të treta”.<sup>262</sup>

Duke qenë se projektligji meksikan shprehet në mënyrë specifike se DHNGP-ja mund të ndodhë në propaganda zgjedhore, kjo klauzolë mund të përfshijë median e lajmeve dhe partitë politike si autorë.<sup>263</sup> Sidoqoftë, statuti i Bolivisë dhe projektligjet nuk specifikojnë në mënyrë specifike partitë politike si përgjegjës të DHNGP-së. Ligji Nr. 243 në Bolivi përmend partitë politike vetëm një herë: autorët që janë edhe kryetarë

të partive do të vuajnë dënimin maksimal.<sup>264</sup> Në mënyrë të ngjashme, projektligji në Kosta Rika identifikon dënime të veçanta në varësi të rolit që zë autori, duke propozuar që anëtarët e kryesisë së partisë përgjegjëse për DHNGP-në do të pësojnë sanksione penale dhe do t'u hiqet posti.<sup>265</sup>

#### **b. Ligjet për dhunën ndaj grave**

Reforma ligjore për të adresuar dhunën ndaj grave në politikë dhe zgjedhje mund të përfshijë edhe futjen e DHNGP-së në ligjet e EVAW-t ose zbatimin e dispozitave të gjera kundër dhunës publike ose komunitare të gjendur në ligjet EVAW-t. Sërish, Amerika Latine ofron shembuj ilustrues.<sup>266</sup> Konventa Ndëramerikane mbi Parandalimin, Dënimin dhe Zhdukjen e Dhunës ndaj Grave (1944), në të cilën marrin pjesë të gjitha vendet e Amerikës Latine, përfshin të drejtën e grave për të pasur akses në shërbimin publik dhe për të marrë pjesë në çështje publike (Neni 4), si dhe iu jep të drejtë grave të ushtrojnë lirisht dhe plotësisht të drejtat e tyre politike (Neni 5). Pas konventës, të gjithë shtetet e Amerikës Latine reformuan ligjet e tyre të EVAW-t. Në legjislationin e ri të shkruar në fund të viteve 1990 dhe gjatë viteve 2000, pjesa më e madhe e shteteve miratuan legjislation të specializuar e të mëvetësishëm për EVAW-n, ndonëse disa i ndryshuan kodet e tyre penale për të përfshirë krimin specifik të dhunës ndaj grave.<sup>267</sup>

258. Piscopo, 2016.

259. ALP, ligji nr. 243/2012. Neni 5.

260. Siç do të kishte bërë propozimi i Ekudorit në 2011, i cili dështoi të kalonte.

261. Pjesë e marrë nga Piscopo, 2016

262. ALP, ligji nr. 243/2012. Neni 5.

263. Laura Albaine, 2015. “Marcos normativos contra el acoso y/o

violencia política en razón de género en América Latina.” Prezantuar në, *Violencia Política contra las mujeres en América Latina: diagnósticos, diálogos y estrategias*, Mexico City, cit. Piscopo 2016

264. ALP, ligji nr. 243/2012. Neni 17.

265. ALRCR, 2013. Neni 32.

266. Paragrafi është i shkëputur nga Piscopo, 2016.

267. Pas Konventës, vetëm Republika Domenikane dështoi të miratonte legjislationin e ri EVAW ose të reformonte Kodin e tij Penal. (Po aty.)

Këto reforma ndoqën gjerësisht kuadrin ligjor normativ të parashtruar në Konventë. Pothuajse të gjitha legjislacionet qartësonin se kjo dhunë mund të ndodhte në publik ose në vendin e punës dhe e përkufizonin dhunën si fizike, psikologjike, seksuale, trashëgimore dhe simbolike.<sup>268</sup> Pjesa më e madhe gjithashtu e identifikonin shtetin ose agjentët e tij si autorë të dhunës kundrejt grave. Ligji i Përgjithshëm i vitit 2007 në Meksikë “Për jetën pa dhunë të grave” ndalon “dhunën komunitare”, e cila përfshin “akte individuale ose kolektive që dhunojnë të drejtat themelore të grave dhe që çojnë në shpifje, diskriminimin, marginalizimin dhe përjashtimin e tyre nga sfera publike.”<sup>269</sup> Ligjet EAW në Salvador (2011) dhe Panama (2013) i referohen në mënyrë të qartë pjesëmarrjes politike dhe të drejtave politike të grave. Statuti i Salvadorit ndalon “pengimin, kufizimin ose krijimin e pengesave për pjesëmarrjen e grave në procese të arsimit, pjesëmarrjes në politikë, bashkimit me forcën e punës ose kërkimit të kujdesit shëndetësor, gjithashtu edhe “vënien në lojë, diskreditimin, degradimin ose izolimin” e grave në kuadër të këtyre hapësirave.<sup>270</sup>

Statuti i Panamasë përfshin violenca política (dhunë politike) si një formë e DHNG-së, përkufizuar si diskriminim në aksesin e mundësive dhe burimeve të lidhura me mbajtjen e posteve partiake, publike dhe të zgjedhura.<sup>271</sup> Përkufizimet e zgjeruara të rajonit për dhunën kundër grave, e kodifikuar në ligjet EAW, sugjerojnë që shtetet mund të adresojnë DHNGZ-në pa miratuar legjislacion të ri. Pranimi se dhuna ndodh në publik dhe në vendin e punës mund të mbrojë jo vetëm kandidatet femra dhe zyrtaret e zgjedhura, por gjithashtu edhe votueset femra dhe nëpunësit civile. Përkufizimet e zgjeruara të DHNG-së, të cilat përfshijnë sulmet fizike dhe jo-fizike në sferën publike, mundësojnë gjithashtu mënyra kompensimi për politikanet femra. Në maj të vitit 2017, Asambleja Legjislative e Qytetit të Meksikos miratoi një ndryshim të Ligjit Vendas mbi të Drejtat e Grave për të Jetuar pa Dhunë,<sup>272</sup> duke shtuar përkufizimin e Dhunës me Bazë Cjinore në Politikë dhe

19 përkufizime ligjore për të provuar dhunën politike kundër grave. Dhuna politike kuptohet se përfshin çdo veprim ose lënie jashtë që ka qëllimin ose rezulton se është e njëanshme, që pengon, kufizon, pezullon, dëmton, shfuqizon, përjashton ose ndikon pranimin, aksesin, gëzimin ose ushtrimin e të drejtave politike ose zgjedhore të një gruaje, po ashtu edhe të drejtën për ushtrim të plotë të detyrave të qenësishme për pozicionin e saj ose funksionet në zyra publike. Ky ndryshim ka për qëllim të mbrojë dhe promovojë të drejtat politike të grave përgjatë procesit parazgjedhor dhe periudhës së fushatës, procesit të zgjedhjeve dhe përgjatë ushtrimit të detyrave si zyrtare publike.<sup>273</sup>

### c. Ligjet zgjedhore

Ligjet zgjedhore mund të vendosin kufizime ligjore për përdorimin e dhunës në zgjedhje, po ashtu edhe të përcaktojnë mandatin e sigurisë dhe fuqitë e organeve të menaxhimit të zgjedhjeve. Ligje të tilla mund gjithashtu të përcaktojnë një kod zgjedhor të sjelljes, i cili mund të përfshijë marrëveshje mbi shmangien e gjuhës së urrejtjes dhe veprimtarive të tjera që mund të sjellin dhunë dhe polarizim.<sup>274</sup> Kodet zgjedhore mund të lidhen me dispozitat e kodit penal, ashtu si në Pakistan, ku rishikimi parashikoi se ndëshkimet duhet të bëheshin të detyrueshme ndaj kujtdo që gjendej fajtor për ndalimin e një gruaje për të votuar.<sup>275</sup> Po ashtu, e drejta e grave për të votuar, e drejta për tu zgjedhur për kandidaturë dhe përfaqësi, përkufizohen nga ligjet zgjedhore. Megjithëse ligjet për regjistrim dhe kandidaturë nuk parashikojnë drejtpërdrejtë dispozita për DHNGZ-në, ato mund të ndihmojnë në balancimin e pozicionit të kandidateve femra, veçanërisht në kontekst me DHNGZ-në. Për shembull, aty ku gratë në situata të tjera do të përballeshin me frikësim ose rezistencë të dhunshme për faktin që kandidojnë për një post publik, kuotat legjislative të pjesëmarrjes ose sistemet zgjedhore që favorizojnë zgjedhjen e tyre, mund t’i ndihmojnë të përfitojnë akses në poste publike. Ligjet zgjedhore mund gjithashtu të synojnë parandalimin e votimit familjar. Standarde të ndryshme

268. OAS, 2014. “Informe Hemisférico 2014.”

269. CGEUM, 2007. Ley General de Acceso de las Mujeres a una Vida Libre de Violencia. Neni 16.

270. Ligji 520/ALES, 2011. Neni 55.

271. LNRP, 2013. Ley 82. Neni 4.

272. Qeveria e Qytetit të Meksikës. Fletorja zyrtare Nr.112, publikuar më 17 korrik 2017.

273. I njëjti.

274. K.Höglund and A.K.Jarstad, 2010. “Strategji për Parandalimin dhe Menaxhimin e Dhunës Zgjedhore: Konsideratë për Politikë.” In Dokument Përmbledhës për Politika dhe Praktikë: Njohuri mbi Paqen që Zgjat, Nr.1, Universiteti Uppsala

275. UN Women Pakistan, 2016.

ndërkombëtare ofrojnë udhëzime mbi këtë. Komisioni i Venecias i Këshillit Evropian deklaroi se “Votimi duhet të jetë individual. Votimi familjar dhe çdo lloj formë tjetër kontrolli nga një votues mbi votën e një tjetri duhet të jenë të ndaluar.”<sup>276</sup> Udhëzimet e International IDEA-s për Rishikimin e Kuadrit Ligjor për Zgjedhjet sugjerojnë se, “Praktika e votimit familjar, ku kryetari i familjes voton në emër të anëtarëve të tjerë të familjes, nuk duhet të kalohet pa u vënë re.”<sup>277</sup>

Megjithatë, ndryshimet në kodin zgjedhor dhe penal janë koncize zakonisht. Ndonëse Kongresi i Ekuadorit refuzoi legjislacionin për DHNGP-në në vitin 2011, kodi zgjedhor i vitit 2012 prezantoi një dispozitë që deklaroi se ngacmimi sistematik i kandidatëve ose zyrtarëve të zgjedhura është subjekt i sanksioneve të Kodit Penal. Klauzola pa dallim gjinore përfshirë në Kodin Zgjedhor të Ekuadorit është shumë e përmblëdhur: “veprimet sistematike të presionit, ngacmimit, kërcënimeve ose veprime të tjera ku përdoret forca kundër një personi me qëllimin për të kufizuar ose penguar aksesin e tyre në pozicione të zgjedhura me votë popullore do të sanksionohen sipas Kodit Penal.”<sup>279</sup>

Për shkak të natyrës koncize të këtyre ndryshimeve të kodeve zgjedhore, ato miratohen më lehtë. Pjesa më e madhe e ligjeve të kuotave gjinore në Amerikën Latine kaluan jo si legjislacion më vete, por si pjesë më e gjerë e reformave zgjedhore. Kjo strategji tërheq vëmendjen e publikut te problemi më i madh, si nevoja e përgjithshme për të përmirësuar cilësinë e drejtësisë në zgjedhje. Ndryshimi i legjislacionit aktual mund të lejojë integrimin e DHNGP-së. Për shembull, sipas një propozimi në Meksikë do të modifikohet kodi zgjedhor për të ndaluar propagandën zgjedhore që nxit DHNGP-në, duke modifikuar gjithashtu ligjin e vitit 2007 për të përfshirë shkelje të tjera (p.sh., ndalimi i kthimit në punë të grave pas periudhave të gjata lejeje).<sup>280</sup>

Zgjedhja ndërmjet miratimit të legjislacionit të posaçëm apo ndryshimit të statuteve ekzistuese përfshin disa kompromise. Ligjet e specializuara përqendrojnë vëmendjen e publikut në një problem specifik. Ato mund ta mbulojnë problemin më hollësisht, duke mundësuar që shtetet të tipizojnë më shumë akte që konsiderohen DHNGP.<sup>281</sup> Për shembull, statuti i posaçëm i Bolivisë tipizon 17 akte si DHNGP,

#### **NXJERRJA E LIGJEVE PËR TË ARDHMEN NË AMERIKËN LATINE<sup>282</sup>**

Përpjekjet për të parandaluar dhe dënuar VAWP në Amerikën Latine po ecin përpara me shpejtësi. Shtetet po kalojnë legjislacione të mëvetëshme, duke vlerësuar ndryshimet për ligjet ekzistuese për EVAW-n dhe kodet penale dhe zgjedhore, si dhe zhvillimin e protokolleve ndërmjet EMB-ve të tyre. Në vitin 2012, Bolivia kaloi të parin ligj të specializuar për DHNGP-në, i cili deri më tani është i vetmi. Megjithatë, zbatimi i Ligjit Nr. 243 ka qenë i padrejtë deri më tani: në shtator të vitit 2016, dega ekzekutive nuk kishte përfunduar procesin e nevojshëm të shkrimit të rregullave dhe Ministria Publike nuk kishte zgjidhur asnjë çështje të DHNGP-së. Pamundësia e grave për tu mbështetur në rrugët ligjore rrezikon shtrirjen e juridiksionit të rrugëve administrative përtej çështjeve zgjedhore deri në procedime penale. Për më tepër, numri i vogël i çështjeve të zgjidhura nxit më tej pandëshkueshmërinë.<sup>283</sup>

Të gjitha fazat për të adresuar DHNGP-në në Amerikën Latine duhet të jenë shkak për sfidat e lidhura me kapacitetet e ulëta të shtetit dhe pandëshkueshmërinë. Ligji Nr. 243 në Bolivi parashton një axhendë ambicioze, por burimet e pamjaftueshme financiare dhe njerëzore mund të kufizojnë zbatimin. Për këtë qëllim, ndjekja e DHNGP-së nën statutet aktuale ose të ndryshuara për EVAW-n do të lejojë shtetet e Amerikës Latine të përdorin procedurat ekzistuese penale ose administrative për të adresuar dhunën ndaj grave. Ndonëse ligjet për EVAW-n vuajnë gjithashtu nga moszbatimi në nivelin e duhur, shumë rregullore, shërbime dhe programe (p.sh., gjykatat e specializuara ose trajnime për ndjeshmërinë gjinore) janë në dispozicion. Në mënyrë të ngjashme, protokollat e EMB-së ndërtohen mbi procedurat ekzistuese, pasi institucionet zgjedhore përpunojnë dhe vendosin për çështje të lidhura me kuotat dhe ligjet e barazisë. Aty ku legjislacioni ka ngecur, aktivistët dhe politikëbërësit kanë ende mjete në dispozicion për t'u përballur me dhunën kundrejt grave në politikë.

276. Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës, 2002. Code of Good Practice in Electoral Matters: Guidelines and Explanatory Report (Kodi i praktiva të mira në çështjet zgjedhore: Udhëzime dhe Raport shpejgues) Strasburg: Këshilli i Evropës.

277. International IDEA, 2002. International Electoral Standards: Udhëzime për Rishikimin e Kuadrit Ligjor të Zgjedhjeve Stockholm.

278. Piscopo, 2016.

279. ALE, 2012. Código de la Democracia. Neni 285.

280. Piscopo, 2016.

281. Albaine, 2015.

282. Informacion i mundësuar nga Jennifer Piscopo.

283. La República (Peru), 2016. “JNE atenderá actos de discriminación contra mujeres en elecciones.” 3 mars.

duke filluar nga imponimi i stereotipave gjinorë e deri në ndalimin e fjalës së grave në takime.

### 3.3. ZBATIMI I LIGJEVE

Politikëbërësit, të cilët synojnë të mbrojnë ndaj DHNGZ-së dhe ta ndëshkojnë atë, kanë në dispozicion të tyre disa opsione legjislative. Ligjet dhe nismat, veçanërisht ato në Amerikën Latine, ofrojnë precedentë dhe shembuj ku vendet e tjera dhe aktorët e ndryshëm mund të mbështeten. Megjithatë ekziston një kuadër normativ rajonal, mjedisi legjislativ për adresimin e dhunës ndaj grave është i dobët në shumicën e vendeve në Amerikën Latine. Sfidat e dokumentimit të ngjarjeve të DHNGZ-së, dhe ndërgjegjësimi i ligjëbërësve për nevojën e mbrojtjes ligjore, janë pengesa të tjera ndaj zhvillimit të legjislacionit të posaçëm. Prandaj, reformat në drejtësi dhe zbatimi i duhur i ligjeve duhet të mbahen parasysh në përpjekjet e ardhshme për reformimin ligjor dhe të politikave. Deklarata e OAS për Ngacmimin dhe Dhunën Politike ndaj Grave (2016) përfshin një propozim për miratimin e rregulloreve dhe masave për parandalimin dhe eliminimin e DHNGP-së, gjë e cila do të mundësojë “ndëshkimin e duhur dhe ndreqjen e këtyre veprimeve, në sferën e normave administrative, penale dhe zgjedhore, duke pasur parasysh instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare.”<sup>284</sup>

Programimi që ka të bëjë me drejtësinë është një element i rëndësishëm i zbatimit të politikave. Prania e gjyqtareve gra, ndjeshmëria gjinore në organin gjyqësor, aksesit në proceset formale të ankesave, zbatimi i ligjeve, janë të gjithë aspekte thelbësore të drejtësisë zgjedhore për ndëshkimin e autorëve të DHNGZ-së dhe mundësimin e shërbimeve për viktimat e DHNGZ-së.<sup>285</sup> Sigurimi i zbatimit dhe vënia e drejtësisë mund të ngadalësohen ose pengohen nga:

- Mungesa e një kuadri ligjor që njeh dhe parashikon masa kundër DHNGZ-së;
- Mungesa e agjencive qeveritare me autoritetin apo vullnetin politik për të zbatuar ndëshkimet;
- Kultura e mosndëshkimit të autorëve, e cila shfaqet në mosndjekjen penale të autorëve dhe/ose mungesa e dëmshpërblimit për viktimat;
- Mungesa e trajnimeve me ndjeshmëri gjinore dhe e personelit femëror në sistemin policor dhe të drejtësisë;

- Vonesa në reagimin gjyqësor ose policor pas reformave ligjore, që mund ta bëjë zbatimin e masave të dobët ose joekzistues;
- Mungesa e ndërgjegjësimin nga ana e organit gjyqësor. Kjo mund të pengojë gratë që të raportojnë formalisht rastet për shkak të turpmit apo frikës nga refuzimi shoqëror; dhe
- Gratë mund të mos kenë dijeni për të drejtat e tyre apo për mekanizmat e disponueshëm të ankesës dhe sistemit gjyqësor

Legjislacioni që adreson DHNGP-në ose DHNGZ-në duhet të mbështetet nga plane kombëtare veprimi të qarta dhe instrumente të tjera zbatimi. Në Amerikën Latine, Grupi i Grave Deputete i ParlAmericas hartoi “Parandalimin e Ngacmimit dhe Dhunës Politike ndaj Grave: Një Plan Veprimi për Deputetët” në vitin 2014, ku ofrohen rekomandime për Shtetet anëtare në fusha të ndryshme, duke përfshirë:

- Përdorimin e ndëshkimeve dhe reagimin e koordinuar të sektorëve të drejtësisë;
- Hartimin e legjislacioneve specifike të bazuar në angazhimet ndërkombëtare dhe rajonale (p.sh., CEDAW, Konventa e Belém do Pará) dhe masat për zbatimin e tyre;
- Krijimin e një sërë mekanizmash civile, penale, zgjedhore dhe administrative për të marrë, hetuar dhe për t’iu përgjigjur ankesave për ngacmim/dhunë politike, në varësi të kontekstit vendor (p.sh. nëpërmjet zyrës së avokatit të popullit ose e ngjashme me të); dhe
- Dhënien e përparësisë së proceseve të sigurta dhe të drejtpërdrejta për të mbijetuarat që zgjedhin të bëjnë ankesë formale.

### ZBATIMI I LIGJIT NR. 243 TË BOLIVISË

Statuti i Bolivisë për DHNGP-në ia vendos përgjegjësinë e plotë të zbatimit të Ligjit Nr. 243 Ministrisë Publike, e cila është ekuivalente me ministrinë e drejtësisë. Viktimat mund të paraqiten drejtpërdrejtë tek autoritetet e zbatimit të ligjit, ose në rastin e parë, mund të zgjedhin rrugën administrative të autoriteteve të institucioneve shtetërore ku ndodhi ngjarja.<sup>286</sup> Për shembull, këshilltaret femra të bashkisë mund të bëjnë ankesën e tyre te kryetarët e këshillit. Më tej, Ligji Nr. 243 udhëzon të gjitha institucionet shtetërore që të krijojnë rrugët e tyre administrative për përpunimin e ankesave të DHNGP-së. Ministria Publike merr të gjitha ankesat e bëra drejtpërdrejtë tek autoritetet e zbatimit të ligjit, si dhe mbikëqyr ankesat e bëra nëpërmjet

284. MESECVI, 2015. Fq. 8-9.

285. UNDP, 2012.



rrugëve administrative. Ligji i Bolivisë iu jep viktimave mundësinë që të anashkalojnë Ministrinë Publike duke e raportuar rastin e tyre drejtpërdrejtë në gjykatën kushtetuese. Projektligjet në vendet e tjera të Amerikës Latine ia vendosin gjithashtu përgjegjësinë kryesore ministrive publike dhe autoriteteve të posaçme të zbatimit të ligjit, megjithatë rrugët administrative dhe kushtetuese duken se janë unike për Bolivinë.<sup>287</sup>

Ligji Nr. 243 i ngarkon EMB-së dy role specifike, duke mundësuar kështu një tjetër rrugë ligjore për trajtimin e ankesave. Dorëheqjet duhet të paraqiten në institutin zgjedhor. Gjithashtu, instituti duhet të “përcaktojë politikat publike dhe strategjitë ndërkulturore për edukimin demokratik rreth barazisë gjinore, që do të garantojnë të drejtat politike të të gjithë njerëzve, veçanërisht grave, dhe veçanërisht mundësitë e barabarta midis burrave dhe grave”.<sup>288</sup> Pavarësisht se legjislacioni nuk i përcakton EMB-ve detyrën e marrjes apo zgjidhjes së ankesave, EMB-ja e ka marrë përsipër këtë rol: gjatë viteve 2010-2014, të gjitha rastet e zgjidhura të DHNGP-së në Bolivi (13 nga 272, ose 4.7%) u përpunuan nëpërmjet rrugëve administrative të këshillave bashkiakë, me vlerësimin e institutit zgjedhor.<sup>289</sup> Ky përdorim i EMB-ve në asistimin e rasteve tregon që ministrinë e drejtësisë dhe autoritetet e zbatimit të ligjit nuk janë ende gati për të zbatuar Ligjin Nr. 243.

Punonjësit e sektorit gjyqësor dhe të sigurisë duhet të trajnohen rreth përbajtjes së legjislacionit të reformuar. Burimet e përshtatshme financiare duhet të shpërndahen nëpërmjet buxhetit kombëtar për zbatimin e reformave dhe penalitetet e posaçme për shkeljet e legjislacionit përkatës duhet të zbatohen në kohën e duhur.

Në Kenia, puna për dëmshpërblimin e viktimave dhe ndjekjen e autorëve pas dhunës zgjedhore të viteve 2007-2008 ka qenë një proces i gjatë, i cili nisi me ngritjen e Komisionit të Hetimit të Dhunës Paszgjedhore në Komisionin e së Vërtetës, Drejtësisë dhe Pajtimin (TJRC). Megjithëse menjëherë pas vitit 2008, qeveria dha një farë mbështetjeje për personat e shpërngulur brenda vendit, janë bërë shumë pak përpjekje për

## ANGAZHIMI DHE ADVOKIMI PËR ZBATIM I OSHC-VE

Në Amerikën Latine, organizatat e shoqërisë civile kanë luajtur rol të rëndësishëm në advokimin për zbatimin e kuadrove normative dhe legjislacionit kombëtar. Më poshtë janë paraqitur disa shembuj të OSHC-ve që kanë ndërmarrë veprim në rajonin e LAC-it (Amerika Latine dhe Karaibet) për të parandaluar dhe zbutur DHNGZ-në.

Rrjeti i Autoriteteve Gra të Amerikës Latine dhe Karaibeve Zgjidhen për Qeverinë Vendore (LaRed Latinoamericana y del Caribe de Mujeres Autoridades Electas de Gobiernos Locales (RedLamugol)), krijuar në vitin 2008, është një nga organizatat që punon në mënyrë aktive për të siguruar zbatimin e efektshëm të Konsensusit të Kuitos. Një nga prioritetet e RedLamugol-it është të advokojë për përfshirjen e statuteve që dënojnë ngacmimin dhe dhunën ndaj autoriteteve të grave të zgjedhura në nivel vendor në axhendat e politikave publike.<sup>290</sup>

Shoqata e Këshilltareve të Bolivisë (ACOBOL) është e vetmja organizatë joshtetërore e përfshirë në miratimin dhe mbikëqyrjen e rasteve të dhunës politike të raportuara nën Ligjin Nr.243 të Bolivisë. Ato ishin jetike për hartimin e protokollit të marrjes, hetimit dhe reagimit ndaj raportimeve të DHNGZ-së. Për shembull, kërkimi i bërë nga ACOBOL-i zbuloi se, pavarësisht miratimit të Ligjit Nr. 243, “në 170 bashki u paraqitën 272 ankesa për dhunë ndaj këshilltareve” në vitin 2014. Për më tepër, ACOBOL-i ka shërbyer si një anëtare e Komitetit për Veprim të të Drejtave Politike të Grave që prej vitit 2004.<sup>291</sup>

Shoqata e Grave Kryebashkiake të Ekuadorit, ka ndjekur shembullin e ACOBOL-it për dënimin e DHNGZ-së duke mbështetur legjislacionin e propozuar të Ekuadorit për dhunën ndaj grave në politikë dhe zgjedhje.<sup>292</sup>

të kompensuar apo mbështetur viktimat e dhunës seksuale, shumë prej të cilave janë gra. Në fakt, një raport i task forcës i vitit 2012 konstatoi se vetëm 23 autorë

286. Piscopo, 2016.

287. Po aty.

288. ALP/Ligji Nr. 243/2012 Neni 10.

289. La Razón (Bolivia), 2015. “Solo 13 casos de acoso político se resolvieron en cinco años.” 4 janar. <http://www.Concejala>, Nr. 7, dhjetor:

290. RedLamugol-i përbëhet nga shoqata prej 11 vendesh: Bolivi, Ekuador, Kolumbi, Peru, El Salvador, Guatemala, Kosta Rika, Honduras, Republika Domenikane, Paraguai dhe Argjentina.

291. ECLAC, 2016a. fq. 125.

292. (n.d.) “Asociación de Mujeres Municipalistas del Ecuador (Shoqata e Grave Kryebashkiake të Ekuadorit)(AMUME).”



Koordinatorëve të Veprim-Edukimit, të cilët punojnë në të gjithë vendin, që t'ia raportin rastet e DHNGP-së institutit për ndjekje të mundshme penale.<sup>297</sup>

Në Evropë, pas identifikimit të votimit familjar si një problem i konsiderueshëm në Maqedoni, Komiteti Shtetëror i Zgjedhjeve (SEC) dha udhëzime praktike për punën e Komisioneve Bashkiake të Zgjedhjeve (MEC) dhe Bordet e Zgjedhjeve (EB), të cilat përmbanin një direktivë të qartë për parandalimin e votimit familjar dhe me përfaqësim. SEC-të gjithashtu zhvilluan dhe trajnime shtesë për përfaqësuesit e MEC-ve dhe EMB-ve.<sup>298</sup>

Në çdo rast, është e rëndësishme që të përcaktohen procedura për raportimin dhe trajtimin e ankesave të bëra tek institucionet zgjedhore. Përdorimi i EMB-ve për të parandaluar dhe ndëshkuar DHNGP-në është një strategji e rëndësishme. Këto institucione kanë juridiksion mbi veprimet e partive dhe proceset zgjedhore në të gjithë Amerikën Latine. EMB-të luajtën rol të rëndësishëm për zbatimin e detyrueshëm të ligjeve për kuotat gjinore. Rrjetet e aktivisteve femra, si ACOBOL-i në Bolivi dhe Mujeres en Plural në Meksikë, kanë marrëdhënie të forta me rregullatorët zgjedhorë, gjë e cila lehtëson aksesin e aktivisteve në këto institucione. Autoriteti për të rrëzuar kandidatët dhe për të ndëshkuar

krerët dhe anëtarët iu takon EMB-ve. Megjithatë, EMB-të nuk mund të ndëshkojnë DHNGP-në kur autorët nuk i përkasin partive politike, pra EMB-të nuk mund të jenë institucionet e vetme shtetërore që kanë autoritetin për të gjykuar DHNGP-në.<sup>299</sup>

### 3.5. KODET E SJELLES TË RREGULLUARA ME LIGJ

Shumë prej akteve të DHNGZ-së kryhen nga zyrtarë, kandidatë ose përkrahës të partive politike. Kodet e Sjelljes të rregulluara me ligj mund të jenë të zbatueshme ndaj një sërë palësh zgjedhore të interesit, duke përfshirë dhe partitë politike, kandidatët e pavarur, koalicionet, dhe lëvizjet, si dhe pjesëtarët e medias, me qëllim ndalimin e sjelljeve që çojnë në dhunë. Brenda partive politike, Kodet e Sjelljes synojnë të rregullojnë sjelljet e kryetarëve, zyrtarëve, kandidatëve, anëtarëve, agjentëve dhe përfaqësuesve të tjerë të partive. “Termet e këtyre kodeve mund të bëhen të detyrueshme e të zbatueshme me ligj përmes ndëshkimit ligjor”.<sup>300</sup> Kodet e Sjelljes nuk janë përdorur sa duhet për promovimin specifik të të drejtave politike dhe lirive të grave, si dhe për mbrojtjen e tyre nga dhuna; megjithatë, OSBE në **BOSNJE-HERCEGOVINË** (1996) dhe **KOSOVË** (2000) ka vendosur disa precedentë ndërkombëtarë, dhe Kombet e Bashkuara kanë bërë

#### DISPOZITAT NË KODET ZGJEDHORE TË SJELLES

Kodi Nigerian i Sjelljes i vitit 2013 përcakton se: “Asnjë parti politike nuk do të marrë pjesë në veprimtari të dhunshme të asnjë forme si mënyrë për të treguar fuqinë e vet. Të gjitha partitë politike do të dënojnë publikisht çdo formë dhune politike” (Neni 6). Gjithashtu, Neni 9 thekson se: “Çdo parti politike do të sigurojë promovimin e pjesëmarrjes aktive të grave, rinisë dhe personave me aftësi të kufizuara fizike në proceset zgjedhore. Si rrjedhojë, të gjitha partitë politike do të:

- Respektojnë të drejtat e grave, të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara fizike për të komunikuar lirisht me partitë dhe kandidatët;
- Lehtësojnë pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave, të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara fizike në veprimtari të politike;
- Garantojnë aksesin e lirë të grave, të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara fizike në të gjitha takimet, marshimet, demonstratat, protestat dhe ngjarjet e tjera politike publike; dhe
- Marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që gratë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara fizike janë të lirë të marrin pjesë në çdo veprimtari politike”.<sup>301</sup>

297. La República (Peru), 2016, cituar në Piscopo, 2016.

298. iKNOW Politics, 2009. “Consolidated Response on the Prevention of Family Voting.” (Përgjigje e konsoliduar për parandalimin e votimit familjar)

299. Piscopo, 2016.

300. Paragraf i përshtatur nga UNDP, 2012.

301. INEC, 2013. “Political Parties Code of Conduct.” (Kodet e Sjelljes së partive politike)

përpjekje për të lehtësuar reformimet e kodeve të partive në **IRAK** (2004), **AFGANISTAN** (2005) dhe **SIERRA LEONE** (2007). **NEPALI** ndan Kodin e Sjelljes në rregullore që iu zbatohen katër kategorish të palëve zgjedhore të interesit.<sup>302</sup>

1) kandidatët, partitë politike dhe “persona të tjerë të interesuar”, si anëtarët e një fushate ose përfaqësuesit e partisë, 2) qeveritë vendore dhe kombëtare, si dhe institucionet publike nepaleze, 3) nëpunësit qeveritarë/publikë, dhe 4) mediat, OJQ-të dhe vëzhguesit zgjedhorë. Kështu, rregullat që kanë të bëjnë me gratë në zgjedhje variojnë sipas lidhjeve me kategoritë e caktuara:

- “Pjesëtarët e kategorisë 1 nuk duhet të marrin pjesë në asnjë veprimtari që “nxit urrejtje apo armiqësi midis... gjinive...” (Neni 4)
- “Pjesëtarët e medias janë të detyruar të shpërndajnë informacion në “mënyrë të paanshme”, t’u japin mundësi të barabarta partive dhe kandidatëve politikë”, dhe të mos cenojnë “marrëdhënien dhe harmoninë midis gjinisë(ve)...të ndryshme”(Neni14).
- “Vëzhguesit gjithashtu udhëzohen të respektojnë “gjinitë...e ndryshme...” dhe të tregohen të paanshëm gjatë procesit zgjedhor (Neni 16).

Në Chad, Neni 4 i Kodit të Sjelljes përcakton se nënshkruesit bien dakord që nuk do të përdorin dhunë të asnjë lloj forme dhe se do të dënojnë publikisht dhe pa asnjë hezitim çdo akt dhune dhe frikësimi. Ata angazhohen që nuk do të mbajnë, financojnë apo përdorin milici, grupe vetëmbrojtje apo parlamentare për mbrojtjen e tyre, për të kërcënuar apo kryer akte dhune dhe ngacmimi, për të treguar forcën dhe për të demonstruar epërsinë e tyre ndaj të tjerëve. Ata angazhohen se do të tregojnë kujdes në fjalimet, shkrimet, qëndrimet dhe sjelljet e tyre përgjatë procesit të zgjedhjeve. Ata refuzojnë përdorimin e komenteve provokuese dhe abuzive që nxisin dhunë apo urrejtje racore, etnike, fetare apo gjinore.<sup>303</sup> Në Kodin Zgjedhor të Sjelljes së Afrikës së Jugut, Neni 9(1) përcakton se diskriminimi gjinor nga partitë dhe kandidatët është i ndaluar. Më tej, ai jep direktiva për përfshirjen aktive të grave duke përcaktuar se “partitë dhe kandidatët duhet të respektojnë të drejtën e grave për të komunikuar lirisht me partitë dhe kandidatët, duhet të lehtësojnë pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në veprimtari politike, dhe të sigurojnë aksesin e lirë të grave në të gjitha aktivitetet politike publike e të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që gratë janë të lira të marrin pjesë në të gjitha veprimtaritë politike.”<sup>304</sup>

#### PËRMBLEDHJE E NISMAVE LEGJISLATIVE QË MUND TË ZBUSIN DHNGZ-NË:

FAZA PARAZGJEDHORE	FAZA ZGJEDHORE	FAZA PASZGJEDHORE
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratoni ligjet dhe politikat që përcaktojnë dhe ofrojnë mbrojtje ndaj DHNGZ-së</li> <li>• Përshtatni legjislacionet ekzistuese të DHNGZ-së ose ndryshoni kodin penal për të përcaktuar dhe parashtruar në mënyrë specifike masat për mbrojtjen ndaj DHNGZ-së</li> <li>• Protokolle dhe rregullore të miratuara nga EMB-të për parandalimin e DHNGZ-së në procesin zgjedhor</li> <li>• Trajtoni DHNGZ-në në Kodet e Sjelljes të zgjedhjeve dhe partive politike</li> <li>• Ofroni trajnimin me ndjeshmëri gjinore për gjyqesit, gjyqtarët, avokatët, etj., të cilët mund të trajtojnë rastet e raportuara të DHNGZ-së</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofroni akses në drejtësinë zgjedhore për gratë dhe kërkesa e drejtësisë për viktimat, si dhe ndjekjen e autorëve</li> <li>• Krijoni metoda për raportimin e sigurt dhe konfidencial të rasteve të DHNGZ-së</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguroni zbatimin e ligjeve dhe politikave të DHNGZ-së</li> <li>• Rishikoni ligjet dhe politikat dhe përshtatini sipas nevojës</li> <li>• Gjykoni mosmarrëveshjet zgjedhore që lidhen me DHNGZ-në</li> <li>• Përndiqni abuzimet e të drejtave të njeriut ndaj grave në politikë</li> <li>• Përshtatni dhe integroni burimet e reja për viktimën në shërbimet aktuale për DHNGZ-në</li> </ul>

302. Komisioni Zgjedhor i Nepalit, 2015. “Kodi i Sjelljes i Zgjedhjeve”.

303. Kodi Zgjedhor i Sjelljes i Çadit, 2011. Gjendet në: <https://www.eisa.org.za/pdf/chad2011code.pdf>

304. Cituar në UNDP, 2012.

# PROPOZIMI 4:

## PARANDALIMI DHE ZBUTJA E DHNGZ-SË NËPËRMJET RREGULLIMEVE ZGJEDHORE

Politikat dhe procedurat e administrimit të zgjedhjeve mund të ndikojnë zbutjen e DHNGZ-së. Aktori kryesor në administrimin zgjedhor është organi i menaxhimit të zgjedhjeve, i cili mund të jetë një institucion i pavarur, një degë e administratës së shtetit (si Ministria e Brendshme ose departamenti i drejtësisë) ose një model i përzier. EMB-të janë aktorët më të rëndësishëm për përcaktimin e besueshmërisë dhe sigurisë së zgjedhjeve, pasi janë vendimet e tyre që përcaktojnë kontekstin për pjesëmarrjen politike të grave. Për shembull, procedurat që vendosin ata për regjistrimin e kandidatëve, mund që të krijojnë një mjedis të askueshëm ose të shtojnë pengesat për gratë aspirante dhe ato candidate. Trajnimi dhe udhëzimet që ata iu ofrojnë punonjësve të qendrave të votimit dhe forcave të sigurisë mund të mbrojnë popullatat e cenueshme ndaj kërcënimeve specifike ose mund të thellojnë më tej frymën e pasigurisë dhe manipulimit për votuesit.<sup>305</sup>

Megjithatë, roli i EMB-së në parandalimin dhe zbutjen e DHNGZ-së është i vështirë për shkak të kohës (përgjatë gjithë periudhave të ciklit zgjedhor) dhe fushëveprimit (mbulimi i territorit kombëtar dhe qindra mijëra punonjësve të qendrave të votimit). Në veçanti, edukimi i stafit në të gjitha nivelet e organizatës, me qëllim që ata të kuptojnë format dhe shfaqjet e ndryshme të DHNGZ-së mund të jetë një proces i ndërlikuar. Pavarësisht modelit administrativ apo përmasës së organizatës, EMB-ja ka një rol specifik në parandalimin e DHNGZ-së, duke pasur dijeni për kërcënimet gjinore që prekin të gjitha fushat e pjesëmarrjes zgjedhore dhe adresimin proaktiv të tyre.

Deklarata e OAS për Ngacmimin dhe Dhunën Politike ndaj Grave (2016) përfshin një propozim drejtuar EMB-ve, në mënyrë që “institucionet zgjedhore dhe subjektet publike...të përfshijnë çështjet e (DHNGZ-së) në kuadrin e funksioneve të tyre që kanë të bëjnë me organizimin e zgjedhjeve, mbrojtjen e të drejtave politiko-zgjedhore të shtetësisë, dhe zhvillimin e politikave civile edukuese, si dhe në punën e tyre me partitë politike”.<sup>306</sup>

Megjithëse ka shumë fusha ku rregullimet zgjedhore mund të mbrojnë gratë ndaj DHNGZ-së, ato më të rëndësishmet përfshijnë:

- Matja dhe hartëzimi i rrezikut për DHNGZ-në;
- Konsiderimi i DHNGZ-së në procedurat e regjistrimit të votuesve dhe kandidatëve;
- Mbrojtja e grave gjatë periudhës së fushatës politike;
- Përfshirja e DHNGZ-së në trajnimin dhe mbulimin;
- Sigurimi që masat e sigurisë dhe votimit në Ditën e Votimit adresojnë DHNGZ-në; dhe
- Përfshirja e DHNGZ-së në raportet dhe analizat paszgjedhore.

305. UNDP/UN Women, 2015.

306. MESECVI, 2015.



#### 4.1. MATJA E RREZIKUT DHE HARTËZIMI I DHNGZ-SË

Sikurse u diskutua në Propozimin 1, për të identifikuar zonat me rrezik të lartë dhe për të projektuar mekanizmat e përshtatshëm të EMB-së për zbutjen dhe monitorimin, mund të nevojitet hartëzimi ose matja. Konsideratat për DHNGZ-në mund gjithashtu të përfshihen në matjet e përgjithshme të sigurisë zgjedhore dhe/ose mund të kryhet një matje e posaçme për DHNGZ-në. Kjo mund të kërkojë koordinim me të tjerë. Përshembull, EMB-të mund të krijojnë partneritete bashkëpunuese me organizatat kombëtare ose joqeveritare për të përmirësuar matjen e rrezikut. Për shembull, International IDEA ka bashkëpunuar me disa EMB, në vende si Bosnje-Hercegovinë, Kenia, Nepal dhe Nigeri për krijimin e Mjetit për Menaxhimin e Rrezikut Zgjedhor (ose ERM). EMB-të kanë përfshirë këtë Mjet si pjesë të strategjive të tyre për parandalimin e dhunës zgjedhore. Mjeti ERM synon të rrisë kapacitetet për të kuptuar, analizuar, parandaluar dhe zbutur ngjarjet e dhunës zgjedhore, duke bërë të mundur që EMB-ja dhe organet e tjera të reagojnë si duhet.<sup>307</sup> Instrumentet e tilla duhet të sigurojnë përfshirjen e pikëpamjes së barazisë gjinore dhe të marrin në konsideratë llojet e ndryshme të dhunës që mund të përjetojnë gratë dhe burrat gjatë zgjedhjeve.

#### 4.2. PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË VOTUESVE DHE KANDIDATËVE

EMB-të kanë mundësinë që të analizojnë disa nga faktorët e mundshëm që mund të pengojnë gratë të regjistrohen për të votuar përpara zgjedhjeve. EMB-të duhet të jenë në dijeni të ruajtjes së sigurisë për gratë si para, gjatë dhe pas procesit të regjistrimit, veçanërisht në rastet kur grave mund t'iu duhet të udhëtojnë në distanca të largëta për të mbërritur në qendrën e regjistrimit. Në rastet kur një individ druhet se votimi publik mund të jetë me rrezik për të, vendet mund të praktikojnë regjistrimin 'anonim' (i quajtur ndryshe 'i heshtur' ose 'konfidencial').<sup>310</sup> Mospublikimi i emrave të votueseve dhe karakteristikave të tyre identifikuese është veçanërisht e rëndësishme në rastet e dhunës në familje.

Procedurat e kandidimit dhe regjistrimit të kandidatëve duhet gjithashtu të shqyrtohen për rreziqe të mundshme të DHNGZ-së nga publiku apo partia përkatëse. Gratë mund të mos kenë dijeni rreth afatit kohor për paraqitjen e kandidaturës së tyre, ose ky afat mund të jetë i shkurtër, gjë e cila do t'i cenonte gratë kur burimet e tyre financiare, lëvizshmëria apo mundësia për të udhëtuar janë të kufizuara. Për të zbutur këto rreziqe, duhen përshtatur kërkesat administrative

#### SHEMBUJ TË HARTËZIMIT TË DHUNËS NGA EMB-JA

*Indi: Komisioni i Zgjedhjeve në Indi kreu një Hartëzim Cenueshmërie për të zbuluar "prekshmerinë e çdo votuesi apo pjesë votuesish, pavarësisht nëse jetojnë apo jo në një zonë gjeografikisht të identifikueshme, të cilët ndalohen padrejtësisht nga apo influencohen lidhur me ushtrimin e të drejtës (së tij/saj) për të votuar në mënyrë të lirë dhe të drejtë, nëpërmjet frikësimit ose përdorimit të influencës së gabuar apo forcës së çdo lloji mbi të". Ky hartëzim përfshin të dhëna mbi familjet e cenueshme dhe individëve/grupeve që janë identifikuar se kanë frikësuar/mashtruar votuesit apo kanë rritur cenueshmërinë, gjë e cila i mundëson EMB-së të njohë më mirë gratë në rrezik për të përjetuar DHNGZ.*<sup>308</sup>

*Afganistan: Përtej matjes fillestare, EMB-të munden gjithashtu që të bëjnë monitorimin dhe raportimin e DHNGZ-së nëpërmjet përfaqësuesve të tyre rajonale. Zyrat rajonale dhe vendore të EMB-së mund të caktohen për të identifikuar dhe raportuar prijet e DHNGZ-së në zonat e tyre, me qëllim që të merren masat e duhura. Në Afganistan, një diskutim në tryezë të rrumbullakët, i organizuar nga Njësia Gjinore e EMB-së, sugjeroi që EMB-ja të krijonte një mekanizëm për mbledhjen dhe krahasimin e detajeve të kërcënimeve ndaj kandidatëve dhe votueseve gra.*<sup>309</sup>

307. Leena Rikkila Tamang, 2012. "Elections in Nepal remain vulnerable to violence." (Zgjedhjet në Nepal ende të prekshme nga dhuna) International IDEA, 9 tetor.

308. UNDP/UN Women, 2015; UNDP, 2012.

309. Komisioni i Pavarur i Zgjedhjeve i Afganistanit, 2010 "Getting the Grade? Lessons Learnt on Women's Participation in the 2010 Afghan Parliamentary Elections." (A kalojnë? Mësimet e nxjerra nga pjesëmarrja e grave në zgjedhjet parlamentare afgane të vitit 2010)

310. UNDP, 2012.



dhe vendi, orari dhe protokollin e sigurisë për zyrat e regjistrimit të kandidatëve me qëllim që të pakësojnë gjasat për konflikt ose dhunë ndaj kandidateve gra.

Gjithashtu, EMB-të mund të japin shtypa për partitë që angazhohen në fuqizimin e grave dhe mbajnë qëndrim të fortë ndaj DHNGZ-së, si dhe ndëshkojnë autorët. Për shembull, në Liberi, Komisioni Kombëtar i Zgjedhjeve punoi me partitë politike për hartimin e kodit të sjelljes. Një nga synimet ishte shmangia e “margjinalizimit të grave nëpërmjet dhunës, frikësimit dhe mashtrimit”. Palët ranë dakord për “parimin e mosdiskriminimit dhe se nuk do të përdornin gjuhë abuzive, dhe për të mos shkaktuar trazira për shkaqe seksuale dhe gjinore”.<sup>311</sup> (Referojuni Propozimit 5 për më shumë shembuj).

#### 4.3. PERIUDHA E FUSHATËS POLITIKE

Në disa vende, rreth 75 për qind e incidenteve të DHNGZ-së kryhen ndaj kandidateve gra ose përkrahëseve të partisë gjatë periudhës së fushatës.<sup>312</sup> Është thelbësore që të krijohen metoda për reagimin ndaj DHNGZ-së nëpërmjet përqendrimit në hapësirat me dhunë të lartë brenda partive politike, si miratimi i politikave zero tolerancë ndaj personave që tentojnë të ndalojnë me forcë gratë që të kandidojnë për post politik. EMB-të mund gjithashtu që të përdorin pikat fokale për mbledhjen e të dhënave mbi rreziqet e mundshme të sigurisë për kandidatet gra.

EMB-të kanë avantazhin unik të njohjes dhe referimit të rasteve të DHNGZ-së tek autoritetet përkatëse, të cilat mund të ngrenë akuza penale ndaj autorëve. Krahas kësaj, EMB-të mund të japin ndëshkime të drejtpërdrejta sipas rastit. “Këto mund të përfshijnë ndëshkime të dhëna në rastet e moszbatimit të kuotave gjinore (si penalitetet financiare, censura dhe sanksion me shkrim/verbal), dokumentacionit të paplotë të kandidimit apo numrit të pamjaftueshëm të mbështetjes ose firmave të nevojshme për tu regjistruar”.<sup>313</sup> (shihni Propozimin 3 për më shumë informacion)

Për të rritur ndërgjegjësimin publik rreth DHNGZ-së, EMB-të mund të krijojnë partneritete me OSHC-të për të promovuar edukimin, veçanërisht në nivelin e komunitetit. Gjithashtu, EMB-të mund të bashkëpunojnë me kanalet e medias për të promovuar transparencën zgjedhore dhe ndjeshmërinë gjinore në paraqitjen e kandidateve gra para zgjedhjeve. Partneritetet edukuese mund të përforcohen duke integruar sensibilizimin gjinor dhe temat që kanë të

bëjnë me gratë në politikë ose DHNGZ-në në programet ekzistuese të EMB-së për edukimin civil dhe të votuesve.

Së fundmi, EMB-të duhet të sigurohen që po punojnë për parandalimin e DHNGZ-së duke integruar praktika dhe politika me ndjeshmëri gjinore në përzgjedhjen e stafit dhe strukturat operacionale. Kur nuk ekzistojnë politika të posaçme, EMB-të mund të miratojnë kode të sjelljes që adresojnë ngacmimin dhe dhunën ndaj grave të punësuar nga EMB-ja. Punësimi i këshilluesve gjinorë ose krijimi i njëjve gjinore brenda EMB-së mund të jetë e nevojshme për krijimin dhe vazhdimësinë e edukimit, parandalimit dhe reagimit ndaj DHNGZ-së. Për shembull, si pjesë e Projektit të Fuqizimit Demokratik (DEP) në Tanzani, një program i përbashkët i zbatuar nga UNDP-ja, UN Women dhe UNESCO, Komisioni Kombëtar i Zgjedhjeve (NEC) dhe Komisioni Zgjedhor i Zanzibarit (ZEC) synuan të pakësonin gjasat e diskriminimit dhe DHNGZ-së ndaj personave me aftësi të kufizuara gjatë zgjedhjeve të vitit 2015 në vend nëpërmjet një sërë veprimesh, duke përfshirë rishikimin e Kodit Zgjedhor të Sjelljes, hartimin e udhëzimeve me ndjeshmëri gjinore si për vëzhguesit e zgjedhjeve dhe për edukimin e votuesve, dhe ZEC-ja miratoi një “Politikë për Përfshirjen Gjinore dhe Shoqërore” të përgjithshme.<sup>314</sup>

#### 4.4. TRAJNIMI DHE MBULIMI

Informacionet rreth ekzistencës së DHNGZ-së, dhe veprimeve për ta adresuar atë, mund të integrohen në programet e vazhdueshme trajnuese të ciklit zgjedhor, veçanërisht përpara zgjedhjeve. Për shembull, Programi Botëror i UNDP-së për Mbështetjen e Ciklit Zgjedhor (GPECS) prezantoi një veprimtari rreth DHNGZ-së në Modulin Gjini dhe Zgjedhjet të kurrikulës së trajnimit të BRIDGE (Ndërtimi i Burimeve në Demokraci, Qeverisje dhe Zgjedhje), me qëllim familjarizimin e administratorëve të zgjedhjeve dhe pjesëmarrësve të tjerë të BRIDGE me DHNGZ-në brenda kontekstit të një programi trajnimi zgjedhor më të gjerë. Moduli mësimor trajton shkaqet, llojet dhe reagimet e mundshme ndaj DHNGZ-së, dhe ndihmon pjesëmarrësit të identifikojnë zgjidhjet për problemin në komunitetet e tyre. Grupe nga Pakistani, Burundi, Haiti, Nigeria, dhe vende të tjera

311. DPKO/DFS-DPA, tetor 2007.

312. Bardall/IFES, 2011.

313. UNDP/UN Women, 2015.

314. UN Women, 2017.

### **SHEMBUJ NGA PROGRAMI I TRAJNIMIT BRIDGE**

Në vitin 2012, UNDP-GPECS ngritën një njësi të re për kursin e Gjinia dhe Zgjedhjet të BRIDGE, me qëllim prezantimin e çështjes së DHNGZ-së tek aktorët. Njësia mësimore trajton shkaqet, llojet dhe pasojat e DHNGZ-së dhe masat e mundshme për adresimin e tyre. UNDP dhe UN Women kanë bashkëpunuar për zhvillimin e këtij kursi.

Në Haiti, në vitin 2013, anëtarët e organit Haitian të menaxhimit të zgjedhjeve punuan në grupe për të analizuar format e ndryshme të dhunës (fizike, seksuale dhe psikologjike) në vendin e tyre dhe të identifikonin mënyrat e mundshme të reagimit ndaj problemit, në kuadër të misionit të EMB-së.

Në Burundi, në vitin 2014, anëtarët e komisionit zgjedhor analizuan statistika nga zgjedhjet e kaluara për të kuptuar natyrën specifike të problemit në Burundi, për të planifikuar strategji ndërhyrjeje në zgjedhjet e vitit 2015, si dhe për të kuptuar mundësitë dhe kufizimet e të dhënave statistikore të kësaj zone.

Në Sudanin e Jugut dhe Sudan në vitin 2010, UN Women organizoi seanca sensibilizimi për anëtarët e Komitetit Zgjedhor të Sudanit të Jugut, Komitetet e Larta Zgjedhore, si dhe në shtetet në dy rajone të Sudanit të prekura nga konflikti; duke përfshirë Gedarefin, Detin e Kuq, Kasalan dhe Darfurin e Jugut. Në këtë të fundit, për shkak të gjendjes së sigurisë së shtetit, trajnimi përfshiu informacione mbi parandalimin e dhunës ndaj grave dhe mbrojtjen e kandidatëve gra nga dhuna e mundshme zgjedhore.<sup>315</sup>

Në Pakistan, anëtarët e komisionit zgjedhor shqyrtuan natyrën e disa akteve të dhunës me bazë gjinore nëpërmjet një debati të frytshëm rreth ngjarjeve të kohëve të fundit në Pakistan, duke përfshirë dhe vrasjen e ish-Kryeministrit dhe kandidatit politik Benazir Bhutto, në vitin 2007. Kursi kontribuoi në planifikimin strategjik për krijimin e një njësie gjinore në EMB.

kanë marrë pjesë në modulën e DHNGZ-së. Ai është përshtatur për të kontribuar në trajnimin e monitoruesve të zgjedhjeve dhe vëzhguesve të dhunës në Burundi e vende të tjera. Gratë votuese janë ndër viktimat më të shpeshta të

DHNGZ-së. Edukimi i grave në baza rreth kësaj teme paraqet sfida unike, që varen dhe nga konteksti. Nivelet e ulëta të alfabetizimit, ndjeshmëria politike në zona tradicionale, tabutë kulturore, mundësia e grave për të marrë pjesë në veprimtari arsimore ndërsa kanë



**GRATË NË RADHË  
PËR TË VOTUAR  
NË ZGJEDHJET  
PARLIAMENTARE  
2011 NË EGJIPT.**

315. UN Women. Raporti përfundimtar i projektit: Mbështetje për pjesëmarrjen e efektshme të grave sudaneze në zgjedhjet e vitit 2010.

## VOTIMI FAMILJAR

Votimi familjar i referohet situatës në të cilën kryefamiljarët (në të shumtën e rasteve meshkuj) influencojnë familjarët në dhënien e votës. Kjo gjë praktikohet rëndom në zona që ruajnë traditën e strukturave familjare të zgjeruara tradicionale, ku pjesëtari mbizotërues i familjes ka të drejtën të marrë vendime të rëndësishme apo të kryejë veprimtari të rëndësishme që ndikojnë familjen. Votimi familjar mund të përbëjë një shkelje serioze, veçanërisht kur është dashakeq dhe përfshin kërcënime dhune, d.m.th, kur kryhet me qëllim që të influencojë apo të heqë të drejtën e zgjedhjes së një votuesi.<sup>316</sup> Në këto raste, votimi familjar shkel parimin qendror të fshehtësisë së votuesit. Ai mund të kryhet nëpërmjet kanosjes dhe frikësimit, duke përfshirë dhe kërcënimin e grave me divorc, nëse nuk i përmbahen votimit të udhëzuar nga familja, fisi apo klani i tyre.<sup>317</sup> Gjithashtu, mendimet se një burrë do të turpërohet nëse pjesëtarët e familjes së tij nuk i binden votimit që parapëlqen ai e përforcon më tepër votimin familjar. Në disa raste, gratë mund të ndiejnë se iu duhet leja e familjes për tu regjistruar dhe votuar, ndaj dhe pranojnë udhëzime se si duhet të votojnë. Po ashtu, grave mund t’iu mësohet se mosbindja ndaj këtyre udhëzimeve është mëkat ose arsye për ndëshkim fizik, divorc, përjashtim shoqëror, dhe humbje e të drejtës prindërore.<sup>319</sup>

Kur votimi familjar është normë kulturore, EMB-së mund t’i duhet që të konsiderojë nëse punonjësit e qendrës së votimit të përzgjedhur nga zona vendase mund gjithashtu të jetë nën presione kulturore për ta lejuar votimin familjar, ose mund të jenë të merakosur për pasojat negative për gratë nëse nuk lejojnë votimin familjar që të kontrollojë votën e tyre.<sup>320</sup> Në vijim janë paraqitur disa nga masat që mund të zbatohen për menaxhimin e ditës së votimit. Këto masa adresojnë një serë çështjes, disa prej të cilave mund të jenë në varësi të vendit:

- Përforcimi i kodit zgjedhor përpara zgjedhjeve ose zbatimi i udhëzimeve operacionale të përcaktuara qartë për ruajtjen e fshehtësisë së votës, duke përfshirë hartimin e masave të veçanta për funksionim të rregullt të qendrave të votimit, mundësimi i hapësirës së mjaftueshme dhe kabinave të votimit, duke lejuar vetëm një votues në kabinë, dhe duke shpërndarë fletët e votimit një nga një;
- Dhënia përparësi e trajnimit të punonjësve të qendrave të votimit për t’iu përmbajtur dispozitave të fshehtësisë;
- Shtrirja e synuar publike për të edukuar votuesit mbi të drejtën e tyre për fshehtësi, veçanërisht për popullatat e cenushme, si gratë dhe votuesit analfabetë;
- Nxitja e besimit dhe transparencës, duke siguruar që, pasi të jetë hedhur vota, EMB-ja do të mbrojë fshehtësinë e votuesve dhe do të sigurojë që zgjedhja e tyre nuk do të zbulohet asnjëherë.<sup>321</sup>

Për shembull, Komisioni Zgjedhor Shtetëror Maqedonas ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji për të zbutur votimin familjar. Si pjesë e programit që synon parandalimin e votimit familjar, Komiteti Zgjedhor Shtetëror udhëzoi të gjithë stafin që parandalimi i votimit familjar dhe atij me përfaqësim ishte me rëndësi.<sup>322</sup> Gjithashtu, Komiteti publikoi dhe një strategji kundër votimit familjar dhe me përfaqësim, me qëllim sigurimin e një kuadri uniform për të gjithë projektet e qeverisë dhe donatorëve, të cilët janë krijuar për të adresuar problemin. Ky kuadër mban parasysh se kjo çështje duhet të trajtohet nëpërmjet veprimtarive të vazhdueshme përgjatë ciklit zgjedhor.<sup>323</sup>

Komisioni Zgjedhor në Papua Guinea e Re konstatoi që gratë ishin të disavantazuara nga praktikat e votimit “familjar” dhe “komunitar”, në të cilat kryefamiljari mashkull ose drejtuesi i komunitetit udhëzonin gratë se si duhet të votonin. Ata konstatuan që këto praktika cenonin fshehtësinë e votuesve. Për këtë arsye, në vitin 2012, Komisioni Zgjedhor “ngriti kabina të ndara votimi për burrat dhe gratë nën supozimin se gratë do të votonin lirshëm nëse nuk do të kishin burrat pranë”.<sup>324</sup>

316. Po aty.

317. Bardall/IFES, 2011

318. Po aty.

319. iKNOW Politics, 2009.

320. UNDP/UN Women, 2015.

321. Komisioni Zgjedhor Shtetëror Maqedonas, 2010. Strategjia e Komisionit Zgjedhor Shtetëror kundër votimit familjar dhe me përfaqësim.

322. Seksion i përshtatur nga UNDP/UNWomen, 2015.

323. UNDP, 2012; UNDP/UN Women, 2015.

324. La República (Peru), 2016.



NJË GRUA QË  
VOTON NË  
ZGJEDHJET E  
LIBISË.

detyrime të tjera, si dhe frika/kanosja, janë të gjithë faktorë që mund të cenojnë mbulimin. Strategjitë e mbulimit, të cilat janë të hartuara për të arritur audiencat të mëdha me alfabetizëm të kufizuar, mund të përshtaten në temat që trajton DHNGZ-ja, duke përfshirë spote në radio dhe televizion, stenda afishimi, fushata me afisha, fushatat e ambasadorëve të rinj, teatri komunitar, seancat ilustruese në klasë, etj. Duke pasur parasysh lidhjen midis DHNGZ-së dhe formave të tjera të DHBGJ-së, duhet të zhvillohen partneritete ndërmjet ofruesve të shërbimeve në këto dy fusha, me qëllim promovimin e edukimit. Për shembull, klinikat shëndetësore në shërbim të viktimave të DHNGZ-së mund të përfshijnë informacione rreth DHNGZ-së në materialet, fletushkat dhe konsultimet e tyre edukative.

#### 4.5. DITA E VOTIMIT DHE ORGANIZIMI I VOTIMIT

Studimet kanë treguar se gratë votuese kanë më shumë gjasë të përjetojnë frikë dhe dhunë në ditën e votimit krahasuar me meshkujt (veçanërisht në zona rurale).<sup>325</sup> EMB-të duhet të tregojnë kujdes në vendosjen e qendrave të votimit, sigurinë dhe trajnimin e komisionerëve në këto qendra, me qëllim që të zbuten aktet e mundshme të DHNGZ-së. Veçanërisht në zonat rurale, qendrat e votimit duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të minimizojnë kohën e udhëtimit nëpërmjet zonave të njohura problematike ose “zonat me ndjeshmëri politike për shkaqe etnike ose fetare”.<sup>326</sup> Punonjësit e qendrave të votimit dhe personeli i sigurisë janë shpeshherë të parët në vendngjarje në rastet e DHNGZ-së gjatë zgjedhjeve. Është thelbësore që EMB-ja dhe stafi i qendrës së votimit të kuptojnë format e ndryshme të DHNGZ-së, si dhe mënyrat e zbutjes dhe reagimit ndaj tyre në Ditën e Votimit.

Pjesë e këtij trajtimi mund të jetë dhe rekrutimi i më shumë grave si pjesë e stafit të EMB-së dhe përgatitja e policëve meshkuj dhe femra për të ndërhyrë në situata të ndjeshme. Si pasojë e rreziqeve të identifikuar të sigurisë gjatë zgjedhjeve në Afganistan, EMB-të u koordinuan me aktorët rajonalë dhe kombëtarë për të rekrutuar dhe shpërndarë në terren mbi 11,000 agjente gra në qendrat e votimit në mbarë vendin. Këto gra kishin për detyrë kryerjen e kontrollit fizik të grave të mbuluara, një përpjekje kjo që mundësoi sigurinë e votueseve afgane gra dhe vendeve të votimit në Ditën e Votimit. Në seksionin vijues do të diskutohet informacioni i mëtejshëm mbi rolin e forcave të sigurisë në parandalimin dhe reagimin ndaj DHNGZ-së.

Disa masa të tjera me ndjeshmëri gjinore mund të përfshijnë radhët e ndara të votimit për burrat dhe gratë. Ndarja e radhëve të votimit është veçanërisht e rëndësishme në zonat ku votimi familjar ndodh rëndom, apo ku normat kulturore/fetare kufizojnë ndërveprimin midis burrave dhe grave. Kjo ndarje ndihmon që të mbrojnë gratë nga frikësimi apo dhuna e mundshme dhe iu mundëson atyre hapësirë për të marrë vendimin e tyre lidhur me votimin, pa presionin e familjarëve. Grupet e cënueshme, përfshirë dhe gratë me aftësi të kufizuara e të moshuarit, mund të marrin përparësi në radhët e votimit për t’iu mundësuar atyre më tepër mbrojtje. Pas përfundimit të votimit, EMB-të dhe stafi tjetër i votimeve duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar që votat do të mbeten konfidenciale. Radhët e ndara mund të bëhen të detyrueshme me ligj

325. Bardall/IFES, 2011.

326. UNDP/UN Women, 2015.

në ligjin zgjedhor, duke u miratuar sistematikisht nga organi qendror i menaxhimit të zgjedhjeve ose duke u zbatuar sipas rastit dhe në përputhje me vlerësimin e presidentit të qendrës së votimit.

Organet e menaxhimit të zgjedhjeve mund të përdorin autoritetin e tyre mbi praktikën e partisë dhe proceset zgjedhore për të miratuar protokolle ose rregullore (shihni Propozimin 3.4 për më shumë informacion). Në Meksikë, disa agjenci shtetërore, përfshirë dhe Institutin Zgjedhor Kombëtar dhe Tribunalin Zgjedhor Federal, publikuan një "Protokoll për të adresuar dhunën ndaj grave në politike" në vitin 2016. Dokumenti përkufizon se çfarë është DHNGP-ja, përcakton të drejtat e viktimave dhe ndan përgjegjësitë përkatëse për agjencitë shtetërore. EMB-ja e Meksikës duhet të zhvillojë fushata edukative, të mbledhë dhe publikojë të dhëna, të sigurojë që dokumentet dhe praktikën e partive nuk nxisin DHNGP-në, dhe të mbikëqyrë shpërndarjen e drejtë të financave partiake. Tribunali Zgjedhor Federal dhe Prokuroria Federale për Krimet Zgjedhore mund të dëgjojnë dhe gjykojnë çështjet, dhe kjo e fundit duhet t'ia kalojë rastet që janë jashtë juridiksionit të vet Prokurorisë së Përgjithshme Publike.<sup>326</sup>

#### 4.6. PUNA ME FORCAT E POLICISË DHE SIGURISË

Forcat e policisë dhe sigurisë mund të luajnë rol kyç në garantimin e sigurisë publike gjatë ciklit zgjedhor; megjithatë, detyrat e tyre në lidhje me DHNGZ-në janë më të dukshme gjatë periudhës konkrete zgjedhore. Planifikimi operacional për sigurinë zgjedhore është i rëndësishëm për të vlerësuar dhe për t'iu përgjigjur rreziqeve të mundshme të sigurisë që mund të cenojnë pjesëmarrjen e plotë të grave në proceset zgjedhore, qofshin ato votuese apo kandidatë. Matja e rreziqeve specifike të sigurisë, si identifikimi i rreziqeve të sigurisë për gratë në zona rurale, mund të përbëjnë një fokus të planifikimit policor ose ushtarak. Siç theksoi Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Operacionet Paqeruajtëse, "shpërndarja e ekipeve të përziera ushtarake në terren për të mundësuar sigurinë zgjedhore mund të lehtësojë arritjen deri te votueset femra, të cilat mund ta kenë më të lehtë t'i afrohen personelit femëror për shqetësimet e tyre në lidhje me sigurinë gjatë zgjedhjeve". Gjithashtu, në vendet ku ka kërcënime ndaj sigurisë së kandidatëve gra, "planifikimi i sigurisë për zgjedhjet duhet të përfshijë një matje të rreziqeve të sigurisë si për kandidatët burra dhe ato gra".<sup>327</sup>

Veprimet specifike që mund të ndërmarrin forcat policore për të adresuar DHNGZ-në përfshijnë:

- Miratimin e pra që marrin parasysh DHNGZ-në;
- Rekrutimin e më shumë oficerëve gra dhe angazhimi i grave për të raportuar në polici sjelljet kundër tyre;<sup>328</sup>
- Ngritjen e pikave gjinore fokale ose sporteve gjinore, dhe referimin e rasteve të DHNGZ-së tek to.
- Sigurimin e një hetimi të pavarur, të hollësishëm e të shpejtë në rastet e akteve të DHNGZ-së;
- Trajnimin e policisë për të rritur ndërgjegjësimin për ndjeshmërinë gjinore, si dhe për çështjet e DHNGZ-së;
- Sigurimin që autori(ët) i identifikuar do të ndiqet penalisht dhe dënohet sipas rastit, dhe që forcat e mbrojtjes dhe sigurisë të përfshirë në shkelle të DHNGZ-së do të shkarkohen;
- Ofrimin e informacionit dhe shërbimeve të mbështetjes për gratë që përjetojnë dhunë, duke përfshirë dhe shërbimet e sektorit shëndetësor, psikosocial, sigurisë/policisë dhe ligjor;<sup>329</sup>
- Integrimin e pikëpamjes gjinore në kërkimet, politikën dhe praktikën e institucioneve të mbrojtjes dhe ushtarake.<sup>330</sup>

#### 4.7. PERIUDHA PASZGJEDHORE

Në rastet kur kanë mandat, EMB-të (dhe tribunalët zgjedhorë) mund të vazhdojnë parandalimin dhe përpjekjet për zbutjen e DHNGZ-së edhe pas përfundimit të zgjedhjeve. Kjo gjë mund të përfshijë nisjen e hetimeve dhe zbatimin e ndëshkimeve ndaj autorëve të DHNGZ-së (në përputhje me mandatin e tyre). Në çështjet gjyqësore, EMB-të mund të luajnë rol duke mundësuar prova ose duke mbështetur menaxhimin e konfliktit dhe zbatimin e strategjive të tjera të drejtësisë zgjedhore.

327. DPKO, 2010. "DPKO/DFS Guidelines: Integrating a Gender Perspective into the Work of the United Nations Military Peace-keeping Operations."

(Udhëzimet e DPKO/DFS: Integrimi i pikëpamjes gjinore në punën e Operacioneve Paqeruajtëse Ushtarake të Kombeve të Bashkuara)

328. UNDP/UNIFEM, 2007. "Policy briefing paper: Gender Sensitive Police Reform in Post Conflict Societies" (Dokument përmbledhës politikash: Reforma me ndjeshmëri gjinore e policisë në shoqëritë paskonfliktit); UNDP, 2012.

329. Publikimi aktual nuk përfshin ofrimin e shërbimeve themelore, pasi ekzistojnë burime gjithëpërfshirëse diku tjetër. Shihni për shembull Essential services package for women and girls subject to violence (Paketa e shërbimeve bazë për gratë dhe vajzat e prekura nga dhuna), në <http://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/12/essential-services-package-for-women-and-girls-subject-to-violence>

330. UNDP, 2005. Gender Mainstreaming in Practice: A Handbook (Integrimi Gjinor në Praktikë:

Doracak). Bot. i 2-të. Fq.125



### **PUNA ME FORCAT E POLICISË DHE SIGURISË NË NISMAT E TRAJNIMIT PËR DHNGZ-NË KENIA:**

UN Women-**KENIA**, me mbështetje nga UNDP-ja, ka hartuar një manual për trajnimin e lehtësuesve (draft 2017) për të rritur kapacitetin e “mbajtësve të detyrës”, të cilët janë persona me “një detyrim ose përgjegjësi të caktuar për të respektuar, promovuar dhe realizuar të drejtat njerëzore, si dhe për të mos shkelur këto të drejta”, për të mbështetur viktimat e DHNGZ-së duke përdorur protokollin dhe masat ekzistuese për raportimin, reagimin, hetimin dhe ndjekjen e DHNGZ-së. Ky manual, i krijuar si përgjigje ndaj DHBGJ-së së përjetuar nga gratë dhe vajzat gjatë dhunës pas zgjedhjeve në Kenia, në vitin 2007, dhe si pjesë e nismave më të gjera të EVAW-t në vend, ofron një kuadër të përgjithshëm trajnimi për (i) adresimin e hendeqeve në “menaxhimin e zinxhirit të provave”, (ii) rritjen e ndërgjegjësimit të mbijetuarave për kuadrin ligjor dhe aksesin në drejtësi dhe (iii) ofrimin e drejtimit praktik për reagim të përshtatshëm ndaj DHNGZ-së për agjencitë përkatëse. Qasja me në qendër të mbijetuarën mbulon çështje komplekse, si mënyrat e duhura të trajtimit të rrefimeve për përjetimin e DHNGZ-së, dhe mundësimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë për të prekurat. Manuali gjithashtu përmban informacione rreth kuadrin të posaçëm ligjor në Kenia, dhe ofron detaje mbi reagimin e sektorit shëndetësor, të sigurisë dhe të drejtësisë ndaj rasteve të DHSBGJ-së (dhuna seksuale dhe me bazë gjinore) në zgjedhje.<sup>331</sup>

**TANZANI:** Në partneritet me Rrjetin e Oficereve të Policisë Femra nga Forca Policore e Tanzanisë, dhe si pjesë e Projektit të Fuqizimit Demokratik (DEP), i cili është një program i UNDP-së i zbatuar në bashkëpunim me UN Women dhe UNESCO-n, UN Women dhe UNDP-ja hartuan një manual trajnimi mbi “Gjininë, të drejtat e njeriut dhe rolin e policisë gjatë zgjedhjeve” para zgjedhjeve të vitit 2015 në vend, kurrikula e së cilit përfshinte përbërësit e formave të ndryshme të dhunës që mund të ndodhë gjatë fushatave zgjedhore dhe se si ato ndikojnë ndryshe tek burrat dhe gratë, si dhe te grupet shoqërore. Trajnimi për forcat e policisë dhe sigurisë përforcoi detyrimin e tyre ligjor që ta marrin seriozisht DHNGZ-në, dhe mundësoi drejtimin se si të reagohet në mënyrën e duhur. Qasja ‘trajnimi i trajnerëve’ aftësoi 103 oficerë policie, të cilët më pas trajnuan 6,000 oficerë të tjerë policie në të gjithë vendin. Ky program gjithashtu mbështeti dhe Forcën Policore të Tanzanisë (TPF) për integrimin e DHNGZ-së dhe grupeve të cenueshme në Sistemin e Raportimit dhe Reagimit ndaj Incidenteve (IRRS), një sistem TI që lehtëson reagimin e shpejtë ndaj rasteve të dhunës gjatë zgjedhjeve, i bazuar në tipologjinë e DHNGZ-së dhe listat e kontrollit të DHBGJ-së, të zhvilluara në partneritet me Rrjetin e Oficereve të Policisë Femra.<sup>332</sup>

Në Zambin, për shembull, Komisioni Zgjedhor ka ngritur Komitete të Menaxhimit të Konfliktit, duke përfshirë dhe Komitetin Kombëtar të Menaxhimit të Konfliktit (NCCM) dhe Komitetet e Rretheve për Menaxhimin e Konfliktit të lidhura me të.

NCCM-ja mbledh së bashku 24 individë, të cilët përfaqësojnë palët shtetërore dhe joshtetërore të interesit, për të dëgjuar ankesat e paraqitura nga kandidatet dhe votueset gra. Pas këtyre seancave, Komitetet mund të vendosin për ndëshkimin e autorëve të DHNGZ-së apo shkeljeve të tjera zgjedhore.<sup>333</sup>

Krahas punës për drejtësinë paszgjedhore, EMB-të mund të sigurojnë dhe përfshirjen e raportimit e çështjeve të DHNGZ-së në shqyrtimet paszgjedhore. EMB-të mund gjithashtu të vazhdojnë me projektet e monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave për incidentet e dhunës, të cilat më pas mund të përdoren në programet e ardhshme të edukimit dhe trajnimit. Si pjesë e këtij kërkimi duhet të përfshihet dhe një rishikim i performancës së shkuar të EMB-së për sa i takon parandalimit të DHNGZ-së, si dhe strategjitë për përmirësim.

331. UN Women et al. 2017. Electoral Gender Based Violence Training Facilitators Manual (Manuali i Trajnimit të Lehtësuesve mbi Dhunën me Bazë Gjinore), projekt i përshtatur i manualit të punës.

332. Negrao, Sara, 2017.

333. UNDP, 2012. Shihni gjithashtu [http://www.elections.org.zm/conflict\\_management.php](http://www.elections.org.zm/conflict_management.php)



## PËRMBLEDHJE E RREGULLIMEVE ZGJEDHORE QË MUND TË ZBUSIN DHNGZ-NË:

Faza parazgjedhore	Faza zgjedhore	Faza paszgjedhore
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sigurohuni që monitorimi dhe matja e rrezikut të dhunës nga ana e EMB-ve të përfshijnë dhe konsiderimin e DHNGZ-së</li> <li>• Trajtoni stafin e EMB-së për reagimet ndaj DHNGZ-së</li> <li>• Merrni masa për të pakësuar votimin familjar sipas nevojës</li> <li>• Integroni DHNGZ-së në edukimin e votuesve, duke përfshirë dhe rritjen e ndërgjegjësimit për fshehtësinë e votës dhe për votimin familjar</li> <li>• Krijoni një njësi përkatëse brenda EMB-së, që ka detyrën e adresimit të shqetësimeve gjinore dhe DHNGZ-së</li> <li>• Mundësoni mbrojtjen për kandidatet gra</li> <li>• Trajtoni forcat e policisë dhe sigurisë rreth DHNGZ-së</li> <li>• Rritni numrin e grave në forcat e policisë dhe në pozicione drejtuese</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merrni parasysh rregullimet për të ruajtur fshehtësinë e votës</li> <li>• Planifikoni logjistikën për ditën e votimit duke përfshirë ndjeshmërinë ndaj DHNGZ-së (vendvotime me ndarje gjinore, roje sigurie femra/ forca policore të sensibilizuara në zonat me rrezikshmëri të lartë, punonjësve të qendrave të votimit të sensibilizuar ndaj DHNGZ-së)</li> <li>• Ndani qendrat e votimeve sipas gjinisë nëse është e nevojshme për të pakësuar dhunën ose presionet për votim familjar</li> <li>• Caktoni oficerë të policisë femra në qendrat e votimit vetëm për gratë</li> <li>• Siguroni mbrojtjen e punonjësve të votimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfshini dimensionin gjinor në rishikimin paszgjedhor</li> <li>• Përforconi ndëshkimet ndaj shkeljeve që kanë të bëjnë me gjininë</li> </ul>

# PROPOZIMI 5:

## PUNA ME PARTITË POLITIKE PËR PARANDALIMIN DHE REDUKTIMIN E DHNGZ-SË

Në shumë vende, një prej sfidave më të mëdha për pjesëmarrjen e grave në politikë është kërcënimi dhe dhuna që ato mund të përjetojnë kur janë kandidatë dhe organizojnë fushata për zgjedhje. Duke qenë se partitë politike janë autorët më të shpeshta të dhunës ndaj grave në zgjedhje, ato kanë rol kyç në reduktimin dhe parandalimin e kësaj dhune.<sup>334</sup> Siç u diskutua në Pjesën A, partitë politike mund të jenë dhe autore të DHNGZ-së por dhe mbrojtëse të grave anëtare të partisë së tyre apo të partive kundërshtarë. Ka shumë veprime që mund të ndërmerren nga partitë politike për të adresuar DHNGZ-në dhe për të promovuar fuqizimin e grave.

Adresimi i DHNGZ-së duhet të nisë me angazhimin e brendshëm të partive që në thelb të dokumenteve të tyre të themelimit, si dhe brenda udhëheqjes së tyre. Kuadri ligjor dhe dokumentet drejtuese të partive politike duhet të refuzojnë në mënyrë kategorike çdo lloj forme të DHNGZ-së ndaj apo nga anëtarët e tyre. Shkeljet duhet të ndëshkohen në momentin më të parë dhe në mënyrën e duhur. Njësitë e veçanta, si grupimet e grave të partisë, duhet të jenë të vëmendshme ndaj këtij problemi dhe ta shqyrtojnë atë rregullisht. Regjistrat e partisë duhet të synojnë dokumentimin e akteve të DHNGZ-së për ta parandaluar atë në të ardhmen dhe për të mbrojtur anëtarët gra. Megjithatë ka shumë fusha në të cilat partitë politike mund të angazhohen për të mbrojtur gratë ndaj DHNGZ-së, ato më të rëndësishmet mund të përfshijnë:

- Sigurimin që kandidatët dhe përkrahësit iu përmbahen kodeve të sjelljes të rregulluara me ligj;
- Adresimin e DHNGZ-së në rregulloret e brendshme të partisë dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- Parandalimin e DHNGZ-së gjatë proceseve të kandidimit;
- Sigurimin e aksesit në financim politik për kandidatet gra;
- Ofrimin e trajnimit dhe sensibilizimin ndaj DHNGZ-së për anëtarët e partisë;
- Përfshirjen e DHNGZ-së në veprimtaritë e monitorimit të partisë;
- Mbështetjen e grave në mandatet e zgjedhura dhe parandalimin e dorëheqjeve të detyruara; dhe
- Mundësimin e informacionit për gratë që përjetojnë dhunë rreth të drejtave që ato gëzojnë dhe për burimet e shërbimet kombëtare dhe vendore të përkrahjes, duke përfshirë ato të sektorit shëndetësor, psikosocial, sigurisë/policisë dhe atij ligjor.

### 5.1. ZBATIMI I KODEVE TË SJELLJES

Sikurse u diskutua në Propozimin 3, Kodet zgjedhore të Sjelljes janë një mjet i rëndësishëm për rregullimin e sjelljeve të kryetarëve, zyrtarëve, kandidatëve, anëtarëve dhe agjentëve të partisë gjatë periudhës së zgjedhjeve. Ato zbatohen për një serë palësh zgjedhore të interesit, duke përfshirë dhe partitë politike, kandidatët

334. Bardall/IFES, 2011.

335. UNDP, 2012.

e pavarur, koalicionet, dhe lëvizjet për të ndaluar sjellje politike që kontribuojnë në DHNGZ.<sup>335</sup> Termat e Kodit të Sjelljes përfaqësojnë një marrëveshje politike e cila mund të bëhet e detyrueshme në legjislacion ose të miratohet vullnetarisht.

Organizatrat ndërkombëtare dhe rajonale mund gjithashtu të luajnë rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin e marrëveshjeve shumëpartiake në Kodin zgjedhor të Sjelljes.

Në Afrikën jugore, Instituti për Demokraci të Qëndrueshme në Afrikë ka mundësuar mbështetje për disa vende duke bërë bashkë partitë politike për të rënë dakord rreth një kodi partiak përpara zgjedhjeve. Në 2008, NDI-ja mbajti diskutime dhe workshop-e në Guine, të cilat trajtuan miratimin e një Kodi të Sjelljes, i cili më pas u miratua nga 41 parti politike. “Kjo qasje pjesëmarrëse për hartimin e kodit mundësoi një hapësirë për diskutim, ku afërsisht 87 për qind e përfaqësuesve të partive shprehën besimin që kodi do të shërbejë për zgjedhje paqësore.”<sup>336</sup>

Kryetarët e partive politike mund të shprehin qëllimin e tyre për të zbatuar dispozitat e kodit zgjedhor të

sjelljes për të pakësuar dhunën zgjedhore, si dhe t’ua komunikojnë këtë mesazh anëtarëve të partive të tyre. Nëse është e nevojshme, partitë mund dhe të konsiderojnë ndëshkimin e përkrahësve apo kandidatëve të partisë, të cilët nuk zbatojnë kërkesat e kodit të sjelljes.

#### **SHEMBUJ TË KODEVE TË SJELLJES**

Për shembull, në Afrikën e Jugut, para zgjedhjeve vendore të vitit 2016, kryetarët dhe përfaqësuesit e 13 partive politike të përfaqësuara në Parlament “angazhuan veten dhe partitë, kandidatët e anëtarët e tyre që t’iu përmbaheshin dispozitave të Kodit Zgjedhor të Sjelljes gjatë Zgjedhjeve Vendore të vitit 2016”.<sup>337</sup> Me nënshkrimin e këtij zotimi, kryetarët e partive morën përsipër, ndër të tjera:

- Të udhëhiqnin partitë e tyre në një mënyrë që i mëshon kulturës së tolerancës ndaj të gjitha palëve kundërshtare në zgjedhje;
- Të këshillonin dhe udhëzonin kandidatët në listat e partive, me qëllim që secili prej tyre të shpërndante mesazhe për tolerancë maksimale;
- Të mos përdornin fjalë apo të merrnin pjesë në veprime të cilat mund të shkaktojnë provokimin e

Në Liberi, Komisioni Kombëtar i Zgjedhjeve punoi me një serë partish politike për të përgatitur Kodin e Sjelljes. Një prej synimeve ishte shmangia e “margjinalizimit të grave nëpërmjet dhunës, frikësimit dhe mashtrimit”. Palët ranë dakord për “parimin e mosdiskriminimit, për të mos përdorur gjuhë abuzive, dhe për të mos shkakuar trazira për shkaqe seksi dhe gjinie”.<sup>338</sup>

Në Maqedoninë e Veriut, partitë politike miratuan një Kod të Sjelljes në vitin 2006, duke shprehur se partitë do të:

- “ndihmojnë në pjesëmarrjen e plotë të qytetarëve, përfshirë dhe gratë e grupet e tjera minoritare, gjatë zgjedhjeve
- sigurojnë aksesin e lirë të qytetarëve, përfshirë dhe gratë e grupet e tjera minoritare, në të gjitha fushatat
- shmangin, në përgjithësi, detyrimin e qytetarëve për të përkrahur një parti apo kandidat të caktuar politik, apo për të marrë pjesë në veprimtari politike kundër zgjedhjes së tyre të lirë.
- mbështesin konceptin universal “një person, një votë” dhe nuk do të nxisin votimin me përfaqësim”.<sup>339</sup>

336. Paragraf i përshtatur nga UNDP, 2012.

337. Qeveria e Afrikës së Jugut, 2016 “Komisioni Zgjedhor për nënshkrimin e Kodit Zgjedhor të Sjelljes nga partitë politike kombëtare”. 16 maj.

338. DPKO/DFS-DPA, 2007.

339. NDI. “Republic of Macedonia: Code of Conduct of Political Parties for Free and Fair Parliamentary Elections.” (Republika e Maqedonisë: Kodi i Sjelljes i partive politike për zgjedhje parlamentare të lira dhe të drejta).

340 I njëjti



përkrahësve të partive ose publikut të gjerë për të kryer akte intolerance apo të bëjnë veprime të tjera provokuese.<sup>340</sup>

## **5.2. ADRESIMI I DHNGZ-SË NË RREGULLORET E BRENDSHME TË PARTISË DHE MONITORIMI I ZBATIMIT TË TYRE**

Funksionimi dhe operacionet e brendshme të partive politike qeverisen nga rregulloret ligjore, si kushtetuta, ligji zgjedhor ose ligji i partive politike, dhe, zakonisht, nga rregulloret e brendshme të partisë. Dokumentet dhe deklaratat zyrtare të një partie politike janë të rëndësishme, jo vetëm për të dhënë një vizion të partisë, po dhe për përcaktimin e rregullave që mbrojnë këtë vizion, ku mund të përfshihet dhe kuadri i barazisë gjinore.<sup>341</sup> Një hap i rëndësishëm është ai i ndryshimit të rregullave të partive nga partitë politike, me qëllim që të sigurohet një deklaratë e fortë dhe e qartë e synimit të tyre për të zbutur dhe adresuar DHNGZ-në, përfshirë dhe për kandidatët dhe përkrahësit e partisë. Gjithashtu, partitë mund të sigurojnë që rregullat e brendshme janë në përputhje me dispozitat e kodeve zgjedhore dhe legjislationit kombëtar për parandalimin e DHNGZ-së, aty ku ato gjejnë zbatim.

Megjithëse miratimi i një deklaratë për DHNGZ-në në rregulloret e partive është një hap i rëndësishëm, është thelbësore që zbatimi i tyre nga anëtarët dhe kandidatët e partisë të monitorohet, dhe të dokumentohen incidentet e DHNGZ-së. Deklarata e OAS për Ngacmimin dhe Dhunën Politike ndaj Grave (2016) përfshin një propozim drejtuar partive politike, ku rekomandohet që ato të “krijojnë instrumentet dhe mekanizmat e tyre të brendshme për parandalimin, ndëshkimin dhe zhdukjen” e DHNGZ-së, duke përfshirë trajnimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit.<sup>342</sup>

Kjo mund të bëhet e mundur nga grupimi i grave të partisë ose një organ i ngjashëm. Grupimet e grave janë pjesë të brendshme të partive, që synojnë forcimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave brenda partisë dhe proceseve politike në përgjithësi, dhe

gjithashtu kërkojnë të gjejnë zgjidhje për problemet e zakonshme në axhendën e partisë.<sup>343</sup> Krahas adresimit të barazisë gjinore në statutet dhe rregulloret e saj, Partia e Veprimit të Qytetarëve në Kosta Rika, ka ngritur një Prokurori për Barazinë Gjinore, e cila ka për detyrë monitorimin, raportimin dhe këshillimin mbi zbatimin e rregulloreve të posaçme.<sup>344</sup>

## **5.3. PARANDALIMI I DHNGZ-SË GJATË PROCESVE TË KANDIDIMIT**

Vendimi për të kandiduar për post është një nga vendimet më të rëndësishme e të vështira për ata që kanë aspirata politike. Kjo mund të jetë akoma më e vështirë për gratë, pasi efektet e DHNGZ-së mund të jenë pjesë e konsiderueshme e procesit të kandidimit. Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe pa ngacmim për gratë është shumë i rëndësishëm për t'i mundësuar atyre që të paraqiten si kandidatë, ndaj duhet bërë çdo përpjekje për të luftuar DHNGZ-në brenda partive politike. Një nga faktorët kyç që ndikon në pjesëmarrjen e grave në zgjedhje është motivimi për të emëruar vetveten në fazën e rekrutimit të kandidatëve. Gratë mund të ngacmohen, ofendohen, frikësohen apo kërcënohen që të mos paraqiten për kandidatë gjatë periudhës së kandidimit, apo dhe të tërheqin kandidaturat e tyre.

Disa parti i refuzojnë hapur kandidatet gra; në Provincën e Frontit Veri Perëndimor të Pakistanit, për shembull, gratë u ndaluan me forcë që të votonin apo kundërshtonin zgjedhjet primare si kandidatë. Situata ishte kaq e rënduar sa që pesë parti politike kryesore nënshkruan marrëveshje në dokumente ligjore, ku deklarohet se nuk do të lejonin gratë të jepnin emrin e tyre për kandidim apo të votonin në zgjedhje. Sipas UNDP-së, “nënshkruarit gjithashtu kërcënuan që do të nisnin një fushatë për të detyruar 25 kandidatë gra, të cilat kishin dhënë emrat e tyre për kandidim, që të tërhiqeshin dhe paralajmëruan organizatat e shoqërisë civile që të ndalonin mobilizimin e grave dhe mbështetjen e tyre për të marrë pjesë në zgjedhje... Si pasojë, kandidatet femra dhe familjet e tyre u ngacmuan dhe u detyruan të tërhiqeshin nga zgjedhjet”<sup>345</sup>

341. UNDP/NDI, 2012. Empowering Women for Stronger Political Parties: A Guide to Promote Women's Political Participation (Fuqizimi i grave për parti më të forta politike: Një udhëzues për promovimin e pjesëmarrjes politike të grave).

342. MESECVI, 2015.

343. iKNOW Politics, 2007. Consolidated Response on Establishing Women's Party Sections (Një reagim i konsoliduar për ngritjen e

grupimeve të grave në parti).

344. Beatriz Llanos dhe Kristen Sample, 2009. From Words to Action: Best Practices for Women's Participation in Latin American Political Parties (Nga fjalë në vepra: Praktikant më të mira për pjesëmarrjen e grave në partitë politike të Amerikës Latine), International IDEA.

345. UN Women Pakistan, 2016.

Partitë mund të pakësojnë mundësitë e ndikimit të padrejtë ndaj kandidateve gra duke siguruar që rregullat e partisë përcaktojnë qartë rregullat e kandidimit. “Sistemet e bazuar në burokraci, që përmbajnë rregulla për të garantuar përfaqësimin e grave, janë një përparësi e rëndësishme për gratë. Kur rregullat janë të pashkruara, bëhet e vështirë që të hartohen dhe zbatohen strategji për të depërtuar në rrethin e brendshëm të pushtetit, dhe askush nuk mban përgjegjësi për moszbatimin e rregullave”.<sup>346</sup> Në partitë politike që kanë organizim të brendshëm të dobët dhe rregulla të paqarta rekrutimi, konkurrenca për vendet e kandidatëve të partisë mund të jetë e ashpër dhe kufizon mundësitë e grave. Do të ishte mirë që proceset e kandidimit të jenë të formalizuara dhe transparente, gjë e cila do të mundësojë përfaqësim dhe konkurrencë të drejtë.<sup>347</sup>

Gjithashtu, kryetarët e partive politike mund që të ndihmojnë në zbutjen e dhunës dhe frikësimit gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve apo në zgjedhjet primare të partisë duke iu dhënë direktiva të qarta anëtarëve të partisë se dhuna nuk do të tolerohet, duke miratuar ndëshkimet përkatëse dhe duke garantuar zbatimin e tyre.

#### 5.4. FINANCIMI POLITIK

Një prej faktorëve më të rëndësishëm, që shkurajon gratë për të hyrë në politikë, është aksesin në financimin politik. Mungesa e fondeve mund t'i pengojë gratë që të mbledhin shumën e nevojshme për të siguruar kandidaturën e tyre brenda partive politike, dhe gjithashtu mund të kufizojë në mënyrë të konsiderueshme veprimtaritë e fushatës nëse ato përzgjidhen për të kandiduar. Kjo mund të jetë një sfidë e veçantë pasi, përgjithësisht, gratë kanë mundësi të pabarabarta dhe më të pakta, si dhe status më të ulët nga burrat, dhe shoqërimi gjinor i shkurajon ato nga të mësuarit të aftësive për mbledhjen e fondeve që iu duhen.<sup>348</sup> Për shkak se fushatat politike varen në mënyrë të konsiderueshme nga disponueshmëria e fondeve, mungesa e aksesit në financim apo varësia ekonomike nga kryefamiljarët meshkuj mund të kufizojë jashtë

mase aftësinë e grave, që aspirojnë të kandidojnë, për të kandiduar e aq më tepër për t'u përzgjedhur për post politik.

Kur ky akses iu mohohet qëllimisht nga bashkëshortët apo pjesëtarët e familjes së tyre, apo kur pjesëtarët e familjes pengojnë aksesin e grave në burime financiare me qëllimin për t'i bërë ato të varura apo për të penguar pjesëmarrjen e tyre në kandidim, kemi të bëjmë me DHNGZ-në ekonomike. Për këtë qëllim, “dëmtimi, kanosja apo abuzimi ekonomik, mund të klasifikohen si dhunë zgjedhore kur përdoren për të ndikuar sjelljet apo zgjedhjet në votime”.<sup>349</sup>

Format ekonomike të DHNGZ-së janë veçanërisht të shpeshta gjatë kandidimeve dhe rekrutimeve. Ato mund të përfshijnë vjedhjen, pengimin e bashkëshortes për të siguruar burime financiare, kufizimin e detyruar të shpenzimeve të grave për të mira bazë, shpenzimin e parave të bashkëshortes pa miratimin e tyre/futja në borxhe, apo pengimi i bashkëshortes për të gjetur punë për financimin e fushatës. “Në familjet tradicionale e patriarkale, pjesëmarrja politike e grave, apo dhe shprehja e pikëpamjeve të ndryshme politike, mund të ndëshkohen duke shtuar detyrimet e tyre, duke mos iu dhënë para për të shpenzuar, duke pakësuar shumën e prikës apo dhe duke zvogëluar racionet ushqimore të familjes”.<sup>350</sup>

Kufizimi i formave ekonomike të DHNGZ-së gjatë rekrutimit të kandidatëve dhe fushatave duhet të bëhet si në sferën publike, dhe në atë private. Financimi publik i grave që aspirojnë të kandidojnë dhe atyre që janë kandidate nëpërmjet arkës së partisë dhe fondeve publike është një nga qasjet; gjithashtu, edukimi i kandidateve të mundshme për të kuptuar kostot dhe mundësitë e financimit të fushatave të tyre mund t'i ndihmojë ato për të tejkaluar këtë hendek. Për më tepër, miratimi i rregullave të qarta për emërimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve nga partitë politike mund të kontribuojë në pakësimin e ndikimit të financimit të fushatës për kandidatet gra.

#### 5.5. TRAJNIMI DHE SENSIBILIZIMI NDAJ DHNGZ-SË

Periodha e fushatës duhet të mundësojë hapësira të sigurta që gratë të komunikojnë me pjesëmarrësit, të ngrenë reputacionin e tyre, të bëhen të njohura dhe të organizojnë aktivitete politike. Trajnimi për kandidate

346. UNDP/NDI, 2011.

347. Po aty.

348. Ballington dhe Kahane, 2014.

349. Bardall/IFES, 2011.

350. Adams et al, 2008; Saunders, 2006 në Bardall/IFES, 2011.

## SHEMBUJ PËR TË BALANCUAR FUSHËN FINANCIARE PËR KANDIDATET GRA

- Në **KANADA**, Partia Liberale ngrii Fondin Judy LaMarsh, një mekanizëm partiak për mbledhjen e parave dhe shpenzimin e tyre për kandidatet gra, në mënyrë që t'i ndihmojnë ato për tu përzgjedhur në parlament. Partia Liberale ka kontroll të drejtpërdrejtë mbi shpenzimin e këtyre parave dhe se cilat candidate kanë përparësi në marrjen e fondeve.<sup>351</sup>
- Disa parti politike në **KOSTA RIKA** dhe **PANAMA** kanë parashikuar që burimet financiare të shkojnë për veprimtaritë e grave, përfshirë dhe trajnimin e tyre. Grupimet e grave në parti ndihmojnë gjithashtu në udhëheqjen e kësaj nisme.<sup>352</sup>
- Në **NIKARAGUA**, “komisioni i grave nga Partia Liberale Konstitucionale krijoi një shkollë udhëheqjeje për gratë, dhe Partia Sandiniste e Çlirimit Kombëtar krijoi gjithashtu mekanizma për të punuar me organizatat e grave për trajnimin e grave dhe organizimin e veprimtarive zgjedhore. Partia përcaktoi 30 për qind të subvencioneve shtetërore për trajnimin politik të grave”.<sup>353</sup>
- Në **HAITI**, partitë politike paguajnë tarifa të reduktuara për regjistrimin e kandidatëve nëse të paktën 30 për qind e listave të tyre janë gra. Tarifat janë gjithashtu më të ulëta për kandidatet gra që përfaqësojnë partitë politike, me qëllim korrigjimin e statusit dhe aksesit të pabarabartë të grave dhe burrave që aspirojnë të hyjnë në politikë.<sup>354</sup>

duhet të integrojë DHNGZ-në në kurrikul, në mënyrë që kandidatet gra të njohin format e ndryshme të DHNGZ-së dhe instrumentet e disponueshme për ta luftuar atë.

Edukimi i votuesve është në interes të partive politike, në mënyrë që të sigurojnë që përkrahësit e tyre do të regjistrohen dhe marrin pjesë në Ditën e Votimit.<sup>355</sup> Partitë politike investojnë shuma të mëdha parash dhe shumë kohë për fushatat e informimit të votuesve, gjë e cila iu mundëson atyre të sensibilizojnë përkrahësit për ekzistencën dhe format e DHNGZ-së, dhe t’iu bëjë atyre me dije që partia nuk i toleron ato. Fushatat e informimit të votuesve duhet të theksojnë rëndësinë e votave të grave për shoqërinë dhe të theksojnë gjithashtu se është e drejta e tyre të marrin pjesë në mënyrë të barabartë si votuese dhe candidate, pa iu trembur dhunës apo frikësimit. Ky mbulim mund të verë në dukje praktikatat e votimit familjar, aty ku ndodh, dhe të theksojë fshehtësinë e votës si një nga mënyrat për t’i bërë ballë presionit të votimit familjar.

Mbulimi i partisë politike dhe trajnimet e tyre duhet t’i përshtatin mesazhet në varësi të kontekstit, kulturës, niveleve të alfabetizimit dhe situatës politike të çdo vendi. Është e rëndësishme që të krijohet një mjedis i sigurt nxënijeje, në të cilin gratë të mos ndihen të frikësuara. Nëse është e nevojshme, mund të konsiderohen dhe trajnimet vetëm për gratë. Në disa komunitete, gratë mund të veçohen nga burrat dhe të kenë nivele të ndryshme lirie të lëvizjes dhe arsimimit.<sup>356</sup> Të gjithë ekipet e edukimit të votuesve duhet të përfshijnë gra dhe, sipas rastit, mund të përbëhen tërësisht nga gra.<sup>357</sup>

### 5.6. PËRFSHIRJA E DHNGZ-SË NË VEPRIMTARITË E MONITORIMIT TË PARTISË

Partitë politike kanë detyrën e rëndësishme për të marrë rolin e vëzhguesit, duke monitoruar nga afër procesin e votimit dhe duke kontrolluar për parregullsi. Blerja e votës, frikësimi i votuesve, votat e rreme, dhe organizimi

351. UNDP/NDI, 2011.

352. Ballington dhe Kahane, 2014.

353. Po aty.

354. Po aty.

355. UNDP/NDI, 2011.

356. DPKO/DFS-DPA, fq. 28. Cituar në UNDP/NDI, 2011.

357. Po aty.

358. DPKO/DFS, 2007, fq.31. Cituar në UNDP/NDI, 2011.

359. UNDP/NDI, 2011.



i dobët cenojnë integritetin e zgjedhjeve. Siguria e pamjaftueshme mund t'i ndikojë votueset dhe kandidatet gra ndryshe nga burrat, veçanërisht në vende ku ka rrezik të lartë të dhunës me bazë gjinore, e cila mund të jetë më e shpeshtë në zgjedhje paskonflikti.<sup>358</sup>

Zakonisht, partitë politike mbajnë nën kontroll zgjedhjet nëpërmjet pranisë së agjentëve ose monitoruesve të partisë gjatë proceseve të regjistrimit dhe votimit, për tu siguruar që votuesit janë në gjendje të votojnë pa u frikësuar.<sup>359</sup> Padyshim, këtu mund të përfshihet dhe monitorimi i incidenteve të DHNGZ-së, së bashku me garantimin e pikëpamjes gjinore në praktikën e monitorimit që përdoren, si sigurimi që listat e kontrollit, të cilat duhet të kontrollohen nga monitoruesit, përfshijnë pyetje që kanë të bëjnë me votimin familjar, dhunën dhe frikësimin, apo me shkelje të tjera që ndikojnë pjesëmarrjen e lirë të grave në zgjedhje.<sup>360</sup>

Partitë politike kanë përgjegjësi për rekrutimin dhe trajnimin e agjentëve të partisë, dhe ato gjithashtu mund të synojnë në mënyrë aktive që të rekrutojnë gra për detyrën e mbikëqyrjes. Kjo është shume e

rëndësishme për qendrat e votimit që janë caktuar vetëm për gratë. Prania e burrave në këto qendra mund të ndalohej në rastet kur ka gjasa që të frikësojë votueset gra. Prania e monitoruesve të partisë mund të sjellë dhe përfitime të tjera; monitoruesit jo vetëm që kontribuojnë në sigurinë e grave gjatë votimit, por mund të mbajnë nën kontroll dhe përkrahësit e partisë së tyre, duke siguruar që ata të mos shkaktojnë frikësimin e votuesve, si dhe të raportojnë incidente të tilla.<sup>361</sup>

## 5.7. PËRKRAHJA E GRAVE TË ZGJEDHURA

Garantimi i pjesëmarrjes së sigurt politike nuk është e kufizuar vetëm në procesin zgjedhor. Duhet të bëjë përpjekje për të luftuar dhunën dhe frikësimin që çon në numër të lartë largimi dhe dorëheqje të grave të zgjedhura dhe atyre që kanë mandate politike. Partitë politike duhet të luajnë rol në sigurimin se deputetja e zgjedhur e partisë është në dijeni të dhunës së mundshme që prek përfaqësueset gra, dhe të sigurojë që grave nuk iu ushtrohet presion nga radhët e partisë për t'ua lënë postin e tyre burrave.

### PËRMBLEDHJE E VEPRIMEVE QË MUND TË NDËRMARRIN PARTITË POLITIKE PËR TË ZBUTUR DHNGZ-NË:

Faza parazgjedhore	Faza zgjedhore	Faza paszgjedhore
<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatoni kodet e sjelljes të rregulluara me ligj dhe sensibilizoni anëtarët e partisë</li> <li>Përditësoni rregulloret dhe statutet e partisë për adresimin e DHNGZ-së</li> <li>Monitoroni dhe zbatoni politikën dhe praktikën e partisë për DHNGZ-në</li> <li>Siguroni rregulla transparente për përzgjedhjen e kandidatëve dhe akses në financimin politik</li> <li>Prezantoni çështjet e DHNGZ-së në trajnimet dhe materialet e përpjekjet për mbulimin e votuesve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Trajtoni agjentë/vëzhgues të partisë për monitorimin e DHNGZ-së</li> <li>Rekrutoni dhe shpërndani në terren më shumë gra në rolin e agjenteve të partisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurohuni që përfaqësueset e përzgjedhura gra përkrahen në funksionet e tyre</li> <li>Sigurohuni që asnjë grua nuk detyrohet të heqë dorë nga posti i saj për përfitim të burrave</li> </ul>

360 OSCE/ODIHR, 2004. fq. 40.

361 Seksion i paraqitur në UNDP/NDI, 2011.

# PROPOZIMI 6:

## RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE NDRYSHIMI I NORMAVE

Në fund të fundit, DHNGZ-ja nuk mund të eliminohet për sa kohë që publiku dhe individët nuk kuptojnë ndikimin që ajo ka në komunitete, se si zbeh të drejtat njerëzore të grave dhe pengon procesin demokratik. Ka një sërë aktorësh, të cilët mund të luajnë rol në rritjen e ndërgjegjësimit dhe shpërndarjen e informacionit rreth DHNGZ-së. Kjo gjë përforcon objektivat e propozimeve të mëparshme duke kontribuar në një kuptim të përbashkët dhe gjithëpërfshirës të shpeshtisë, formave dhe parandalimit të DHNGZ-së.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksojmë që, pavarësisht se rritja e ndërgjegjësimit është një pjesë e rëndësishme e strategjisë për parandalimin e DHNGZ-së, ajo duhet të shoqërohet dhe me ndërhyrje të tjera që synojnë adresimin e stereotipave gjinorë, normave, qëndrimeve, sjelljeve dhe praktikave shoqërore që tolerojnë dhe justifikojnë këtë dhunë, dhe që janë të rrënjësura në pabarazitë gjinore dhe marrëdhëniet e çekuilibruara të pushtetit midis burrave dhe grave. Të dhënat tregojnë se ndërhyrjet e efektshme për parandalimin e DHNGZ-së përdorin shumëllojshmëri metodash (media dhe fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit, të ndërthurura me trajnimet në grup për barazinë gjinore dhe nismat për fuqizimin ekonomik të grave), në nivele të shumfishta (shoqëri, komunitet, familje/marrëdhënie dhe individual), në mënyrë

plotësuese me njëra-tjetrën.<sup>362</sup> Megjithëse shqyrtimi i këtyre ndërhyrjeve mund të jetë përtej fushës së këtij Udhëzuesi, është e rëndësishme të theksojmë që eliminimi i DHNGZ-së do të kërkojë masa parandaluese përtej botës politike dhe zgjedhore, dhe, për aq sa është e mundur, duhen bërë lidhje midis këtyre masave dhe atyre të DHNGZ-së.

Qasjet për rritjen e ndërgjegjësimit mund të përfshijnë, por jo vetëm:

- Rritjen e ndërgjegjësimit nëpërmjet fushatave;
- Punën me mediat për të rritur ndërgjegjësimin;
- Angazhimin e ligjvënësve dhe rrjeteve parlamentare;
- Përfshirjen e burrave në përpjekjet për parandalimin dhe reagimin ndaj DHNGZ-së.

### 6.1. RREDITJA E NDËRGJEGJËSIMIT NËPËRMJET FUSHATAVE;

Rritja e ndërgjegjësimit rreth DHNGZ-së është me rëndësi për të gjitha palët e interesit të përfshira në procesin zgjedhor, duke filluar që nga aspirantët dhe kandidatët, anëtarët e partisë, kryetarët e zgjedhur, dhe personat e përfshirë në administrimin e zgjedhjeve, si EMB-ja dhe stafi i saj. Gjithashtu, është me rëndësi që gratë, të cilat kanë përjetuar DHNGZ, të flasin për përvojat e tyre si një mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin me kryetarët dhe kandidatet gra. Rol kyç në këto fushata kanë luajtur dhe organizata të ndryshme, të cilat kanë mbajtur dhe workshop-e për promovimin e ndërgjegjësimit ndaj DHNGZ-së. Puna e OSHC-ve mund të jetë me rëndësi të veçantë. Ka një sërë shembujsh organizatash kombëtare dhe ndërkombëtare që përkrahin fushatat kundër dhunës zgjedhore.

362. UN Women, 2015a. A Framework to Underpin Action to Prevent Violence Against Women (Një kuadër për përkrahjen e parandalimit të dhunës ndaj grave). <http://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/11/prevention-framework>

## SHEMBUJ TË FUSHATAVE PËR RITJEN E NDËRGJEGJËSIMIT

- Në **BOLIVI**, në vitin 2014, UN Women, së bashku me Ministrinë për Autonomitë dhe Konfederatën Kombëtare Bartolina Sisa të Grave Fshatare, zhvilluan disa workshop-e trajnimi dhe për rritjen e ndërgjegjësimit, të cilët kishin si shënjestër autoritetet bashkiake dhe kryetaret femra, për të forcuar kapacitetet e trajtimit të ngacmimit dhe dhunës politike në departamentet e Koçabambas dhe Santa Kruzit. Propozimet për zbatimin e Ligjit nr. 243 u hartuan nga autoritetet bashkiake dhe kryetaret gra, të cilat përjetonin ngacmim dhe dhunë politike në mënyrë të drejtpërdrejtë.
- Në **BURUNDI**, në vitin 2010, teksa kërcënimet për dhunë rriteshin gjatë periudhës zgjedhore, shoqatat e grave ndërmorën hapa për parandalimin dhe zbutjen e dhunës nga zgjedhjet. Në veçanti, Kolektivi i Shoqatave dhe OJQ-ve Femërore të Burundit dhe Dushirehamwe nisën fushatën Shalle të Bardha për Paqe me temën 'gratë kanë vlerë për paqen në Burundi'. Qëllimet e fushatës ishin të tregonin refuzimin e grave në Burundi ndaj dhunës dhe t'i ftonin këto gra në parandalimin e dhunës brenda komuniteteve të tyre. UNDP, në koordinim me Panos Paris, Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Burundi dhe Alarmin Ndërkombëtar mbështetën këtë fushatë, duke përfshirë gjithashtu dhe mundësimin e ekspertizës së komunikimit dhe mbështetjes materiale prej 10,000 shallesh të bardha. Fushata pati një mbulim të lartë në televizionin dhe stacionet e radios vendase, e cila kontribuoi në parandalimin e dhunës gjatë një momenti të tensionuar në periudhën zgjedhore.<sup>363</sup>
- Në **GANË**, para zgjedhjeve presidenciale të vitit 2016, Këshilli Kombëtar i Paqes, një organ kombëtar ganez, synimi i të cilit është rritja e ndërgjegjësimit për përdorimin e strategjive jo të dhunshme si reagim ndaj konfliktit nëpërmjet bashkëpunimit, koordinimit dhe fushatave, pati besimin e kandidatëve presidencialë dhe publikut për të lidhur një marrëveshje paqeje në Deklaratën e Accra-s, me ndihmën e UNDP-së. Me përkrahjen e UNDP-së, u adresuan çështje me rëndësi, si dhuna zgjedhore dhe dhuna nga grave.<sup>364</sup>
- Në vitin 2012 në **KENIA**, UN Women punoi për rritjen e ndërgjegjësimit nëpërmjet nismave shumëpalëshe, si programi me Komisionin për Kohezionin dhe Integrimin Kombëtar, Komisionin e Pavarur të Zgjedhjeve dhe Kufijve, mediat dhe dy platforma të shoqërisë civile vendase (Platforma për Paqe UWIANO dhe Platforma USALAMA), për edukim dhe integrimin e mekanizmave për të reaguar ndaj çështjeve të DHNG-së zgjedhore.<sup>365</sup>
- Në **SIERRA LEONE**, në vitin 2007, OSHC-të e grave nisën një fushatë për advokimin e zgjedhjeve pa dhunë, e mbështetur nga UN Women, që kishte në synim partitë politike si reagim ndaj rritjes së dhunës politike. Fushata nisi në qytetën jugore Bo gjatë përplasjeve të dhunshme mes grupeve politike rivale. Grupet e grave, të shoqëruara nga një bandë muzikore tunxhi, marshuan nëpër rrugët e qytetës me mesazhe paqeje dhe u adresuan nga Kryetari i bashkisë së qytetës. Mesazhet e paqes iu transmetuan dhe selive të partive politike në katër provincat e Sierra Leones. Në kryeqytetin e Freetown-it, kryetarët e partive politike ose përfaqësuesit e tyre morën përsipër të mbanin zgjedhje pa dhunë. Kësaj nisme iu bashkuan edhe palët e tjera të interesit dhe ajo u përshkallëzua nga UNDP-ja dhe Misioni i KB-së në Sierra Leone.<sup>366</sup>
- Në **ZIMBABVE**, para zgjedhjeve të vitit 2010, Asambleja Kombëtare Kushtetuese (NCA), një organizatë vendase, zhvilloi fushatën "Vepro Tani Kundër Dhunës Politike", një projekt njëvjeçar kundër dhunës politike ndaj grave. Siç e përshkruan NCA-ja, "fushata...ndër të tjera, synon të njohë përvojën rajonale për adresimin e epidemisë së dhunës politike, teksa vendi shkon drejt zgjedhjeve të radhës, duke rritur ndërgjegjësimin, duke ngritur struktura mbështetjeje, duke identifikuar dhe ndëshkuar autorët e dhunës,

363. Këshilli i Sigurimit i KB, 2010, S/2010/608. Seventh report of the Secretary-General on the United Nations Integrated Office in Burundi (Raporti i shtatë i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Zyrën e Integruar të Kombeve të Bashkuara në Burundi), 30 nëntor; UNDP, 2014 Promoting Gender Equality in Electoral Assistance: Lessons Learned in Comparative Perspective. Country Report for Burundi (Promovimi i barazisë gjinore në asistencën zgjedh.ore: Mësimet e nxjerra në pikëpamje krahasuese. Raport mbi shtetin e Burundit).

364. Shembull i mundësuar nga Thomas Rossignol, UNDP, prill 2017.

365. UN Women. Kenya Annual Work Plan for 2012 (Plani Vjetor i Punës në Kenia për vitin 2012) I pa botuar.

366. Korrespondencë me Jebbeh Foster, Këshilltar i UN Women për Paqen dhe Sigurinë në ESA, 30 janar 2017.

367. Asambleja Kombëtare Kushtetuese, 2010. "Nisja e Fushatës kundër dhunës ndaj grave". 14 dhjetor.



Në muajin mars 2016, nisi një fushatë botërore advokimi nga NDI-ja, e quajtur #NotTheCost (#JoKostoja). Megjithëse nuk u përqendrua në mënyrë specifike te DHNGZ-ja, kjo Thirrje për Veprim synonte ngritjen e një platforme të përbashkët për të nisur një diskutim botëror mbi ndalimin e dhunës ndaj grave në politikë, duke përfshirë dhe çfarë është kjo dhunë dhe zgjidhjet e disponueshme.<sup>368</sup> Thirrja për Veprim përfshin një plan veprimi, i cili parashtron veprimtaritë kyçe që mund të ndërmerren nga palët e ndryshme të interesit, përfshirë dhe institucionet botërore e rajonale, qeveritë dhe parlamentet, partitë politike, shoqëritë civile, sektorin e drejtësisë dhe sigurisë, dhe vëzhguesit e autoritetet zgjedhore. Faqja e internetit e NDI-së (<https://www.ndi.org/not-the-cost>) përfshin një adresë ku përdoruesit e interesuar mund të bëhen pjesë e thirrjes botërore për veprim për të ndaluar dhunën ndaj grave në politikë dhe për të raportuar çdo incident dhune ndaj grave aktive në politikë.

## 6.2 PUNA ME MEDIAT

Deklarata e OAS për Ngacmimin Politik dhe Dhunën ndaj Grave (2016) thekson rëndësinë e pjesëmarrjes në “fushata për rritjen e ndërgjegjësimit rreth problemit të ngacmimit dhe/ose dhunës politike ndaj grave për publikun e gjerë”, dhe gjithashtu tregon se si mediat, në veçanti, mund të ndërmarrin hapa. Kjo përfshin edukimin e profesionistëve të medias rreth DHNGZ-së, dhe nxitjen e mediave, kompanive të reklamave dhe rrjeteve sociale për hartimin e kodeve të etikës për DHNGZ-në, theksimin e nevojës për pasqyrimin e grave në “mënyrë të drejtë, të respektueshme dhe të larmishme...duke eliminuar stereotipat seksistë”.<sup>369</sup> Kjo është një pikënisje e dobishme për angazhimin e organizatave të mediave.

Një sërë organizatash kanë synuar të punojnë me mediat për të promovuar raportimin me ndjeshmëri gjinore. Për shembull, në vitin 2013 në Jordani, u zhvillua një workshop trajnues nga Instituti Jordanez i Medias në bashkëpunim me UNESCO-n rreth

raportimit me ndjeshmëri gjinore në zgjedhje. Trajnimi synonte të “nxiste dialogun mbi barazinë gjinore dhe të angazhonte pjesëmarrësit në një proces të përshtatur për kontekstin e tyre dhe të identifikonte hapat e mundshëm të gazetarëve, që mund të kenë ndikime praktike pozitive në raportimin me ndjeshmëri gjinore”.<sup>370</sup>

International IDEA dhe UN Women zhvilluan publikimin Election Coverage from a Gender Perspective: A Media Monitoring Manual (Mbulimi zgjedhor nga pikëpamja gjinore: Një manual për monitorimin e medias) në vitin 2011, ku identifikohet se si variablat gjinore të monitorimit në mbulimin mediatik të zgjedhjeve mund të drejtonin punën e EMB-së, dhe përfshinte gjithashtu çështjet e dhunës ndaj grave.<sup>371</sup> Roli i mediave në parandalimin dhe raportimin e DHNGZ-së mund të integrohet në trajnime të tjera zgjedhore, si programi i trajnimit BRIDGE për administratorët zgjedhorë. Megjithatë, këto taktika monitorimi duhet të marrin parasysh realitetin që raportimet e dhunës ndaj grave nuk kanë shumë gjasa të dalin në media krahasuar me raportet e dhunës ndaj burrave.<sup>372</sup>

Gjithashtu, rritja e DHNGZ-së në platformat e medias në internet dhe asaj celulare është kthyer në një shqetësim për deputete gra: “Për shembull, rastet e deputeteve britanike Stella Creasy (2013) dhe Jess Phillips (2016) u përshkallëzuan në mënyrë të shpejtë, deri në pikën ku Creasy mori rreth 50 kërcënime në orë në internet për një periudhë prej 12 orësh, dhe Phillips, e cila raportoi se kish marrë mbi 600 kërcënime përdhunimi dhe rreth 5,000 njoftime në Twitter nga njerëz që diskutonin nëse do ta sulmonin atë seksualisht”.<sup>373</sup> Fushatat si “Merr mbrapsht Teknologjinë!” kanë pasur për qëllim theksimin e gjurmimit të formave të ngacmimit mediatik ndaj grave në nivel botëror

370. UNESCO, korrik 2013. Media and Elections Journal (Revista e Mediave dhe Zgjedhjeve), Nr. 1.

371. IDEA Ndërkombëtare dhe UN Women, 2011. Election Coverage from a Gender Perspective. A Media Monitoring Manual (Mbulimi zgjedhor nga pikëpamja gjinore: Një manual për monitorimin e medias). 372. Bardall/IFES, 2011.

373. L.Döing, 2013. “British banknote prompts hazing on social media.” (Kartëmonedha britanike nxit ngacmimin në mediat sociale) DeutscheWelle. 4 gusht; Laura Hughes, 2016. “Labour MP Jess Phillips receives more than 600 rape threats in one night.” (Deputetja e Partisë së Punës merr mbi 600 kërcënime për përdhunim brenda një nate) The Telegraph.

374. Shihni <https://www.takebackthetech.net/mapit/>

368. NDI, 2016. #NotTheCost: Plani i veprimit.

369. MESECVI, 2015.

nëpërmjet teknikave të hartëzimit.<sup>374</sup> Megjithëse faqja ueb nuk i kategorizon incidentet e dhunës politike apo zgjedhore në mënyrë specifike, përqendrimi i hartës është te dhuna e mediave të reja, duke theksuar rolin e hapësirës kibernetike dhe platformave celulare si një mjedis për parandalimin e dhunës.

### 6.3. ANGAZHIMI I LIGJVËNËSVE DHE RRJETEVE PARLAMENTARE



Deputetët kanë rol kryesor në thyerjen e heshtjes rreth DHNGZ-së, nëpërmjet sensibilizimit të punonjësve dhe kolegëve të tyre ligjbërës, dhe advokimin për zgjidhje dhe reagime legjislative të përshtatshme. Rrjetet e deputeteve gra po shtohen ndjeshëm, si në

nivel kombëtar dhe në atë rajonal. Këto rrjete ofrojnë një forum për të diskutuar çështjet e DHNGZ-së. Unioni Ndërparlamentar (IPU) ka qenë në krye të përpjekjeve për të angazhuar ligjvënësit duke mbledhur deputetë nga rajone të ndryshme për të diskutuar dhe debatuar çështjet e DHNGZ-së dhe DHNGP-së. Për shembull, në vitin 2012, IPU-ja dhe Un Women organizuan një aktivitet parlamentar me rastin e Seancës së 57-të të Komisionit për Statusin e Grave të quajtur "Strategjitë parlamentare për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave" në mars 2012. Aktiviteti mbledhi së bashku më shumë se 100 deputetë nga vendet e shumë rajoneve për të diskutuar se si ligjvënëset gra mund të luftojnë DHNG-në, përfshirë dhe DHNGZ-në.

Në vitin 2016, IPU publikoi rezultatet e anketës botërore "Seksizmi, ngacmimi dhe dhuna ndaj grave deputete", i bazuar në intervistat e thelluara me 55 gra deputete nga 39 vende. Ky studim vuri në dukje se mbi 80 për qind e pjesëmarrësve kishin përjetuar forma të dhunës psikologjike, dhe 44 për qind e tyre thanë se kishin marrë kërcënime me vdekje, për përdhunim, rrahje ose pengmarrje gjatë mandateve të tyre parlamentare. Në Asamblenë e 135-të të IPU-së në tetor 2016, deputetët miratuan unanimisht rezolutën e titulluar "Liria e grave për të marrë pjesë në proceset politike plotësisht, në mënyrë të sigurt dhe pa pengesë". Ajo iu bën thirrje "deputetëve burra dhe gra që të punojnë së bashku për hartimin dhe zbatimin efektiv të legjislacionit

dhe politikave për ngacmimin dhe dhunën ndaj grave, përfshirë atë politike, dhe të bashkëpunonin për këtë nismë me agjencitë qeveritare përkatëse, shoqërinë civile dhe palët e interesit, përfshirë dhe kompanitë e teknologjisë, me qëllim trajtimin e abuzimit në internet".<sup>375</sup>

Në dhjetor 2016, Konferenca e 5-të e Grave Deputete të Komonuelthit u mbledh në Londër për të diskutuar çështjen e 'Dhunës politike ndaj grave'. Deputete nga disa prej shteteve të Komonuelthit diskutuan rolin e parlamentit për rritjen e ndërgjegjësimit rreth DHNGP-së, dhe shqyrtuan mënyrat se si Shoqata Parlamentare e Komonuelthit mund të mbronte dhe promovonte gratë. Disa nga masat specifike që u morën në konsideratë përfshinin ngritjen e një Komisioni Vëzhgimi dhe Hetimi nën Gratë Deputete të Komonuelthit, ku mund të trajtoheshin shqetësimet e grave, dhe krijoheshin kodet e sjelljes parlamentare që adresonin ngacmimin seksual dhe procedurat e zgjidhjes së ankesave. Parlamentet u inkurajuan të ngrinin grupe parlamentare grash si një hap drejt solidarizimit në dhunën politike me bazë gjinore. U theksua gjithashtu dhe roli i shoqërisë civile dhe mediave në denoncimin e sjelljeve të papranueshme ndaj grave.<sup>376</sup>

Në shkurt të vitit 2015, Komisioni Ndëramerikan i Grave i OAS organizoi një tryezë diskutimi të titulluar 'Dhuna politike ndaj grave: Një sfidë hemisferike', si pjesë e veprimtarive të përkujtimit të Ditës së Grave të Amerikave (18 shkurt), dhe Ditës Ndërkombëtare të Grave (8 mars). Kjo ngjarje mbledhi delegatë nga 34 shtete anëtare për të shqyrtuar nismat e ndryshme legjislative në rajon, për t'i kaluar çështjet e DHNGZ-së nga të pandëshkueshme në ligj, dhe nga ligji në zbatim.<sup>377</sup> ParlAmericas, rrejtja i legjislaturave kombëtare të Shteteve anëtare të OAS, ka adresuar gjithashtu çështjen e DHNGP-së. Ngacmimi dhe dhuna politike u identifikuan si çështje parësore gjatë seancës së

375. IPU, 2016a. "The freedom of women to participate in political processes fully, safely and without interference: Building partnerships between men and women to achieve this objective." (Liria e grave për të marrë pjesë në proceset politike plotësisht, në mënyrë të sigurt dhe pa pengesë: Ndërtimi i partneriteteve midis burrave dhe grave për arritjen e këtij objekti). Rezolutë e miratuar në Asamblenë e 135-të të IPU-së, Gjenevë, 27 tetor.

376. Shoqata Parlamentare e Komonuelthit, 2016. 62nd Commonwealth Parliamentary Conference: Conference Concluding Statement (Konferenca e 62-të Parlamentare e Komonuelthit: Deklarata përmbyllëse e konferencës), e dhënë më 21 dhjetor fq. 7.

planifikimit strategjik të mbajtur nga delegatet e Grupit të Grave Deputete në mbledhjen e organizuar në Mexico City, në vitin 2014.

#### 6.4 PËRFSHIRJA E BURRAVE DHE DJEMVE NË PËRPEKJET PËR PARANDALIMIN DHE REAGIMIN NDAJ DHNGZ-SË



Së fundmi, mbulimi specifik duhet të drejtohet ndaj burrave dhe djemve. Të dhënat tregojnë se puna me burrat dhe djemtë, së bashku me gratë dhe vajzat, për adresimin e dhunës dhe pabarazisë ka sjellë rezultate pozitive.<sup>378</sup> Puna me burrat si partnerë ndihmon në identifikimin e këtyre aleatëve në luftën

kundër këtij problemi. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, një numër gjithmonë e më i lartë burrash janë duke punuar në mënyrë të përkushtuar për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe për të promovuar barazinë gjinore. Përfshirja e burrave dhe djemve nga përpjekjet për t'i dhënë fund dhunës i ndan ata nga zgjidhjet e dhunës, përforcon normat gjinore të dhunës mashkullore dhe e vendos barrën e adresimit të dhunës mbi shpatullat e grave.

Nismat dhe platformat e paqes që kanë për synim rininë janë një nga mënyrat për angazhimin pozitiv të burrave në moshë të re dhe djemve, të cilët në të kundërt mund të ishin nën shënjestrën e grupeve politike rivale, dhe do të mashtroheshin nga premtimet parash dhe dhuratash për të nxitur dhunë gjatë zgjedhjeve. Bordi i Situatës së Grave (WSR) në Ugandë, para zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të vitit 2016, është

një nga shembujt se si një nismë e drejtuar nga gratë arriti në mënyrë efektive të bindte shumë të rinj nga Uganda, të cilët mbijetonin me vështirësi për shkak të papunësisë shumë të lartë, që procesi paqësor zgjedhor dhe kalimi i pushtetit demokratik ka më shumë rëndësi për të ardhmen e tyre se sa përfitimet afatshkurtra si marrja e parave për të kryer akte të dhunshme. Duke punuar me shoqatat rinore dhe punonjësit informalë, organizatorët e WSR-së realizuan mbulim specifik të grupet më në rrezik të të rinjve dhe bandat, dhe iu ofruan atyre mundësinë që të luanin rol qendror në formimin e të ardhmes së vendit të tyre, të ishin lajmëtarët e mesazheve të paqes te moshatarët e tyre, dhe të fitonin aftësi duke trajnuar dhe organizuar të tjerët. Të rinjtë u inkurajuan të kontribuonin idetë e tyre unike se si ata mund të shpërndanin mesazhe paqeje në mënyrë kreative me gojë dhe nëpërmjet medias sociale, duke përfshirë dhe përcjelljen e tyre në zonat e varfra e të vështira për tu arritur, të cilat janë shpesh shënjestra të dhunës. Ky efekt “zinxhir” ndihmoi të arriheshin mbi 3,000 të rinj, të cilët, nëpërmjet mesazheve të paqes, iu ofruan moshatarëve të tyre një alternativë ndaj dhunës dhe një vizion më premtues për të ardhmen.<sup>380</sup>

Deputetët meshkuj mund të jenë advokues me ndikim të veçantë nëpërmjet punës me kolegët e tyre në parlament, dhe duke u përfshirë me punonjësit në terren. Rezoluta e IPU-së, e miratuar në vitin 2016, “Liria e grave për të marrë pjesë në proceset politike plotësisht, në mënyrë të sigurt dhe pa pengesë”, iu bënë thirrje “drejtuesve politikë dhe deputetëve burra e gra në veçanti, që të dënojnë aktet e ngacmimit, frikësimit dhe dhunës ndaj kandidateve dhe deputeteve gra, duke përfshirë ato që ndodhin në mediat sociale dhe në internet; dhe gjithashtu iu bënë thirrje parlamenteve të miratojnë masa ligjore dhe praktike për parandalimin dhe ndëshkimin e akteve të tilla.”<sup>381</sup>

Si përfundim, fushata “AipërAtë” është një lëvizje solidarizimi për barazi gjinore, e zhvilluar nga UN Women për të angazhuar burrat dhe djemtë si

377. OAS, 2015. “Commission of Women of the OAS Debated Political Violence Against Women in the Hemisphere” (Komisioni i Grave i OAS debatuan mbi dhunën politike ndaj grave në hemisferë) Deklaratë për shtyp, 25 shkurt.

378. OBSH, 2009 “Why engage men in the fight to end violence against women and girls?” (Përse duhen angazhuar burrat në luftën për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave?)

379. Po aty.

380. UN Women, 2016. “Case Study: Women Situation Room Uganda,” (Studim rasti: Bordi i Situatës së Grave në Ugandë) raport i brendshëm i pabotuar.

381. IPU, 2016.




advokues dhe agjentët e ndryshimit, përtë arritur barazi gjinore dhe të drejtat e grave. Qëllimi i përgjithshëm i fushatës është të përhapë ndërgjegjësim dhe të nxisë vepra për përgjegjësinë e burrave dhe djemve për eliminimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave. “Paketa e Veprimeve AipërAtë për Parlamentet” ofron udhëzime se si deputetët burra mund të

angazhohen me fushatën dhe të ndërmarrin veprime për të pakësuar dhunën ndaj grave, duke përfshirë dhe prezantimin apo përkrahjen e projektligjeve për barazi gjinore, si dhe përdorimin e mekanizmave parlamentarë për të punuar me advokuesit gjinorë, si përfaqësuesit e shoqërisë civile, në çështjet e DHNGP-së dhe DHNGZ-së.

#### **PËRMBLEDHJE E VEPRIMEVE QË MUND TË NDËRMERREN PËR TË ZBUTUR DHNGZ-NË NË CIKLIN ZGJEDHOR:**

- Fushata ndërgjegjësimi për parandalimin e DHNGZ-së
- Përshtatja e programeve të trajnimit për të prezantuar DHNGZ-në
- Përshtatja e materialeve të mbulimit civil me çështjet e DHNGZ-së
- Angazhim për të raportuar rastet e DHNGZ-së në media
- Ngritja e kapaciteteve të medias për DHNGZ-në
- Monitorimi i medias për anshmëri gjinore
- Angazhimi i ligjvënësve dhe rrjeteve parlamentare
- Angazhimi i burrave si aleatë dhe advokues me ndikim të lartë



## REFERENCAT

1. Albaine, Laura, nëntor 2015. Marcos normativos contra el acoso y/o violencia política en razón de género en América Latina." Paraqitur në, Violencia Política contra las mujeres en América Latina: diagnósticos, diálogos y estrategias. Mexico City.
2. Ansari, Hina, 2013. "Could Mobile Technology Combat Sexual Harassment?" (A mundet teknologjia celulare të luftoje ngacmimin seksual?) Huffington Post: The Blog, 11 shkurt . [http://www.huffingtonpost.ca/hina-p-ansari/harassmap-egypt\\_b\\_2654388.html?view=screen](http://www.huffingtonpost.ca/hina-p-ansari/harassmap-egypt_b_2654388.html?view=screen)
3. Arboleda, María, 2012. Levantado el velo: Levantado el velo: Estudio sobre acoso y violencia política en contra de las mujeres autoridades públicas electas a nivel local en Ecuador. ONU Mujeres-AMUNE.
4. Asamblea Legislativa de Ecuador (ALE), 2012. Código de la Democracia. <http://aceproject.org/ero-en/regions/americas/EC/ecuador-ley-organica-electoral-codigo-de-la/view>
5. Asamblea Legislativa de El Salvador (ALES), 2011. Ley Especial Integral Para Una Vida Libre De Violencia Para Las Mujeres (Ley 520), No. 520. <http://www.asamblea.gob.sv/eparlamento/indice-legislativo/buscador-de-documentos-legislativos/ley-especial-integral-para-una-vida-libre-de-violencia-para-las-mujeres>
6. Asamblea Legislativa Plurinacional (ALP), 2012. Ley Contra el Acoso y Violencia Política Hacia Las Mujeres (Ley 243), Nr. 0026. <http://www.redunitas.org/proyecto%20de%20ley%20acoso%20y%20violencia%20politica%20mujeres-diputados.pdf>
7. Asamblea Legislativa de la República de Costa Rica (ALRCR), 2013. Proyecto de Ley Contra Acoso y/o Violencia Política Contra Las Mujeres, Nr. 18.719.
8. Asociación de Concelejas de Bolivia (ACOBOL). (n.d.) "Asociación de Mujeres Municipalistas del Ecuador (AMUME)." <http://www.acobol.org.bo/site/index.php/redes-4>
9. ACOBOL, 2014. Concejala, Nr. 7, 7 dhjetor. [http://www.autonomias.gob.bo/portal3/images/stories/minifp/2015/Archivos\\_PDF/genero\\_7\\_boletin%20concejala.pdf](http://www.autonomias.gob.bo/portal3/images/stories/minifp/2015/Archivos_PDF/genero_7_boletin%20concejala.pdf)
10. Bardall, Gabrielle, 2016. "Gender-Based Distinctions and Motivations in Political Violence." (Dallime dhe nxitje me bazë gjinore në dhunën politike) In Voices, Votes and Violence: Essays on Selected Dynamics of Electoral Authoritarianism. (Në Zëra, vota dhe dhunë: Ese mbi dinamikat e zgjedhura të autoritarizmit zgjedhor) Universiteti i Montrealit.
11. Bardall/IFES, 2012. Intervistë personale me autoren (Ballington), 17 tetor. Gabrielle Bardall, Elin Bjarnegård dhe Jennifer Piscopo, së shpejti 2017.
12. Bardall, Gabrielle/Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), 2011. "Breaking the Mold: Understanding Gender and Electoral Violence." (Thyerja e heshtjes: Të kuptuarit të dhunës gjinore dhe zgjedhore) Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore, dhjetor, Uashington, D.C. [http://ifes.org/sites/default/files/gender\\_and\\_electoral\\_violence\\_2011.pdf](http://ifes.org/sites/default/files/gender_and_electoral_violence_2011.pdf)
13. Ballington, Julie, 2016. "Turning the Tide on Violence against Women in Politics: How Are We Measuring Up?" (Ndryshimi i rrjedhës së dhunës ndaj grave në politikë: Si po shkojnë gjërat?) Paraqitur në Kongresin Botëror të 24-t të Shoqatës së Shkencave Politike. Poznan, Poloni, 23-28 korrik.
14. Ballington, Julie/Unioni Ndërparlamentar (IPU), 2008. Equality in Politics: A Survey of Women and Men in Parliaments (Barazia në politikë: Një studim i grave dhe burrave në parlamente) <http://www.ipu.org/PDF/publications/equality08-overview-e.pdf>
15. Ballington, Julie dhe Muriel Kahane, 2014. "Women in Politics: Financing for Gender Equality" (Gratë në politikë: Financimi i barazisë gjinore). Në International IDEA, Funding of Political Parties and Election Campaigns: A Handbook on Political Finance (Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore:

- Manuali i financimit politik) Stockholm.
16. BBC News, 2010. "Kidnapped Workers for Afghan Female MP Found Dead." (Gjenden të vdekura punonjëset e rrëmbyera që punonin për deputeten afgane.) 29 gusht. <http://www.bbc.co.uk/news/world-south-asia-11125517>
  17. Bearak, Max, 2016. "Almost all of Israel's 32 women in parliament have been sexually harassed or assaulted." (Pothuajse të gjitha 32 gratë në parlamentin e Izraelit janë ngacmuar ose sulmuar seksualisht).
  18. Washington Post, 31 maj. <https://www.washingtonpost.com/news/worldviews/wp/2016/05/31/almost-all-of-israels-32-women-in-parliament-have-been-sexually-harassed-or-assaulted/> Beavers, Suki, 2016. Korrespondencë me autoren (Ballington), qershor.
  19. Bjarnegard, Elin. 2016. "Gender and Election Violence: The Case of the Maldives (Gjinia dhe dhuna në zgjedhje: Rasti i Maldiveve)." IPSA. Boone, Jon, 2015. "Women Barred from Voting in Parts of Pakistan." (Gratë ndalohen të votojnë në disa pjesë të Pakistanit) The Guardian, 29 maj. <http://www.theguardian.com/world/2015/may/29/women-barred-voting-pakistan-khyber-pakhtunkh> Castaño, Juncal Plazaola, Korrik 2016, intervistë personale.
  20. CEDAW Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 30. 2013. <http://www.ohchr.org/documents/hrbodies/cedaw/gcomments/cedaw.c.cg.30.pdf>
  21. Kodi Zgjedhor i Sjelljes i Chadit, 2011. Gjendur në adresën <https://www.eisa.org.za/pdf/chad2011code.pdf>
  22. Chavez, Franz, 2009. "BOLIVIA: Politics, a Risky Business for Women." (BOLIVI: Politika, një biznes i rrezikshëm për gratë). Inter Press Service, 27 tetor. <http://www.ipsnews.net/2009/10/bolivia-politics-a-risky-business-for-women/>
  23. Chrisafis, Angeliq, 2016. "We can no longer stay silent': Fury erupts over sexism in French politics." (Nuk mund të heshtim më: Shpërthen tërbimi ndaj seksizmit në politikën franceze) The Guardian, 13 maj. <https://www.theguardian.com/world/2016/may/13/we-can-no-longer-stay-silent-fury-erupts-over-sexism-in-french-politics>
  24. Commonwealth Parliamentary Association, 2016. Konferenca e 62-të Parlamentare e Komonuelthit: Deklarata përmbyllëse e konferencës, dhënë më 21 dhjetor. [http://www.cpahq.org/cpahq/Main/Annual\\_Conference/United\\_Kingdom\\_2016/CPC\\_London\\_2016.aspx](http://www.cpahq.org/cpahq/Main/Annual_Conference/United_Kingdom_2016/CPC_London_2016.aspx)
  25. Congreso de la República de Peru, 2012. Proyecto de Ley Contra el Acoso Politico Hacia Las Mujeres, No. 1903.
  26. Congreso General de Los Estados Unidos Mexicanos, 2007. Ley General de Acceso de las Mujeres a una Vida Libre de Violencia. [http://www.diputados.gob.mx/LeyesBiblio/pdf/LGAMVLV\\_171215.pdf](http://www.diputados.gob.mx/LeyesBiblio/pdf/LGAMVLV_171215.pdf)
  27. Këshilli i Evropës, 2011. Konventa për të parandaluar dhe për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168046031c> <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168046031c>
  28. Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës, 2002. Code of Good Practice in Electoral Matters: Guidelines and Explanatory Report (Kodi i praktiva të mira në çështjet zgjedhore: Udhëzime dhe Raport shpejgues) Strasburg: Këshilli i Evropës. [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2002\)023rev-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2002)023rev-e)
  29. Davies, Lizzy, 2014. "Laura Boldrini: The Italian politician rising above the rape threats." (Laura Boldrini: politikania italiane që ngrihet mbi kërcënimet e përdhunimit) The Guardian, 9 shkurt. <http://gu.com/p/3mf77/sbl>
  30. Demetriades, Justina, 2007. "Gender Indicators: What, Why, How?" (Treguesit gjinorë: Çfarë, Përse, Si?) [http://www.bridge.ids.ac.uk/reports\\_gend\\_CEP.html#Indicators](http://www.bridge.ids.ac.uk/reports_gend_CEP.html#Indicators)
  31. Departamenti për Operacionet Paqeruajtëse (DPKO), mars 2010. "DPKO/DFS Guidelines: Integrating a Gender Perspective into the Work of the United Nations Military Peacekeeping Operations." (Udhëzimet e DPKO/DFS: Integrimi i pikëpamjes gjinore në punën e Operacioneve Paqeruajtëse Ushtarake të Kombeve të Bashkuara) [http://www.un.org/en/peacekeeping/documents/dpko\\_dfs\\_gender\\_military\\_perspective.pdf](http://www.un.org/en/peacekeeping/documents/dpko_dfs_gender_military_perspective.pdf)
  32. DPKO dhe Departamenti i Mbështetjes në Terren- Departamenti i Çështjeve Politike (DFS-DPA), tetor 2007. Joint Guide- lines on Enhancing the Role of Women in Post-Conflict Electoral Processes (Udhëzimet e përbashkëta për forcimin e rolit

- të grave në proceset zgjedhore pas konfliktit). [http://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/democratic-governance/electoral\\_systemsandprocesses/dpko-dfs---dpa-joint-guidelines-on-enhancing-the-role-of-women-i.html](http://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/democratic-governance/electoral_systemsandprocesses/dpko-dfs---dpa-joint-guidelines-on-enhancing-the-role-of-women-i.html)
33. Drumond, Paula, 2015. "Promoting Democracy in Preventing Electoral Violence: The Women's Situation Room." (Promovimi i demokracisë për parandalimin e dhunës zgjedhore: Bordi i Situatës së Grave) Rrjeti i Zgjidhjeve për Zhvillim të Qëndrueshëm, 1 qershor. Fq. 7-8.
  34. Komisioni Ekonomik për Amerikën Latine dhe Karaibet (ECLAC), 2016a. "Equality and Women's Autonomy in the Sustainable Development Agenda" (Barazia dhe Autonomia e grave në axhendën e zhvillimit të qëndrueshëm) në Konferencën e Trembëdhjetë Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe. Montevideo, Uruguai, 25 – 28 tetor. <http://conferenciamujer.cepal.org/13/en/documents/equality-and-womens-autonomy-sustainable-development-agenda>
  35. ECLAC, 2016b. Montevideo Strategy for Implementation of the Regional Gender Agenda within the Sustainable Development Framework by 2030 (Montevideo Strategy) (Strategjia e Montevideo-s për Zbatimin e Axhendës Rajonale brenda Kuadrit të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030 (Strategjia e Montevideos)) në Konferencën e Trembëdhjetë Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe. Montevideo, Uruguai, 25 – 28 tetor. <http://conferenciamujer.cepal.org/en/documents/montevideo-strategy-implementation-regional-gender-agenda-within-sustainable-development>
  36. ECLAC, 2013a. "Objective of the XII session of the Regional Conference on Women in Latin America and the Caribbean." (Objektivi i Seancës së Dymbëdhjetë të Konferencës Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe) <http://www.cepal.org/cgi-bin/getprod.asp?xml=/12conferenciamujer/noticias/paginas/1/49991/P49991.xml&xsl=/12conferenciamujer/tpl-i/p18f-st.xml&base=/12conferenciamujer/tpl-i/top-bottom.xml>
  37. ECLAC, 2013b. Santo Domingo Consensus at the Twelfth session of the Regional Conference on Women in Latin America and the Caribbean. (Konsensusi i Santo Domingos në Seancën e Dymbëdhjetë të Konferencës Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe) Santo Domingo, Republika Domenikane, 15 – 18 tetor. <http://www.cepal.org/cgi-bin/getProd.asp?xml=/12conferenciamujer/noticias/paginas/5/49995/P49995.xml&xsl=/12conferenciamujer/tpl-i/p18f.xml&base=/12conferenciamujer/tpl-i/top-bottom.xml>
  38. ECLAC, 2007. Quito Consensus at the Tenth session of the Regional Conference on Women in Latin America and the Caribbean. (Konsensusi i Kuitos në Seancën e Dhjetë të Konferencës Rajonale për Gratë në Amerikën Latine dhe Karaibe). Kuito, Ekuador. <http://www.cepal.org/publicaciones/xml/9/29489/dsc1i.pdf>
  39. Komisioni Zgjedhor i Indisë, 2011. Nr. 464/ Udhëzime/ EPS/ 2011, 5 march. [http://eci.nic.in/eci\\_main/CurrentElections/ECI\\_Instructions/ins05032011A.pdf](http://eci.nic.in/eci_main/CurrentElections/ECI_Instructions/ins05032011A.pdf)
  40. Komisioni Zgjedhor i Nepalit, 2015. "Kodi i Sjelljes i Zgjedhjeve" <http://www.election.gov.np/ecn/uploads/user-files/Election20CoC20-20English1.pdf>
  41. Escalante, Ana Cecilia dhe Nineth Méndez, 2011. Sistematización de experiencias de acoso político que viven o han vivido las mujeres que ocupan puestos de elección popular en el nivel local. ONU Mujeres- INAMU -SOLIDAR. [http://iknowpolitics.org/sites/default/files/acoso\\_politico\\_costa\\_rica.pdf](http://iknowpolitics.org/sites/default/files/acoso_politico_costa_rica.pdf)
  42. Ford, Liz, 2016. "From Peru to Kosovo, female MPs aim to end abuse of women in politics." (Nga Peruja në Kosovë, gratë deputete synojnë t'i japin fund abuzimit të grave në politikë) The Guardian, 24 mars. <http://www.theguardian.com/global-development/2016/mar/24/violence-against-women-in-politics-not-the-cost-campaign-national-democratic-institute>
  43. Female head of Kyrgyz Central Election Commission resigns over threats. (Kryetarja femër e Komisionit Qendror Zgjedhor të Kirgizistanit jep dorëheqjen për shkak të kërcënimeve). Shtator. <https://genderstan.wordpress.com/2008/09/27/female-head-of-kyrgyz-central-election-commission-resigns-over-threats/>
  44. "Evidence from a Voter Awareness Campaign in Pakistan." (Fakte nga një fushatë e ndërgjegjësimit të zgjedhësve në Pakistan) Banka Botërore, prezantuar në Konferenca mbi Ndikimin dhe Politikën, Bangkok.
  45. Glowacki, Laura, 2016. "Manitoba MLA speaks

- out about violence against women in politics.” (Deputetja e Asamblesë Ligjvënese të Manitobës flet për dhunën ndaj grave në politikë) CBS News, 20 qershor. <http://www.cbc.ca/news/canada/manitoba/nahanni-fontaine-blasts-misogyny-1.3644089>
46. Qeveria e Afrikës së Jugut, 2016. “Electoral Commission on signing of Electoral Code of Conduct by national political parties.” (“Komisioni Zgjedhor për nënshkrimin e Kodit Zgjedhor të Sjelljes nga partitë politike kombëtare”). 16 maj. <http://www.gov.za/speeches/signing-electoral-code-conduct-national-political-parties-16-may-2016-0000>
  47. Hedman, Birgitta, Perucci, Francesca dhe Pehr Sundström, 1996. “Engendering statistics: A Tool for Change” (Statistika me bazë gjinore: një mjet për ndryshim). Orebro: Statistika Suedi [http://www.scb.se/statistik/\\_publikationer/LE0202\\_1996A01\\_BR\\_X93%C3%96P9601.pdf](http://www.scb.se/statistik/_publikationer/LE0202_1996A01_BR_X93%C3%96P9601.pdf)
  48. van der Heijden, Ingrid, Abrahams, Naemah, dhe Jane Harries, 2016. “Additional Layers of Violence: The Intersections of Gender and Disability in the Violence Experiences of Women with Physical Disabilities in South Africa.” (Shtresa të tjerat të dhunës: kryqëzimet e gjinisë dhe aftësisë së kufizuar në përjetimet e dhunës nga gratë me aftësi të kufizuara në Afrikën e Jugut). Journal of Interpersonal Violence (Revista e Dhunës Ndërpersonale)
  49. Morena Herrera, Mitzy Arias dhe Sara García, 2012. Hostilidad y violencia política: Develando realidades de mujeres autoridades municipales. Sistematización de experiencias de violencia política que viven mujeres electas en gobiernos municipales en El Salvador. Santo Domingo: ONU Mujeres. <http://iknowpolitics.org/es/knowledge-library/case-study/hostilidad-y-violencia-politica-develando-realidades-de-mujeres>
  50. Höglund, K. dhe A.K. Jarstad, 2010. “Strategies to Prevent and Manage Electoral Violence: Considerations for Policy.” (Strategji për parandalimin dhe menaxhimin e dhunës zgjedhore: Konsideratat për Politikën) Në Policy and Practice Brief: Knowledge for Durable Peace (Dokumenti i politikave dhe praktikës: Dija për paqe të qëndrueshme), Nr. 1, Universiteti i Uppsala-s. <https://www.files.ethz.ch/isn/121072/Brief1.pdf>
  51. Caroline Hubbard dhe Claire DeSoi/NDI, 2016. Votes without Violence: A Citizen Observer’s Guide to Addressing Violence against Women in Elections ((Vota pa dhunë: Udhëzuesi i vëzhguesit të qytetarëve për adresimin e dhunës ndaj grave në zgjedhje). Washington, D.C.: Instituti Demokratik Kombëtar.
  52. Human Rights Watch (HRW), 2016. “Përmbledhje.” Në ‘I Just Sit and Wait to Die’: Reparations for Survivors of Kenya’s 2007--2008 Post-Election Sexual Violence (Unë thjesht rri dhe pres të vdes: Dëmshpërblimi i të mbijetuarave të dhunës paszgjedhore të viteve 2007-2008 në Kenia). Raport. 15 shkurt. <https://www.hrw.org/report/2016/02/15/i-just-sit-and-wait-die/reparations-survivors-kenyas-2007-2008-post-election>
  53. Hunt, Swanee, 2007. “Let Women Rule,” (Lerini gratë të drejtojnë) Politics and Society (Politikat dhe Shoqëria), maj/qershor. <https://www.foreignaffairs.com/articles/2007-05-01/let-women-rule>
  54. iKNOW Politics, 2016. “Women in politics and cyber abuse in the United Kingdom.” (Gratë në politikë dhe abuzimi kibernetik në Mbretërinë e Bashkuar) <http://iknowpolitics.org/en/learn/knowledge-resources/multimedia/women-politics-and-cyber-abuse-united-kingdom>
  55. iKNOW Politics, 2009. “Consolidated Response on the Prevention of Family Voting.” (Reagim i konsoliduar për parandalimin e votimit familjar) [http://iknowpolitics.org/sites/default/files/cr\\_family20voting\\_en.pdf](http://iknowpolitics.org/sites/default/files/cr_family20voting_en.pdf)
  56. iKNOW Politics, 2007. Consolidated Response on Establishing Women’s Party Sections (Një reagim i konsoliduar për ngritjen e grupimeve të grave në parti). <http://www.iknowpolitics.org/node/3527>
  57. Imp-Act, 2005. “Choosing and Using Indicators for Effective Social Performance Management.” (Zgjedhja dhe përdorimi i treguesve për menaxhimin e performancës së efektshme shoqërore) Në Imp-Act Practice Notes (Shënime të Praktikës së Impact). Nr. 5, Brighton: IDS. [http://sptf.info/images/pn5\\_indicators.pdf](http://sptf.info/images/pn5_indicators.pdf)
  58. Komisioni i Pavarur i Zgjedhjeve i Afganistanit, 2010 “Getting the Grade? Lessons Learnt on Women’s Participation in the 2010 Afghan Parliamentary Elections.” (A kalojnë? Mësimet e nxjerra nga pjesëmarrja e grave në zgjedhjet parlamentare afgane të vitit 2010) <http://www.>

- iec.org.af/pdf/gender/ll\_gender\_workshop.pdf.
59. Komisioni i Pavarur Kombëtar i Zgjedhjeve, 2013. "Political Parties Code of Conduct" (Kodi i Sjelljes së Partive Politike). [http://www.inecnigeria.org/?page\\_id=3552](http://www.inecnigeria.org/?page_id=3552)
  60. Instituto Nacional Electoral (INE), Tribunal Electoral del Poder Judicial de la Federación, Fundación Empresarial Para el Desarrollo, Secretaría de Gobernación, Comisión Ejecutiva de Atención a Víctimas, Comisión Nacional para Prevenir y Erradicar la Violencia Contra la Mujeres, Instituto Nacional de la Mujeres, and Fiscalía Especial para los Delitos de Violencia Contra las Mujeres y Trata de Personas, 2016. "Protocolo para Atender la Violencia Política hacia las Mujeres." Ciudad de México.
  61. Instituti Ndërkombëtar për Demokracinë dhe Asistencën Zgjedhore (International IDEA), 2016. "Electoral risk management through a gender lens." (Menaxhimi i rrezikut zgjedhore nëpërmjet pikëpamjes gjinore). 29 mars. <http://www.idea.int/elections/electoral-risk-management-through-a-gender-lens.cfm>
  62. International IDEA, 2002. International Electoral Standards: Guidelines for Reviewing the Legal Framework of Elections (Standardet ndërkombëtare zgjedhore: Udhëzime për rishikimin e kuadrit ligjor të zgjedhjeve). Stokholm. <http://www.idea.int/es/publications/catalogue/international-electoral-standards-guidelines-reviewing-legal-framework>
  63. International IDEA dhe UN Women, 2011. Election Coverage from a Gender Perspective. A Media Monitoring Manual (Mbulimi zgjedhor nga perspektiva gjinore: Një manual për monitorimin e medias). [http://www.idea.int/publications/election\\_coverage\\_gender\\_perspective/](http://www.idea.int/publications/election_coverage_gender_perspective/)
  64. Unioni Ndërparlamentar (IPU), 2016. "The freedom of women to participate in political processes fully, safely and without interference: Building partnerships between men and women to achieve this objective," (Liria e grave për të marrë pjesë në proceset politike plotësisht, në mënyrë të sigurt dhe pa pengesë: Ndërtimi i partneriteteve midis burrave dhe grave për arritjen e këtij objektiv). Rezolutë e miratuar në Asamblenë e 135-të IPU-së, Gjenevë, 27 tetor. <http://www.ipu.org/conf-e/135/item4.pdf>
  65. IPU, 2016. Baza e të dhënave e PARLINE. <http://www.ipu.org/parline-e/ToolboxParline.asp>
  66. IPU dhe UN Women, 2017. Map on Women in Politics (Harta e Grave në Politikë). <http://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2017/4/women-in-politics-2017-map>
  67. Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), gusht 2016. "Violence Against Women in Elections: An Excerpt from IFES' Framework." (Dhuna ndaj grave në zgjedhje: Pjesë e marrë nga Kuadri i IFES-it) United States Agency for International Development (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar), Arlington, VA. [https://www.ifes.org/sites/default/files/2016\\_ifes\\_violence\\_against\\_women\\_in\\_elections.pdf](https://www.ifes.org/sites/default/files/2016_ifes_violence_against_women_in_elections.pdf)
  68. Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI), 2015. Matja Gjinore e Zgjedhjeve Kombëtare të Tanzanisë. 25 tetor. [http://www.iri.org/sites/default/files/wysiwyg/tanzania\\_gender\\_report.pdf](http://www.iri.org/sites/default/files/wysiwyg/tanzania_gender_report.pdf)
  69. Kampo, Chatula, 2012. "Zambia: I Live in Fear of Being Raped." (Zambia: jetoj me frikën se do të më përdhunojnë) Times of Zambia, 14 nëntor. <http://allafrica.com/stories/201211140428.html>
  70. Krook, Mona Lena. 2017. "Dhuna ndaj grave në politikë." Revista e Demokracisë, 28 (1): 74-88.
  71. Larris, Rachel Joy and Rosalie Maggio, 2012. "The Women's Media Center Media Guide to Gender Neutral Coverage of Women Candidates and Politicians." (Udhëzuesi mediatik për mbulimin neutral gjinor të kandidatëve dhe politikaneve gra nga Qendra e Medias së Grave) [www.nameitchangeit.org](http://www.nameitchangeit.org)
  72. La Razón (Bolivia), 2015. "Solo 13 casos de acoso político se resolvieron en cinco años." 4 janar. [http://www.la-razon.com/nacional/Solo-casos-politico-mujer-resolvieron\\_0\\_2192180836.html](http://www.la-razon.com/nacional/Solo-casos-politico-mujer-resolvieron_0_2192180836.html)
  73. La República (Peru), 2016, "JNE atenderá actos de discriminación contra mujeres en elecciones." 3 mars. <http://larepublica.pe/impres/politica/745722-jne-atendera-actos-de-discriminacion-contra-mujeres-en-elecciones>
  74. Legislativa Nacional de la República de Panamá, 2013. Ligji Nr. 82. [http://oig.cepal.org/sites/default/files/2013\\_pan\\_ley82.pdf](http://oig.cepal.org/sites/default/files/2013_pan_ley82.pdf) Llanos, Beatriz, dhe Kristen Sample, 2009. From Words to Action: Best Practices for Women's Participation in Latin American Political Parties (Nga fjalë në vepra: Praktikat më të mira për pjesëmarrjen e grave në partitë politike të Amerikës Latine). IDEA Ndërkombëtare.



75. Lorscheider, Lou, 2016. "French Ex-ministers take on Sexual Misconduct in Politics." (Ish-ministret franceze trajtojnë sjelljet e pahijshme seksuale në politikë) Zëri i Amerikës, 15 maj. <http://www.voanews.com/a/france-sexual-misconduct-politics/3331377.html>
76. Komisioni Zgjedhor Shtetëror Maqedonas, 2010. Strategy against Family and Proxy Voting of the State Election Commission (Strategjia e Komisionit Zgjedhor Shtetëror kundër votimit familjar dhe me përfaqësim) <https://www.scribd.com/document/71484419/Strategy-Against-Proxy-and-Family-Voting>
77. Nat Manning, 2016. "USA Election Monitor: Of the People, By the People." (Monitori i zgjedhjeve të SHBA-ve: E njerëzve, nga njerëzit) Ushahidi, 1 nëntor. <https://www.ushahidi.com/blog/2016/11/01/usa-election-monitor-of-the-people-by-the-people>
78. Martínez, Anayeli García, 2015. "Reportaje - Reacción violenta del patriarcado contra la paridad." Cimacnoticias, México, 3 gusht. <http://www.cimacnoticias.com.mx/node/70336>
79. Mekanizmi për Konventën Belem do Para (MESECVI), 2015. Declaration on Political Harassment and Violence Against Women (Deklarata për ngacmimin dhe dhunën politike ndaj grave). Lima, Peru, 15-16 tetor. <http://www.oas.org/es/mesecvi/docs/DeclaracionViolenciaPolitica-EN.pdf>
80. Moore, Jack, 2016. "Female Entrepreneurs Launch Online Sexual Harassment Tracker in Beirut." (Sipërmarrëset femra vënë në punë Gjurmuesin e ngacmuesit seksual në internet në Beirut) Newsweek, 25 shkurt. <http://www.newsweek.com/female-sexual-harassment-tracker-launched-lebanon-beirut-430253>
81. Morgan, John. 2016. "Julia Gillard on tackling sexism against female leaders" (Julia Gillard mbi ndalimin e seksizmit ndaj drejtuesve grave). Times Higher Education (Arsimi i Lartë Times). <https://www.timeshighereducation.com/features/julia-gillard-on-tackling-sexism-against-female-leaders>
82. Ms. Magazine, 2009. "Women's Fingers Cut Off in Afghan Election Violence." (Grave iu priten gishtat gjatë dhunës zgjedhore në Afganistan) Feminist Wire, 24 Gusht. <http://www.msomagazine.com/news/uswirestory.asp?id=11900>
83. National Constitutional Assembly (Asambleja Kombëtare Kushtetuese), 2010. "Campaign Against Violence Targeting Women Launched" (Nisja e Fushatës kundër dhunës ndaj grave). 14 dhjetor.
84. Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), (n.d.). "Republic of Macedonia: Code of Conduct of Political Parties for Free and Fair Parliamentary Elections." (Republika e Maqedonisë: Kodi i Sjelljes i partive politike për zgjedhje parlamentare të lira dhe të drejta) [https://www.ndi.org/files/2031\\_mk\\_CoC\\_071006.pdf](https://www.ndi.org/files/2031_mk_CoC_071006.pdf)
85. NDI, 2016. #NotTheCost: Plani i veprimit. <https://contribute.ndi.org/files/not-the-cost-action-plan.pdf>
86. NDI, 2012. Tunisia's National Constituent Assembly Gender Assessment. (Vlerësimi Kombëtar Gjinator i Asamblesë Kushtetuese në Tunizi) <https://www.ndi.org/files/Tunisia-Gen-der-Assessment-National-Constituent-Assembly-ENG.pdf>
87. Negrao, Sara, 2017. "Monitoring, Mitigating and Responding to Violence Against Women during Elections (VAWE) Experience of UN Women Tanzania in the 2015 General Elections." (Monitorimi, zbutja dhe reagimi ndaj dhunës kundër grave gjatë zgjedhjeve (DHNGZ) Përvoja e UN Women në Tanzani gjatë Zgjedhjeve Kombëtare të vitit 2015) Prezantuar në Rutgers University Eagleton Institute conference on Resisting Women's Political Leadership: Theories, Data, Solutions (Konferenca e Institutit Eagleton të Universitetit Rutgers mbi Rezistencën ndaj Udhëheqjes Politike të Grave: Teori, të dhëna, zgjidhje), New Brunswick, New Jersey, SHBA, 22-26 maj 2017.
88. O'Neil, Tam dhe Domingo, Pilar, 2016. Women and power: Overcoming pengess to leadership and influence (Gratë dhe pushteti: Kapërcimi i pengesave të udhëheqjes dhe influencës). Raport, Departamenti i Jashtëm i Zhvillimit. <https://www.odi.org/sites/odi.org.uk/files/resource-documents/10443.pdf>
89. Opoien, Jessie, 2016. "Handling hate: Women in politics face a remarkable amount of sexist vitriol." (Trajtimi i urrejtjes: gratë në politikë përballen me një sasi të konsiderueshme të sarkazmës seksiste) The Capital Times, 11 maj. [http://host.madison.com/ct/news/local/govt-and-politics/election-matters/handling-hate-women-in-politics-face-a-remarkable-amount-of/article\\_258ea7bc-b3af-5fb4-aceb-e6128e04f4f1.html](http://host.madison.com/ct/news/local/govt-and-politics/election-matters/handling-hate-women-in-politics-face-a-remarkable-amount-of/article_258ea7bc-b3af-5fb4-aceb-e6128e04f4f1.html)

90. Organizata e Bashkimit Afrikan (OAU), qershor 1995. Protocol to the African Charter on Human and Peoples' Rights on the Rights of Women in Africa (Protokoll i Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve për të Drejtat e Grave në Afrikë) prezantuar në Thirty-first Ordinary meeting of the Organization of African Unity (Takimin e tridhjetë e një të zakonshëm të organizatës së bashkimit Afrikan) [http://www.achpr.org/files/instruments/women-protocol/achpr\\_instr\\_proto\\_women\\_eng.pdf](http://www.achpr.org/files/instruments/women-protocol/achpr_instr_proto_women_eng.pdf)
91. Organization of American States (OAS), 2015. "Commission of Women of the OAS Debated Political Violence Against Women in the Hemisphere," (Komisioni i OAS i Grave debatuan mbi dhunën politike ndaj grave në hemisferë) Deklaratë për shtyp, 25 shkurt. [http://www.oas.org/en/media\\_center/press\\_release.asp?sCodigo=E-058/15](http://www.oas.org/en/media_center/press_release.asp?sCodigo=E-058/15)
92. OAS, 2014. "Informe Hemisférico 2014." <http://belemdopara.org/portal/?anio=2014>
93. OAS, 2013. Manual for Incorporating a Gender Perspective into OAS Electoral Observation Missions (Manual për Përfshirjen e Pikëpamjes Gjimore në Misionet e OAS të Vëzhgimit të Zgjedhjeve) [https://www.oas.org/es/sap/deco/pubs/manuales/Manual\\_gender\\_e.pdf](https://www.oas.org/es/sap/deco/pubs/manuales/Manual_gender_e.pdf)
94. OAS, 1994. Inter-American Convention on the Prevention, Punishment and Eradication of Violence against Women (Konventa Ndëramerikane për Parandalimin, Ndëshkimin dhe Zhdukjen e Dhunës ndaj Grave) ("Konventa e Belem do Para"), 9 qershor. <http://www.oas.org/juridico/english/treaties/a-61.html>
95. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë-Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE-ODHIR), 2014. Handbook for Monitoring Women's Participation in Elections (Manual për monitorimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje) <http://www.osce.org/odhr/elections/13938>
96. Queremos Paridad, 2015. "Three Historias de Mujeres que Han Luchado por Espacios en sus Propios Partidos." 11 gusht. <http://queremosparidad.net/2015/08/11/3-historias-de-mujeres-que-han-luchado-por-espacios-en-sus-propios-partidos/>
97. ParlAmericas, 2017. Mapping gender-based political harassment: Parliamentarians speak out (Hartëzimi i ngacmimit politik me bazë gjimore: Flasin deputetet) <http://www.parlAmericas.org/en/group-of-women/political-harassment-map.aspx>
99. ParlAmericas, 2016. Declaration of Commitment at the Eighth Annual Gathering on Diversifying Political Power to Build Inclusive Societies (Deklaratë Angazhimi në Mbledhjen e Tetë vjetore për Diversifikimin e Pushtetit Politik për Ngritjen e Shoqërive Përfshirëse) Kuito, Ekuador, 2-3 qershor. <http://www.parlAmericas.org/uploads/documents/Declaration-Ecuador-2016-ENG.pdf>
100. Piscopo, Jennifer, 2016. Legislative Trends to Mitigate Violence against Women in Politics (VAWP) (Tendencat legjislative për zbutjen e dhunës ndaj grave në politikë (DHNGP)) në Amerikën Latine. UN Women, dokument prezantues papublikuar
101. RAU, 2009. "Hear Us – Zimbabwean Women Affected by Political Violence Speak Out." (Na dëgjoni - Flasin gratë në Zimbabve të prekura nga dhuna politike) The Hub, 4 maj. <http://hub.witness.org/HearUs-ViolenceAgainstWomeninZimbabwe2>
102. Recknagel, Charles, 2016. "In Moldova, Smears, Orthodox Church Target Pro-EU Candidate Ahead Of Runoff." (Në Moldavi, Shpifje, Kisha Ortodokse vë në shënjestër kandidaten pro-Evropiane përpara garës) RadioFreeEurope, 11 nëntor. <https://www.rferl.org/a/moldova-sandusmears-orthodox-church-pro-eu-candidate-russia/28108474.html>
103. Rempel, Michelle, 2016. "Confront your Sexism" (Përballo me seksizmin tënd). National Post, 18 prill. <http://news.nationalpost.com/full-comment/michelle-rempel-confront-your-sexism>
104. Rojas, Maria Eugenia, 2012. Acoso y violencia política en contra de mujeres autoridades públicas electas en los gobiernos locales - municipales en Bolivia. ONU Mujeres-ACOBOL-AECID. <http://americalatinagenera.org>
105. Secretaria de Gobernación and Consejo Nacional para Prevenir la Discriminación (SEGEB/CONAPRED), 2016.
106. Guía para la Acción Pública: Elecciones sin discriminación. Qyteti i Meksikës.
107. Sirajuddin, 2015. "PK-95: A Short-Lived Victory for Hopeful Female Voters in Lower Dir." (Një fitore jetëshkurtër për votueset gra në Dirin e Poshtëm) 18 qershor. <http://www.dawn.com/news/1188981>
108. Smith, Samuel, 2015. "KB: ISIS Killing Educated

- Women, Especially Politicians.”(ISIS vret gratë e arsimuara, veçanërisht ato politikane) Christian Post. <http://www.christianpost.com/news/un-isis-killing-educated-women-especially-politicians-already-killed-3-female-lawyers-this-month-132915/#BmS8bDvpGZFaKzbl.99>
109. Partneriteti Ndërkombëtar i Azisë së Jugut (SAP), dhjetor 2006. Violence Against Women in Politics Surveillance System Guidebook (Udhëzuesi për sistemin e mbikëqyrjes së dhunës ndaj grave në politikë) [http://peacewomen.org/sites/default/files/PartPol-VAW\\_Surveillance\\_SAPI-VAWP\\_2007\\_0.pdf](http://peacewomen.org/sites/default/files/PartPol-VAW_Surveillance_SAPI-VAWP_2007_0.pdf)
  110. SAP International dhe International IDEA, 2008. Women, Representation and Violence: Exploring Constituent Assembly Election in Nepal. (Gratë, përfaqësimi dhe dhuna: eksplorimi i zgjedhjeve parlamentare në Nepal.) Gusht. <http://iknowpolitics.org/sites/default/files/vawip-report.pdf>
  111. SAP International, International IDEA dhe UN Women, 2007. Declaration of the South Asian Regional Conference on the Invisible Faces of Violence on Women in Politics: Breaking the Silence (Deklarata e Konferencës Rajonale të Azisë Jugore për Fytyrat e padukshme të dhunës ndaj grave në politikë)(Deklarata e Kathmandusë).
  112. Kathmandu, Nepal, 18 – 20 shtator. [http://download.idea.int/asia\\_pacific/upload/Kathmandu\\_Declaration\\_On\\_Violence\\_Against\\_Women\\_in\\_Politics.pdf](http://download.idea.int/asia_pacific/upload/Kathmandu_Declaration_On_Violence_Against_Women_in_Politics.pdf)
  113. Shoqata e Azisë së Jugut për Bashkëpunim Rajonal (SAARC), Maj 1997. Convention on Preventing and Combating Trafficking in Women and Children for Prostitution (Konventa për Parandalimin dhe luftimin e trafikut të grave dhe fëmijëve për prostitucion). <http://www.saarc-sec.org/userfiles/conv-trafficking.pdf>
  114. Stephen, Chris, 2014. “Libya in shock after murder of human rights activist Salwa Bugaighis.” (Libia e shokuar pas vrasjes së aktivistes së të drejtave të njeriut Salwa Bugaighis)The Guardian, 26 qershor. <https://www.theguardian.com/world/2014/jun/26/libya-shock-murder-human-rights-activist-salwa-bugaighis-benghazi>
  115. Tamang, Leena Rikkila, 2012. “Elections in Nepal remain vulnerable to violence.” (Zgjedhjet në Nepal ende të prekshme nga dhuna) International IDEA, 9 tetor. <http://www.oldsite.idea.int/elections/elections-in-nepal-remain-vulnerable-to-violence.cfm>
  116. Trabelsi, Meriem, 2016. “Half of Labour’s female councillors in Glasgow to quit ‘macho’ council” (Gjysma e këshilltareve laburiste gra në Glasgow japin dorëheqjen nga këshilli ‘maskilist’) iKNOW Politics, 16 qershor. <http://iknowpolitics.org/en/news/world-news/half-labours-female-councillors-glasgow-quit-macho-council>
  117. Tristan, Flora/Centro de la Mujer Peruana, 2015. “Las Mujeres Rurales Dijeron NO a la Violencia de Genero.” 27 nëntor. [http://www.flora.org.pe/web2/index.php?option=com\\_content&view=article&id=685:mujeres-rurales&catid=55:desarrollo-rural&Itemid=70](http://www.flora.org.pe/web2/index.php?option=com_content&view=article&id=685:mujeres-rurales&catid=55:desarrollo-rural&Itemid=70)
  118. Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), 2009. “Report of the International Commission of Inquiry Mandated to Establish the Facts and Circumstances of the Events of 28 September 2009 in Guinea.” (Raport i Komisionit Ndërkombëtar të Hetimit për të Zbuluar Faktet dhe Rrethanat në Ngjarjet e 28 shtatorit 2009 në Guinea). UN doc. S/2009/693. 18 dhjetor.
  119. OKB, 2006. Ending violence against women: From Words to Action. (T’i japim fund dhunës ndaj grave: Nga fjalë në vepra) Studim nga Sekretari i Përgjithshëm. [http://www.un.org/womenwatch/daw/public/VAW\\_Study/VAWstudyE.pdf](http://www.un.org/womenwatch/daw/public/VAW_Study/VAWstudyE.pdf)
  120. OKB, 1995. Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim, miratuar në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë. 27 tetor. <http://www.refworld.org/docid/3dde04324.html>
  121. OKB/Departamenti i Çështjeve Politike (DPA), 2016. Policy Directive on Preventing and Mitigating Election-related Violence (Direktiva e Politikave të OKB-së mbi Parandalimin dhe Zbutjen e Dhunës lidhur me Zgjedhjet)
  122. OKB/DPA, 2013. Promoting Women’s Electoral and Political Participation through UN Electoral Assistance (Promovimi i pjesëmarrjes zgjedhore dhe politike të grave nëpërmjet asistencës zgjedhore të Kombeve të Bashkuara). Direktivë Politikash, 14 dhjetor. [http://toolkit-elections.unteamworks.org/?q=webfm\\_send/520](http://toolkit-elections.unteamworks.org/?q=webfm_send/520)
  123. Komisioni i Kombeve të bashkuara mbi Statusin e Grave (CSW), 2013. Raporti për seancën e pesëdhjetë e shtatë. Shtojca Nr. 7, 4-15 mars. [http://www.un.org/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=E/2013/27](http://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=E/2013/27)
  124. Departamenti i Kombeve të Bashkuara për

- Çështjet Ekonomike dhe Sociale (DESA) (n.d.). Sustainable Development Goal Knowledge Platform (Platforma e njohurive për qëllimin e zhvillimit të qëndrueshëm) <https://sustainabledevelopment.un.org/sdgs>
125. UN DESA, 2014. ST/ESA/STAT/SER.F/110. Guidelines for Producing Statistics on Violence against Women: Statistical surveys (Udhëzime për Prodhimin e Statistikave mbi Dhunën ndaj Grave: Anketa statistikore) [http://unstats.un.org/unsd/gender/docs/Guidelines\\_Statistics\\_VAW.pdf](http://unstats.un.org/unsd/gender/docs/Guidelines_Statistics_VAW.pdf)
  126. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), 2014. Promoting Gender Equality in Electoral Assistance: Lessons Learned in Comparative Perspective. Country Report for Burundi (Promovimi i barazisë gjinore në asistencën zgjedh.ore: Mësimet e nxjerra në pikëpamje krahasuese. Raport mbi shtetin e Burundit).
  127. UNDP, 2012. Letër prezantimi për Dhunën politike ndaj grave, përgatitur nga Jeff Fischer-i, e papublikuar
  128. UNDP, 2011. "Understanding Electoral Violence in Asia." (Të kuptuarit të dhunës zgjedhore në Azi) [http://www.undp.org/content/undp/en/home/ourwork/democraticgovernance/global\\_programmes/global\\_programmeforelectoralcyclesupport/high-lights/undp\\_study\\_on\\_understandingelectoralviolenceinasia.html](http://www.undp.org/content/undp/en/home/ourwork/democraticgovernance/global_programmes/global_programmeforelectoralcyclesupport/high-lights/undp_study_on_understandingelectoralviolenceinasia.html)
  129. UNDP, 2009a. Elections and Conflict Prevention: A Guide to Analysis, Planning, and Programming (Zgjedhjet dhe parandalimi i konfliktit: Udhëzues për analizimin, planifikimin dhe programimin) [http://content-ext.undp.org/aplaws\\_publications/2431678/Elections-Conflict-Prevention.pdf](http://content-ext.undp.org/aplaws_publications/2431678/Elections-Conflict-Prevention.pdf)
  130. UNDP, 2009b. Shënime udhëzuese: Gender-Based Violence in Crisis and Post-Crisis Settings (Dhuna me bazë gjinore në rrethana krize dhe pas krize) nëntor. <http://www.undp.org/content/dam/undp/library/gender/Gender%20and%20CPR/Guidance%20Note-%20Gender-based%20Violence%20in%20Crisis%20and%20Post-Crisis%20Settings.pdf>
  131. UNDP, 2005. Gender Mainstreaming in Practice: A Handbook (Integrimi Gjinator në Praktikë: Doracak). Bot. 2-të [http://www1.uneca.org/Portals/ngm/Documents/Gender%20Mainstreaming/Gender\\_Mainstreaming\\_in\\_PracticeRBC.pdf](http://www1.uneca.org/Portals/ngm/Documents/Gender%20Mainstreaming/Gender_Mainstreaming_in_PracticeRBC.pdf)
  132. UNDP dhe NDI, shkurt 2012. Empowering Women for Stronger Political Parties: A Guide to Promote Women's Political Participation (Fuqizimi i grave për parti më të forta politike: Një udhëzues për promovimin e pjesëmarrjes politike të grave). <https://www.ndi.org/files/Empowering-Women-Full-Case-Study-ENG.pdf>
  133. UNDP dhe Fondi i Zhvillimit për Gratë i Kombeve të Bashkuara, 2007. "Policy briefing paper: Gender Sensitive Police Reform in Post Conflict Societies." (Dokument përmbledhës politikash: Reforma me ndjeshmëri gjinore e policisë në shoqëritë paskonfliktit) [http://www2.unwomen.org/-/media/headquarters/media/publications/unifem/gendersensitivepolicereformpolicybrief2007\\_eng.pdf?v=1&d=20140917T101012](http://www2.unwomen.org/-/media/headquarters/media/publications/unifem/gendersensitivepolicereformpolicybrief2007_eng.pdf?v=1&d=20140917T101012)
  134. UNDP, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (UNHCR), Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), UN Women, etj. (n.d.). "Gender-Based Political Violence: Bolivia." (Dhuna politike me bazë gjinore: Bolivia) në Advancing Gender Equality: Promising Practices (Avancimi i Barazisë Gjinore: Praktika premtuese) [http://www.unwomen.org/mdgf/downloads/MDG-F\\_Bolivia\\_C.pdf](http://www.unwomen.org/mdgf/downloads/MDG-F_Bolivia_C.pdf)
  135. UNDP dhe UN Women, 2015. Inclusive Electoral Processes: A Guide for Electoral Management Bodies on Promoting Gender Equality and Women's Participation (Procese zgjedhore përfshirëse: Udhëzues për Organet e Menaxhimit të Zgjedhjeve për promovimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave). Nju Jork.
  136. Këshilli Ekonomik dhe Social i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (ECOSOC), 2016 E/CN.3/2016/2/Rish.1. Report of the Inter-Agency and Expert Group on Sustainable Development Goal Indicators (Raport i grupit ndër-agjencor dhe ekspertëve për treguesit e qëllimit të zhvillimit të qëndrueshëm). 8-11 mars. <http://unstats.un.org/unsd/statcom/47th-session/documents/2016-2-SDGs-Rev1-E.pdf>
  137. Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara, Korrik 2013. Media and Elections Journal (Revista e Mediave dhe Zgjedhjeve). Nr. 1. <http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/FIELD/Amman/pdf/UNESCOE.pdf>
  138. Asambleja e Përgjithshme e Organizatës

- së Kombeve të Bashkuara (UNGA), 2015, A/RES/70/1. Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development (Transformimi i botës sonë: Axhenda e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm), 25 shtator. <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>
139. UNGA, 2011, A/66/130. Resolution on Women and Political Participation (Rezolutë për gratë dhe pjesëmarrjen politike), 19 dhjetor. [http://www.un.org/en/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=%20A/RES/66/130](http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=%20A/RES/66/130)
  140. UNGA, 2010, A/HRC/14/24/Add.6. Report of the Special Rapporteur on Extrajudicial, Summary or Arbitrary Killing– Election-Related Violence and Killings (Raport i Raportuesit special mbi vrasjet jashtëgjyqësore, ekzekutimet pa gjyq dhe ato arbitrare - Dhuna dhe Vrasjet në Zgjedhje). <http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrcouncil/docs/14session/A.HRC.14.24.Add6.pdf>
  141. UNGA, 2006, A/61/122/Add.1. In-Depth Study on All Forms of Violence against Women: Report of the Secretary General (Studim i hollësishëm mbi të gjitha format e dhunës ndaj grave: Raport i Sekretarit të Përgjithshëm), 6 korrik. <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N06/419/74/PDF/N0641974.pdf?OpenElement>
  142. UNGA, 1993, A/RES/48/104. Declaration on the Elimination of Violence against Women (Deklarata për Eliminimin e dhunës ndaj grave), 20 dhjetor. <http://www.refworld.org/docid/3b00f25d2c.html>
  143. UNGA, 1979, A/RES/34/180. Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women (Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave), 18 dhjetor. <http://www.refworld.org/docid/3b00f2244.html>
  144. UNGA, 1966. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Politike dhe Civile, në Serinë e Pakteve të Kombeve të Bashkuara, Vëll. 999, 16 dhjetor. 999, 16 dhjetor. <http://www.refworld.org/docid/3ae6b3aa0.html>
  145. UNGA, 1952, A/RES/640(VII). Konventa e të Drejtave Politike të Grave, 20 dhjetor. <http://www.refworld.org/docid/3ae6b3b08.html>
  146. UNGA, 1948, 217 A (III). Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor. <http://www.refworld.org/docid/3ae6b3712c.html>
  147. Fondi për Popullsinë i OKB-së (UNFPA), UNHCR, UNICEF et al. (n.d.). Gender-Based Violence Information Management System (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për dhunën me bazë gjinore). <http://www.gbvim.com/what-is-gbvims/>
  148. Këshilli i Sigurisë i OKB-së (UNSC), 2010. S/2010/608. Seventh report of the Secretary-General on the United Nations Integrated Office in Burundi (Raporti i shtatë i Sekretarit të Përgjithshëm për Zyrën e Integruar të Kombeve të Bashkuara në Burundi), 30 nëntor. <http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/burundi%20s-2010-608.pdf>
  149. UNSC, 2000. S/RES/1325. Rezoluta Nr. 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, 31 tetor. <http://www.refworld.org/docid/3b00f4672e.html>
  150. UNWomen, (n.d.). "Glossary of Terms from Programming Essentials and Monitoring and Evaluation Sections." (Fjalorthi i termave nga pikat kyçe të programimit dhe seksionet e monitorimit dhe matjes). Virtual Knowledge Center to End Violence against Women and Girls (Qendra virtuale e njohurive për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave) <http://www.endvawnow.org/en/articles/347-glossary-of-terms-from-programming-essentials-and-monitoring-and-evaluation-sections.html>
  151. UN Women, (n.d.). Final Project Report: Support to Sudanese Women's Effective Participation in the 2010 Elections (Raporti Përfundimtar për Projektin: Mbështetje për pjesëmarrjen e efektshme të grave sudaneze në zgjedhjet e vitit 2010).
  152. UN Women, 2015. Summary Report: The Beijing Declaration and Platform for Action Turns 20. (Raport përmbledhës: Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit bën 20 vjeç). <http://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/02/beijing-synthesis-report>
  153. UN Women, 2015a. A Framework to Underpin Action to Prevent Violence Against Women (Një kuadër për përkrahjen e parandalimit të dhunës ndaj grave). <http://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2015/11/prevention-framework>
  154. UN Women, 2012. Violence against Women Prevalence Data: Surveys by Country (Të dhëna mbi prevalencën e dhunës ndaj grave: Sondazhet sipas vendeve). Mbledhur nga UN Women,

- dhjetor. [http://www.endvawnow.org/uploads/browser/files/vawprevalence\\_matrix\\_june2013.pdf](http://www.endvawnow.org/uploads/browser/files/vawprevalence_matrix_june2013.pdf).
155. UN Women dhe Qendra për Kërkime Shoqërore, 2014. Violence against Women in Politics: A study conducted in India, Nepal and Pakistan (Dhuna ndaj grave në politikë: Studim i kryer në Indi, Nepal dhe Pakistan), Indi. <http://iknowpolitics.org/sites/default/files/vawip-report.pdf>
  156. UN Women/Marco, Derrick, 2011. A Toolkit for Managing and Preventing Political Violence against Women (PVAW) in Africa (Paketë masash për menaxhimin dhe parandalimin e dhunës politike ndaj grave (PVAW) në Afrikë). I pa botuar.
  157. UN Women /Sen, Purna, 2016. "Global Perspectives on Violence against Women in Politics," (Pikëpamjet botërore për dhunën ndaj grave në politikë) prezantuar në Konferencën e National Democratic Institute for International Affairs (Instituti Demokratik Kombëtar për Çështjet Ndërkombëtare) #NotTheCost : Stopping Violence against Women in Politics (Dhënia fund e dhunës ndaj grave në politikë). Mars, Nju Jork.
  158. UN Women, UNDP dhe Unioni i Telekomunikacionit Ndërkombëtar, 2015. Cyber Violence against Women and Girls: A World-Wide Wake-Up Call (Dhuna kibernetike ndaj grave dhe vajzave: një thirrje mbarëbotërore për ndërgjegjësim). Raport nga The UN Broadband Commission for Digital Development Working Group. [http://www2.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2015/cyber\\_violence\\_gender%20report.pdf?v=1&d=20150924T154259](http://www2.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2015/cyber_violence_gender%20report.pdf?v=1&d=20150924T154259)
  159. UN Women et al. 2017. Electoral Gender Based Violence Training Facilitators Manual (Manuali i Trajnimit të Lehtësuesve mbi Dhunën me Bazë Gjinore), projekt i përshtatur i manualit të punës. I pa botuar.
  160. UN Women Pakistan, 2016. Creating an Enabling Environment for Women's Political Participation: Ending violence against women in political and electoral processes (Krijimi i një mjedisi mundësues për pjesëmarrjen politike të grave: Dhënia fund e dhunës ndaj grave në proceset politike dhe zgjedhore) I pa botuar.
  161. Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), janar 2013. "Best Practices in Electoral Security: A Guide for Democracy, Human Rights and Governance Programming." (Një Praktikë me të mira për sigurinë në zgjedhje: Udhëzues për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe programimin e qeverisjes) [https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/2496/Electoral\\_Security\\_Best\\_Practices\\_USAID.pdf](https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/2496/Electoral_Security_Best_Practices_USAID.pdf)
  162. USAID, mars 2010. "Electoral Security Assessment: Bangladesh, Zimbabwe, and Colombia" (Matja e sigurimit në zgjedhje: Bangladeshi, Zimbabve dhe Kolombi) <http://41pylqn86jp37e3n04us8vqq.wpengine.netdna-cdn.com/wp-content/uploads/2003/01/Creative-Electoral-Threat-Assessment-Pilot-Version-Final.pdf>
  163. USAID, 2010. Electoral Security Framework, Technical Guidance Handbook for Democracy and Governance Officers (Kudri i Sigurisë në zgjedhje, manual udhëzues teknik për nëpunësit e demokracisë dhe qeverisë). Korrik. <https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1866/1-Electoral-Security-Framework.pdf>
  164. Wafa, Dawood, 2004. "Blast Kills 2 Female Poll Workers in Afghanistan." (Shpërthimi vret dy punonjëse të qendrës së votimit në Afganistan) Reuters, 27 qershor. [www.arabnews.com/node/251634](http://www.arabnews.com/node/251634)
  165. Wanyeki, L. Muthoni, 2008. "Lessons from Kenya: Women and the Post-Election Violence." (Mësime nga Kenia: Gratë dhe dhuna paszgjedhore) Feminist Africa. [http://agi.ac.za/sites/agi.ac.za/files/fa\\_10\\_standpoint\\_2.pdf](http://agi.ac.za/sites/agi.ac.za/files/fa_10_standpoint_2.pdf)
  166. Winrock International, 2001. Prevention of Domestic Violence and Trafficking in Humans, Training Manual (Manual trajnues për parandalimin e dhunës në familje dhe trafikimit njerëzor). Kiev, Ukrainë. <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?rep=rep1&type=pdf&doi=10.1.1.216.5682>
  167. OBSH, 2009 "Why engage men in the fight to end violence against women and girls?" (Përse duhen angazhuar burrat në luftën për t'i dhënë fund luftës ndaj grave dhe vajzave?) [http://apps.who.int/gender/topics/why\\_engage\\_men/en/index.html](http://apps.who.int/gender/topics/why_engage_men/en/index.html)
  168. OBSH, Departamenti i Shëndetit Riprodhues dhe Kërkimit; Shkolla Londineze e Higjienës dhe Mjekësisë Tropikale, dhe Këshilli i Kërkimeve Mjekësore i Afrikës së Jugut, 2013. Global and regional estimates of violence against women: prevalence and health effects of intimate



partner violence and non-partner sexual violence (Përlllogaritjet botërore dhe rajonale të dhunës ndaj grave: prevalenca dhe efektet shëndetësore të dhunës seksuale nga partneri dhe jopartneri). [Http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/85239/1/9789241564625\\_eng.pdf](http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/85239/1/9789241564625_eng.pdf)

169. ZESN, 2015. Policy Brief: Challenges in Attaining Gender Balance in Elections in Zimbabwe. (Dokument politikash: Sfidat në arritjen e balancës gjinore në zgjedhjet në Zimbabve). <http://www.zesn.org.zw/wp-content/uploads/2016/10/policybrief.pdf>





*“ Ky Udhëzues  
përqendrohet në  
epideminë e dhunës  
ndaj grave në zgjedhje.  
Ai paraqet veprime të  
ndryshme programimi  
për zbutjen e saj dhe  
garantimin që gratë të  
mund të ushtrojnë të  
drejtat e tyre politike. ”*

